

ASLLAN HAMITI

**NDIHMESAT E DISA  
GJUHËTARËVE PËR  
SHQIPEN**

Shkup, 2021

**Redaktor:**

Prof. dr. Ajten Qamili

**Recensues:**

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

Doc. dr. Farketa Dibra - Zeqiri

Përpunimi teknik: Ordançe Petrov

Shtëpia botuese: Stobi Trejd

**© Autori**

Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë mjet apo në asnjë formë (as me fotokopje), pa lejen me shkrim të autorit.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент  
Охридски", Скопје

811.18'374

811.18'373

81-115

НАМИТИ, Asllan

Ndihmesat e disa gjuhëtarëve për shqipen / Asllan Hamiti. - Shkup :  
Stobi Trejd, 2021. - 250 стр. ; 25 см : илустр.

Фусноти кон текстот. - Библиографија кон главите

ISBN 978-608-4767-33-6

а) Албански јазик -- Лексикографија б) Албански јазик --  
Лексикологија

в) Компаративна лингвистика

COBISS.MK-ID 55543045



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Kulturës

**Libri u botua me përkrahjen financiare të Ministrisë së  
Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

## PËRMBAJTJA

Parathënie .....	5
1. LEKSIKOGRAFI, LEKSIKOLOGJI, GJUHËSI KRAHASUESE.....	7
1.1. Gjorgji Pulevski dhe dy Fjalorët shumëgjuhësh të tij .....	7
1.2. Alfabeti cirilik i Pulevskit .....	27
1.3. Tiparet gjuhësore të tekstit shqip të fjalorëve të Pulevskit .....	36
1.4. Vëzhgime për shqipen e përkthyer në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit .....	45
1.5. Leksikografia shqip-maqedonisht e anasjelltas .....	72
1.6. Fjalori shqip-maqedonisht i prof. Haki Ymerit .....	85
1.7. Ndhimesa të akad. Jani Thomait në fushën e leksikut dialektor.....	93
1.8. Ngjashmëri fonetike e fonologjike të shqipes me maqedonishten .....	109
2. GJUHA E VEPRAVE LETRARE.....	119
2.1. Funkzioni i letërsisë për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së gjuhës .....	119
2.2. Gjatësia e zanoreve në “Gjellën e Shën Mëris s’virgjër“ të Jul Varibobës .....	124
2.3. Vlera ekspresive-impresive e tingujve në poezinë “Anës lumenjve” dhe “Rent, or Marathonomak” të Fan Nolit .....	134
2.4. Gjuha e Josif Bagerit dhe e folmja e Rekës së Dibrës .....	144

3. PRURJE ALBANOLOGJIKE.....	157
3.1. Ndihmesa e prof. Eqrem Çabejt në studimin e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët sllave.....	157
3.2. Studimet e prof. Selman Rizës për fonetikën dhe drejtshkrimin e shqipes .....	166
3.3. Ndihmesa e prof. Shaban Demirajt për ballkanologjinë .....	174
3.4. Veprimtaria shumëplanëshe e akademik Idriz Ajetit .....	185
3.5. Profesor Remzi Nesimi rroi për të jetuar .....	199
3.6. Profesor Remzi Nesimi – studiues i të folmeve shqipe në Maqedoni .....	217
3.7. Ndihmesa e profesor Tomor Osmanit për shqipen standarde .....	228
3.8. Profesor Xhevat Gega – gojëtar i shquar.....	235
3.9. Prof. dr. Imri Badallaj – pedagog dhe albanolog.....	240

## PARATHËNIE

Libri “Ndihmesat e disa gjuhëtarëve për shqipen” përmban trajtesa të përzgjedhura, të prezantuara në konferenca shkencore ndërkombëtare albanologjike, të mbajtura në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut e të botuara në revista përkatëse në shqip, maqedonisht ose në anglisht gjatë një periudhe të gjatë kohore.

Një punë e tillë e përzgjedhjes së artikujve dhe e botimit të tyre në një libër ka qenë, është e do të jetë praktikë e nevojshme dhe e dobishme jo vetëm për pasqyrimin e veprimtarisë hulumtuese të ndonjë autori, por edhe për t’ia paraqitur lexuesit në një vend shtjellimet tematike, për ta njoftuar atë me përpjekjet kërkimore, përshirë jo vetëm atë që është thënë, por edhe ndonjë prurje të re në zhvillimin e mendimit shkencor. Ndonjëherë edhe në punime të shkurtra mund të gjejmë gjëra të vlefshme, sidomos për hulumtuesit e rinj.

Kjo përmbledhje trajtesash përfshin 21 punime sistemuar në tre krerë tematikë: 1. Leksokografi, leksikologji, gjuhësi krahasuese; 2. Gjuha e veprave letrare; 3. Prurje albanologjike.

Në **kreun e parë** kemi përfshirë këto tema: Gjorgji Pulevski dhe dy Fjalorët shumëgjuhësh të tij. Alfabeti cirilik i Pulevskit. Tiparet gjuhësore të tekstit shqip të fjalorëve të Pulevskit. Vëzhgime për shqipen e përkthyer në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit. Leksikografia shqip-maqedonisht e anasjelltas. Fjalori shqip-maqedonisht i prof. Haki Ymerit. Ndihmesa të akad. Jani Thomait në fushën e leksikut dialektor. Ngjashmëri fonetike e fonologjike të shqipes me maqedonishten.

Në **kreun e dytë** kemi trajtuar këto tema: Funkzioni i letërsisë për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së gjuhës. Gjatësia e zanoreve në “Gjellën e Shën Mëris s’virgjër“ të Jul Varibobës. Vlera ekspresive-impresive e tingujve në poezinë “Anës lumenjve” dhe “Rent, or Marathonomak” të Fan Nolit. Gjuha e Josif Bagerit dhe e folmja e Rekës së Dibrës.

**Kapitullin e tretë** ia kemi kushtuar prurjeve albanologjike. Këtu përzgjedhëm trembëdhjetë tema që kanë të bëjnë me punën madhore të gjuhëtarëve tanë të mëdhenj: Ndihmesa e prof. Eqrem Çabejt në studimin e marrëdhënies të shqipes me gjuhët sllave. Studimet e prof. Selman Rizës për fonetikën dhe drejtshkrimin e shqipes. Ndihmesa e prof. Shaban Demirajt për ballkanologjinë. Veprimtaria shumëplanëshe e akademik Idriz Ajetit. Profesor Remzi Nesimi rroi për të jetuar. Profesor Remzi Nesimi – studiues i të folmeve shqipe në Maqedoni. Ndihmesa e profesor Tomor Osmanit për shqipen standarde. Profesor Xhevat Gega – gojëtar i shquar. Prof. dr. Imri Badallaj – pedagog dhe albanolog.

Falënderoj gjithë ata që ndihmuan daljen në dritë të këtij teksti: redaktorin, recensentët, përpunuesin teknik e shtëpinë botuese. Jam mirënjohës Ministrisë së Kulturës të Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbështetjen financiare të botimit të librit.

Autori

# 1. LEKSIKOGRAFI, GJUHËSI KRAHASUESE

## 1.1. GJORGJI PULEVSKI DHE DY FJALORËT SHUMËGJUHËSH TË TIJ<sup>1</sup>

### Përmbledhje

Në këtë punim do të japim disa të dhëna të përgjithshme për jetën dhe veprimtarinë e Gjorgji Pulevskit, meqë në qarqet shkencore shqiptare është pak i njohur, si dhe të dhëna të përgjithshme për dy fjalorët shumëgjuhësh të tij: I. Fjalorin katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873; dhe II. Fjalorin bisedimor tregjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875.

### Summary

Georgi Pulevski and his two multilingualistic dictionaries. In this article we will introduce you with some general information about the life and the activity of Georgi Pulevski, as in scientific circles he is not well known the same is also about the general information for his two multilingual dictionaries: I. Vocabulary with four languages: Macedonian-Albanian-Turkish-Greek, Belgrade, 1873, and II. Trilingual conversational vocabulary: Macedonian-Albanian-Turkish, Belgrade, 1875.

**Fjalët çelës:** Pulevski, fjalor, shumëgjuhësi, shqip, maqedonisht

**Key words:** Pulevski, dictionary, multilingualism, Albanian, Macedonian

### Hyrje

Studimet filologjike zënë vend të posaçëm në albanologji. Deri më tani është shkruar për gjuhën e shumë shkrimtarëve tanë të

---

<sup>1</sup> Kumtesë inja (e përditësuar) e botuar në përmbledhjen e punimeve të Revistës Shkencore ANAS nr. 3-4, Institutit Alb-Shkenca, Shkup, 2014, f. 95-110.

traditës. Megjithkëtë edhe më tej duhet vazhduar studimi dhe analiza e teksteve të shkruara. Rezultatet e arritura do të jenë dobiprurëse dhe do të ndriçonin shumë çështje të historisë së gjuhës së shkruar, zhvillimit të dialekteve dhe do të ishin të vlefshme për kulturën tonë në përgjithësi. Puna e tillë do të japë rezultate shumëdimensionale, veçmas kur kihet parasysh se shqipja është gjuhë e folur shumë herët, por mjerisht vonë e dokumentuar.<sup>2</sup>

Vëzhgimin tonë për fjalorët e Pulevskit e kemi mbështetur mbi botimin në origjinal të të dy fjalorëve. Të dy fjalorët i kemi siguruar nga Biblioteka Popullore dhe Universitare e Shkupit me siglat: Fjalori katërgjuhësh: R II-1501/I, ndërsa Fjalori tregjuhësh me siglat: R II-1501/II dbl. Shih ballinat e tyre më poshtë:

<p style="text-align: center;"><b>Речникъ</b></p> <p style="text-align: center;"><b>ОТЪ ЧЕТИРИ ЈЕЗИКА.</b></p> <p style="text-align: center;">I. Српско-Албански. II. Арбански-Арнаутски. III. Турски. IV. Грчки.</p> <p style="text-align: center;">СКОРЈЕНА И НАПИСАНА ОТЪ</p> <p style="text-align: center;"><b>БОРЪА М. ПУЛЪВСКИ,</b> АРХИТЕКТА У ГАЛИЧНИКЪ ОКОЛУЈЕ ДИБРАНСКО 1872. ГОДИНЕ.</p> <p style="text-align: center;"><b>I-ва ЧАСТЪ.</b></p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;">БЕОГРАДЪ, ШТАМПАРИЈА Н. СТЕФАНОВИЊА И ДРУЖИНЕ, 1873. Факсимил I</p> <p style="text-align: center;"><b>a</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>РЕЧНИК</b></p> <p style="text-align: center;"><b>ОТЪ ЧЕТИРИ ЈЕЗИКА.</b></p> <p style="text-align: center;">I. Српско-албански. II. Арбански-Арнаутски. III. Турски. IV. Грчки.</p> <p style="text-align: center;">Скројена и написана отъ <b>БОРЪА М. ПУЛЪВСКИ,</b> архитекта у Галичникъ, околује дибранско, 1872 године. I-ва ЧАСТЪ.</p> <p style="text-align: center;"><b>БЕОГРАДЪ.</b> Штампарія Н. Стефановића и Дружине 1873.</p> <p style="text-align: center;"><b>b</b></p>
--	---

1. *Ballina e Fjalorit Katërgjuhësh*: a) origjinali, b) e rishkruar me të njëjtin alfabet.

<sup>2</sup> Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, f. 8.



**РЕЧНИК  
ОТ ÇETIRI JEZIKA.**


- I. Srpsko-allbanski.
- II. Arbanski-Arnautski.
- III. Turski.
- IV. Grçki.

Skrojena i napisana ot  
**GJORGJA M. PULEVSKI,**  
arhitekta u  
Galiçnik, okružhje dibransko,  
1872 godine.  
I-va ÇAST.  
**BEOGRAD.**

Shtamparija N. Stefanoviça i Družhine  
1873.

c

2. Ballina e Fjalorit Katërgjuhësh: c) e tejshkruar (e transliteruar) me alfabetin e shqipes



a

9

<b>РЕЧНИК</b>	<b>FJALTOR</b>
ОД ТРИ ЈЕЗИКА	NKA TRE G'JUHA
С. МАКЕДОНСКИ	SHKINISHT MAKEDONISE
АРБАНСКИ	SHKIP
И	EDHE
ТУРСКИ	TURQISH
КЊИГА II.	Liberti II
НАПИСАО	EKASHRUU
ЂОРЂЕ М. ПУЛЕВСКИ.	GJORGJI PULES.
МИЈАК ГАЛИЧКИ,	MIJAK GALIÇKI,
У БЕОГРАД	U BEOGRAD
У ДРЖАВНОЈ ШТАМПАРИЈИ	U DRZHAVNOJ SHTAMPARIJI
1875	1875
<b>b</b>	<b>c</b>


3. *Ballina e Fjalorit Tregjuhësh*: a) origjinali, b) paralelja në maqedonisht e rishkruar, c) paralelja në shqip e tejshkruar

### **1. Të dhëna biografike për autorin (1817-1893)**

Gjorgji (emrin e të cilit e gjejmë të shënuar në disa variante: Gjorgjo, Gjorgjija, Gjorgje, Gjergj; dhe me mbiemrin Pulevski e Pula) ishte leksikograf, poet, historian, mbledhës i folklorit, gramatikan dhe luftëtar i dalluar kundër perandorisë Osmane për çlirimin e popujve të robëruar. Në bazë të shënimeve të gjetura, por edhe sipas asaj që vetë autori ka shkruar në fjalorë, del se Pulevski ka qenë autodidakt, me profesion murator, ose siç parapëlqente ta quante veten - arkitekt.

Lindi në Galiçnik më vitin 1817, katund i Rekës së Vogël në qarkun e Dibrës (Конески, 1961: 25; Ристовски, 1974: 5).

Vetëdija për përkatësinë kombëtare te banorët e Rekës ka qenë dhe ende është mjaft e zbehur. Përgjithësisht, banorët e kësaj ane njohin dy e më tepër gjuhë. Zaten, ka familje që në mënyrë të njëpasnjëshme përdorin disa gjuhë: shqip, maqedonisht, turqisht; por më shpesh dy të parat. Konfiguracioni tokësor malor, izolimi nga pjesët e tjera, por me kontakte të brendshme të zonës së Mjakut; martesat e përziera, mund të jenë disa ndër faktorët e gjendjes së këtillë. Luhatjes dhe paqartësisë së përkatësisë kombëtare të popullatës së kësaj ane ndonjëherë i vjen në ndihmë përkatësia fetare. Kështu, ata që e ndjejnë veten myslimanë deklarohen për shqiptarë, ndërkaq ortodoksët për maqedonë. Me sa duket, rast i njëjtë është edhe me Pulevskin, i cili veten e shënon edhe si Gjergj Pula. Për faktorët sociolinguistikë të kësaj çështjeje kanë shkruar disa autorë. Mirëpo, me gjasë, shpjegim më të mirë jep Muhamet Pirraku, kur thotë, veç tjerash, se sipas teorisë së qarqeve diplomatike serbe, në Kosovë (e në Jugosllavinë e dikurshme – shënim yni) nuk ka shqiptarë, por vetëm arnautë – serbë a sllavë të shqiptarizuar. Mbështetur në këtë pikëpamje u thellua dukuria e asimilimit të elementit shqiptar, veçmas të besimit ortodoks. Sllavizimit me anë të kishës, të gjuhës e të alfabetit iu nënshtruan sidomos shqiptarët ortodoksë të Rekës (Pirraku 1980: 191-199).



Sido që të jetë, duke u mbështetur në të dhënat për jetën dhe veprimtarinë e tij, - Pulevski lindi dhe vetëm fëmijërinë e hershme e kaloi në qarkun e Dibrës, ndërsa pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Beograd e Sofje. Mori pjesë aktive në luftën e bullgarëve dhe të rusëve kundër osmanlinjve. Nga tiparet gjuhësore hetohet se pati kontakte të shpeshta me shumë shqiptarë visesh të ndryshme. Megjithatë, pavarësisht nga etnogjeneza dhe mbi të gjitha nga shkrimet e tij, mund të thuhet se Pulevski nuk e ndjeu veten shqiptar.

Megjithkëtë, përkatësia nacionale e cilitdo njeri nuk është parësore, shumë më e rëndësishme është puna e tij. Për ne i vlefshëm është shkrimi i shqipes në dy fjalorët tre-katër gjuhësh. Andaj, si çdo vepër e shkruar në shqip, edhe teksti i Pulevskit meriton një analizë gjuhësore.

Kushtet e vështira ekonomike, pozita e papërshtatshme gjeografike bënë që banorët e këtij qarku të jetojnë në varfëri. Prandaj,

afër 90% e meshkujve të Rekës, të aftë për punë, merrnin rrugën e kurbetit (Тодоровски, 1970: 66-69). Familja Pula e Rekës që nga të parat që shkoi për punë sezonale në vend të huaj. Kjo mënyrë e jetesës e përcolli edhe Gjergjin. I ati i Gjergjit ishte kurbetçi, murator në Rumani, në vendin e quajtur Turno-Mogurell. Njohësit e mirë të jetës dhe të veprimtarisë së Pulevskit thonë se ky e mori me vete të birin qysh atëherë kur Gjergji kishte vetëm shtatë vjet. Atje, nga mjeshtrit dhe shegertët i mësoi shkronjat. Supozohet se nevoja për të komunikuar me anë të letrave me të afërmit e vet dhe me familjen, e cila ende jetonte në Galiçnik, e motivoi Pulevskin që të mësojë shkrim-leximin. Edhe pse nuk vijoi ndonjë shkollë të rregullt, pati vullnet të madh dhe interesim për vetësimim dhe ngritje të përgjithshme intelektuale. Ai u njoh me të kaluarën e popujve të Ballkanit, me gjuhën dhe kulturën ballkanike. Nga Rumania, në çerekun e parë të viteve të 70-ta të shekullit XIX, Pulevski do të gjendet në Beograd. Aty do të botojë dy fjalorët shumëgjuhësh për të cilët do të bëjmë fjalë në vijim.

Kontaktet e shumta të Pulevskit me patriotë nga vise të ndryshme mundësuan që edhe ai të frymëzohej me ide revolucionare e patriotike. Këtë e dëshmojnë, përveç shkrimeve edhe pjesëmarrja e tij e drejtpërdrejtë në shumë luftëra. Siç dihet, ai me një çetë bashkatdhetarësh, shumica nga regjioni i Mjakut, mori pjesë në luftën kundër osmanlive me rastin e rrethimit të kalasë së Beogradit (1862), me çrast garnizoni turk e bombardoi qytetin (Саздов 1985: 8). Pas përfundimit të luftës, nga qarqet serbe të Beogradit kërkoi të emërohet mësues në vendlindje. Meqë kjo dëshirë nuk i plotësohet, Pulevski shkoi në Sofje të Bullgarisë.

Ai me disa bashkëluftëtarë vullnetarë ishin pjesëmarrës në anën e rusëve në luftën ruso-turke (1877/78), duke u shquar në përleshjet e njohura në vendin e quajtur Shipka. Meqë u dallua për guxim e trimëri, nga perandori rus Aleksandër Nikollaeviq u dekorua me medalje për trimëri. Pulevski edhe kësaj here nga pushtetmbajtësit kërkoi ndonjë detyrë a punë, por nuk e fitoi (Конески, 1959: 87).

Do përmendur se Gjergji luftoi kundër Perandorisë Osmane si në territorin e Serbisë, ashtu edhe në tokat e Rusisë, duke menduar se njëherë nga këto troje duhet çrrënjosur sundimi osman e pastaj do të vijë koha kur edhe në Maqedoni dhe në pjesët e tjera të Ballkanit duhet zhvilluar një luftë e tillë. Ishte i mendimit se gjithë të robëruarit duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin, sepse vetëm të bashkuar do të mund të çliroheshin.

Nga skica jetësore e Pulevskit merret vesh se ai mori pjesë në kryengritjen e Kresnenit në Maqedoninë Lindore, që u bë në tetor të vitit 1878. Në këtë kryengritje ai ishte prijës i çetës VI dhe anëtar i Këshillit të Vojvodëve. Në vitin 1878 ka qenë prefekt i Qustendilit dhe ditët e fundit të jetës së tij i kaloi në Bullgari. Në vitin 1888 Pulevski ushtroi detyrën e kryetarit të Shoqërisë Letrare Sllavo-Maqedonase (“Славјанско-Македонска книжевна дружина”) me seli në Sofje.

Në pleqëri, larg nga vendlindja, vdiq më 13 shkurt të vitit 1893 në Sofje ku dhe u varros.

Siç shihet, jeta e Pulevskit sillej në trekëndëshin Maqedoni - Serbi - Bullgari. Jeta dhe orientimi i tij revolucionar, patriotik e luftarak do të shprehen edhe në shkrimet e tij. Me pendë e pushkë në dorë luftoi kundër robërisë shumëshekullore osmane dhe njëherit kontribuoi për bashkimin e popujve të shtypur në luftë të përbashkët kundër robëruesit të njëjtë.

Vetë fakti se shkroi dy fjalorë: njërin katërgjuhësh e tjetrin tregjuhësh flet bindshëm se ai ishte poliglot, përkatësisht dinte maqedonisht, serbisht, bullgarisht, shqip, greqisht e turqisht. Pulevski kishte mendim të drejtë se në kushtet e fqinjësisë e të bashkëjetesës në një territor të përbashkët, siç është Ballkani, duhej pasur një fqinjësi të mirë ndërmjet popujve dhe se njohja reciproke e gjuhëve, e kulturës e traditave është më se e nevojshme. Përveç kësaj, popujt kanë nevojë shumë të madhe për komunikim të drejtpërdrejtë, andaj duhet jetësuar dygjuhësia dhe shumëgjuhësia.

## 2. Bibliografia e Pulevskit

Në vazhdim po paraqesim bibliografinë e Pulevskit sipas radhitjes kronologjike. Duhet thënë se disa nga veprat e tij janë të njohura për opinionin, disa janë në dorëshkrim, por ka edhe të tilla që përmenden nga vetë autori, por për to nuk dihet asgjë. Ne do t'i shënojmë titujt në origjinal, e pastaj të përkthyer në shqip:

1. “Речник отъ четири језика: I. Српско-Албански. II. Арбански-Арнаутски. III. Турски. IV. Грчки. Скројена и написана отъ Ђорђа М. Пулѣвски, архитекта у Галичникъ, окружје дибранско, 1872 године. I-ва часть. Београдъ. Штампарія Н. Стефановића и Дружине, 1873”. Në përkthim të fjalëpërfjalshëm në shqip do të ishte: **Fjalor katërgjuhësh:**



I. serbisht-shqip. II. arbanisht-arnautisht. III. turqisht. IV. greqisht. Hartuar dhe shkruar nga Gjorgja M. Pulevski, arkitekt nga Galiçniku, qarku i Dibrës 1872. Botimi I. Beograd, Shtypshkronja e N. Stefanoviqit dhe e Shoqërisë, 1873. Sipas shqipes së sotme ky fjalor do të emërtohej si **Fjalor katërgjuhësh**: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873.

2. “Речник од три језика: С. Македонски, Арбански и Турски. Књига II. Написао Ђорђе М. Пулевски, мијак галички. У Београд, у државној штампарији, 1875.” Në përkthimin e bërë nga vetë autori në gjuhën shqipe shënon: “**Fjalor nka tre g-juha**: shkinisht - makedonise, shkip edhe turqish, liberti II,

ekashruu Gjorgji Pules.” Sipas shqipes standarde mund të themi se ky është **Fjalor tregjuhësh**: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875.

3. “Македонска песнарка I, II”, Софија 1879 (Këngëtore maqedonase I, II; Sofje 1879).

4. “Славјанско-насељениски-македонска слогница речовска за исправување правословски-језическо писание. III-та книга. Написал ју Ѓ. М. Пулевски. Основана на III-то одделение училишко, а напичатена пот на столателството Г. Угрини Џиков, трг. Галички от Албанија. 1880 година в Софија. Први дел” (Gramatika e popullsisë sllave-maqedonase për shkrimin e drejtë të fjalëve. Libri III. E shkroi Gj. M. Pulevski. Hartuar për klasën III të shkollës, ndërsa botuar nën përkujdesjen e zotëri Ugrina Xhikovit, tregtar i Galiçnikut të Shqipërisë. Viti 1880 në Sofje. Pjesa e parë).

Njohësit e jetës së këtij autori, thonë se Pulevski në dorëshkrim ka lënë këto vepra:

5. “Славјанскомакедонска општа историја за сви полострофски народности” (Historia e përgjithshme sllavomaqedonase

për të gjithë popujt e Gadishullit Ballkanik), tekst që thuhet se ka mbi 1600 faqe. Dorëshkrimi ruhet në Bibliotekën Popullore “Cirili dhe Metodi” të Sofjes.

Ky autor në *Gramatikën ...* pohon se ka përgatitur edhe disa libra të tjerë, që deri më sot nuk janë zbuluar, si:

- a) “Родословница” (Fond i pasur shkronjash dhe fjalësh);
- b) “II Граматика. Речница” (Gramatika II, Glosar);
- c) “Народна песнословница – Митологија” (Këngë popullore – mitologji);
- ç) “Смисленица – Лоѓика” (Logjika);
- d) “Буквар који је от четири језика: турски, словенски, латински и грчки” (Abetare në katër gjuhë: turqisht, sllavisht, latinisht, greqisht); dhe
- dh) “Обичаји и песни југословенски” (Zakone dhe këngë të sllavëve të jugut).

### 3. Punime të derisotme për veprimtarinë e Pulevskit

Për jetën dhe veprimtarinë e Gjorgji Pulevskit në gjuhën maqedonase e bullgare deri më tani janë shkruar disa artikuj e monografi. Por, përgjithësisht në gjuhën shqipe për të është shkruar pak, andaj e shohim të udhës që për lexuesit e interesuar shqiptarë të shënojmë bibliografinë e punimeve më të rëndësishme kushtuar këtij leksikografi popullor (Саздов 1985: 194-195):

Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.

Аслан Хамити, *Реципрочното влијание на македонскиот и албанскиот јазик во речницитѐ на Пулевски: Македонскиот јазик во XIX век*, Shkup, 1995: 215-222;

Аслан Хамити, *Албанскиот јазик во речницитѐ на Пулевски: Јазиците на почвата на Македонија*, МАНУ, Скопје, 1996: 177-185;

Asllan Hamiti, *Disa veçori fonetike dhe fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit*: Shqyrtime albanologjike 6, Shkup 2000: 161-176;



- А. П. Стоилов: “Фолклор V в. Марица” (1878-1885): Известија на Народнија етнографски музеј в Софија, 1926 год., VI, нр. 1-4: 27-28.
- Блаже Конески, *За јазикот на Пулевски – графиски, фонетски и фонолошки особености: Македонскиот од XIX век*, Култура, Скопје, 1986: 210-223;
- Блаже Конески, *Белешки за Пулевски (јазично и книжевно-историски прилози): Македонскиот IX век*, Култура, Скопје, 1986: 224-230;
- Блаже Конески, *Кон македонската прероба: Македонските учебници од XIX век*, Скопје, 1949: 87-97;
- Блаже Конески, *Македонистот Ѓорѓи (Ѓорѓо) Пулевски: Културен живот*, Скопје, 1961, VI, бр. 2: 25-26;
- Блаже Конески, *За македонскиот литературен јазик: Избрани дела во седум книги*. Култура, Скопје, 1967: 253-265;
- Блаже Конески, *Граматицата на Ѓ. Пулевски: Македонски јазик IV*, Скопје, 1953, 2: 45-47.
- Блаже Конески, *Ѓорѓи Пулевски: Литературен збор, XXV, книга 2*, Скопје, 1954.
- Блаже Конески – Оливера Јашар - Настева, *Балкански јазични паралели во речниците на Ѓорѓи Пулевски: Прилози IX 2*, МАНУ, Скопје, 1984: 57-63.
- Блаже Ристовски, *Ѓорѓија М. Пулевски: Одбрани страници*, Македонска книга (përzgjedhjem redaktim, parathënie dhe shënime), Shkup, 1974;
- Блаже Ристовски, *Ѓорѓија М. Пулевски и неговите книшки: “Самовила македонска” и “Македонска песнарка”*, Институт за фолклор I, Скопје, 1973;
- Блаже Ристовски, *Ѓорѓија М. Пулевски како поет и фолклорист: “Македонската народна и уметничка литература”*, Шести “Рацинови средби”, Титов Велес, 1969: 70-83;
- Блаже Ристовски, *Прилози кон истражувањето на македонските научно-литературни оруштва и афирмацијата на македонската*



- национална и државна мисла*: “Развиток на државноста на македонскиот народ”, Скопје, 1966: 171-188.
- Блаже Ристовски, *Појави и профили од македонската културна историја*, 2 дел, Студентски збор, Скопје, 1982;
- Блаже Ристовски, *Белешки за Пулевски*: Македонскиот XIX век, Јазично и книжевно-историски прилози, Скопје, 1986: 225-230.
- Д. Пановски, *Горѓија М. Пулевски*: Литературни портрети, Развитие, Битола, 1975: 105-117.
- Д. Лепчески, *Горѓе Пулевски*: Културен живот, Скопје, 1965, година X, бр. 6: 25-27.
- Г. Трајчев, *Книџа за миџациите* (Историско-географски очерк), Софија, 1941: 42.
- Georg Hazai, Rumeli ağızları tarihinin iki kaynağı üzerine: *Türk Dili Araştırmaları Yılığı Belleten*, 1963: 117-120 (TDK Yayınları 234).
- Х. Поленаковић, *Миџачки лексикограф Ђорђе М. Пулевски*: Глас Југа, Скопје, 1941: 30-32;
- Х. Поленаковић, *За граматиката на Пулевски*: Македонски јазик IV, 1953, бр. 8: 188-189.
- К. Шапкарев, *Народни песни и старини*, Марица, Пловдив, 13. 04. 1982 и 16. 04. 1882.
- М. Георгиевски, *Песнарките од Горѓи Пулевски*, Журнал, Скопје, 10. 10. 1970.
- Петро Јанура, *Значајот на делото на Горѓи Пулевски како претходник во културната преродба на Албанскиот народ*: Бигорски научно-културни собири, Научен собир I: 169-175.
- Петро Јанура, *Кирилицата во албанската писменост*: Литературен збор, бр. 6, Скопје, 1969.
- Оливера Јашар - Настева, *За речниците на Пулевски и албанската паралела во нив*: Прилози (kontributions), IX 2, МАНУ, Скопје, 1984: 43-56;
- Оливера Јашар - Настева, *Искажувањата на Горѓи Пулевски за*

- јазичната ситџација во Македонија: Јазичите на почвата на Македонија, МАНУ, Книга 3, Скопје, 1996: 33-51.*
- П. Драганов, *Етнографическиј очерк славјанској частии Македонии. Дебријане: Арнауто-Арбанаси и Албано-Мијаци: Известија С. Петербурга славјанскогo благотворителнагo обителства, С. Петербург, 1888, бр. 2: 89;*
- П. Драганов, *Македонско-славјанскиј сборник с ѓриложением словарииа. Редактура П. Драганов, Винуск I, С. Петербург, 1894: 230-234;*
- П. Драганов, *Дедо Георѓо Пулевски, Дебрски глас, Софија, 6. 05. 1911: 4.*
- П. Драганов, *Дедо Георѓо Пулевски, Македонија – Macedonia, Софија, 17. 06. 1911: 1.*
- Трајко Стаматоски, *“Слоџница речовска” – израз на националната свест на Пулевски: Нова Македонија, Скопје, 28. 12. 1980: 9;*
- Трајко Стаматоски, *Од историјата на македонската книжевност – “Грамаџика” израз на националната свест на Пулевски: Нова Македонија, Скопје, 28.12. 1980: 9;*
- Trajko Stamatovski, *Gjorgji Pulevski dhe gramatika e tij: Jehona, nr. 10, Shkup, 1987: 29-40;*
- Трајко Стаматоски, *Страници од историјата на нашиот јазик, Македонистичкиот Ѓорѓи Пулевски - автор на првата грамаџика на македонскиот јазик: Нова Македонија, бр. 3432. XI (04. 12. 1955): 5;*
- Трајко Стаматоски, *Кон графичкиот систем на Пулевски: Бигорски научно-културни средби, I, Науна средба, Гостивар, 21-22. 10. 1971, Скопје, 1973: 37-44;*
- Трајко Стаматоски, *Ѓорѓи Пулевски и неговата “Слоџница речовска: Македонски јазик XXXI, Скопје, 1980.*
- Томе Саздов, *Ѓорѓи Пулевски: Избрани текстови, Скопје, 1985;*
- Tome Sazdov, *Vepra e Gjorgji Pulevskit (1838-1895): Jehona, nr. 7, Shkup, 1984: 92-109.*
- С. Димевски, *Ѓорѓи Пулевски: Вечер, Скопје, 12-19. 06. 1971;*

- C. Димевски, *Две писма на Ѓорѓи Пулевски до браќата Бацовиќ од 1878/79*: Разгледи, година XIV, бр. 10, 1972, Скопје: 1130-1132.
- П. Чакар, *Нови откритија во случај 75-годишнината од смртта на Ѓорѓи Пулевски. Мијачкиот ѕидар – највиден македонистички учебникар*: Нова Македонија, Скопје, 25. 08. 1969 и 04. 09. 1969: 10.
- Т. Панговски, *Нов прилог кон издавањето на речникот на Ѓорѓи Пулевски во Белград*: Просветно дело, Скопје, 1965, XXI, бр. 7-8: 399-404.
- Т. Смиланиќ - Брадина, *Борбе М. Пулевски (Мијак јалички)*: Јужни преглед, Скопје, 1927, I, бр. 2-3: 61-65.
- Весна Матијашевиќ, *Јазикот на Ѓексировиќ на Ѓорѓи Пулевски* (punim magistrature, arkivi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, Shkup, 1992).
- Viktor Fridman, *Gjorgji Pulevski, fjalorët e tij dhe Rilindjet kombëtare Shqiptare e Maqedone*: Konferenca për 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, Prishtinë, 1978.

Pjesa më e madhe e punimeve të derisotme, që i shënuam në këtë bibliografi, bëjnë fjalë për paralelen e gjuhës maqedonase, më mirë të themi sllave, të fjalorëve, për vjershëzat e Pulevskit, për Gramatikën e tij, jetën, idetë revolucionare e patriotike të autorit. Për shqipen e fjalorëve tri-katër gjuhësh të Pulevskit është shkruar pak, edhe pse këta fjalorë janë shfletuar nga disa gjuhëtarë.

#### 4. Struktura e fjalorëve

Siç u tha edhe më parë, Gjorgji Pulevski ka shkruar, veç tjerash, edhe dy fjalorë shumëgjuhësh.

Nga vetë titujt e veprave të Pulevskit, si edhe nga dy fjalorët e tij vërehen dy gjëra të rëndësishme. Së pari, rregullisht i shënon me shifra romake librat e vet: *Fjalori katërgjuhësh* sipas tij është libri I; *Fjalorin tregjuhësh* e shënon me II, dhe *Gramatikën* me numrin III. Me atë që për Gramatikën thotë se është pjesa e parë, paralajmëron se ka ose do të ketë edhe pjesë të tjera të saj. Dhe meqenëse, *Vjershëzat (Pesnarki)* nuk i numëron, fitohet përshtypja se ato janë jashtë serisë së paramenduar, ndoshta janë lënë për një publikim më të gjerë.

Së dyti, vërehen emërtime të larmishme për gjuhët. Kështu, për të emërtuar gjuhën shqipe përdori termet *arbanski-arnautski* në ballinën e *Fjalorit katërgjuhësh*, ndërsa në brendi të tij disa terme të tjera, si: *arbanski* – 66 herë, *arnautski* – 16 herë dhe vetëm 6 herë - *albanski*. Termin *arbanski* për emërtimin e shqipes e shkruan në kolonat e *Fjalorit tregjuhësh*, por në faksimilin e po të njëjtit fjalor shkruan *shkip*. Këto emërtesa janë të njohura në shkencën albanologjike (Çabej 1976: 85-88; Ismajli 1987: 96-104).

Autori, duke ditur disa gjuhë, por duke mos pasur as njohuritë elementare linguistike, emërtimin e shqipes e bëri me një larmi të madhe, sikundër bëri edhe me emërtimin e gjuhës sllave të pranishme në kolonën e parë në të dy fjalorët. Atë gjuhë sllave, tani mund të themi një maqedonishte të përzier me përplot serbizma e bullgarizma e pagëzoi si *srpsko-albanski*, *s(lovensko)-makedonski*, *slavjansko-makedonski*, *slovenski*, *makedonski*. Kjo mund të shpjegohet me faktin se në atë kohë nga qarqet serbe, maqedonasit ende nuk njiheshin si komb e as maqedonishtja si gjuhë kombëtare (Конески 1986: 225-230).

Sido që të jetë, për ne me rëndësi më të madhe është struktura gjuhësore e shqipes së shkruar në të dy fjalorët. Për lehtësi shënimi, në punën tonë të mëtejme *Fjalorin katërgjuhësh* do ta shënojmë me numrin romak I, ndërsa *Fjalorin tregjuhësh* me numrin II.

Fjalorët në shqyrtim dallohen mjaft njëri nga tjetri si në strukturë, ashtu edhe në metodën e mbarështrimit, në grafi etj. *Fjalorin katërgjuhësh* mund ta quajmë në një mënyrë si fjalor të mirëfilltë. Në kolonën e parë janë shënuar fjalët në maqedonisht (përkatësisht në sllavisht) e pastaj në kolonat gjegjëse për gjuhët e tjera është dhënë fjala e përkthyer. Këtu nuk kemi fare të dhëna për përkatësinë gramatikore të fjalës, as për shumkuptimësinë e fjalëve, figurshmërinë e tyre, fushat e përdorimit etj., por janë dhënë vetëm fjalët, pa shënuar asgjë pas tyre, si p.sh.:

<i>maqedonisht</i>	<i>shqip</i>
место	veni
нос	унда (unda)
ГОСПОДИН	зотнии (zotnii)
глава	кока, креа, каптина (koka, krea, kaptina)

Siç po shihet nga shembulli i fundit, në disa raste janë dhënë disa sinonime fjalësh, që pasurojnë fondin e fjalorit. Ndonjëherë e njëjta fjalë

është paraqitur disa herë në forma gramatikore të ndryshme: në trajtë të pashquar e në të shquarën, në njëjës e në shumës, si p.sh.: *ni vii, vijat* I 18; *sumbull, sumbullat* I 30; *shapoll, shapolla* (shapullë, shuplakë) I 23 etj.

4.1. ***Fjalori katërgjuhësh*** ka afërsisht 2.560 fjalë e shprehje shqipe, por duke marrë parasysh se ka raste kur një fjalë e vetme na paraqitet me forma të ndryshme, ky fond fjalësh është më i vogël. Ky fjalor ka 98 faqe të formatit 14 x 17 cm. Fjalori është i ndarë në 74 çerdhe fjalësh, me sfera leksikore të ndryshme. Kështu, bie fjala, aty ka leksema “për perëndinë dhe mirësinë e tij” nga faqja 12 deri në faqen 14. Pastaj kapituj me fjalë nga sfera e gjithësisë, emërtime gjeografike, gur e metale; emërtime të kohës dhe të ditëve; numrat themelorë; shprehje dhe emra gjërash të veshmbathjes; terme nga sfera e orendive shtëpiake dhe e enëve; fjalë nga sfera e blegtorisë, emra drurësh, tituj e profesione njerëzish, emërtime veglash e sendesh, emërtime njerëzish për nga mosha e pamja e jashtme (ngjyra e lëkurës); shprehje përshëndetëse, fjalë pa ndonjë lidhje me botën materiale.

Në fund të librit janë dhënë përmirësimet e gabimeve teknike e në tri faqet e fundit janë shënuar emrat e parapaguesve të fjalorit me të dhënat për profesionin, adresën si dhe numrin e ekzemplarëve të paguar, përkatësisht emrat e njerëzve që e financuan botimin e librit.

4.2. ***Fjalori tregjuhësh*** dallohet shumë nga *Fjalori katërgjuhësh*, sidomos për nga forma. Fjalori tregjuhësh nuk është fjalor klasik ose fjalor fjalësh, por i tipit pyetje – përgjigje, që mund të quhet fjalor bisedimor. Në të kemi paralele trigjuhësore me fjali e periudha të tëra, pra me tekst të kontinuar. Ky libër i përgjigjet një enciklopedie të kohës me njohuri të llojllojshme nga religjioni, filozofia e jetës, historia, gjeografia. Sipas Bllazhe Koneskit, Pulevski në 91 faqet e para të *Fjalorit tregjuhësh* e ka shfrytëzuar në tërësi (me ndonjë ndryshim të vogël e përshtatje) tekstin e Kuzman Shapkarevit (1834-1909) *Mësimet fillestare për fëmijët e vegjël*, botuar në Stamboll në vitin 1868 (Конески 1959: 90).

Model për përpilim të tillë të fjalorit, autori ka mundur të gjejë edhe në bisedat dhe dialogjet e banorëve të kësaj ane, si dhe te banorët e vendeve të tjera. Për këtë është e njohur sidomos oda shqiptare e quajtur edhe si “fakultet i popullit”, sidomos atëherë kur përvoja njerëzore, dija, trashëgimia mendore e kulturore bartej vetëm nëpërmjet traditës gojore.

Krahas burimit të zbuluar për 90 faqet e para të Fjalorit tregjuhësh, është konstatuar se Pulevski ka shfrytëzuar edhe modele të tjera. Kështu, prej faqes 93 deri në faqen 128 hetohet se Pulevski ka shfrytëzuar ndonjë shkrim serb, që vërehet sidomos në modelet gjuhësore. Nga faqja 127-157 gjendet një regjistër fjalësh sipas alfabetit, të hartuar nga autori.

*Fjalori tregjuhësh (Fjalor nka tre g-juha)* është i formatit 14 x 20 cm me gjithsej 162 faqe tekst të shkruar me pyetje-përgjigje në tri kolona: sllavisht (maqedonisht), shqip dhe turqisht, me fjali e periudha të tëra. Kjo mënyrë e hartimit të fjalorit mundëson të bëhet vështrim mbi strukturën gjuhësore të këtij fjalori. Së këndejmi, mund të bëhen përgjithësime për tërë gjuhën shqipe të regjistruar nga Pulevski, anipse Fjalori katërgjuhësh nuk është i këtij tipi.

Fjalori në fjalë fillon me një bisedë (maq. - razgovor, shqip - kuvend dhe turq. - muhabet) dhe vazhdon me pyetje (maq. pitanje, shq. pjtmea e turq. suval) dhe përgjigje (maq. odgovor, shq. u prxheq e turq. xhuvab).

4.3. Në të dy fjalorthët shumëgjuhësh, kolona e maqedonishtes së përzier me gjuhë të tjera sllave është bazë, e cila është përkthyer në dy-tri gjuhët e tjera. Mirëpo, në Fjalorthin tregjuhësh autori herëherë i është shmangur paraleles maqedonase, duke u përpjekur ta ruajë origjinalitetin e çështjeve që shtjellon, varësisht nga gjuha në të cilën shkruan. Kështu, bie fjala, në f. 49 kur bën fjalë për popujt dhe atdheun e tyre, në shtyllën e maqedonishtes thotë se: maqedonasit janë popull dhe se atdheu i tyre quhet Maqedoni, ndërkaq në paralelen e përkthyer në shqipen shkruan se shqiptarët janë popull që jetojnë edhe në Maqedoni: maqedonisht: *“Така и македонциве се народ и местиво њиховно је Македонија.* Shqip: *Ashtu ede shkipitarat jan njeraz ede vendin etijse po thijn Makedonija, cili po roin aqe.”*

Nga faqja 41-48 të *Fjalorit II* ku trajtohen çështje për ardhjen e sllavëve në Gadishullin Ballkanik, ndarjen e tyre në popuj, vendosjen e tyre, degëzimin dialektor të maqedonishtes etj., teksti është shkruar vetëm në maqedonisht, pa u përkthyer fare as në shqip e as në turqisht. Gjykojmë se kjo pjesë nuk është përkthyer, sepse autorit i është dukur se kjo tematikë është e parëndësishme për shqiptarët dhe turqit.

Për nga metodologjia e hartimit, dallohet edhe pjesa e fundit e *Fjalorit II* ku nga faqja 113 deri në faqen 118 është dhënë pasqyra e alfabetit të përdorur në këtë fjalës, bashkë me disa përshkrime nyjëtimore të tingujve themelore të paraqitur me shkronjat e alfabetit të tij. Artikulimi i tingujve është dhënë në mënyrë popullore e laike. Prej

faqes 121 deri në faqen 128 përsëri kthehet në pyetje e përgjigje e më pas në 30 faqet pasuese jepet një fjalorth në afro 30 faqe (f. 128-157) me fjalë të radhitura sipas alfabetit cirilik të modifikuar, ku kemi edhe një përpjekje për paraqitje gramatikore të fjalëve, me ndarje dhe shënim të formave të mundshme të tyre.

Në pesë faqet e fundit të *Fjalorit II* (163-167) janë shkruar emrat e parapaguesve, profesioni i tyre, adresa e numri i kopjeve të porositura dhe përmbajtja. Sipas kësaj liste të gjatë, mund të shihet se interesimi i njerëzve për këtë *Fjalorth* që i madh. Pason një përshëndetje mirënjohëse kushtuar parapaguesve dhe njëherit autori bën thirrje për t'u parapaguar (ose për ta financuar) e ndihmuar materialisht botimin e një abetareje në katër gjuhë: turqisht, sllavisht, latinisht dhe greqisht. Ndërkaq, këngë dhe zakone të kombeve e kombësive të sllavëve të jugut, Pulevski sipas kësaj që ka shënuar, e pati planifikuar t'i publikojë për një rreth më të gjerë lexuesish.

Edhe ky *Fjalor*, i ashtuquajtur i dytë, është ndarë në tema të ndryshme me sfera të veçanta leksikore. P.sh. ka një hyrje, pastaj shkruhet për vetitë psiko-fizike të njeriut, për bimët e kafshët, për xehet dhe lëgurat, për kontinentet e botës, yjet, për fenomenet natyrore, për banorët e Mjakut.

## 5. Rëndësia e fjalorëve

Të dy fjalorët e Pulevskit, vështruar në retrospektivën kohore, patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këtë konstatim mund ta mbështesim me disa fakte:

Fjalorët (veçmas *Fjalori tregjuhësh*) paraqesin një enciklopedi të vogël popullore të kohës. Ata patën karakter praktik, d.m.th. se u hartuan për nevojat praktike të popullatës së Ballkanit, por edhe më gjerë; për të nxënë disa gjuhë ballkanike (maqedonishten, shqipen, greqishten e turqishten), për komunikim të ndërsjellë, njohjen reciproke të gjuhëve dhe kulturave, por edhe për afrimin e tyre. Komunikimi i njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme është më se i nevojshëm. Të përkujtojmë me këtë rast konstatimin e njohur të gjuhëtarëve se njohja e disa gjuhëve ka pasoja pozitive edhe në inteligjencë. Përvoja në dy e më tepër sisteme gjuhësore ndikon që personi i tillë të ketë fleksibilitet më të madh mendor, superioritet në përpilimin e ideve, si dhe shumë më tepër zgjedhje të aftësive mendore nga njeriu që di vetëm një gjuhë. Njeriu që zotëron disa gjuhë e vështron



botën në disa aspekte të ndryshme. E në fund, mesi me dy e më tepër gjuhë e kultura mundëson që njohësi i këtyre gjuhëve të fitojë përvojë më të pasur e më të llojllojshme. Prandaj, bashkëjetesa, kontaktet e përditshme të popullatës në anët e Maqedonisë Perëndimore ndërmjet folësve të disa gjuhëve ka krijuar domosdonë e hartimit të fjalorëve shumëgjuhësh.

Nga fjalorët del konstatimi se gjuhët duhet të jenë të barabarta, d.m.th. duhet zbatuar dygjuhësia e shumëgjuhësia e jo diglosia, qëndrim ky më i drejti për mjediset shumëgjuhësore. Nuk është e rastit zgjedhja e gjuhëve: maqedonisht, shqip, turqisht e greqisht. Të rikujtojmë se në atë kohë greqishtja ka qenë gjuhë e arsimit, e kulturës; turqishtja – gjuhë e administratës shtetërore; ndërsa shqipja e maqedonishtja gjuhë amtare e popullsisë së Maqedonisë, si dhe gjuhë e komunikimit të përditshëm në kushtet e bashkëjetesës së shqiptarëve dhe maqedonasve.

Fjalorët janë edhe një dëshmi se shqipja u shkrua, përveç me alfabetin latin, arabo-turk, grek edhe me alfabetin cirilik. Siç dihet, shkrimi i shqipes me alfabet cirilik ka një traditë të shkurtër. Kështu, si i pari dokument me alfabet cirilik merret mbishkrimi tregjuhësh që gjendet mbi derën e manastirit të Shën Vlladimirit të Elbasanit, ndërtuar nga princi shqiptar Karl Topia më 1381. Sprovimet e para për të shkruar shqipen me alfabet cirilik i bënë Papa Totasi ose Anonimi i Elbasanit, beratasi Kostë Berati, Teodor Haxhi Filipi etj. (Janura, 1969: 43-56).

Shqipen me alfabet cirilik e shkruan edhe Gjorgje Pulevski, Kuzman Shapkarevi etj. Vlen të përmendet se Fjalorët e Pulevskit nuk janë të parët, ku në fjalorët shumëgjuhësorë gjuhësh ballkanike hartuar nga joshqiptarët në shekullin XIX merr pjesë edhe shqipja. Shqipen e ndeshim edhe në një fjalor Katërgjuhësh: greqisht-arumanisht-shqip dhe maqedonisht nga voskopojari *Dhanil Haxhiu*, botuar në Venedik më 1794, botimi I dhe më 1802 botimi II.

Fjalorët kanë rëndësi leksikografike, meqë përbëjnë një nga hallkat në vargoin e leksikografisë shqiptare. Materiali i dy Fjalorëve është shfrytëzuar në punimin e Aleksandër Beliqit “Dialekti i Galiçnikut”, Beograd 1935.

## **Përfundim**

Edhe pse në dy *Fjalorët shumëgjuhësh* të Gjorgji Pulevskit nuk është pasqyruar me besnikëri shqipja e kohës, d.m.th. format e fjalëve e të fjalive duhet marrë me rezervë, megjithkëtë mund të thuhet se ata



kanë rëndësi të madhe gjuhësore, sepse këtu e gjejmë një variant të shkruar të shqipes së shekullit XIX. Aty na paraqiten disa forma të vjetra të shqipes, ka tipare të të folmes së qarkut të Dibrës, tipare gjuhësore të të folmeve të tjera gege, një numër të vogël veçorish gjuhësore të të folmeve toske, por edhe kalke, forma e fjalëkrijime të paqëlluara. Megjithë mangësitë që ka, shqipja e Pulevskit siguron një material të shkruar për të vëzhguar gjuhën dhe stilin e tij, për të parë zhvillimin historik të të folmes së Dibrës, e bashkë me shkrimet e tjera të kohës, për të pasqyruar rrjedhën kohore të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore e më gjerë. Meqë është fiksuar një shqipe e shekullit XIX, *Fjalorët* mund të plotësojnë një pjesë të mozaikut për ecurinë kohore të dialekteve dhe të të folmeve shqipe, historinë e shqipes së shkruar e të historisë së gjuhës në përgjithësi.

Këta *Fjalorë*, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm (por jo autentik) për të parë ndikimet ndërgjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike. Dy fjalorët kanë edhe vlerë historike për shkencën albanologjike, veçmas për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi. Fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit mund të shfrytëzohen si material burimor i kohës për të trajtuar çështje gjuhësore, kulturore e historike.

### **Bibliografia:**

- Çabej, dr. Eqrem (1976), *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, f. 85-88.
- Hamiti, Asllan (2000), *Disa veçori fonetike dhe fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit: Shqyrtime albanologjike* 6, Shkup: 161-176.
- Hamiti, Asllan (2005), *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup.
- Хамити, Аслан (1995), *Реципрочното влијание на македонскиот и албанскиот јазик во речнициите на Пулевски: Македонскиот јазик во XIX век*, Скопје: 215-222.
- Хамити, Аслан (1996), *Албанскиот јазик во речнициите на Пулевски: Јазиците на почвата на Македонија*, МАНУ, Скопје: 177-185.

- Ismajli, Rexhep (1987), Emri i shqiptarëve: *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë: 96-104.
- Janura, dr. Petro (1969), *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup: 43-56.
- Pirraqu, Muhamet (1980), *Çështje të alfabetit të shqipes në qarqet shkencore e diplomatike serbe në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare: Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë: 191-199.
- Конески, Блаже (1959), *Кон македонската ѓперодба: Македонските учебници од XIX век*, Институт за национална историја, Скопје.
- Конески, Блаже (1986), *Белешки за Пулевски: Македонскиот XIX век*, Јазично и книжевно-историски прилози, Скопје: 225-230.
- Ристовски, Блаже (1974), *Ѓорѓија М. Пулевски: Одбрани страници, Македонска книга (përzgjedhjem redaktim, parathënie dhe shënime)*, Shkup;
- Саздов, Томе (1985), *Ѓорѓи Пулевски, избрани текстови*, Наша книга, Скопје.
- Тодоровски, Глигор (1970), *Малореканскиот ѓредел*, Скопје.

## 1.2. ALFABETI CIRILIK I PULEVSKIT

Gjatë analizës gjuhësore të shqipes së Fjalorëve të Pulevskit kemi hasur në disa vështirësi, ashtu siç ka vështirësi çdo studiues i teksteve të shkruara. Probleme na kanë dalë së pari sepse kemi pasur para vetes një tekst të shkruar e jo një ligjërim tingullor të njerëzve. Në vend të tingujve këtu kemi shkronja, e siç dihet, shkronjat në mënyrë të zbehtë e ndonjëherë të deformuar paraqesin fonemat. Pra, nuk ka asnjë sistem grafik aq të përsosur, i cili do të mund t'i regjistronte në mënyrë besnike të gjitha nuancat tingullore që i merr fonema në pozicione të ndryshme fonetike e kombinatorë në procesin e ligjërimin.

Vështirësia është edhe më e madhe kur kihet parasysh se Fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit nuk janë shkruar me alfabetin latin të përshtatur për transkriptimin e shqipes. Autori ka përdorur ato grafema të sllavishtes të cilat ka pandehur se më së miri e pasqyrojnë vlerën e fonemave të shqipes. Por, megjithatë, gjuhët e ndryshme kanë edhe tinguj themelorë të ndryshëm, disa nga ta për nga shqiptimi mund të jenë të ngjashëm ose të përafërt, por asnjëherë të njëjtë. Të përkujtojmë, veç kësaj, se dallime akustike të tingujve ka edhe ndërmjet pjesëtarëve të një gjuhe, të një dialekti, nëndialekti, grupi të të folmes, të folmes, por dallime fonike hasen edhe ndërmjet individëve të një të folmeje. Kështu, pra edhe e folmja e qarkut të Dibrës, që përbën bazën dialektore të shqipes së fjalorëve në spikamë, nuk është gjithkund e njëjtë. Zaten, përveç kësaj baze gjuhësore, gjuha e Fjalorëve ka plot veçori gjuhësore edhe të të folmeve të tjera të gegërishtes si dhe tipare të toskërishtes.

Me një fjalë, shqipja e fjalorëve të Pulevskit është një “amalgamë gjuhësore artificiale”: një gjuhë popullore joautentike, një stil që dëshmon nivelin e ulët të njohjes së natyrës së shqipes, me përzierje të shqipes territoriale, me shumë ndikime të huaja joreale, pa ndarje morfologjike në shkrimin e fjalëve, përplot me kalke e krijime artificiale të autorit etj.

Duke pasur para vetes një përfaqësim të tillë të dobët të shqipes së një autodidakti, me grafi jokonsekuente e pa kritere të caktuara gjuhësore, kuptohet se e kishim mjaft të vështirë të gjejmë rregulla të përgjithshme për tërë sistemin gjuhësor të shqipes së fjalorëve. Megjithatë, jemi përpjekur të nxjerrim dhe t'i njoftojmë të interesuarit shqiptarë me tiparet kryesore të variantit shqip të të dy Fjalorëve.

Alfabeti që e përdori Pulevski që fonematik, i plotësuar me alfabetin rrokjesor. Përgjithësisht, mund të thuhet se fjalët i shkroi sipas parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhet ashtu siç shqiptohen dhe lexohen ashtu siç shkruhen. Në shkrim, siç dihet, fonemën e përfaqëson grafema, andaj në këtë vëzhgim gjuhësor do të flitet për grafinë e Pulevskit. Përgjithësisht, me një shkronjë Pulevski ka shkruar një fonemë, ka edhe dyshkronjësha si dhe ndonjëherë me një shkronjë ka paraqitur një rrokje (sipas traditës shkrimore të rusishtes e bullgarishtes). Meqë gjatë përfaqësimit grafik të disa fonemave hetohet mospërputhje ndërmjet grafemës e fonemës, do të bëhet fjalë edhe për këtë mospërputhje.

Sistemi grafik i teksteve të Pulevskit, si edhe gjuha e tij, nuk është e njëjtë, por dallohet nga teksti në tekst. Grafia e dy Fjalorëve të botuar në Beograd dallon nga grafia e teksteve të tjera të botuara në Sofje. Edhe dy fjalorët e Pulevskit botuar në Beograd në dallim kohor vetëm për dy vjet (Fjalori I më 1873, ndërsa Fjalori II më 1875) dallohen mjaft edhe në grafi. Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin cirilik tradicional (me shkronja serbe-ruse-sllave), ndërsa në Fjalorin tregjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i Vuk Karaxhiqit.<sup>3</sup>

Për sistemin grafik të Pulevskit kanë bërë fjalë disa gjuhëtarë maqedonas, ndër ta Trajko Stamatovski, Bllazhe Koneski, Bllazhe Ristovski, Tome Sazdov etj.<sup>4</sup> Për shkrimin e të gjitha paraleleve gjuhësore të fjalorëve, d.m.th. në maqedonisht, shqip, greqisht e turqisht është përdorur i njëjti alfabet. Në këtë punim do të përpiqemi të japim inventarin e grafisë dhe të shpjegojmë me çfarë vlere është përdorur ky sistem grafik për të shënuar fonemat e idiolektit shqip të Pulevskit.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë për grafinë e Pulevskit, më poshtë po paraqesim dy alfabetet, të fjalorit I dhe të Fjalorit II:

<sup>3</sup> Блаже Конески, *Македонскиот XIX век*, Јазични и книжевно-историски прилози, Скопје, 1986, f. 219.

<sup>4</sup> Shih: Б. Конески, *punim i sapocituar*, f. 211; Т. Стаматоски, *Кон графискиот сисџем на Пулевски*, Бигорски научно-културни средби, I Научен собир, Gostivar, 1971, f. 37-44; Б. Конески, *За јазикот на Пулевски* (графиски, фонетски и фонолошки особености), Македонскиот XIX век, Shkup, 1986, f. 210-223; А. Hamiti, *Албанскиот јазик во речницитџе на Пулевски*, Јазичите на почвата на Македонија, AShAM, Shkup, 1996, f. 177-185;

Alfabeti i Fjalorit katërgjuhësh:

Alfabet fonetik							
А а	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	Ь ь	Ф ф
Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Л л	Лл лл
М м	Н н	О о	П п	Ђ ђ	Р р	С с	Ш ш
Т т	Ѳ Ѳ	У у	В в	Ц ц	З з	Ж ж	
Alfabet rrokjesor							
Ѣ Ѣ	Я я	Ю ю	Ы ы				

Alfabeti i Fjalorit tregjuhësh:							
Alfabet fonetik							
А а	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	-	Ф ф
Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Љ љ	Л л
М м	Н н	О о	П п	Ђ ђ	Р р	С с	Ш ш
Т т	Ѳ Ѳ	У у	В в	Ц ц	З з	Ж ж	
Alfabet rrokjesor							
Је је	Ја ја	Ју ју	Ји ји				

Nga këto dy tabela të alfabeteve, mund të shihet se pjesa më e madhe e shkronjave është e njëjtë në të dy Fjalorët. Numri i shkronjave në paralelen shqipe në të dy Fjalorët është i njëjtë – 35 shkronja, me dallim që në Fjalorin I përdor edhe një shkronjë më tepër, siç e quajmë në gjuhët sllave “erin e madh” <Ѣ>, por pa ndonjë vlerë fonematike.<sup>5</sup>

Në Fjalorin tregjuhësh ai i mënjanoi disa shkronja të vjetra të përdorura në Fjalorin katërgjuhësh, por e mbajti mend vendin e vlerën e tyre shenjuese. Kështu, fonografet e para i zëvendësoi me të dytat, si <Ѣ> = /je/ ose /e/, <Ы> = /ji/ ose /i/ <я> = ja, <ю> = /ju/ etj. Shkronjat <ђ> = /q/, <ѓ> = /gj/ dhe shkronjën greke <Ѳ> = /th/ i përdori në të dy Fjalorët. Këtë të fundit kuptohet se e përdori për paralelen në gjuhën shqipe dhe greke, ndërkaq në maqedonishten nuk e shënon, ngase maqedonishtja nuk e ka këtë fonemë; me përjashtim të emrit të Metodit që e shkruan si Методијее (Methodije) II 42.

Në Fjalorin I nuk pamë grafemë për ta shënuar fonemën /nj/. Mirëpo, këtë e shkruan me kombinimin e shkronjës <н> (n) dhe <ы> (ji): нызетепес дремь (njizetepes drem) I 97; нюокъ (nji ok), ны окас (nji okas) I 97, ны (nji) I 34 etj., ose me kombinimin <н> + <я>, si p.sh. ня (nja) I 27, 28; няни (njani) I 53; ndërkaq për rrokjen /je/ shkroi

<sup>5</sup> Në faqen 111 për sasinë e shkronjave, Pulevski thotë: “Slavjanise kishten 44, po veç me 35 shtil ma pastr u shkrunte”.

shkronjën e sllavishtes së vjetër <ѣ>: нѣрии (njerii) I 97, бѣваръ (bjevar, blerës) I 88, темѣръ (tëmjer) I 74 etj.

Dallimi në grafi ndërmjet dy Fjalorëve shihet edhe se në Fjalorin I /l/-në shqipe e shënon me fonografin <л>, ndërsa /ll/-në me <лл>, me siguri nën ndikimin e shkronjës dyshe <ll> të shqipes. Në Fjalorin II /l/ = <љ> e /ll/ = <лл>.

E folmja maqedonase e Galiçnikut, në inventarin e saj nuk e ka fonemën /x/, andaj Pulevski nuk ka shkronjë për ta shënuar këtë fonemë, por këtë e zëvendëson me ndonjë tingull tjetër.<sup>6</sup>

Në Fjalorin e Parë i gjejmë mjaft dendur dy shkronja të sllavishtes së vjetër (tani të bullgarishtes e rusishtes) të quajtura eri i madh <ъ> dhe eri i vogël <ь>. Këto dy grafema shpeshherë kanë vlerë tingullore e në disa raste shërbejnë për t'i mbyllur fjalët që mbarojnë me bashkëtingëllore. Eri i madh sipas etimologjisë është gjysmëzanore, mirëpo në shqipen e Fjalorëve të Pulevskit, kjo shkronjë më së shpeshti i mbyll fjalët që mbarojnë me bashkëtingëllore, sipas modelit të sllavishtes. P.sh. чилась (çillas) I 11, чилать (çillat) I 11, пунать (punat) I 11, зоть (zot) I 11, малъ (mal) I 16, ливадъ (livadh) I 16, уратъ (urat) I 18, гуръ (gur) I 19 etj.

Në gjuhët sllave para erit të madh (<ъ>) është ruajtur shqiptimi më i butë (më i prapmë) i bashkëtingëllores që gjendet para saj, e më vonë në maqedonishten dhe bullgarishten eri i madh ka kaluar në /e/. Se vërtet shkronja, që quhet er i madh <ъ> te shkrimet e Pulevskit përdoret për të mbyllur fjalët që mbarojnë me bashkëtingëllore, dëshmojnë mjaft qartë edhe po të njëjtat fjalë duke marrë trajta të ndryshme gramatikore, si p.sh.: гуръ – гури (gur-guri) I 19, вени мадемитъ – мадеми екурить (veni mademit – mademi ekurit), балли - балль (balli – ball) I 21, барку - баркъ (barku – bark) I 22, шаполль – шаполла (shapoll – shapolla) I 23, низеть - низете ня (njizet – njzete nja) I 26, тредиеть – тредиете ня (tredhiet – tredhiete nja) I 27, нандадијеть – нандадијете ня (nandadhijet – nandadhijete nja) I 28 etj.

Duke pasur parasysh se foljen *jam* në vetën e tretë në Fjalorin e dytë Pulevski e shkruan аште (ashtë), atëherë mund të supozohet se këtë formë e ka përdorur edhe në Fjalorin e parë. Nga kjo mund të përfundojmë se erin e madh <ъ> e ka përdorur në disa raste për të shënuar /ë/-në e shqipes, si екхеллатъ ѡштъ (e khellat është, “e kthjellët” është). Në

<sup>6</sup> Блаже Конески, *Македонскиот XIX век*, Јазични и книжевно-историски прилози, Скопје, 1986, f. 219.

faqen 65 të Fjalorit katërgjuhësh kemi lexuar турпъ аштъ edhe мабаре ѡштъ (turp është, mabare “mbarre” është). Shembujt si këta na japin të drejtë të gjykojmë se përveç mbylljes së leksemave që mbarojnë me bashkëtingëllore, shkronja <ъ> ka raste edhe kur shënon /ë/-në e shqipes në pozitë fundore të patheksuar, por rrallëherë edhe në pozitë nistore (ѡштъ).

Në përdorimin e gjysmëzanores, përkatësisht erit të vogël <ь>, çështja na del më e njësuar. Në tekstin e paraleles sllave Pulevski këtë shkronjë e ka përdorur për të shenjuar shqiptimin më të butë të bashkëtingëllores /n/ dhe për formimin e shkronjës për të shkruar bashkëtingëlloren /nj/.<sup>7</sup> Në shqipen e Pulevskit kjo shkronjë është përdorur për ta shënuar zanoren /ë/. Krahaso shembujt: кѡмбъ, кѡмбатъ (këmb, këmbat) I 22, дѡмбъ, дѡмби, дѡмбатъ (dhëmb, dhëmbi, dhëmbat) I 22, нѡнъскетуль (nënësketull) I 21, катърдијетъ (katërdhijet) I 27, пѡсѡдијетѡ (pësëdhijetë) I 27, кѡсула (kësula) I 29, нѡн кок (nën kok) I 32, пѡрфундъ (përfund) I 38 etj.

/Ë/-në shqipe Pulevski në Fjalorin II nuk e shënon me erin e vogël <ь>, por me një vizë të shkurtër <->, e njohur si vizë lidhëse: м-шилур (mëshilur) II 99, вог-л (vogël) II 104 etj. Edhe në fjalët пас ц-л, пас ц-ла, пас цилат (pas cëll, pas cëlla, pas cillat) II 149 viza ka shënuar zanoren /ë/, meqë përemrat pyetës *cili, cila, cilët* në të folmen e Kërçovës dalin në formën *cëlli, cëlla, cëllët*.

Disa grafema në Fjalorin e dytë të Pulevskit janë regjistruar me një lloj gërshetimi a përzierje ndërmjet shënimit të tyre të vjetër (në Fjalorin I) dhe shënimit të ri, si <њ> (nj): бошњјакисѡ (boshnjjakise) II 40, њјани (njјani) II 24, њја (njја) II 68, њјевин (njјevin “njefin, njehin, numërojnë”) II 24, њјофин (njјоfim, “njohim”) II 10; <љ>: ѳољј (gjoљј, gjoљ “liqen”) II 19, циљј (cilј, “cili”) II 21, лјдме (ljđme, “lindme, lindur”) II 13, улјјиндим (ulјјindim “lindim”) II 14 etj.

Pulevski nuk ka përdorur shkronja të veçanta për ndërthemboren e zëshme të shqipes /dh/ e as për shumëdrdhësen tingëlluese /rr/, meqë gjuhët sllave nuk i kanë këto fonema, rrjedhimisht asnjë nga alfabetet e gjuhëve sllave nuk kanë as shkronja për to. Ndërdhemboren e shurdhët /th/ Pulevski e shënoi me shkronjën greke <θ>.

Nga kjo që u tha deri më tani mund të pandehim se edhe Fjalori tregjuhësh që shkruar me alfabet cirilik tradicional, por më vonë me donjë sugjerim para botimit, u bë një transliterim i vogël.

<sup>7</sup> Shih: Блаже Конески, *vepra e cituar*, f. 219.

Teksti i fjalorëve në shqip mund të vlerësohet i një niveli shumë më të ulët shkrimor sesa shkrimet e tjera shqipe të kohës. Pulevski që autodidakt dhe si duket nuk e ka njohur traditën e shkrimit të shqipes. Përgjithësisht, mund të thuhet se teksti i tij i takon stilit popullor, që përshkohet nga rregullat e fonetikës sintaksore, pa ndarje morfologjike të fjalëve, derisa mund të lexohet edhe një fjali e tërë e shkruar si një fjalë e vetme: *potabojshindet* I 75; *kushkoni*, *kurdozhkojsh* I 78, *bjerinishkëm* I 76, *aikurëqeshen* I 61, *mosufrik*, *eboplak* I 80, *ekabarove* II 8, *poeçillojm* II 75, *mosufrik* I 80, *eboplak* I 71 etj.

Gabime të shumta hetohen si në kufijtë e ndarjes së fjalëve, ashtu edhe në shenjat e pikësisht. Shkrimi i fjalëve veçmas, bashkë ose me vizë në mes të Pulevski kanë një ndryshim të madh nga mënyra e sotme e shkrimit. Kështu, p.sh. një fjalë të vetme që shkruhet bashkë, Pulevski e shkruan ndaras në dy apo tri pjesë; ose dy e më tepër fjalë (që sot shkruhen ndaras) ai i shkruan si një fjalë të vetme të pandarë. Thënë troç, më shumë gjejmë fjalë të shkruara gabimisht, sesa fjalë të shkruara sipas ndarjes së rregullt të tyre. Le t'i regjistrojmë disa shembuj të tillë të transliteruar me alfabetin e sotëm të shqipes:

*“Tretisë ubojet xhoja çu porujn tufa dhen dhi kalë shum edhe lopa* II 55; ... *that sira, apo kuashtë, uhoq, plot, ashtë, menji* II 18; *mepemna* II 21; *gjith çvar* II 9; *melikura* II 35; *pougjeg* II 31; *ma shum, tadijm, nkaduhet, ekam, çepreajo* II 3; *let lishoe* II 8; *matemadh* II 11; *pouxhindet* II 11; *meffjali* II 16; *dot uthojet* II 160; *zotishindosh* I 76, *zotishindosh* I 76, *nëqofëshindosh* I 75, *mëngjesimir* I 75, *ipamartoum* I 70, *venekuror* I 64, *damimadh* I 82, *besaturçisht* I 78, *ipapasun* I 69” etj.

Siç shihet nga shembujt e dhënë “kjo nuk është një ortografi fonetike moderne, me ndarje morfologjike të fjalëve, por është një ortografi popullore e fonetikës sintaktike.”<sup>8</sup> Autori laik, ashtu siç e ka ndier me veshë, ashtu e ka shënuar.

Dihet se çdo fjalë, kur shqiptohet e veçuar nga të tjerat, ka theksin e vet. Mirëpo, kur ato bashkohen në fjali, disa e humbasin theksin, përkatësisht bëhen të patheksuara. Përgjithësisht, fjalët emërtuese a quajtëse e ruajnë theksin, ndërsa fjalët shërbyese bëhen të patheksuara. Si fjalë të patheksuara në fjali paraqiten zakonisht fjalët shërbyese (parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, foljet ndihmëse, nyjat, trajtat e shkurtra të përemrave vetore etj.), por edhe disa fjalë emërtuese, zakonisht

<sup>8</sup> Eqrem Çabej, “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555) I, Tiranë, 1968, f. 93.



njërrokëshe. Këto fjalë klitike (pa theks) bashkohen në shqiptim me fjalët emërtuese që kanë theks (me fjalët akcentogjene), formojnë me to një grup që shqiptohet me një theks të vetëm, d.m.th. formojnë një njësi theksore ose, siç thuhet ndryshe, formojnë një fjalë fonetike.<sup>9</sup>

Vlen të përmendet edhe ajo se të vetmet shenja të pikësimit të përdorura në glosarët për të cilët po bëjmë fjalë janë presja, pika dhe kllapat. Por, edhe këto tri shenja pikësimi, Pulevski nuk i përdor me vend. Bie fjala, për t'i ndarë pjesët homogjene të fjalisë, autori nuk përdor presje: “*A po të zhallurat jan njerji dele kali lopa edhe qeter shum*” II 24. Nga ana tjetër, ka raste kur pothuajse pas çdo fjale është vënë presje, si: “*Clla, msumea, zan diktojet nja, bas nja, pre, xhithë, trej, mpretënija, vrtetunis*” II 25 me kuptimin “Cila dije (shkencë) tregon shtruar për tri mbretëritë e së vërtetës?”; ose një shembull tjetër për përdorimin e pavend e të tepruar të presjes: “*Kallaji, ashtë, bardhë, edhe mademi, but, cili, po xhindet, prziun, me troll ...*” II 25 etj.

### **Pasqyrë e alfabetit të Pulevskit krahasuar me abëcë-në e shqipes së sotme**

Gjatë përpunimit të sistemit grafik të tekstit shqip të të dy fjalorëve të Pulevskit i kemi krahasuar grafemat e këtyre fjalorëve me shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe. Për të përfutur një ide sa më të qartë të alfabetit të Pulevskit, po japim edhe një pasqyrë që dëfton vlerën kryesore fonematike të shkronjave, duke shënuar majtas shkronjat e alfabetit të sotëm të shqipes e djathtas shkronjat e përdorura në fjalorët në shqyrtim:

Abëcëja e shqipes	Alfabeti i Pulevskit	Shembuj
<b>a</b>	а	вла, влаа, авул, машкул, кока, калаа,
<b>b</b>	б	барка, барна, букур, брум, бјешка, мбас
<b>c</b>	ц	цопа, гац, маца, циљи, цопацоп, копуц
<b>ç</b>	ч	чаји, че кач, чепъ, те пача, чиш
<b>d</b>	д	дита, дега, перенди, дии, дамъ, вдесин

<sup>9</sup> Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2/1990, Tiranë, f. 8.

<b>dh</b>	д	еде, и мад, у збард, у дерд, ден, верд, уда
	ј	јии
	л	ул, ултар
	лл	улла, уллтар
<b>e</b>	е	пела, деле, беса, рее, тетъ, леш
	ѣ	нѣсеръ, мѣс
	-	з-м-р, з-м-рат
<b>ë</b>	с	катеръ, ка веше, аште
	ь	катъръ, вогълъ, мьзъ, с'ыштъ, кьмбъ
	ъ	ыштъ, кьпуцатъ
	-	т-и, з-м-р, вог-лъ, к-та, м-нѣс, данд-р
<b>f</b>	ф	фара, фрор, фтохт, фич, нофула
<b>g</b>	г	гуръ, гропа, гомари, гаць, груа
<b>gj</b>	ђ	ђат, џашт, џиѳ, џит, џуђи
<b>h</b>	х	ханат, фтохт, духет, џуха, у хођ
<b>i</b>	и	мишин, кии, шии, миир, зотнии, дети
	ы	дылли бые, фаы, ны, сыи, сыт, џумшты
<b>j</b>	ј	јан, јет, маји, уји, вјети, бије, кусија
<b>ja</b> <sup>10</sup>	я	вия, зоня, гоа, яка, фяли, мялти, бия
	ѣ	бринѣ, џунѣт
<b>je</b>	ѣ	мѣкра, вѣра, пѣшт, пѣргулл, нѣрс
<b>ju</b>	ю	юве, пьоте, јю, јюве, фјютуръ
<b>k</b>	к	кам, нук, кафе, кур, калнор, ка
<b>l</b>	лъ	љуље, фольим, џуми, џопа, пеља, деље
	л	лелек
<b>ll</b>	л	бал, троли, Анадол, славјан, коломбођ
	лл	ветулла, молла, каллнор, даллга
<b>m</b>	м	мбас, муји, манастир, земра, шум
<b>n</b>	н	нук, на, натан, вендин, јан, анза
<b>nj</b>	њ	њи, њом, њофе, њерии, доњи, нањи
	ня	дуня, зоня, няни, куняа
<b>o</b>	о	ода, зот, нофула, пошта, вдор, мос бон
<b>p</b>	п	перенди, пор, па, апо, паша, пруга, прсе
<b>q</b>	ћ	ћелћеџи, дућан, ћора, шећер, шћепон
<b>r</b>	р	кур, мир, лепуръ, грош, корба, кумри
<b>s</b>	с	соръ, беса, роса, прсе
<b>sh</b>	ш	шкалль, дашь, деш, душк, шкиле, шкип
<b>t</b>	т	трупа, пует, сахат, дит, труп, те мрети
<b>th</b>	ѳ	ѳаш, ѳон, ѳоште, дриѳ
	т	тире, тошин, тесат, рет, џита, тес, ктес
	с	суа, дрисъ, сартъ, џисъ, мбасуръ, сатъ
<b>u</b>	у	дул, пруга, фуш, унда, гуша, кумбулла

v	в	венди, вера, вии, вдор, встулла, јава
xh	ц	цал, цепат, цамиит, миџъ, цеваир
γ <sup>11</sup>	уи	дуи, друи, суи, дуимадијет, дуизет
z	з	зине, забель, збразе, брез, шкозъ
zh	ж	жаба, жив, аждер

**Literatura:**

- Çabej, Eqrem (1968), *“Meshari” i Gjon Buzukut (1555) I*, Tiranë.
- Dodi, Anastas (1990), *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2/1990, Tiranë.
- Конески, Блаже (1986), *Македонскиот XIX век*, Јазично и книжевно-историски прилози, Скопје.
- Хамити, Аслан (1995), *Реципрочноото влијание на македонскиот и албанскиот јазик во речниците на Пулевски: Македонскиот јазик во XIX век*, Скопје: 215-222.
- Хамити, Аслан (1996), *Албанскиот јазик во речниците на Пулевски: Јазичите на почвата на Македонија*, МАНУ, Скопје: 177-185.
- Hamiti, Asllan (2000), *Disa veçori fonetike dhe fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit: Shqyrtime albanologjike 6*, Shkup: 161-176.
- Hamiti, Asllan (2005), *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup.
- Конески, Блаже (1959), *Кон македонската ѝ прероба: Македонските учебници од XIX век*, Институт за национална историја, Скопје.
- Конески, Блаже (1986), *Белешки за Пулевски: Македонскиот XIX век*, Јазично и книжевно-историски прилози, Скопје: 225-230.

<sup>10</sup> Alfabeti i shqipes është plotësisht fonematik, d.m.th. një tingull = një shkronjë të thjeshtë ose të përbërë. Rrjedhimisht, grafemat <ja, je, ju> nuk janë pjesë e alfabetit të shqipes, por ato i ka përdorur Pulevski në tekstet e tij. Shkronjat rrokjesore të Fjalorit tregjuhësh të Pulevskit <ja, je, ju> në Fjalorin katërgjuhësh korrespondojnë me shkronjat po kështu rrokjesore të alfabetit të sotëm të rusishtes <я, ю, ъ>, të cilat lexohen kështu: <я> = [ja], <ю> = [ju], <ъ> = [ji] ose [i].

<sup>11</sup> <γ> grafemë që shënon një [y] më pak buzore se [y]-ja e rëndomtë e mbarë shqipes. Nga struktura grafike e Pulevskit mungon grafema që do ta shënonte fonemën /x/ të shqipes.

### 1.3. TIPARET GJUHËSORE TË TEKSTIT SHQIP TË FJALORËVE TË PULEVSKIT

Veçoritë fonologjike e fonetike të tekstit shqip të fjalorëve të Pulevskit, të paraqitura në formë të shkurtuar, janë:<sup>12</sup>

1. *Dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve.* Zanoret e shkurtra dhe të mesmet i regjistron vetëm me një shkronjë; ndërsa të gjatat, marrë në tërësi, me dyzimin e po të njëjtave shkronja.
2. *Inventar fonemash pa zanore hundore.* - Duke u mbështetur në kundërvëniet me vlerë fonologjike të shkallës së gjatësisë së fonemave zanore (të shkurtra ~ të gjata), pa serinë e fonemave hundore (ngase nuk i ka), mund të pohojmë se shqipja e Fjalorëve të Pulevskit në rrokje të theksuar ka gjithsej 12 fonema zanore: /a/, /a:/, /u/, /u:/, /e/, /e:/, /o/, /o:/, /i/, /i:/, /ɣ/ dhe /ë/. Analiza e tekstit shqip të këtyre Fjalorëve na nxori 26 fonema bashkëtingëllore. Në krahasim me shqipen standarde këtu mungojnë paragjuhlorja afrikate e zhurmët [x], sonorja shumëdridhëse [rr] dhe laringalja [h].
3. *Zanorja [ë].* - Siç dihet në të folmet e gegërishtes [ë]-ja është e paqëndrueshme: ajo nuk përdoret asnjëherë në rrokje të theksuar dhe nuk bën pjesë në inventarin e fonemave zanore, d.m.th. në të folmet geqe ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës. Mirëpo, te shkrimi i shqipes në fjalorët për të cilët po bëjmë fjalë jemi të mendimit se ekzistojnë pak shembuj të ruajtjes së kësaj zanoreje edhe në pozitë fundore.
4. *Buzorëzimi i zanores [ë] në [o].* - Te Pulevski vërejtëm disa raste buzorëzimi të [ë] > [o]: *numor* (< numër) I 9, *pollomba* (< pëllëmba) I 24, *thongjill* (< thëngjill) I 38, *kopucar* (< këpucar) I 55, *fomei* (< fëmijë) II 155, *tono* (< tonë) II 70 e 74 dhe ndonjë rast tjetër.
5. *Buzorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o].* – Në fjalët si *nona* < nana, *bojet* < bahet II 87, *hona* < hana, *bone* < bane etj., [a]-ja hundore, dikur e mbarë gegërishtes, buzorëzohet aq shumë saqë në fjalorët e Pulevskit është shndërruar plotësisht në zanoren e

---

<sup>12</sup> Dukuritë fonologjike e fonetike të fjalorëve të Pulevskit më gjerësisht i kemi trajtuar në monografinë “Paralelja shqipe në dy Fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit”, Vatra, Shkup, 2005, f. 77-102. Tiparet morfologjike në po të njëjtin libër, f. 103-141.

- buzorëzuar [o].
6. *Qiellzorëzimi i [ë]-së në [i]*. – Zanoren gjysmë të hapur të radhës së mesme [ë] në rrokje të patheksuar në disa raste e gjejmë të qiellzorëzuar.
  7. *Rënia e [ë]-së para sonoreve [r, l, ll, m, n, nj]*. – Përpos rasteve (që shënuam) të ruajtjes së zanores [ë] para bashkëtingëlloreve tingëlluese, mjaft e shpeshtë është dukuria e rënies së kësaj zanoreje në pozitë para sonanteve.
  8. *Diftongimi dytësor i zanoreve të theksuara [i] dhe [u]*. – Shpërbërja e [i]-së dhe e [u]-së së theksuar në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulevskit është dukuri fonetike mjaft e shpeshtë, që është karakteristik për tërë krahinën e principatës së Kastriotëve, përkatësisht grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore.
  9. *Monoftongimi i grupzanorshit [ue] ose [ua] në [u:]*. – Grupi vokalik [ue] është monoftonguar në [u:] të gjatë dhe si i tillë në pak raste është ruajtur në Fjalorët e Pulevskit., si *du:l* (< doli) I 15, II 70; *bu:ll* (< buell, buall) I 41, *kapru:ll* (< kapruell) I 47, *shkru:r* (< shkruar) I 61, *besu:* (< besue, besuar) I 68, *i kullu:m* (< i kulluem, i kulluar) I 90 etj. Këto janë raste të rralla ku [u]-ja e theksuar i ka përballuar risisë diftonguese.
  10. *Prania jo e vogël e togut zanor [ua]*. – Togun vokalik [ua] e kemi hasur në disa fjalë në shqipen e fjalorëve të Pulevskit.
  11. *Ka forma të rotacizuara*. – Krahas formave të fjalëve me [n] ndërzanore, kur dihet se fjalorët janë shkruar në dialektin e gegërishtes: *pruna* I 68, *i pasun* I 69, *xhilpan* I 88, *barna* II 6 etj., ka edhe një numër të konsiderueshëm fjalësh në formë të rotacizuar, si bie fjala: *egërsira* II 9, *ature* (atyre) II 13, 15; *i varfër*, *vllazër* II 67, *verë* (pije), *diturija* I 59, I 88; *breshër* II 88, si dhe në pjesoret toske *shitur* I 88, *shtrirë* I 72, *shkurtuar*, *çiruar* I 72; *mbledhur*, *zbuluar*, *grisur* I 71, *gëzuar* I 59, *shitur* I 88 etj.
  12. *Zhbuzorëzimi i [y]-së në [i]*. – Zanorja e përparme e mbyllur [y] në të shumtën e rasteve është zhbuzorëzuar në [i]: *tlin* < tëlin < tëlien < tëlyen I 39, *brim* < brymë, *fill* < fyell I 57 etj.
  13. *Shpërbërja dytësore e [y]-së në [êi] dhe rrallëherë në [êi]*. – Te një numër i konsiderueshëm fjalësh [y]-ja e theksuar, përveç që është

- zhbuzorëzuar në [i], ajo pastaj ka evoluar edhe më tej dhe, sipas rrethanave fonetike, është diftonguar në [êi]: *fêit* < fit < fyt, *frêim* < frim < frymë, *sêi* < si < sy etj.
14. *Shndërrimi i [y]-së në [u].* - [Y]-ja e mbarë shqipes në fjalorët e Pulevskit në pak raste ka evoluar në [u], si te *shut* < shyt I 42, *çush* < çysh II 71, *kruqa* < kryqa II 73, *nrushe* < ndryshe II 72 e në ndonjë fjalë tjetër.
15. *Përdorimi i një [y]-je më pak buzore se e rëndomta.* – Përveç shumë zhvillimeve të larmishme që ka pësuar zanorja [y] në shqipen e shkruar të fjalorëve të Pulevskit, na ra në sy edhe përdorimi i një [y]-je më pak buzore se ajo e rëndomta, të cilën e ndeshim të shkruar me kombinimin e shkronjave <ui>, ne do ta shënojmë me [ɣ].
16. *Përdorimi i grupit [vo] në fillim të fjalës.* – Në fjalorët e Pulës e kemi hasur grupin [vo] në fillim të fjalëve, që është karakteristik për dialektin verior të shqipes.
17. *Togzanori [ie] është monoftonguar në [i:].* – Për ta përdëftuar këtë dukuri fonetike po mjaftohemi të sjellim dy shembuj të shënuar nga dy herë: *dilli* (< dielli) I 91 dhe II 70; *çilli* (< qielli) I faqe 11 dhe faqe 14.
18. *Afrikatizimi i qiellzoreve [q, gj] në [ç, xh].* – Sipas gjendjes faktike, fjalorët e Pulevskit karakterizohen me praninë e dy çifteve bashkëtingëlloresh: bashkëtingëllore qiellzore ~ bashkëtingëllore afrikate, por shpeshherë dallimi i tyre nuk del i qartë, d.m.th. bëhet përzierja e tyre në të shkruar.
19. *Humbja e kundërvënies fonologjike e fonemave /r/ ~ /rr/. –* Në të folmen e Dibrës si dhe në shqipen e fjalorëve të Pulevskit nga sistemi bashkëtingëllor është zhdukur shumëdridhësja /rr/ dhe vendin e saj e ka zënë dridhësja simotër /r/ në të gjitha pozicionet e fjalës
20. *Ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb], [nd], [ng] me pak përjashtime.* – Përgjithësisht, mund të themi se në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit grupet e bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] janë ruajtur të papërngjashmuara.
21. *Përdorimi i rrallë i mesgjuhores [j].* – Bashkëtingëllorja mesgjuhore sonante shtegore [j] në shqipen e dy fjalorëve për të cilët jemi duke bërë fjalë përdoret mjaft rrallë, krahasuar me dendurinë e përdorimit të rëndomtë në gjuhën e sotme shqipe, po edhe me dendurinë relativisht

- të madhe të saj në të folmet shqipe.
22. *Grupet e vjetra konsonantike [kl], [gl] kanë evoluar në [q] e [gj].*
  23. *Grupet e bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] paraqiten në variante të ndryshme. – Grupin e parë konsonantik e gjejmë të shënuar në dy forma: [pl] dhe [pj], ndërsa grupi [bl] në fjalorët e Gjergjit del si [bj]. Edhe [fl]-ja në fjalorët në vështrim ka dhënë [fj].*
  24. *Qiellzorëzimi i grupeve [tj] > [q] dhe [dj] > [gj].*
  25. *Qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] në disa raste.*
  26. *Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore.*
  27. *Rënia e bashkëtingëllores glotale shtegore të shurdhët [h].*
  28. *Ruajtja e grupit bashkëtingëllor [fsh].*
  29. *Shndërrimi [th] > [f].*
  30. *Këmbimi [f] > [v].*
  31. *Zëvendësimi [h] > [f].*
  32. *Metateza. – Kjo dukuri fonetike, e ndërrimit të tingujve ose të rrokjeve brenda fjalës, në shqipen e fjalorëve të Pulevskit është e shpeshtë.*
  33. *Përngjashmimi. – Dukuria e përngjashmimit të tingujve është e shpeshtë në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit. Vërehet asimilimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve, por më i shpeshtë është përngjashmimi i zanoreve, sidomos asimilimi i plotë në largësi.*
  34. *Përngjitja. – Dukuria e përngjitjes ka një përhapje të madhe në shqipen e fjalorëve në shqyrtim.*
  35. *Shtimi i tingujve. – Në tekstin shqip për të cilin po bëjmë fjalë ka një numër fjalësh me tinguj ose fonema të shtuara, të shprehura nëpërmjet grafemave. Kemi hetuar shtimin e tingujve në fillim të fjalës, në mes dhe në fund të fjalës.*
  36. *Rënia e tingujve. – Dukuria fonetike e rënies së tingujve në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit është më e shpeshtë sesa shtimi i tingujve. Gjuha e këtij autori i përket stilit të bisedimit dialektor, por edhe ky stil nuk është paraqitur me besnikëri, sepse ai qe autodidakt dhe duket se nuk e ka njohur aq sa duhet strukturën e fjalëve të shqipes.*

### **Larmia dialektore e shqipes së fjalorëve**

Gjatë shtjellimit të grafisë si dhe veçorive fonologjike e fonetike të paraleles shqipe të dy fjalorëve shumëgjuhësh të Gjergji Pulevskit na dolën në shesh një numër i madh veçorish gjuhësore që e karakterizojnë tekstin shqip në spikamë.

Për të nxjerrë përfundime të drejta vlejnë të përmenden disa fakte nga jeta dhe veprimtaria e Gjergjit. Kështu, nga shkrimet shqipe që ka lënë trashëgim, mund të konstatohet se Pulevski nuk e ka njohur mirë as edhe ligjërimin dialektor të shqipes. Ishte autodidakt dhe sipas gjithë gjasash pa njohuri për traditën e shkrimit të letrave shqipe. U end mjaft dhe nuk qëndroi për një kohë të gjatë as në vendlindje e as në ndonjë vendbanim tjetër. I ati e mori me vete në Rumani qysh kur Gjergji kishte vetëm shtatë vjet. Pati kontakt me shumë individë, pjesëtarë të të folmeve të ndryshme të shqipes. Njohu disa gjuhë ballkanike dhe tek ai u reflektua dukuria e ndërndikimit gjuhësor.

Nga jetëshkrimi për Pulevskin gjetëm mbështetje dhe arsyetim të tipareve dialektore të gjuhës së tij. Përgjithësisht, gjuha e Pulevskit është mjaft e larmishme nga aspekti dialektor. Duke e krahasuar shqipen e shkruar në Fjalorin Katërgjuhësh si dhe në Fjalorin Tregjuhësh me studimet dialektore për disa të folme shqipe, të përafërta me gjuhën e fjalorëve në shqyrtim, kemi ardhur në përfundim se:

a) Bazën dialektore të gjuhës së Pulevskit e përbën e folmja e vendlindjes së tij (e folmja e Rekës së Dibrës). Këtë e dëshmojnë, si bie fjala, mospërdorimi i fonemës /y/, përkatësisht zh buzorëzimi i saj në /i/ dhe diftongimi dytësor i saj; shpërbërja dytësore e zanores së theksuar [i] në [ëi] dhe e [u]-së në [ou]; mosshqiptimi i ndër hundshëm i zanoreve që gjenden ose janë gjetur pranë bashkëtingëlloreve hundore; dallimi i gjatësisë së zanoreve: në zanore të shkurtra e të mesme kundrejt zanoreve të gjata; rënia e laringales [h] në të gjitha pozitat e fjalës; defonologjizimi i kundërvënies ndërmjet çiftit të tingëllueseve dridhëse /r/ e /rr/; mosafrikatizimi i qiellzoreve [q, gj]; ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] përgjithësisht të parrëgjua; qiellzorëzimi i shpeshtë i prapagjuhores [g] në [gj]; mbizotërimi i zhvillimit të grupeve [pl, bl, fl] në [pj, bj, fj]; qiellzorëzimi i grupeve të vjetra konsonantike [kl, gl] në [q, gj] dhe mosafrikatizimi i tyre etj.

b) Prania e një numri të konsiderueshëm veçorish gjuhësore



tipike për toskërishten, si: përdorimi i /ë/-së në rrokje të theksuar; rotacizmi, shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore të fjalës; shquarsia e emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me temë në bashkëtingëlloret [k, g, h] me mbaresën –u; e pakryera asigmatike e foljeve në formën veprorë; përdorimi i lidhores e jo i paskajores gege, përdorimi i pjesoreve të toskërishtes si dhe shumë veçori të tjera.

c) në tekstet shqip të fjalorëve të Pulevskit aty-këtu hetohen edhe disa tipare të të folmeve të tjera të gegërishtes (e jo të të folmes së qarkut të Dibrës), veçmas të të folmeve të rrethit të Gostivarit e të Kërçovës, të cilat për nga sasia janë më të pakta. Zaten, shpeshherë vërehen veçori që janë karakteristike për grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore si dhe për disa grupe të tjera të folmesh, si p.sh. buzorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o]; monoftongimi i grupit [ue] në [u:], afrikatizimi i bashkëtingëlloreve mesgjuhore [q, gj] në [ç, xh]; përngjashmimi i rrallë i grupeve [mb, nd, ng] në [m, n, g e k]; qiellzorëzimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [tj] > [q] e [dj] > [gj] etj.

Në bazë të vëzhgimit filologjik, përmbledhtas, mund të themi se shqipen e fjalësve të Pulevskit e karakterizojnë:

a) *tipare fonetike e fonologjike, morfologjike e leksikore të të folmes së qarkut të Dibrës, të cilat mbizotërojnë;*

b) *tipare dialektore të të folmeve të tjera gege, që bashkëpërkojnë veçmas me të folmen e Gostivarit e të Kërçovës;*

c) *veçori dialektore të toskërishtes, dhe*

ç) *kalke, huazime e krijime fjalësh artificiale që nuk përkojnë me asnjë të folme shqipe.*

Një karakteristikë e përgjithshme e gjuhës shqipe të paraqitur në fjalorët nga autori në fjalë është konstatimi se ligjërimi shqip i Pulevskit është mjaft i ndikuar nga gjuhët sllave.

Format morfologjike të fjalëve në të dy fjalorët gjykojmë se nuk paraqesin ndonjë interes e as që kanë rëndësi të madhe për gramatikën e gjuhës shqipe, as për dialektologjinë historike të shqipes e as për historinë e gjuhës shqipe, përkatësisht për morfologjinë historike të shqipes. Kësaj mund t'i shtojmë edhe faktin se në përgjithësi veçoritë dalluese në rrafshin dialektor janë më të mëdha në fushën e fonetikës e të fonologjisë sesa në morfologji.

Posa të mënjanohen gabimet e shumta e të rënda në format

morfologjike të fjalëve shqipe, do të vërehet se baza morfologjike e gjuhës së tij është e folmja e vendlindjes, përkatësisht e folmja e Rekës së Dibrës.

Në lidhje me format rasore mund të themi se përdorimi i rasave në shqipen e fjalorëve në vështrim është shumë i pavend, saqë nuk kemi mundur të nxjerrim ndonjë sistem apo rregull për të parë mënyrën e përdorimit të tyre.

Në gjuhën e shkruar shqipe të Pulevskit kjo kategoria morfologjike e foljes na del e koklavitur, meqë autori nuk e ka njohur në thelb sistemin morfologjik të shqipes. Gabime janë bërë si në vetë, numër, kohë, diatezë, zgjedhim etj. Përgjithësisht, fjalorët janë shkruar në mënyrën dëftore. Përdorim më të madh gjejnë koha e tashme, koha e pakryer, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera dhe koha e ardhme.

Përgjithësisht mund të thuhet se shqipja e fjalorëve të Pulevskit është një “amalgamë gjuhësore artificiale”: një gjuhë popullore joautentike, një stil që dëshmon nivelin e ulët të njohjes së natyrës së shqipes, me përzierje të shqipes territoriale, me shumë ndikime të huaja joreale, pa ndarje morfologjike në shkrimin e fjalëve, përplot me kalke e krijime artificiale të autorit etj.

Duke pasur para vetes një përfaqësim të tillë të dobët të shqipes së një autodidakti, me grafi jokonsekuente e pa kritere të caktuara gjuhësore, kuptohet se e kishim mjaft të vështirë të gjejmë rregulla të përgjithshme për tërë sistemin gjuhësor të shqipes së fjalorëve. Megjithatë, jemi përpjekur të nxjerrim dhe t’i njoftojmë të interesuarit shqiptarë me tiparet kryesore të variantit shqip të të dy Fjalorëve.

Përkthimi, sintaksa dhe leksiku i fjalësve të Pulës mund të jetë edhe temë shqyrtimi më vete, ngase siç dihet, autori ka qenë njohës i disa gjuhëve sllave e joslave dhe nuk ka mundur t’i ruajë të paprekura kodet gjuhësore të gjuhëve që i ka ditur, por përkundrazi te ky na del shumë qartë në shesh dukuria e ndikimit ndërgjuhësor. Prandaj, kjo temë sociolinguistike është me interes të trajtohet. Dukuria e interferencës gjuhësore te individët shumëgjuhësorë është e njohur në gjuhësinë e zbatuar. Ne me këtë rast do të përpiqemi t’i vijëzojmë veçoritë themelore të përkthimit, sintaksës si dhe të leksikut të idiolektit shqip të Pulevskit.

Marrë në tërësi, fjalitë shqipe janë përkthim nga paralelja e tekstit

në gjuhën sllave. Por, megjithëkëtë, fund e krye fjalorët i karakterizon përkthimi “robërisht besnik” (ad literam), që e dëmtoi shumë tekstin shqip të fjalorëve. Kështu, Pulevski krijoi trajta e konstrukte të pamundshme në shqipe. Për mosnjohjen e natyrës së shqipes si dhe bastardimin e saj nga ana e autorit dëshmojnë mjaft qartë edhe përkthimi i disa përshtetjesh dhe i shprehjeve përshtetëse në faqet 75-78 të Fjalorit katërgjuhësh. Ka fjali ku edhe kuptimi (semantika) i tyre është mjaft i errët. Sasia e çrregullimeve semantike, përveç pështjellimeve të tjera të shumta gjuhësore (fonetike, fonologjike, morfologjike, sintaksore) është shumë e madhe, zaten e kanë përfshirë tërë idiolektin shqip të Pulevskit.

Si njohës i përciptë i disa gjuhëve, si duket, Pulevski me belbëzimin e tij në shqipe është shembull tipik i përzjerjes gjuhësore. Në këtë pikëpamje, shumë gjurmë të gjuhëve sllave shihen në gjuhën e shkruar shqipe të këtij autori; gjurmë të shqipes në idiolektin e sllavishtes së tij, por edhe gjurmë të greqishtes e të turqishtes në dy gjuhët e përmendura. Praktikisht, gjuha e Pulës është **një amalgamë gjuhësore sllave - shqipe - greke - turke**. Kjo përzjerje gjuhësore vërehet në të gjitha rrafshet, si në fonetikë e fonologji, morfologji, leksik e sintaksë. Nuk është i vogël edhe ndikimi sintaksor i shqipes në paralelen e shkruar të maqedonishtes.

### Literatura:

- Çabej, Eqrem (1968), “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555) I, Tiranë.
- Dodi, Anastas (1990), *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2/1990, Tiranë.
- Конески, Блаже (1986), *Македонскиот XIX век*, Јазично и книжевно-историски прилози, Скопје.
- Хамити, Аслан (1995), *Реципрочното влијание на македонскиот и албанскиот јазик во речницитѝе на Пулевски*: Македонскиот јазик во XIX век, Скопје: 215-222.
- Хамити, Аслан (1996), *Албанскиот јазик во речницитѝе на Пулевски*: Јазичите на почвата на Македонија, МАНУ, Скопје: 177-185.

Hamiti, Asllan (2000), *Disa veçori fonetike dhe fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit: Shqyrtime albanologjike* 6, Shkup: 161-176.

Hamiti, Asllan (2005), *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup.

Конески, Блаже (1959), *Кон македонската ѓрероѓба: Македонските учебници од XIX век*, Институт за национална историја, Скопје.

Конески, Блаже (1986), *Белешки за Пулевски: Македонскиот XIX век*, Јазично и книжевно-историски прилози, Скопје: 225-230.

## 1.4. VËZHGIME PËR SHQIPEN E PËRKTHYER NË DY FJALORËT E GJORGJI PULEVSKIT<sup>13</sup>

### Abstrakt

Në këtë punim do të trajtojmë variantin e shqipes së përkthyer në dy fjalorët e Gjorgji Pulevskit. Autori ka qenë njohës i disa gjuhëve sllave e josllave dhe nuk ka mundur t'i ruajë të paprekura kodet gjuhësore të gjuhëve që i ka ditur, por përkundrazi te ky na del shumë qartë në shesh dukuria e ndikimit ndërgjuhësor. Dukuria e interferencës gjuhësore te individët shumëgjuhësorë është e njohur në gjuhësinë e zbatuar. Ne me këtë rast do të përpiqemi t'i vijëzojmë veçoritë themelore të përkthimit, sintaksës si dhe të leksikut të idiolektit shqip të Pulevskit.

Marrë në tërësi, fjalitë shqipe janë përkthim nga paralelja e tekstit në gjuhën sllave. Ka raste kur ky përkthim, qoftë në Fjalorin katërgjuhësh, qoftë në Fjalorin tregjuhësh, është i qëlluar, kuptohet me bazë gjuhësore të të folmes së Dibrës me rrethinë. Por, megjithkëtë, fjalorët i karakterizon përkthimi “robërisht besnik” (ad literam). Në këtë pikëpamje, shumë gjurmë të gjuhëve sllave shihen në gjuhën e shkruar shqipe të këtij autori; gjurmë të shqipes në idiolektin e sllavishtes së tij, por edhe gjurmë të greqishtes e të turqishtes në dy gjuhët e përmendura.

**Fjalë kyçe:** fjalor, përkthim, ndërndikim, strukturë

### Observations on two translated into Albanian language dictionaries Gjorgjija Pulevski

#### Abstract

This paper will discuss the Albanian version of the translated Albanian in the two Gorgji Pulevski dictionaries. The author has spoken some of the non-Slavic and Slavic languages and was unable to keep intact the language codes aware of it, but instead of this it appears very clearly to light the impact of lingual phenomenon. The phenomenon of linguistic interference of multilingual individuals is known in applied linguistics.

---

<sup>13</sup> Kumtesë imja e botuar në revistën shkencore ndërkombëtare Albanologjia, vëll. 4, nr. 7 (ISSN 1857-9485), Universiteti i Tetovës, 2017, f. 31-48.

In this case we will try to show the basic translation features, syntax and vocabulary of Pulevski.

In general, the Albanian sentences are translated from parallel text in Slavic. There are times when the translation, whether in the four languages dictionary, either trilingual vocabulary is targeted well, of course with base language of the Dialect of Debar and surroundings. But, besides, dictionaries of translation characterizes “faithful captives” (ad literam). In this view, traces of Slavic written language are evident in the Albanian language of this author; sings of the Albanian footprint in the Cyrillic, but also traces of Greek and Turkish.

**Keywords:** dictionary, translation, interference, structure

Pulevski ishte njohës i disa gjuhëve sllave e josllave dhe nuk ka mundur t’i ruajë të paprekura kodet gjuhësore të gjuhëve që i ka ditur, por përkundrazi te ky na del shumë qartë në pah dukuria e ndikimit ndërghjuhësor. Dukuria e interferencës gjuhësore te individët shumëgjuhësorë është e njohur në gjuhësinë e zbatuar. Ne me këtë rast do të përpiqemi t’i vijëzojmë veçoritë themelore të përkthimit, sintaksës si dhe të leksikut të idiolektit shqip të Pulevskit.

Marrë në tërësi, fjalitë shqipe janë përkthim nga paralelja e tekstit në gjuhën sllave. Ka raste kur ky përkthim, qoftë në Fjalorin katërgjuhësh, qoftë në Fjalorin tregjuhësh, është i qëlluar, kuptohet me bazë gjuhësore të të folmes së Dibrës me rrethinë, nëse ua heqim këtyre gabimet e shumta gjuhësore të natyrës grafike, fonetike, fonologjike e morfologjike. Në fjalorin e fjalëve, përkatësisht në Fjalorin katërgjuhësh përkthimin e kemi më të mirë. P.sh.: sllavisht *reka, reku* – shq. *lumi*, sll. *potok* – shq. *prua, proa* I 16; sll. *mostovi* – shq. *urat* I 18, sll. *jazovi* – shq. *vijat* I 18; por kur Pulevski ka krijuar tekst, kuptohet në Fjalorin tregjuhësh, ai aty është më pak i suksesshëm: sll. *znanja na mnogu jezika* – shq. *ma shum gjuha ta dijm* (njohja e shumë gjuhëve) II 3 etj.

Por, megjithkëtë, fjalorët i karakterizon përkthimi “robërisht besnik” (ad literam), që e dëmtoi shumë tekstin shqip të fjalorëve. Kështu, Pulevski krijoi trajta e konstrukte të pamundshme në shqipe. Kjo mund të vërehet gjithkund në tekstin e Fjalorit tregjuhësh. Krahaso: paralelen në gjuhën sllave “*Za tova treba da se zbered od svi napred rečeni narodnosti po 4-5 ludi učen, koji go poznavajed jezikod majčin*

*çisto.*” me atë në idiolektin e tij shqip “*Prë ajo duhet ta u mbledhim nka njerazisë shkipinisht nka xhithë fisat nka 4-5 njerji msoum, cili poenjofin giuha te nonas pastër*” II 124. Ose: “*No, kako biduvad den i noç, koga je taka kako çto velish, kazhi mi*” – “*Apo si bojet dit edhe natn, kur ashtë ashtu si çush e tha, diftom mu*” II 71. “*Drugi biduvajed lovxhiji i lovad zhivotinje i ribi, pak ji prodavajed i za parite si kupuvajed zhito i drugi potrebi za da se ranad i oblekuvajed*”. - “*Qetër u bojet gjetar edhe gjonte zhallura edhe peshka, opet po e shesin edhe prë ollat bjen drith edhe qetër çish po e duhet po prë ta ushqeen edhe ta veshin*”. II 55 etj. etj.

Për njohjen jo të mjaftueshme të shqipes dëshmojnë mjaft qartë edhe përkthimi i disa përsëndetjeve dhe i shprehjeve përsëndetëse në faqet 75-78 të Fjalorit katërgjuhësh, si bie fjala: “*E ka kallzova shindet me të gjith*” (për: Keni të fala nga të gjithë). *Kija ka bone shindet* (për: Ai të ka përsëndetur). *Prune shindet, bone shindet* (për: I bën të fala). *To boftë mir fituum* (p.sh. si kalkim: Të bëftë mirë fjetja, gjumi; përkatësisht sipas natyrës së shqipes: Gjumë të rehatshëm!). *Moti shkofsha* (për: vjet, vitin e kaluar) etj.

Ka fjali ku edhe kuptimi (semantika) i tyre është mjaft i errët, si p.sh.: “*Të thati gjikunde edhe xhithi apo gjith se si ashtë nuk*” II 20; Pyetje: “*Prse bojet ndë venden edhe po nuk ashtë pemna sesi gjikunde?*”, Përgjigje: “*Nka ato bojet nja nka trolli prse nuk ashtë gjikunde se si qeter nka brezi eras*” II 22 etj., etj.

Në shqipen e Pulevskit, ndodh që edhe fjalët të përkthehen gabimisht dhe për pasojë të ketë pështjellim kuptimor të tërë fjalisë, si “*Cilj madem, jan mashum marunvesht edhe mashum të duhet prë neve*” II 26 ... Për të kuptuar domethënien e fjalive të këtilla, lexuesi do të detyrohet ta lexojë fjalinë gjegjëse edhe në gjuhë të tjera të përfaqësuar në fjalorë. Me këtë rrugë, kuptuam se fjalja e saposhënuar ka këtë domethënie: *Cilat xehe janë më të përhapura* (gjenden në sasi më të mëdha në tokë) *dhe më të nevojshme?*

Sasia e çrregullimeve të këtilla semantike, përveç pështjellimeve të tjera të shumta gjuhësore (fonetike, fonologjike, morfologjike, sintaksore) është shumë e madhe, zaten e kanë përfshirë tërë idiolektin shqip të Pulevskit. Ja edhe disa përkthime fjalësh pa përputhshmëri semantike: sll. *najposle* – shq. *ma posht vend* (do të duhej: më në fund) I 88; sll. *Bllagovec* – shq. *amëlzani dita* (kalk nga “*bllago*” – ëmbël) I 13; sll. *bllagodarim* – shq. *të çofsha, të paça* (për: faleminderit!) I 77;

sll. *jug* – shq. mesdit (për: jug); *rugdoni* (për shërbehuni, merrni diçka për të ngrënë ose për të pirë); *bjemun* (për: përkthyer); *besoshin ashtë* (për: beson se..., i bindur është) II 153; *navoi* (për: fatkeqësi, pafatësi) II 12 etj.

Përveç ngatërimeve të shumta, në faqen 92 të Fjalorit tregjuhësh kemi hetuar një përpjekje të vogël të autorit për t’iu shmangur përkthimit të fjalëpërfjalshëm dhe për të bërë njëfarë përshtatje tematike ose të mbajë një origjinalitet tematik, varësisht nga gjuha në të cilën shkruan. Kështu, kur bën fjalë për huazimet leksikore në të tri gjuhët (në gjuhën maqedonase, shqipe e turke) shënon leksema krejtësisht të tjera. P.sh. në kolonën e maqedonishtes shkruan: “*Tugji zborovi se ami, frishko, onomad, par i priçija*”. Në kolonën e shqipes shkruan: “*Vetmi fjal jan jeshil, kapacina, profet edhe kallo*”. Pastaj vazhdon më tutje, duke i shpjeguar këto huazime, varësisht nga gjuha dhe fjalët që i ka shënuar për të huaja, si maq. *ami* – thotë se është fjalë greke, ndërsa në shqipen: “*jeshil ashtë fjal turqisht, apo na thom verdh*” dhe kështu vazhdon më tutje.

Si njohës i përciptë i disa gjuhëve, si duket, Pulevski është shembull tipik i përzierjes gjuhësore. Në këtë pikëpamje, shumë gjurmë të gjuhëve sllave shihen në gjuhën e shkruar shqipe të këtij autori; gjurmë të shqipes në idiolektin e sllavishtes së tij, por edhe gjurmë të greqishtes e të turqishtes në dy gjuhët e sapërmendura. Praktikisht, gjuha e Pulës është **një amalgamë gjuhësore sllave - shqipe - greke - turke**. Kjo përzierje gjuhësore vërehet në të gjitha rrafshet, si në fonetikë e fonologji, morfologji, leksik e sintaksë. Krahaso paralelen sllave me atë shqipe: “*Starite ludi napred ubivale zhivotinje i od mesoto zhivotinjsko se ranile a so kozhite od zhivotinjeto se oblekale*” – *Njerazi të vjetër nka para e u vrvan zhallura edhe nka mishin zhallurisë e ushqeshin*” II 57. Në këtë periudhë të togfjalëshi “*mesoto zhivotinjsko*” hetohet ndikimi i shqipes në sintaksën e maqedonishtes, sepse në maqedonisht mbiemri – përcaktori përdoret para emrit të përcaktuar, pra sipas natyrës së maqedonishtes do të kishim “*zhivotinsko meso*” e në shqip “*mish gjedhash, mish kafshësh*”. Për ndikim leksikor mund ta marrim përkthimin “*njerazi të vjetër*” si kalk nga maqedonishtja “*starite ljudi*”, ngaqë në shqipen duhej të ishte “*njerëzit e egër a të paqytetëruar*”. Në shqipen e Pulevskit lexojmë: “*Faqe, të trollis, krkunde ashtë grijtun, edhe nalt, apo krkunde, ashtë, u hoq, agje, ku ashtë, u ngritun, trolli, that, ashtë, sëi thatsira, apo kuashtë, uhoq, plot, ashtë, menji*” e në



paralelen maqedonase “*Liceto, od zemjave, nekade je, izdignato, suva zemlja je, ili, suvota, a kade je, zgrofnato, plno je so roda*” II 18 etj.

Ndikimi i maqedonishtes në sintaksën e shqipes së fjalorëve në shqyrtim vërehet më së shumti në vendin e përcaktorit dhe gjymtyrës së përcaktuar. Kështu, sipas natyrës së gjuhës shqipe në ligjërimin asnjës përcaktori (cilësori, mbiemri, atributi) vihet rregullisht pas fjalës së përcaktuar, përveç në disa raste kur cilësori do të vihet në spikamë ose për qëllime stilistike në letërsinë artistike (zog i shkretë – i shkreti zog). Në konstrukte të këtilla disa herë kemi hetuar përdorimin e përcaktorit para gjymtyrës së përcaktuar, të cilën e konsiderojmë për analogjike me të maqedonishtes. P.sh. *vogl zhallura – sitni zhivotinje* (për gjallesat e imta) II 18, *thati trollis – suvota zemlja* (për: tokë e thatë) II 20, *qetër shumë – mnogu drugi* (për: shumë të tjera) II 25, 32, 35, 56 etj.; *ran mademi – teshka ruda* (për: xehe e rëndë) II 27, 54, 56; *ma fort enten – najaki sudovi* (për: enë më të forta, më të qëndrueshme) II 28; *ma madhe peshka – pogolemi ribi* (për: peshq më të mëdhenj) II 35; *fort shtëpija – jaki kuqi* (për: shtëpi të forta, shtëpi të ndërtuara me material të fortë) II 54, 55 etj.

Nuk është i vogël edhe ndikimi sintaksor i shqipes në paralelen e shkruar të maqedonishtes. Në maqedonishte, siç u theksua, rëndom përcaktori përdoret para gjymtyrës së përcaktuar, e në gjuhën shqipe topika e tyre është e anasjelltë. Nisur nga kjo, konstruktet si: *svetila mali* (dritin vogl, drita të vogla) II 7, *svetilata nebesni* (dritin të çillas, dritat e qiellit; përkatësisht dielli, hëna dhe yjet) II 7, *kitovi morski* (balenat e detit) II 8; *ribite morski* (peshqit e detit) II 9; *pilcite nebesni* (zogjtë e qiellit) II 9; *dushi nashji* (shpirtërat tanë) II 10, *rodninjeto nashi* (fiset tona) II 14; *ruda bela* (xehe e bardhë) II 28 e shumë shembuj të tjerë.

Në faqen 33 të Fjalorit tregjuhësh në maqedonisht kemi lexuar: “*Çaji je bilka od niski rastenija ...*”, ku emri *çaji* në rolin e kryefjalës ka nyjën shquese **-i** të gjuhës shqipe. Në maqedonishten, sipas rregullave ky emër në trajtën e pashquar është në formën *çaj*, ndërsa në të shquarën *çajot*. Në fjalinë në shqyrtim ky emër duhej përdorur në trajtën e shquar *çajot*. Trajtën *çaji* në maqedonishte e kemi parë edhe në II 34, të cilën e kemi marrë për ndikim të shqipes në nyjën shquese.

Në bazë të studimeve gjuhësore është përdëftuar se forma më e shpejtë dhe më masive e ndikimit ndërgjuhësor është huazimi leksikor. Kështu, edhe në fjalorët e Gjergjit, në ndikimet ndërgjuhësore që janë pasojë e plurilinguizmit individual të autorit, në të gjitha rrafshet,

padyshim leksiku zë një vend mjaft të rëndësishëm. Aty do të gjejmë një numër të madh fjalësh që janë të përbashkëta për shqipen, maqedonishten, turqishten e greqishten si dhe për gjuhët e tjera ballkanike; pastaj huazime leksikore sllave në gjuhën shqipe, albanizma në paralelen e maqedonishtes, orientalizma e greqizma në shqipen e sllavishten etj. Me këtë rast nuk do të shtjellojmë këtë çështje në mënyrë të shtruar, por do të mjaftohemi vetëm me paraqitjen e disa huazimeve leksikore të vëna re në fjalorët e Pulevskit.

Ja disa huazime leksikore sllave në shqipen e fjalorëve të Pulevskit: *opet* (përsëri, rishtas) II 18, *kipat* (balenat) II 8, *allat* (mjet, vegël) II 26, *korav* (i egër, i thyeshëm, i ngurtë, joelastik) II 26, *kozhok*, *kozhuf* (gëzof) I 30, *bivlic* (buallicë) I 41, *zhab* (bretkosë) I 51, *kral* (mbret), *ogradar* (punues i rrethojave kopshtare) I 56; *tërkall* (rrotë) I 57, *çasha* (gotë) I 87, *komshi* (fqj) II 103 etj. Mirëpo, vlen të theksohet se në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulës ndeshim më pak sllavizma sesa në gjendjen e sotme të të folmes shqipe të Dibrës dhe të qarkut të saj. Kjo do të thotë se përgjithësisht sasia e sllavizmave në të folmet shqipe në Maqedoni dikur (në rastin tonë në shekullin XIX) ka qenë më i vogël sesa sot dhe se numri i tyre është shtuar proporcionalisht me rrjedhën e kohës.

Në shqipen e fjalorëve të Pulevskit kanë një numër të konsiderueshëm huazimesh leksikore orientale, si p.sh. *ikram* (kujdes, përkujdesje) II 11, *tamin*, *tahmin* (kuturu, jo saktësisht) II 14; *ise*, *hise* (pjesë, pjesëmarrje në diçka), *ada* (ishull) II 20; *azar*, *hazër* (gati) I 87, II 30; *jeshil* (i, e gjelbër) II 31, *teneqe* (llamarinë) I 20, *terzi* (rrobaqepës) I 20, *penxhere* (dritare) I 34, *saatçi* (orëndreqës), *eqim* (mjek) I 56, *shart* (rregull, ligj, parim) I 58, *nishan* (shenjë) I 61, *zengin* (i pasur) I 69, *xhenaze* (kufomë) I 74, *jabanxhi* (i huaj) I 74, *dakik* (minut) I 85, *imza* (nënshkrim) II 101, *sheherli* (qytetar) II 107, *zehër* (helm) II 27, *asker* (ushtar) I 56; *haps*, *aps* (burg) I 56 etj. Përgjithësisht, mund të thuhet se pjesa më e madhe e këtyre orientalizmeve edhe sot e kësaj dite përdoren në të folmen e Dibrës e më gjerë, por këta dy fjalorë nuk janë shumë të vërshuar me orientalizma. Ndonjë prej tyre tani më ka kaluar në leksikun pasiv të shqipes dhe janë historizma, si fjalët *eqim*, *imza* etj.

Ndikimet ndërgjuhësore të gjuhëve në kontakt nuk bëhet vetëm në njërën kahje. Nga kjo rrjedh se edhe shqipja ka ndikuar në leksikun e sllavishtes së Pulevskit. Kemi regjistruar disa albanizma që kemi mundur t'i hetojmë në paralelen e maqedonishtes së fjalorëve të

Pulevskit: *farosh* (enë ku ruhen farat) I 34; *specare* (enë ku ruhet biberi i specave) I 35, *vatra* I 38, *lopar* (bari lopësh), *plluk*, *pllug* I 57; *leshta*, *lesha*, *leshi* I 49, *përç* II 93, *buzi*, *buzët* II 37, *kokar* (ndoshta nga kokërr ose kokë, meqë qepujka del në kokë, në krye të qepës, qepujkë) etj.

Edhe greqishtja merr pjesë në interferencën gjuhësore të gjuhëve të përfaqësuara në fjalorët e Gjergjit. Për greqizma i kemi konsideruar fjalët *metron* (matë, peshon) II 16, *gjoll* (liqen) II 18, *as*, *aspër* (para, monedhë) II 28, *kallogjer* I 25; *pras*, *praz* I 50, *daskall* (mësues) I 59 etj.

Do përmendur se huazimet leksikore përbëjnë një nga veçoritë leksikore të gjuhës së fjalorëve të Pulevskit. Megjithkëtë, karakteristikë kryesore e leksikut të shqipes së fjalorëve të tij është ajo se autori për nevojat e përkthimit më tepër krijoi fjalë të reja (neologjizma) sesa që huazoi.

Fondi leksikor i fjalësve të këtij autori është i kufizuar. Ai gjatë përkthimit ndonjë fjalë e ka përdorur me vend, por shpeshherë krijoi edhe shumë fjalë të tjera në mënyrë artificiale: disa nga to janë kalke, disa krijim i paqëlluar i autorit me brum të shqipes, shpeshherë emërzoj folje etj. Sasia e fjalëve të këtilla është shumë e madhe, por ne do t'i shënojmë vetëm disa nga to që na u dukën më interesante, si *thatiuis* (ujëtokësorët) II 35, *çerrexhi* (qerrepuues), *bukatar* (bukëpjekës) I 56; *dhentar*, *delar* (delmer) I 55, 93; *fjorar* (artar, argjendar) I 56, *peshkëzintar* (peshkatar) I 56, *kart çoar* (kolporter, postier); *ka kor*, *ka korr* (korrës), *eshkatar* (qymyrxhi), *derrar* (bari derrash); *vorxhi*, *vorrxhi* (mihës i varreve, varrgërryes, varrmihës) I 56, *çamena* (ankesa) I 68, *në gjims moti* (njeri në moshë mesatare, në gjysmë të jetës së tij, 30-40 vjeç) I 70, *bjevar* (blerës, konsumator) I 88; *shkrujtar*, *libërtar* (shkrimtar, autor librash) II 56, *shkruitar kanga* (shkrimtar këngësh, poet) II 121, *vishillontar* (fishkëllues, muzikant), *ritetun* (bimët) II 59; *pamarvesht* (i paarsimuar, i paditur) II 60, *pajtoshtar* (kontratues, palët që lidhin kontratë) II 101; *kuvisor*, *thoishtor* (kontratë) I 96; *shkruitar* (sekretar) II 109, *shkronjisora* (alfabeti) II 110, *msujesori* (shkencë, dije) II 122, *çelznica* (çelësndreqëse, punëtori për ndreqjen e çelësave) I 33, *liberti vrtetun çashtus* (libri i verifikimit të gjërave, i konfirmimit të të vërtetave, pra libri i historisë) II 33; *kaurat*, *kaurrat* (gaforret) II 35; *lontor*, *pçellme* (pjellore, frytdhënëse) II 22, 61; *pajtomea* (çmimi) II 28, *paradiftoshin* (profet) II 32, *kartë kallzumea të fala* (letër përshëndetëse, kartë postale) II 94, *telin shkronja* (telegram) II 96, *fajtor vet* (dorëzan, zhirant) II 100, *fajtorvet* (borxhli), *dhimsetar* (të

mëshirshëm, mëshirues) II 37, *gojas amle* (gojëmbël) II 37, *shokunismet* (shoqërimet) II 49, *mishishitme* (mishtore) I 19, *shesmntar* (shitës) I 88, *endejtmeja* (foleja, çerdhja), *voci mretit* (biri i mbretit, princi) I 53, *koka askerit* (vojvoda, prijësi, komandanti) I 53, *bomun faq* (dyfytyrësi) I 81, *faqe* (personalitet), *granmea* (ushqimi), *ipmea* (kalurimi) II 156, *besoshin ashtë* (i bindur është) II 153, *gjizar* (njeri që ka për profesion përpunimin ose shitjen e gjizës) II 152, *vetzanisë* (zanore) II 116, *emin edhe prmi emin* (emrin dhe mbiemrin) II 109, *shkelmea* (shkallët), *deshur* (rrobat), *murar* (murator) I 99, *krtolla* (patate), *pashmea* (drita) II 76, *ujtor* (enëlarëse, orendi shtëpiake ku lahen enët) II 92, *brinjiundas* (rinoqer) II 60, *zhallishkrujtor* (jetëshkruës, biograf) II 58, *ulindmeja* (fruti), *drejtumea* (të drejtuarit, qeverisja, jurispodenca), *epmea* (tatimi), *tufalshin* (shkathtësi, prirje, aftësi e lindur) II 36, *pou gjeg* (piqet) II 31, *pektun* (lëgurë metalesh, bashkëshkrirje) II 29, *trullin shkrumea* (gjeografia), *larojtar* (lavruës, bujk), *rugdoni* (shërbehuni) etj.

Përgjithësisht, edhe fusha e leksikut, si edhe e rrafsheve të tjera gjuhësore pasqyrojnë gjuhën e një individi. Ajo nuk e paraqet me besnikëri shqipen e folur të shekullit XIX në anët e Maqedonisë perëndimore. Megjithë shumë pështjellime, gabime e paqartësi që ka gjuha e këtij autori, ajo mbështetet në të folmen e Dibrës dhe të qarkut të saj.

Tipar tjetër i leksikut të shqipes së fjalorëve të Pulës është edhe përdorimi i herëpashershëm i sinonimeve për të shpjeguar e qartësuar më mirë fjalët. Kjo mund të konsiderohet edhe si përpjekje e autorit për t'i kapërcyer kufijtë vendorë dhe vepra të ketë karakter më të përgjithshëm e përdorim më të gjerë. Ja disa sinonime të shënuara në Fjalorin katërgjuhësh e në Fjalorin tregjuhësh: *koka*, *krea*, *kaptina* I 21; *qime*, *flok* I 21; *tamlë*, *qumsht* I 39; *gati* asht, *azër* I 40; *gomar*, *magjar* I 40; *petrit*, *skifter* I 45; *livoshka*, *likura* I 45; *kaprull*, *dree* I 47; *dhelbun*, *skile* I 48; *dac*, *maçurek* I 48; *xhamxhi*, *qelqexhi* I 55; *rafme*, *liftome* I 58; *kartë*, *letra* I 60; *tat*, *ati*, *baba* I 63; *kumri*, *gugushka* I 44; *cuc*, *çup*, *gac* I 70; *djal*, *çun*, *voc* I 70; mos u *frik*, mos u *tut* I 80; *vështro*, *çillo* I 34; *punc*, *bunar* II 16; *gropa*, *vrma* II 16; *prëpjet*, *tërma* I 17; *katund*, *vshat* I 17; *robe*, *petka* I 29; *fjal*, *kuvend*, *llaf* I 81 etj.

Dy fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit, vështuar në tërësinë e trashëgimisë tonë leksikografike, edhe pse nuk meritojnë të zënë ndonjë vend qendror, por për periudhën kohore në të cilën u botuan, meritojnë të përmenden në kuadrin e fjalorëve shumëgjuhësh të kohës dhe përgjithësisht të shënohen në historinë e leksikografisë shqiptare.

Vështruar në retrospektivën kohore, fjalorët patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këta Fjalorë, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm (por jo autentik) për të parë ndikimet ndërghjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike. Dy fjalorët kanë edhe vlerë historike për shkencën albanologjike, veçmas për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi.

## FRAGMENTE NGA DY FJALORËT

РЕЧНИК ОТЪ ЧЕТИРИ ЈЕЗИКА		
I. Српско-Албански.		
II. Арбански-Арнаутски.		
III. Турски.		
IV. Грчки.		
Београдъ, 1873		
FJALOR KATËRGJUHËSH: sllavisht-shqip-turqisht-greqisht		
Српско-албански sllavisht	Арбански shqip	Transliteruar me alfabetin e sotëm të shqipes
Одамна не суве виделлъ, нисамъ васъ видео	Шумъ вактъ ка, метисунъ упоча	shum vakt ka, metisun upoça
Нисамъ се састао	Сунъ упоча	sun upoça
Збогумъ господине	Ламъ те меръ затуни	lam te mer zatuni
Опростите молимъ васъ	Шумъ телутемъ ть мафалишъ	shum telutem tëmafalish
Простите, опростите	Ть фалма	të falma
Здрагомъ духомъ	Премије кретекомъ	premiije kretëkëm
Мошне су подврзанъ врлло самъ обвезанъ	Шумъ тијемъ гь зоумъ	shum tijem gëzoum
Драговолно	Екамъ кандисунъ	ekam kandisun
Благодаримъ	Теѳофша	teqofsha
Благодаримъ вамъ	схумъ шиѳиръ бона прѳтеи	shum shiqir bona prëtei
Опроштѳнѳ	Уфалма	ufalma

Подпоможува	Тандифи	tandifi
Христосъ се роди	Кришти улее, упулѣ	Krishti ulee, upull
Христосъ се крсти	Кришти круѣтимъ, пагезотни	Krishti kruqtim, pagezotni
Христосъ воскресе	Кришти унѣаллѣ	Krishti ungjall
Истина воскресе	Вртеунѣаллѣ, унгрить	Vrteungjall, ungrit
Данашни за многу година	Сотасъ прешумъ вѣтъ	Sotas preshum vjet
Се фалить, валисе	Лавдирохетъ	Lavdirohet
И до година со здравје	Нѣрънѣмотимот мешиндет	njerënmotimot meshindet
Благодаримъ, фалла	Тѣ пача, тефалемъ	të paça, tëfalem
Честато, среѣно	Нгати ѣофшѣ	ngati qofsh
Поспешнати, среѣан радѣ	Пунамбарѣ	punambar!
Доборѣ потѣ, среѣанѣ путѣ	Улламбарѣ	udhambar!
Да богѣ да	Мбарѣ пачѣ	mbar paç!
Наздравје	Мешиндетѣ	meshindet!
Наздравје брианѣ	Мешиндетѣ, бофте миръ	meshindet, bofte mir
Приятанѣ ручакѣ	Тѣбофтемеирѣ	tëboftemejr
Мравя, мравка	Миза труллы	miza trulli
Пајачина, паучина	Мармага	marmaga
Коњска мува	Мизѣ кали	miz kali
Вошка, ушѣ	Мора	mora
Балла, бува	Пѣштѣ	pjesht
Пчелла, челла	Бѣтѣ мялти	gjet mjalti
Улиште, стрмки	Бѣтѣ	bjet
Оса, осу	Гренасѣ	grenas
Брѣмбалецѣ, бумбарѣ	Бумбаллѣ	bumball
Скакулецѣ, скакавецѣ	Кацимардѣ	kacimard
Пеперуга, лептирь	Фјютурѣ	fjatur
Критѣ, кртица	Уринтѣ	urinth
За прозорѣ	Препенцере	prepenxhere
Кутии на врата, футери	Току дерасѣ	toku deras

Долны бой, долны спрать	Штруар тепосхть	shtruar teposht
Подь, патось	Штруарь медраса	shtruar medrasa
Ключеви, чивиллукъ	Кунять	kunjat
Покривачь, крофь	Мьльмоея	mëlomeja
Зидь, зить	Мурь	mur
Полица, рафь	Мекуня	mekunja
Подполица, исподь рафа	Нань мекуня	nan mekunja
На полица, на рафу	Макуня	makunja
Прагь	Прагудерась	praguderas
Одая, соба, собу	Ода	oda
Затвори	Мьшиле	mëshile
Удри	Бини, бѣри	bini, bjeri
Клеть, подрумь	Буркь, ħурь	burk, qur
Скрибница, сокровиште	Емче орать	emçe orat
<b>Потреба - nevojë</b>		
Трьлло, оборь, кошара	Трьлла	trëlla
Котарь, оградакъ	Котарь	kotar
Строга, лочилиште	Вадсь	vath
Стригарница	Кечедсиндеть	keçethindhjet
Бачилло, стань	Стани	stani
Макази	Грьшань	grëshan
Крьлукъ, кукача	Зеурь, крьликъ	zeur, krëlik
Палець	Гишти зеурить	gishti zeurit
Белег, белешка	Шкаллъ	shkall
Катрань	Катрань	katran
Арань, арарь	Арарь	arar
Ягнилло	Ентућель денть	entuqell dhent
Стрикь	Ентуи чедсь	entui çeth
Разллокъ	Ентујдаа	entujdaa
Бачь, станарь	Станарь, бачь	stanar, baç
Фичурь	Шегрьтистанарить	shegrëtistanarit
Одацияа	Одаџи	odaxhi
Ѓеая, скотоводецъ	Чехаи	çehaj
Настоиникъ	Урдуноарь	urdhunoar
Офчари, чобани	Делари	delari
Бутинь, бутлача	Мутаи	mutaj



Каџи	Шегать	shegat
Плотъ, плетъ	Гартъ, крѣпешъ	garth, krëpesh
Мьллзи, музи	Мили	mili
Мьллзетъ, музу	Миле	mile
Броитъ, броју	Метронъ, мѣлинь	metron, mjelin
Брои, преброи	Метроо, мѣле	metroo, mjele
<b>Потврђенъ – pohime, verifikime</b>		
Вистина, доисто	Врѣте	vrëte
Такаје, такојесъ	Асхту асхтъ	ashtu asht
Није таке, није тако	Сьштъ аштѣ, нукује	sësht ashtu, nukuje
Богами	Преперенди	preperendi
Такоми госпотъ	Прѣзоти	prëzot
Животами	Прѣумъръ име	prëumër ime
Таколюбезни	Аштѣ димсетаръ	ashtu dhimsetar
Дусхе ми	Прѣшпиртъ	prëshpirt
Дусхо	Шпиртъ	shpirt
Адусхо	Орѣ шпиртъ	or shpirt
Тврѣдаје вера	Бесабесъ	besabes
Вереме	Беса	besa
За богами	Прѣшарт име	prëshart ime
Тако ми бога вискѣнга	Прѣтата налт	prëtata nalt
Коиси	Цилије	cilije
Никога, никојега	Куркѣндъ, асњани	kurkënd, asnjani
Евеме	Чеунъ куямъ, лепе	çeun kujam, lepe
Ясу, ясамъ	Ун ѣмъ	un jam
Мнозина, многихъ	Шумѣянъ, иштешумъ	shumëjan, ishteshum
Многу, млого	Шумъ	shum
Грѣшка, погрѣшка	Фаи, фава	faj, fava
Грѣшки, погрѣшки	Фаја, фајатъ	faja, fajat
Грѣшено	Фаитуръ аштѣ	fajtur asht
Грашиллъ, погрѣшијо	Кабо фаи	kabo faj
Грѣшиле, погрѣшили су	Канъ бо фаы	kan bo faj
Простите	Фални	falni
Величество	Мети, мадъ	meti madh
Свои	Тѣ ветинъ	të vetin
Овамо, аамо	Кѣнде	kënde



Отоде, отуда	Ђеандеи	qeandej
Одоваде, отуда	Ђекату	qekatu
Одспротия, спротия	Пратеи	pratej
Вась	Ју	ju
Ваше	Јюве	juve
<b>Мери – masa</b>		
Ока, оку, е	Ньюкъ, оке	njiok, oke
Трилитри, триста драма	Трећинтъ дремъ	treqin drem
Поль ока, по оке	Зимсъ, ђимсъ оке	zims, gjims oke
Стодрамъ, литра	Нычинъ дреемъ	njiqin dreem
Педесетъ драма, полићъ	Песьдијетъ дремъ	pesëdhijet drem
Двадесетъ и петъ драма, чоқанъ	Нызетепесъ дремъ	njizetepes drem
Оканица	Ны окасъ	nji okas
Поллоканица, полуяка	Цимсаръ	xhimsar
Стодрамникъ, литра	Ђинтаръ	qintar
Педесетъникъ, полићъ	Нкапеседијетъ	nkapesëdhijet
Тръгаи, мери, накантаръ	Пешо мекантари	pesho mekantari
Мери со аршинъ	Метро	metro
Тесхко	Ранъ	ran
Лесно	Илеснь	ileen
<b>Наречение покућнина – fjalë e shprehje të amvisërisë</b>		
Покућнина, покућанство	Тъштъписа	tështëpisa
Котелль, бакрачъ	Куся	kusija
Грне, лонац	Поче, ворба	poçe, vorba
Тавасонози, шерпа	Почемекъмба	poçemekëmba
Тиганъ, тава	Фтере	ftere
Каленикъ, каленица	Купа	kupa
Ллодица, кашика	Луга	luga
Буунъбла, вилушка	Перуна	peruna
Чиния, таныръ	Чиния барда	çinija bardha
Риза, пешкиръ	Авллыи	avllii
Аванъ, ступа	Дубекъ	dubek
Тллчило, тучакъ	Тесте дубекутъ	teste dubekut
Миялка, пачавра	Пачавра	paçavra

Струска	Ллућесъ	lluqes
Роженъ, ражанъ	Елль	ell
Леђенъ, леђанъ	Леђенъ	legjen
Ресхетка	Скара	skara
Терезии, терезије	Терезите	terezitë
Мешарка, текне, здѣно	Мађе	magje
Амбаръ, житница	Амбаръ	ambar
Сандукъ	Аркъ	ark
Асталь, столъ	Софра	sofra
Ллопаръ	Палларее	pallaree
Столль, столица	Шкъ мбъ	shkëmb
Ключъ, кука	Ченгелы	çengeli
Метла, метлу	Фшесъ	fshes
Замети, почисти	Фшесе	fshese
Сметоносец, фарошъ	Фарошъ	farosh
Соленикъ, слланикъ	Крипоре	kripore
Целло, читаво	Цидсь	xhith
Пиперница, биберница	Спецаре	specare
Буниште	Пђе	pjee
Дворъ, у дворъ, предъ кућомъ, наполѣ	Авлее	avlee
Наиди	Цете, џете	xhete, gjete
Се наодить	Циндет	xhindet
<b>Наречение затвори – Shprehje për mbyllje</b>		
Врата	Дера	dera
Заворна, опонъ	Сурмень	surmen
Доллапъ, орманъ	Доллапъ	dollap
Крилло одъ врата	Нѣ краа предера	nji kraa predera
Двокрилна врата	Медуи краа дера	medui kraa dera
Подупирачъ	Ямъ быштеть	jam bështet
Клучаница	Чельзница	çelëznica
Катанацъ	Друи	dru
Басамаке	Шкалль	shkall
Шкрипи	Цимон	xhimon
<b>Ремë e perime</b>		
Ллоза, ллозинка	Пђргулль	pjergull

## LEKSIKOGRAFI, GJUHËSI KRAHASUESE

Гроизе, грожђе	Рушъ, руши	rush, rushi
Роговачка, рохчиња	Брины деи	brinji dheu
Сирка	Жинџифа	zhinxhafa
Паллма, юрма	Урми	urmi
Костенъ, кастанъ	Гъштень	gështen
Орефъ, орехъ, ора	Арь	ar
Лимонъ	Лимонъ	limon
Помаранџа, пртокалль	Пртокалль	prtokall
Црница, муринка, дутъ	Маны зије	mani zije
Черешна, трешня	Грьсхее	grëshee
Вишна, вишня	Вишня	vishnja
Белвица, ашллама	Ебардетъ	ebardhët
Праска, бресква	Пѣшкъ	pjeshk
Мушулла, зерделия	Мушмулль	mushmull
Ехлла, јеова	Верени	vereni
Црнъ гллоккъ	Морисъ, фѣръзезе	moris, fjerëzezë
Песъы гллоккъ	Качъ, мурисъ ченитъ	kaç, muris çenit
Леска, лешникъ	Лесы, летиы	lethji, lethii
Бадемъ, баямъ	Бадемъ	badem
Кокусъ, ораси	Арь деутъ	ar dheut
Чикерь, гроздъ	Рошъ	rosh
Здрено, здрелло	Зуму ме ућекъ	zumu me uqek
<b>Kafshë të egra</b>		
Дивина, зверки	Егресиръ	egresir
Диви кози, диво кози	Де егр	dhe egr
Црна	Езезъ	ezez
Леленъ	Капруль, дре е	kaprull, dree
Зајекъ, зец	Лепуръ	lepur
Курякъ	Уикъ, укъ	ujk, uk
<b>Profesione</b>		
Сфећаръ	Чираръ	çirar
Кацаръ, пинтеръ	Шегаръ	shegar
Градинарь, бафчованъ	Оградаръ, копоиџиу	ogradar, kopoixhiu
Книговезецъ	Картелидсме	kartelidhme

Риболловець, аллась	Пешкезинтарь	peshkëzintar
Крпачь	Чепарь	çepar
Кошничарь	Шпортарь	shportar
Потникъ, путникъ	Улларь	udhtar
Брѣзоодець	Врежкь шкуарь	vrejk shkuar
Книгоносець	Картъ чоарь	kart çoar
Колларь путникъ	Черари уллась	çerari (< qerrari) udhas
Косачь, косилаць	Какорь	kakor
Орачь, землѣделець	Калларуу	kallaruu
Жетварь	Какорь	kakor
Ягленарь, угленарь	Ешкатарь	eshkatar
Говедарь	Лопарь	lopar
Сфинярь	Дерарь	derar
Погребувачь	Ворци	vorxhi
Лекарь, докторь	Еѣими	eqimi
Художества, занати	Занатчиите	zanatçitë
Ходожникъ, занатчия	Мѣштерь, занатчи	mjeshtër, zinatçi
Маисторь	Мѣштерь	mjeshtër
Пеячь, пѣвачь	Къндоишинь	këndojshin
Гуслларь	Ллаутарь	llautar
Воѣа, клиндарь	Куллаузи	kallauzi
Слушкinya	Шулла, дадь	shulla, dad
Менгене, стега	Менгене	mengene
Чекичь, чокань	Чекичь	çekiç
Чаковаллно	Тезге скурить	tezge ekurit
Еге, пилла	Троскъ	trosk
Клесхти	Дана	dana
Лекови, медици	Барна, илачатъ	barna, ilaçat
Медицинь	Ныбарнаь	njibarna
Прашаиго, питаиго	Пъюте, пьите	pjute, pjite
Немикажувать, некаѣми	Сьмадифтоје	sëmadiftoje

<p><b>РЕЧНИК</b> ОД ТРИ ЈЕЗИКА <b>С. МАКЕДОНСКИ</b> <b>АРБАНСКИ</b> <b>И</b> <b>ТУРСКИ</b></p> <p>КЊИГА II НАПИСАО Ђорѓе М. Пуљевски</p>	<p><b>ФЈАЉТОР</b> НКА ТРЕ ГЈУХА <b>ШКИНИШТ</b> <b>МАКЕДОНИСЕ</b> <b>ШКИП</b> <b>ЕДЕ</b> <b>ТУРЧИШ</b></p> <p>Љиберти II ЕКАШРУУ Ђорѓи Пуљес</p>	<p><b>FJALTOR</b> NKA TRE G-JUHA <b>SHKINISHT</b> <b>MAKEDONISE</b> <b>SHKIP</b> <b>EDHE</b> <b>TURÇISH</b></p> <p><b>Liberti II</b> EKASHRUU Gjorgji Pules</p>
<p>МИЈАК ГАЉИЧКИ У БЕОГРАД 1875</p>		
<p><b>С. Македонски</b> (S. Makedonski)</p>	<p><b>Арбански или</b> <b>арнаутски</b> (Arbanski ili arnautski)</p>	<p><b>Transliteruar me</b> <b>alfabetin e sotëm</b> <b>të shqipes</b></p>
<p><b>Разговор</b></p> <p>Знања на многу језика, да је потребно, за свакога човека, од највишег до најнижег реда, који странствује у данашња времена, ово сам казао и у првој књизи.</p> <p>Груго, говорио сам, како треба доста времена, док матерњи језик утврдимо, сазнамо и изобразимо, то треба учинити,</p>	<p><b>Кувенд</b></p> <p>Машум гјуха, тадијм, н аште нкадухет, препас вет њерји нка мате наљти, ђерте мате унђет, арада, циљи пошкон наана теветуи, нде моти сотис, кијо, камѠа, еде нде љиберти парас.</p> <p>Ђетер екам кувендова, сиподухет, шум мот, ђертафортоим, еде гјуха те нонас тонте, татњофим, еде тат мсоим, ајо подухет, препас вет, табароим,</p>	<p><b>Bisedë</b></p> <p>Mashum g-juha, tadijm, n ashte nkaduhet, prepas vet njerji nka mate nalti, gjerte mate ungjjet, aradha, cili poshkron naana tevetui, nde moti sotis, kijo, kamtha, edhe ndë liberti paras.</p> <p>Qeter ekam kuvendova, sipoduhet, shum mot, gjertafortojm, edhe g-juha te nonas tonte, tatnjofim, edhe tat msojm, ajo poduhet,</p>

<p>јер тако здрави разум изискује, пак потом и други језика по потреби да учимо.</p> <p>Треће, рекоа сам, да штогод је у првој књизи кусо и погрешно, да ћу у овој другој све недостатке попунити и поправити, а човек кад обеђа нешто треба испунити, но ја нашао сам за добро, да ову другу књигу овако напишем поради одговора на обеђање.</p> <p>Па зато на с. македонском језику и написах ју. Почем у овом крају не разбира се језик бугарски, но овај језик има своје наречије мијачки, које значи чист разговор, на који су и црквени књига превели, од грчког Кирил и Методије, за наш народ.</p>	<p>псе ашту пас мена, шиндоши, кркоје, пор пастаи, еде ћетер гјуха, пасте духет, ветис, тамсоим.</p> <p>Третис камџа, почиш аште нде љиберти парас шкурт, еде фаитун, си до та мбуш нде љиберти удутис, циџа скишмаја, еде дота дрито. Апоњерји, курксуџашт њиер, доњисенд, духет, ајо та сосе, пор ун еџета пребукур, кји љиберт удутис, ћекашту ешкрува, преупрџеч н ксуџашт тем.</p> <p>Џепреајо мбас гјухате шкиништ, македонисе ешкрува, прсе нде кји скаи нук поу марет вешт гјуха те бугарисе, апо кји гјуха киште емин те ветис, мијакисе, цилиџоин, фољмат епастр, мбас циљи јан, еде либерта кишас, бјемун, нка гречишт, киштен бије Кирили еде Методије, прењерази тона.</p>	<p>prepas vet, tabarojm, pse ashtu pas mend, shindoshi, krkoje, por pastaj, edhe qeter gjuha, paste duhet, vetis, tamsojm.</p> <p>Tretis kamtha, poçish ashte nde liberti paras shkurt, edhe fajtun, si do ta mbush nde liberti udutis, xhitha skishmaja, edhe dota drito. Aponjerji, kurksuthasht njier, donjised, duhet, ajo ta sose, por un exheta prebukur, kji libert udutis, qekashtu eshkruva, preuprxheç n ksuthasht tem.</p> <p>Çepreajo mbas g-juhate shkinisht, makedonise eshkruva, prse nde kji skai nuk pou maret vesht g-juha te bugarisë, apo kji gjuha kishte emin te vetis, mijakise, cilithoin, folmat epastr, mbas cili jan, edhe liberta kishas, bjemun, nka greçisht, kishten bije Kirili ede Methodije, prenjerazi tona.</p>
--	---	---

<p>Нека Бог поживи негово царство вељичество султан Абдул азис азамет, дао је царску високу вољу, свима поданицима у царству неговог величества царевине сваки да се учимо језици, према свом матерњем разговору, и други.</p>	<p>Тинђатијета, мретис имад, Султан Абдул азис азамет, каепе дашнимите налт емретис, мцит куш њераз, ндемпретенија темаде, етисе, паскуш, тамсоим гјуха, напарте гјуха теветис, еде ћетер гјуха.</p>	<p>Tingjatijeta, mretis imadh, Sulltan Abdul aziz azamet, kaepe dashnimit nalt emretis, mxhit kush njeraz, ndempretenija temadhe, etise, paskush, tamsojm g-juha, naparte g-juha tevetis, edhe qeter gjuha.</p>
<p>Даклем послужите се овом другом, књигом зато, и скроијо самју овако, и од многу разлога говорио сам по мало, те ученици, читајаћи по овоји, и други језици хаучићеду, а и свој матерњи, јазик, поправићеду.</p>	<p>Порташти ругдони мекји ћетер преајо, еде кам кјерч, чашту еде нкашумсенд екувендова капагс, псе воцат, ме кндомеа мбаскји, еде ћетер гјуха, тамсоин, апо еде гјуха вети инонас, дот дритоин.</p>	<p>Portashti rugdoni mekji qeter preajo, edhe kam kjerç, çashtu edhe nkashumsend ekuvendova kapags, pse vocat, me kndomea mbaskji, edhe qeter g-juha, tamsojn, apo edhe g-juha veti inonas, dot dritojn.</p>

<b>С. Македонски</b>	<b>Арбански</b>	<b>Transliterimi i tekstit shqip</b>
<p>Питање Шта је основ на секаква мудрос. Одг. Страх од Бога, секоиј да имаме, и да веруваме бога. Питање Што је Бог. Одг. Бога именуваме навјисоко сусхтество, дека создал нас,</p>	<p>Пјутмеа Чиш ашт рња теђит чиш диићун. Упрдеч Фрик нказоти, паскуш та кијем, еде табесоим њизот. Пју. Чиш ашт Перенди. Упр. Перенди повојем ајо манаљти вртетун, псе ека бона на еде</p>	<p>Pjutmea Çish asht rnja tegjith çish diigjun. Uprxheç Frik nkazoti, paskush ta kijem, edhe tabesoim njizot. Pju. Çish asht Perendi. Upr. Perendi pothojem ajo manalti vrtetun, pse eka bona na edhe xhith threti</p>

<p>и сијов, век, и све схто је вовиделово, видимимже всјем и невидимим от нисхто. Бог је вистина, бог, је свекоде, бог је дух, бог, немат ниначало нито краи, бог све может, и све знајет, бог, познават, сви схто мислиме, и видит све схтоработиме.</p>	<p>џиѠ Ѡрети еде џиѠ чиш дукет еде чиш нук дукет ка асџа. Перенди ашт вртее, перенди ашт ѣикунде, перенди ашт фрем перенди скиште, ас скаи, ас сосун, перенди џиѠ мунде, еде џиѠдии перенди њофе, џиѠ чиш на куитоим, еде шикоје џиѠе чиш на пуноим.</p>	<p>ede xhith çish duket edhe çish nuk duket ka asxha. Perendi asht vrtee, perendi asht gjikunde, perendi asht frem perendi skishte, as skaj, as sosun, perendi xhith munde, edhe xhithdii perendi njofe, xhith çish na kujtojm, edhe shikoje xithë çish na punojm.</p>
<p>Пи. Како состворил бог овја свет.</p>	<p>Пју. По си ека барове зот кии Ѡрети.</p>	<p>Рју. Po si eka barove zot kii threti.</p>
<p>Од. Наинапред создал бог небо и земја, а земја ва бесхе безлице, и пуста, и темница, бесхе како некоја дупка схто је без дно, само здих господов седигасхе над водата, и рече господ нека бидет видело, и биде видело, а кога виде господ, виделото аљеје убаво, тога господ ја раздели видельината, от темницата, и виделината ја нарече господ дан, а темницата ја наређе ноћ, и тога се сторји утро доиде, и вечер, првијот ден.</p>	<p>Упр. Мате пара скабарова зот, ћели, еде троли, пор трол иштен пафаче, еде шкрет, еде ерт, иштен сидоњи гропа циља аште пафунд веч фрем зотис угриште прмиуи едева зот, љета бофт Ѡрет, еде убофт Ѡрети, покур шикова зот Ѡрети сиашт букур, ата ер, зот, екадаје Ѡрети, каертин еде Ѡрети, екаѠа зот, дит, а по ертин, екаѠа натн, еде атаер убон мнџес, еарде, еде прам, дитн те парас.</p>	<p>Упр. Mate para ekabarova zot, qelli, edhe trolli, por troll ishten pafaçe, edhe shkret, edhe ert, ishten sidonji gropa cila ashte pafund veç frem zotis ugrishte prmiuj edhetha zot, leta boft thret, edhe uboft threti, pokur shikova zot threti siasht bukur, ata er, zot, ekadaje threti, kaertin edhe threti, ekatha zot, dit, a po ertin, ekatha natn, edhe ataer ubon mnxhes, eardhe, edhe pram, ditn te paras.</p>
<p>Пи. А схто соствори во другијот ден, господ.</p>	<p>Пју. Апо чиш ека барова зот, нде дитинте ѣетер.</p>	<p>Рју. Apo çish eka barova zot, nde ditinte qeter.</p>
<p>Одг. Во другијот ден рече господ, нека бидет свод над водата,</p>	<p>Упр. Нде дит удугис евазот, љете бафт смљомеја прмиуин,</p>	<p>Упр. Nde dit udutis ethazot, lete baft smlomeja prmiujn, prtadajet uji, me</p>



<p>да се раздeљуват, вода совода, и одељи бог, водата под сводот, и така се стори и тога господ, сводот го нарече небо, и тога се стори утро и вечер другијот ден.</p>	<p>пртадајет уји, ме уји, еде екадаје зот уји нан смљомеја, еде прми смљомеја, еде ашту убафт, еде атаер зот ајо смљомеја еѠа ђели, еде атаер узбард, минџес еде прам ндедитин те удудитис.</p>	<p>uji, edhe ekadaje zot uji nan smlomeja, edhe prmi smlomeja, edhe ashtu ubaft, edhe ataer zot ajo smlomeja etha qelli, edhe ataer uzbardh, minxhes edhe pram ndeditin te ududitis.</p>
<p>Пи. А после схто соствори Господ.</p>	<p>Пју. Пор пастаи чиш екабарове зот.</p>	<p>Pju. Por pastai çish ekabarove zot.</p>
<p>Од. Во тређијот ден рече господ, нека се соберет сета вода схто је под небо, на једној инека се покажат суви места, и така биде, и сувите места, ји нарече господ земја, а таја собранијата водна, ја нарече мориња, и виде господ аљ је убаво.</p>	<p>Упр. Нде дитнте трети еѠа зот, љете убљид џиѠе уји чиш ашт нан ђели, нде њја љете училонте венд те сат, еде ашту убаруве еде венд те сат уѠа зот трол, апо ата мбљидмеја ујис, уѠа детин, еде шикове зот сипоаште букур.</p>	<p>Upr. Nde ditnte treti etha zot, lete ublid xithe uji çish asht nan qeli, nde nja lete uçillonte vend te that, edhe ashtu ubaruve edhe vend te that utha zot troll, apo ata mblidmeja ujis, utha detin, edhe shikove zot sipoashte bukur.</p>
<p>Пак рече нека пустит земјата од себе трева и биљки, који давајет семиња, и дрвја родни Што раајетн плод, поредот свои воним ђа бидет семињата нифни на земи, и така се учини; и виде господ аљ је добро.</p>	<p>Опет Ѡаа љетелишо трол каватвете колос, еде барна, циљи епин фаре, еде друн мепемна чиш љеен пемна, мбас арада те ветис, нде ата убафт фаре ајанат матрол, еде ашту уџетман, еде шиковазот сипоаште букур.</p>	<p>Opet thaa letelisho troll kavatvete kollos, edhe barna, cili epin fare, edhe drun mepemna çish leen pemna, mbas aradha te vetis, nde ata ubaft fare ajanat matroll, edhe ashtu uxhetman, edhe shikovazot sipoashte bukur.</p>
<p>Пи. А схто соствори господ во четвртијот ден.</p>	<p>Пју. По чиш екабарове зот нде дитин те катрис.</p>	<p>Pju. Po çish ekabarove zot nde ditin te katris.</p>
<p>Од. Во четвртијот ден рече господ, нека бидет светила, на</p>	<p>Упр. Нде дитн те катрит еѠа зот, љет убафт дритин м смлемеја</p>	<p>Upr. Nde ditn te katrit etha zot, let ubaft dritin m smlomeja qellis prta dajen</p>

<p>сводот небесни да го дељат денот, и ноћот, једно от друго, да бидат белџези от времињата, и за дните, и за годините, и нека светат од сводот небесни, за даидет видељина на земјава.</p> <p>Пи.</p> <p>А кољку светила состворил господ, на сводот небесни.</p> <p>Од.</p> <p>Господ состворил две светила гољеми, и многу светила маљи.</p> <p>Пи.</p> <p>А каква сила и дјеиство содржавајет светилата.</p> <p>Од.</p> <p>От двете светила поголемото, рече господ денот даго дељит, и управуват, а помалото и ситните, даго дељат ноћот и да светат, от небо на земјава даја раздељувајет једното дењја а друготите ноћја.</p>	<p>ћелис прта дајен дिति еде нати њан каћетер, та убафт шкал камотин, еде превјетат, еде љет бајет дритин касмлџомеја ћелис, пртавјен дритин матроли.</p> <p>Пју.</p> <p>А по саа дритин ебарове зот, мсмљомеја ћелис.</p> <p>Упр.</p> <p>Зоти, ебарове дуи дритин маде, еде шум дритин вогљ.</p> <p>Пју.</p> <p>Апо чвар фуџија, еде пуномеја бајен ата тедритин.</p> <p>Упр.</p> <p>Кадуите дритин ајо те мамаде, ева зот дिति прта даје, еде та рапшоје апо мате вогљи еде теисат, татдајен, еде тат дритин натан, еде та бајен дритин нкаћели матроли татдајен, њани дитн, апо ћерат натн.</p>	<p>diti edhe nati njan kaqeter, ta ubaft shkall kamotin, edhe prevjetat, edhe let bajet dritin kasmlomeja qellis, prtavjen dritin matrolli.</p> <p>Pju.</p> <p>A po saa dritin ebarove zot, msmlomeja qellis.</p> <p>Upr.</p> <p>Zoti, ebarove dui dritin madhe, edhe shum dritin vogl.</p> <p>Pju.</p> <p>Apo çvar fuçija, edhe punomeja bajen ata tedritin.</p> <p>Upr.</p> <p>Kaduite dritin ajo te mamadhe, etha zot diti prta daje, edhe ta rapshoje apo mate vogli edhe teisat, tadtajen, edhe tat dritojn natan, edhe ta bajen dritin nkaqelli matrolli tadtajen, njani diti, apo qerat natn.</p>
--	--	--

### **Rëndësia e fjalorëve të Pulevskit**

Si vepra të shkruara në shekullin XIX dy fjalorët shunëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit kanë rëndësi të madhe dhe mund të shfrytëzohen si material burimor i kohës për të trajtuar çështje gjuhësore, kulturore e historike.

Këty dy fjalorë vështruar në tërësinë e trashëgimisë sonë leksikografike, duhet të zënë vendin e merituar në kuadrin e fjalorëve shumëgjuhësh të kohës dhe përgjithësisht të shënohen edhe në historinë e leksikografisë maqedonase, shqiptare, turke dhe greke.

Fjalorët patën rëndësi relativisht të madhe praktike, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Dy fjalorët kanë edhe vlerë historike për gjuhët dhe kulturat ballkanike si dhe për ballkanologjinë në përgjithësi. Këta Fjalorë, na sigurojnë material të vlefshëm për të parë jo vetëm 3-4 gjuhë ballkanike në shekullin XIX, por edhe për kulturën e popujve të Ballkanit, përpjekjet e tyre për çlirimin nga robëria, fqinjësinë e mirë, njohjen dhe respektin e ndërsjellë ndërmjet popujve të Ballkanit.

Me këta dy fjalorë Pulevski promovoi jo vetëm shumëgjuhësinë, por edhe barazinë midis gjuhëve e popujve, mirëqenien e bashkëjetesën në Ballkan, multikulturalizmin dhe interkulturën, vlera këto që duhet të kultivohen në çdo kohë e në çdo shoqëri.

### **Fjalori tregjuhësh - enciklopedi e vogël popullore e kohës**

Fjalori tregjuhësh është ndarë në tema të ndryshme me sfera të veçanta leksikore. P.sh. ka një hyrje, pastaj shkruhet për vetitë psikofizike të njeriut, për bimët e kafshët, për xehet dhe lëgurat, për kontinentet e botës, yjet, për fenomenet natyrore, për banorët e Galicnikut etj.

Në bazë të kësaj, mund të themi se Fjalori tregjuhësh paraqet një enciklopedi të vogël popullore të kohës.

Si Fjalori tregjuhësh, ashtu edhe ai Katërgjuhësh të Pulevskit janë edhe një dëshmi se shqipja u shkrua, përveç me alfabetin latin, arabo-turk, grek edhe me alfabetin cirilik. Siç dihet, shkrimi i shqipes me alfabet cirilik ka një traditë jo të gjatë. Kështu, si i pari dokument me alfabet cirilik merret mbishkrimi tregjuhësh që gjendet mbi derën e manastirit të “Shën Vlladimirit” të Elbasanit, ndërtuar nga princi shqiptar Karl Topia më 1381. Përpjekjet e para për të shkruar shqipen me alfabet cirilik i bënë Papa Totasi ose Anonimi i Elbasanit, beratasi

Kostë Berati, Teodor Haxhi Filipi etj.<sup>14</sup> Shqipen e ndeshim edhe në një fjalor Katërgjuhësh: greqisht-arumanisht-shqip dhe maqedonisht nga voskopojari Pop Danailli, botuar në Veneci më 1794, botimi I dhe më 1802 botimi II. Shqipen me alfabet cirilik e shkruan edhe Gjorgje Pulevski, Kuzman Shapkarevi etj.

Të dy fjalorët e Pulevskit, vështruar në retrospektivën kohore, patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këtë konstatim mund ta mbështesim në disa fakte:

Fjalorët patën karakter praktik, d.m.th. se u hartuan për nevojat praktike të popullatës së Ballkanit, por edhe më gjerë; për të nxënë disa gjuhë ballkanike (maqedonishten, shqipen, greqishten e turqishten), për komunikim të ndërsjellë, njohjen reciproke të gjuhëve dhe të kulturave, por edhe për afrimin e tyre.

Komunikimi i njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme është më se i nevojshëm edhe për Pulevskin. Të përkujtojmë me këtë rast konstatimin e njohur të gjuhëtarëve se njohja e disa gjuhëve ka pasoja pozitive edhe në intelegjencë. Përvoja në dy e më tepër sisteme gjuhësore ndikon që personi i tillë të ketë fleksibilitet më të madh mendor, superioritet në përpilimin e ideve si dhe shumë më tepër zgjedhje të aftësive mendore nga njeriu që di vetëm një gjuhë.

Njeriu që zotëron disa gjuhë e vështron botën në disa pikëpamje të ndryshme. E në fund, mjedisi me dy e më tepër gjuhë e kultura mundëson që njohësi i këtyre gjuhëve të fitojë përvojë më të pasur e më të llojllojshme. Prandaj, bashkëjetesa, kontaktet e përditshme të popullatës në anët e Maqedonisë Perëndimore ndërmjet folësve të disa gjuhëve ka krijuar domosdonë e hartimit të fjalorëve shumëgjuhësh. Ja se çfarë shkruan Pulevski për rëndësinë e njohjes së gjuhës amtare dhe të gjuhëve të tjera në Fjalorin tregjuhësh:

Nga fjalorët del konstatimi se gjuhët duhet të jenë të barabarta, d.m.th. duhet zbatuar dygjuhësia e shumëgjuhësia e jo diglosia, qëndrim ky më i drejti për mjediset shumëgjuhësore. Nuk është e rastit zgjedhja e gjuhëve: maqedonisht, shqip, turqisht e greqisht. Të rikujtojmë se në atë kohë greqishtja ka qenë gjuhë e arsimit, e kulturës etj., turqishtja – gjuhë e administratës shtetërore; ndërsa shqipja e maqedonishtja gjuhë amtare e popullsisë së Maqedonisë si dhe gjuhë e komunikimit të përditshëm në kushtet e bashkëjetesës së shqiptarëve me maqedonasit.

Fjalorët kanë rëndësi leksikografike, meqë përbëjnë një nga

<sup>14</sup> Dr. Petro Janura, *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, 1969, f. 43-56.

hallkat në vargoin e leksikografisë shumëgjuhëshe. Edhe pse në Fjalorë nuk është pasqyruar me besnikëri shqipja e kohës, d.m.th. format e fjalëve e të fjalive duhet marrë me rezervë, megjithkëtë mund të thuhet se të njëjtit kanë rëndësi gjuhësore, sepse këtu e gjejmë një variant të shkruar të shqipes së shekullit XIX. Aty na paraqiten disa forma të vjetra të shqipes, ka tipare të të folmes së qarkut të Dibrës, tipare gjuhësore të të folmeve të tjera gege, një numër të vogël veçorish gjuhësore të të folmeve toske, por edhe kalke, forma e fjalëkrijime që nuk u pranuan, nuk u përvetësuan apo edhe nuk u bënë pronë e mbarë shqipes.

Megjithë mangësitë që ka, shqipja e Pulevskit siguron një material të shkruar për të vëzhguar gjuhën dhe stilin e tij, për të parë zhvillimin historik të të folmes së Dibrës, e bashkë me shkrimet e tjera të kohës, për të plotësuar rrjedhën kohore të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore e më gjerë. Meqë është fiksuar një shqipe e shekullit XIX, Fjalorët mund të plotësojnë një pjesë të mozaikut për ecurinë kohore të dialekteve dhe të të folmeve shqipe, historinë e shqipes së shkruar e të historisë së gjuhës në përgjithësi.

Këta Fjalorë, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm për të parë ndikimet ndër-gjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike.

Dy fjalorët kanë edhe vlerë historike për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi.

Materiali i dy Fjalorëve është shfrytëzuar në punimin e Aleksandër Beliçiqit “Dialekti i Galiçnikut”, Beograd, 1935 si dhe nga studiues të shumtë, si nga Bllazhe Koneski, Bllazhe Ristovski, Harallampie Polenakoviç, Trajko Stamatovski, Tome Sazdov, Olivera Jashar – Nasteva, Viktor Fridman, Petro Janura, unë etj. Megjithkëtë, veprat e Pulevskit sigurojnë material për studime të mëtejme ballkanistike e multidisiplinare.

### **Bibliografia:**

Basha, Naim: *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

Berani, Shaqir: *Gjuha e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988.

Fridman, Viktor: *Gjorgji Pulevski, fjalorët e tij dhe Rilindjet kombëtare Shqiptare e Maqedone*, Konferenca për 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, Prishtinë, 1978.

- Halimi, Mehmet: *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985, f. 273.
- Hamiti, Asllan: *Disa veçori fonetike dhe fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup 2000, f. 161-176.
- Hamiti, Asllan: *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.
- Hamiti, Asllan: *Vëzhgime për shqipen e përkthyer në dy fjalorët e Gjorgji Pulevskit*, Albanologjia, vëll. 4, nr. 7 (ISSN 1857-9485), Universiteti i Tetovës, 2017, f. 31-48.
- Пулевски, Ѓорѓи: *Речник од њри језика: С. Македонски, Арбански и Турски*. Књига II. Написао Ђорђе М. Пулевски, мијак галички. У Београд, у државној штампарији, 1875. (Fjalor tregjuhësh: sllavisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875).
- Пулевски, Ѓорѓи: *Речник оиџ чеџири језика: I. Срџско-Албански. II. Арбански-Арнауџски. III. Турски. IV. Грчки*. Скројена и написана отђ Ђорђа М. Пуљвски, архитекта у Галичникџ, окружје дибранско, 1872 године. I-ва часть. Београдџ. Штампарија Н. Стефановиђа и Дружине, 1873. (Fjalor katërgjuhësh: sllavisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873).
- Sazdov, Tome: *Vepra e Gjorgji Pulevskit (1838-1895)*: Jehona, nr. 7, Shkup, 1984, f. 92-109.
- Stamatoski, Trajko: *Gjorgji Pulevski dhe gramatika e tij*: Jehona, nr. 10, Shkup, 1987, f. 29-40
- Јашар - Настева, Оливера: *За речницџиџе на Пулевски и албанскаџиџа џаралела во нив*: Прилози (kontributions), IX 2, МАНУ, Скопје, 1984, f. 43-56.
- Јашар – Настева, Оливера: *Искажувањата на Ѓорѓи Пулевски за јазичната сџџуација во Македонија*: Јазичите на почвата на Македонија, МАНУ, Книга 3, Скопје, 1996, f. 33-51.
- Конески Блаже – Јашар - Настева, Оливера: *Балкански јазични џаралели во речницџиџе на Ѓорѓи Пулевски*: Прилози IX 2, МАНУ, Скопје, 1984, f. 57-63.
- Конески, Блаже: *Белешки за Пулевски* (јазично и книжевно-

историски прилози): Македонскиот IX век, Култура, Скопје, 1986, f. 224-230.

Конески, Блаже: *За јазикот на Пулевски – графиски, фонетски и фонолошки особености: Македонскиот од XIX век*, Култура, Скопје, 1986, f. 210-223.

Ристовски, Блаже: *Ѓорѓија М. Пулевски: Одбрани страници*, Македонска книга (përzgjedhje, redaktim, parathënie dhe shënime), Shkup, 1974.

Ристовски, Блаже: *Појави и профили од македонската културна историја*, 2 дел, Студентски збор, Скопје, 1982.

Саздов, Томе: *Ѓорѓи Пулевски: Избрани текстови*, Скопје, 1985.

## 1.5. LEKSIKOGRAFIA SHQIP – MAQEDONISHT E ANASJELLTAS

### Abstrakt

Në këtë kumtesë do të përpiqemi të pasqyrojmë historikun e fjalorëve të deritashëm dygjuhësh shqip – maqedonisht e anasjelltas të botuar kryesisht ë Maqedoni. Deri më tani janë botuar mbi 20 fjalorë të tillë, si: Fjalori *maqedonisht - shqip* të autorëve Mile Qorvezirovski e Lutfi Rusi, botuar më vitin 1967; *Fjalor maqedonisht - shqip dhe shqip - maqedonisht* të Adnan dhe Kimete Agait; *Fjalor maqedonisht - shqip dhe shqip - maqedonisht*, nga Haki Ymeri, Patar Atanasov, Zihni Osmani, Kumanovë, 1996; *Fjalori maqedonisht – shqip* nga Haki Ymeri – Zihni Osmani, Logos-A, Shkup, 2000, Shkup; *Fjalor shqip - maqedonisht* nga Haki Ymeri – Bina, Shkup, 2012.

Pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, shqipja, krahas maqedonishtes, filloi të përdorej me shumë pengesa edhe në institucionet zyrtare në Maqedoni në komunat ku ka mbi 20% shqiptarë dhe u shtua interesimi i maqedonasve për ta mësuar shqipen. Fjalorët dygjuhësh shqip – maqedonisht e anasjelltas të botuar deri më tani jo vetëm që kanë vlerë të madhe praktike, por mund të shërbejnë edhe si lëndë e vlefshme për të hulumtuar e studiuar lidhjet e shqipes dhe të maqedonishtes në fushën e leksikut si dhe të fjalësit në mesin e gjuhëve ballkanike.

Në të ardhmen kërkohet që të bëhet punë ekipore në hartimin e fjalorëve dygjuhësh. Duhet shfrytëzuar të arriturat e leksikografisë shqipe e të huaja e rrjedhimisht të përpilohen fjalorë cilësorë të leksikut të përgjithshëm si dhe fjalorë terminologjikë dygjuhësh fushash të ndryshme.

**Fjalët kyçe:** gjuhë, fjalor, fjalë, denduri, përdorim, nxënie, ndërndikim, ngjashmëri

Historia e leksikografisë shqipe tani më po i kalon 380 vjetët (më saktësisht 379 vjet).<sup>15</sup> Si kufi nistor të fjalorëve shumëgjuhësh, me përfaqësimin e shqipes e të maqedonishtes mund të konsiderojmë vitet e 80-ta të shekullit XIX, përkatësisht ajo zë fill me dy fjalorët

<sup>15</sup> Si kufi historik nistor i leksikografisë shqipe mbetet “Fjalori latinisht – shqip” i Frang Bardhit i vitit 1635. Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002, f. 275.



shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit: *Fjalor katërgjuhësh: maqedonisht–shqip–turqisht–greqisht*, Beograd, 1873 dhe *Fjalor tregjuhësh* (Fjalor nka tre g-juha), Beograd, 1875. Fjalori i parë përfshin 2500 fjalë e shprehje të përkthyer, ndërsa fjalori i dytë ka tekst të shkruar me fjali e periudha të tëra (me pyetje-përgjigje) në tri kolona gjuhësh.<sup>16</sup>

Dy fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit, vështruar në tërësinë e trashëgimisë sonë leksikografike, për periudhën kohore në të cilën u botuan, meritojnë të përmenden në kuadrin e fjalorëve shumëgjuhësh të kohës dhe përgjithësisht të shënohen në historinë e leksikografisë shqiptare. Vështruar në retrospektivën kohore, fjalorët patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këta Fjalorë, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm (por jo autentik) për të parë ndikimet ndërgjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike. Dy glosarët kanë edhe vlerë historike për shkencën albanologjike, veçmas për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi.<sup>17</sup>

Megjithëkëtë, mund të themi se leksikografia dygjuhëshe shqip - maqedonisht e anasjelltas është e re, pesëdhjetëvjeçare, përkatësisht ajo sivjet mbush 47 vjet. Fjalori i parë i mirëfilltë i këtij lloji është “Fjalori maqedonisht–shqip” botuar në Shkup më 1967, hartuar nga Mile Qorvezirovski – Lutvi Rusi.

Në bazë të kërkimeve tona për të përpiluar bibliografinë e fjalorëve shqip - maqedonisht na dolën 20 të tillë. Historinë e shkurtër të leksikografisë dygjuhëshe shqip - maqedonisht e anasjelltas mund ta ndajmë në dy periudha:

- a) e para, periudha e tri dekadave të fundit të shekullit XX, dhe
- b) e dyta, periudha e fillimit të shekullit XXI e deri më sot.

Të dyja këto periudha kanë ndërlidhje të ngushtë, por që kanë edhe dallime ndërmjet tyre.

Përmbledhtas mund të thuhet se qëllimi i hartimit të fjalorëve në periudhën e parë, e që ka vazhduar edhe në të dytën, ka qenë praktik: t’i shërbenin mësimin të maqedonishtes nga shqiptarët ose të shqipes nga maqedonasit. Pak fjalorët e botuar në fundin e shekulli XX kanë plotësuar nevojat e shkollës, lehtësimin e përdorimit praktik të këtyre dy gjuhëve, por edhe nevojave të përkthimit si dhe të fushave të tjera

<sup>16</sup> Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005, f. 30-32.

<sup>17</sup> Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005, f. 32-35.

të veprimtarisë shoqërore. Nga ana tjetër, këta fjalorë dhanë edhe një lëndë të vlefshme edhe për studimet krahasuese ndërmjet shqipes e maqedonishtes, nëpërmjet saj edhe me gjuhët e tjera sllave të jugut.

Në periudhën e dytë të leksikografisë dygjuhëshe shqip - maqedonisht u arritën nivele cilësore më të larta. Brenda 10-15 vjetësh u botuan 17 fjalorë dygjuhësh tipesh të ndryshme: fjalorë dygjuhësh të leksikut të përgjithshëm, fjalorë terminologjikë si dhe fjalorth e bashkëbisedimor.

Po paraqesim bibliografinë e fjalorëve dygjuhësh shqip - maqedonisht e anasjelltas, sipas viteve të botimit, që nuk pretendojmë se është e plotë:

1. Mile Qorvezirovski – Lutvi Rusi, *Fjalor maqedonisht – shqip*, Prosvetno Dello, Shkup, 1967.
2. R. Çadri, *Fjalor shqip–maqedonisht*, Албанско-македонски разговорник, Tiranë, 1995.
3. Adnan Agai – Kimete Agai, *Fjalor shqip – maqedonisht*, Meshari, Shkup, 1996.
4. Haki Ymeri – Petar Atanasov - Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht – shqip dhe shqip – maqedonisht*, Dav Mari, Kumanovë, 1997.
5. Adnan Agai – Kimete Agai, *Fjalor maqedonisht – shqip*, Meshari, Shkup, 1999.
6. Jani Thomai, Xhevat Lloshi, Rusana Hristova, Kosta Qiriazhi, Ana Melonashi, *Fjalor frazeologjik ballkanik*, Dituria, Tiranë, 1999.
7. Halit Burrniku, *Fjalor tematik shqip – anglisht – maqedonisht*, 1999.
8. Haki Ymeri – Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht – shqip*, Logos-A, Shkup, 2000.
9. Qemal Murati, *Fjalor ideomatik shqip – maqedonisht*, 2003.
10. Ilija Strashevski, *Fjalor maqedonisht – shqip, shqip – maqedonisht*, 2004.
11. Afrim Osmani, *Fjalor terminologjik juridik*, Furkan, ISM, Shkup, 2004.
12. Adnan Agai – Kimete Agai, *Fjalor shqip – maqedonisht*, Meshari, Shkup, 2005.
13. Mustafa Ibrahim, *Fjalor bashkëbisedues maqedonisht – shqip*, Interlingua, Shkup, 2005.
14. Shaban Prevalla, *Fjalor afarist maqedonisht – shqip dhe shqip maqedonisht*, Veles, 2007.

15. Haki Ymeri – Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht – shqip*, Menora, Shkup, 2008.
16. Ismail Zejneli, Jeton Shasivari, *Fjalor juridik shqip – maqedonisht*, 2008.
17. Azis Pollozhani, *Fjalor i frazeologjizmave të mjekësisë* (doracak për punonjësit shëndetësorë dhe për pacientët), 2009.
18. Ismet Osmani, *Fjalor i terminologjisë juridike shqip – maqedonisht*, 2008 (për nevojat e studentëve, në dorëshkrim)
19. Vebi Rrustemi, *Fjalor shqip – maqedonisht për fillestarë*, 2011.
20. Haki Ymeri – Bina, *Fjalor shqip – maqedonisht*, Shkup, 2012.

**Do të themi pak fjalë për disa nga fjalorët më të  
rëndësishëm sipas kronologjisë së botimit:**

1. Mile Qorvezirovski – Lutvi Rusi, **Fjalor maqedonisht – shqip**, Prosvetno Dello, Shkup, 1967, 712 faqe, formati 13 x 20 cm.

Ky është fjalori i parë dygjuhësh shqip-maqedonisht i shekullit XX i botuar në Maqedoni. Ai përfshin afër 40.000 fjalë të leksikut të përgjithshëm të maqedonishtes letrare të kohës. Ky fjalës, si për nga vëllimi, ashtu edhe për nga struktura që dedikuar për nevojat e shkollimit të mesëm, por u shërbeu me sukses edhe atyre që u morën me veprimtari përkthyes, shoqërore e kulturore. Si i tillë luajti një rol të rëndësishëm jo vetëm që për 40 vjet rresht plotësoi nevojat për përkthim dhe përvetësimin e maqedonishtes nga shqiptarët si dhe të shqipes nga maqedonasit fare pak të interesuar për të mësuar shqipen, por ai pa dyshim mund të konsiderohet si pararendës i fjalorëve të mëvonshëm dygjuhësh.

Fjalori në fjalë shquhet për saktësi në përkthimin e fjalëve, pasurinë sinonimike, pedanterinë e shkrimit, saqë edhe sot është i dobishëm e i përdorshëm. Ai ka një hyrje, shpjegime për strukturën e fjalorit, literaturën me mbi 20 njësi bibliografike, shkurtime, alfabetin e maqedonishtes e më pas fjalët janë dhënë sipas radhitjes së shkronjave. Në fund të Fjalorit (f. 692-712), brenda 22 faqesh është përfshirë një gramatikë e shkurtër e maqedonishtes. Kjo sipas njohurive tona është gramatika e parë e maqedonishtes e interpretuar në shqip.

2. Haki Ymeri – Petar Atanasov - Zihni Osmani, **Fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht**, Dav Mari, Kumanovë, 1997, 782 faqe.

Ky është një fjalor shkollor i fjalësit të përgjithshëm dykahësh shqip – maqedonisht e anasjelltas me një pasqyrë të shkurtër të fonetikës e të morfologjisë së maqedonishtes. Fjalori përmban 13.000 fjalë në njërin kah dhe afërsisht po aq në kahun tjetër. Ai u dedikohet kryesisht nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, por edhe të interesuarve të tjerë që duan ta mësojnë shqipen apo maqedonishten që nuk e kanë gjuhë amtare. Këtu hartuesit kanë zbatuar metodologjinë tradicionale të përpilimit të fjalorëve. Ai shquhet për zgjedhjen e fjalëve më të përdorshme si në njërin ashtu edhe në gjuhën tjetër, për saktësi në përkthim, përpunim të mirë teknik si dhe lidhje të qëndrueshme fletësh e kopertina të trasha.

3. Adnan Agai – Kimete Agai, **Fjalor maqedonisht – shqip**, Meshari, Shkup, 1999, 437 faqe.

Me demokratizimin e sistemit shoqëror, leksikografia në Maqedoni merr hov të mbarë, kështu që imponohet nevoja për përpilimin e një fjalori bashkëkohor që do të duhej të mbante një ritëm së paku të përafërt me jetën dinamike të gjuhëve të prezantuara në fjalor. Në këtë fjalor jeton një fond i pasur fjalësh, frymon një frazeologji e begatshme, gjallërojnë proverba popullore dhe shprehje ideomatike të të dy gjuhëve, të cilat edhe një herë dëshmojnë afrinë e bashkëjetesën gjeografike dhe historike të këtyre dy popujve ballkanikë. Ky fjalor në fund të fundit, nuk synon të mbetet në një vend, ai ecën me kohën dhe u drejtohet të gjithë atyre që kërkojnë të hyjnë e të shkojnë në një fushë të re, duke përfshirë këtu lexuesin, studiuesin, linguistin në lëminë e maqedonistikës, albanologjisë dhe më gjerë.<sup>18</sup>

Fjalët në kolonën e parë janë dhënë sipas radhitjes alfabetike të maqedonishtes. Të dhënat gramatikore, stilistike apo ndonjë e dhënë tjetër janë shënuar me shkronja të pjerrëta. Fjalori është përpiluar sipas sistemit gjysmëçerdhor me qëllim që lexuesi të mund të shërbehet më lehtë.

4. Haki Ymeri - Zihni Osmani, **Fjalor maqedonisht-shqip**, Menora, Shkup, 2008, 930 faqe, me 50.000 fjalë (botim i dytë i plotësuar e i përmirësuar i mbështetur në botimin e parë, Logos-A, Shkup, 2000 që përmban 42.000 fjalë)

<sup>18</sup> Adnan Agai – Kimete Agai, Parathënie në *Fjalor maqedonisht-shqip*, Meshari, Shkup, 1999.

Fjalori fillon me një maksimë të dijetarit dhe filologut të shquar J. C. Scalinger-it (1484 – 1558): “Nëse do që të torturosh dikë, mos e detyro të rrahë metalin në farkëtari, as mos e dërgo në punë të rënda në miniera, por më mirë jepi të bëjë fjalorë; kjo punë është më e rëndë se të gjitha llojet e mundimeve të tjera.”

Ky fjalor me mbi 50.000 fjalë, përfshin leksikon e përdorshëm të gjuhës së sotme maqedonase. Në të janë pasqyruar edhe një sasi e leksikut bisedor (të thjeshtë), ndonjë arkaizëm e historizëm, si dhe një numër njësisish frazeologjike. Përveç kësaj janë përfshirë edhe jo pak terma profesionalë e shkencorë, që kanë përdorim të dendur. Përveç kuptimit të parë të fjalës (të shënuar me 1), shpeshherë janë dhënë edhe kuptimet e tjera (të shënuara me 2, 3, 4, ...) figurative, përbuzëse (pejorative), zvogëluese (deminutive), përkëdhelëse (hipokoristike), zmadhuese (augmentative) etj.

Autorët kanë konsultuar mbi 90 fjalorë shpjegues njëgjuhësh, fjalorë enciklopedikë, frazeologjikë, fjalorë shumëgjuhësh, fjalorë fjalësh e shprehjesh të huaja, fjalorë të specializuar fushash të ndryshme etj.

Fjalori shquhet për pasqyrimin e një fondi të pasur leksikor të mbështetur në Fjalorin shpjegues të maqedonishtes në tri vëllime (vëllimi I, II, III), botuar nga Instituti i Gjuhës Maqedonase,<sup>19</sup> por ai shquhet edhe për saktësi në gjetjen e fjalëve të barasvlershme të maqedonishtes me ato të shqipes.

5. Adnan Agai – Kimete Agai, **Fjalor shqip-maqedonisht**, Meshari, Shkup, 2005, 814 faqe.

Në parathënie hartuesit e fjalorit ia parashtrojnë vetes pyetjen: “Ç’është ajo që na imponon dëshirën për realizimin e një projekti të këtillë? S’do mend – jeta e përbashkët e popullit shqiptar dhe atij maqedonas në të njëjtat troje, që njëkohësisht krijon domosdonë e njohjes së ndërsjellë të thesarit shpirtëror, kulturor e historik të këtyre dy popujve.” Përpiluesit e fjalorit me punën e suksesshme 15-vjeçare, lexuesve u ofrojnë një fond të pasur leksikor prej 50.000 fjalësh, “shprehje të gjalla të shqipes e të maqedonishtes, në mënyrë që lexuesit të zellshëm t’i mundësohet mësimi i këtyre dy gjuhëve

<sup>19</sup> Институт за македонски јазик, *Толковен речник на македонскиот јазик*, том I (А-Ж), Скопје, 2003; *Толковен речник на македонскиот јазик*, том II (З-К), Скопје, 2005; *Толковен речник на македонскиот јазик*, том III (Л-О), Скопје, 2006.

ballkanike dhe zbatimi në jetën e përditshme; frazeologji të pasur e cila gjallëron e pasqyron dhe njëkohësisht mundëson përdorimin e fjalorit për analiza letrare nga njëra anë, apo edhe për studime krahasuese leksikografike, nga ana tjetër; fjalë të urta të vjela me durim më se një dekadë, të aplikuara paralelisht në të dy gjuhët, që çuditërisht shprehin afrinë e përvojës jetësore të këtyre dy popujve ballkanikë.”<sup>20</sup>

Në këto vitet e fundit janë bërë edhe disa përpjekje për hartimin e dy-tre fjalorëve terminologjikë shqip - maqedonisht ose anasjelltas, nga Shaban Prevalla, Afrim Osmani dhe Ismet Osmani.

6. Shaban Prevalla, **Fjalor afarist maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht**, Veles, 2007, 520 faqe.

Moto e dy fjalorëve të shkruirë në një është “Sa më shumë njihemi, aq më shumë do të respektohemi.”

Përgjithësisht është e njohur se të rinjtë shqiptarë që kryejnë studimet, dikush edhe magistraturën e doktoratin në maqedonisht përvetësojnë mirë edhe terminologjinë profesionale të gjuhës në të cilën shkollohen, por nuk njohin sa duhet terminologjinë shqipe dhe anasjelltas: ata që mbarojnë shkollimin në shqip nuk dinë gjuhën e specializuar në maqedonisht. Pikërisht duke pasur parasysh këtë dukuri, hartuesi Fjalorin afarist maqedonisht – shqip dhe shqip – maqedonisht ia dedikoi studentëve, afaristëve maqedonas si edhe të gjithë të interesuarve të tjerë që të mësojnë termet ekonomike edhe në gjuhën shqipe si dhe shqiptarëve të dinë termet edhe në maqedonisht.

Njohja e terminologjisë ekonomike është mjaft e rëndësishme, veçmas në kushte kur marrëdhëniet ekonomike-tregtare dhe marrëdhëniet e tjera ndërmjet vendeve të Ballkanit e të Evropës në përgjithësi janë intensifikuar. Për komunikim të mirëfilltë, negociata si dhe për lidhjen e marrëveshjeve të sakta e të qarta ekonomike ndërmjet Maqedonisë, Shqipërisë e Kosovës kërkohet edhe njohja dhe standardizimi i terminologjisë afariste dygjuhëshe shqip-maqedonisht.

Në hartimin e këtij fjalori autori shkriu njohuritë dhe përvojat e veta si ekonomist, drejtor financiar, bankier, përkthyes, deputet, vice-

---

<sup>20</sup> Adnan Agai – Kimete Agai, Parathënie në *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, 2005.

gubernator i Bankës Popullore të Maqedonisë dhe si mësimdhënës: titullar i lëndës Terminologjia e biznesit në Fakultetin e Shkencave Shoqërore (FON) në Shkup, bashkëpunëtor i jashtëm në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, në kolegjin “Fama” dhe në Universitetin “Pjetër Budi” në Prishtinë.

7. Afrim Osmani, **Fjalor terminologjik juridik**, Furkan, ISM, Shkup, 2004, 202 faqe, përmasat 24 x 16 cm

Ky është fjalor termash juridikë maqedonisht-shqip ku përfshihen rreth 7000 terma për të plotësuar nevojat profesionale në fushën e jurisipodencës, në radhë të parë të juristëve shqiptarë dhe ata maqedonas, të studentëve, të politikanëve, të nëpunësve shtetërorë si dhe të gjithë të të interesuarve të tjerë. Vendin kryesor e zënë termat e praktikës gjyqësore, të legjislacionit (të gjykatës, të arbitrazhit, të prokurorisë, të hetuesisë, të noterisë, të zyrave të ndihmës juridike) etj.

Pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (2001), krahas me përmirësimin e lirisë dhe të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni u përmirësua sado pak edhe zbatimi i shqipes në pushtetin shtetëror, përkatësisht në atë administrativ, gjyqësor e ligjvënës e veçmas në vetadministrimin lokal ku ka mbi 20% shqiptarë. Për përdorimin e shqipes (edhe pse edhe sot e kësaj dite i kufizuar) në administratën shtetërore e publike duhej ditur termat juridikë. Por, edhe pse me mjaft mangësi, si i pari i këtij lloji te ne, është një ndihmesë që në praktikën e zbatimit të shqipes nëpërmjet termeve juridike në maqedonisht të njohin e të përdorin përgjegjëset e tyre në shqip.

Më të suksesshmit në fushën e leksikografisë dygjuhëshe shqip-maqedonisht e anasjelltas deri më tani janë Haki Ymeri, Zihni Osmani, Adnan e Kimete Agai.

8. Haki Ymeri – Bina, **Fjalor shqip-maqedonisht**, Shkup, 2012, 976 faqe

Fjalori shqip-maqedonisht i Haki Ymerit - Binës për nga madhësia me afër 1000 faqe, përkatësisht me 976 faqe, është vepra më e vëllimshme leksikografike deri më tani në tipin e fjalorëve dygjuhësh shqip-maqedonisht. Pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit përdorimi i shqipes u shtri dukshëm në përdorim zyrtar në Maqedoni si dhe u shtua interesimi i maqedonasve për ta mësuar shqipen.



Fjalorët paraprakë nuk mund të plotësonin kërkesat e kohës, andaj u ndje nevoja që të hartohet një fjalor më i pasur, para së gjithash për të lehtësuar përkthimin dhe interpretimin nga shqipja në maqedonisht, sidomos në administratën shtetërore e publike dhe në kuvendin e Maqedonisë.

Rrjedhimisht, ky Fjalor jo vetëm që ka vlerë të madhe praktike, por mund të shërbejë edhe si lëndë e vlefshme për të hulumtuar e studiuar lidhjet e shqipes dhe të maqedonishtes në fushën e leksikut si dhe të fjalësit në mesin e gjuhëve ballkanike. Për këtë punë madhore, autori ka konsultuar një mal fjalorësh terminologjikë, frazeologjikë, fjalorë shpjegues, enciklopedikë, dygjuhësh e shumëgjuhësh në shqip e në disa gjuhë të tjera.

Fjalori shqip - maqedonisht i prof. Hakiut është fryt i punës sistematike e të palodhshme shtatëvjeçare. Rëndom, sipas praktikës së përgjithshme, fjalorë përpilojnë një grup autorësh që punojnë në institute leksikografike, ndërsa prof. Hakiu falë punës vetëmohuese për më se shtatë vjet ka arritur të na japë një fjalor të vëllimshëm me rreth 1000 faqe.

Fjalori shqip-maqedonisht i Haki Ymerit - Binës plotëson kërkesat e një numri të madh përdoruesish të sferave të ndryshme profesionale, të përkthyesve nga shqipja në maqedonisht, të studentëve dhe të intelektualëve shqiptarë ose të tjerëve që e njohin gjuhën e sotme shqipe dhe që kanë nevojë ta flasin e ta shkruajnë drejt shqipen e maqedonishten. Kjo kërkesë dita-ditës po rritet, krahas me demokratizimin e jetës, jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë në nënqiellin e Ballkanit, mbi të gjitha në Republikën e Shqipërisë, me të cilën lidhjet tradicionalisht të mira midis dy popujve po intensifikohen ditë e për ditë. Ky realitet e rrit jo vetëm vlerën praktike të fjalorëve të këtillë, por pa mëdyshje, zgjon edhe interes shkencor, meqenëse me këta fjalorë plotësohet lidhja ndërleksikore e të dy gjuhëve, e cila paraqet edhe bërthamën e unionit gjuhësor ballkanik. Vështruar nga ky aspekt, vlera e këtij fjalori është shumëdimensional.

Ky fjalor përfshin pjesën e tërësishme të leksikut të përdorshëm të gjuhës së sotme shqipe. Në të, përveç fjalëve me kuptime të rëndomtë dhe atyre me ngjyrim ekspresiv, janë futur edhe frazeologjizma, po edhe ndonjë dialektizëm, krahinorizëm e arkaizëm, por të cilat mendojmë se janë me interes gjuhësor. Fjalori përfshin edhe ndonjë fjalë ndërkombëtare, por vetëm ato që kanë përdorim shumë të gjerë



në shqipen dhe që janë përfshirë në Fjalorin Shpjegues të Gjuhës Shqipe.

Fjalori përshkohet nga një stil shkencor leksikografik, me një gjuhë të pasur dhe përkthime të qëlluara e tekst të ndërlidhur për lakmi. Një punë e tillë, dëshmon jo vetëm formimin e gjerë e të shëndoshë teorik, praktik dhe gjuhësor e metodologjik, veçmas leksikologjik e leksikografik, por edhe aftësinë e gjykimit të drejtë dhe kreativitetin e autorit.

Me këtë fjalor si edhe me fjalorët e tjerë, hartuesi dëshmon zell dhe përkushtim të madh në leksikografinë dygjuhëshe shqip - maqedonisht e anasjelltas.

### **Pikëpamje, këshilla e propozime**

Natyrisht se në çdo fjalor, por diku më shumë e diku më pak, mund të gjendet ndonjë gabim material e drejtshkrimor, pasaktësi në gjetjen e fjalës përkatëse të gjuhës A në gjuhën B, lëshime në gjetjen e frazeologjisë përkatëse të shqipes apo të maqedonishtes, ndonjëherë edhe me përkthime të paqëlluara që nuk përkojnë me natyrën e gjuhës etj. Fjala vjen, në një fjalor dygjuhësh kur jepet alfabeti i një gjuhe, mbi të shkruan: македонска азбука - alfabeti maqedon. Dihet se nuk themi alfabet shqiptar, alfabet maqedon; por alfabeti i gjuhës shqipe, alfabeti i maqedonishtes, meqë abëcëja lidhet me gjuhën e jo me kombin.

Në një nga udhëzimet për përdorimin e fjalorit është thënë një e pavërtetë se: “theksi në gjuhën shqipe, ndryshe nga maqedonishtja, është i lëvizshëm.” Ky pohim do të ishte i drejtë po qe se do të thuhej e kundërta, se: *shqipja ka theks të lirë të palëvizshëm (të ngulitur) në rrënjë të fjalës gjatë paradigmës së eptimit (lakimit dhe zgjedhimit), ndërsa maqedonishtja ka theks të lëvizshëm, meqë kur fjala merr forma të ndryshme gramatikore, ajo zhvendoset dhe bie gjithnjë në zanoren e tretë të fjalës.*<sup>21</sup>

<sup>21</sup> Në maqedonishte në fjalët shumërokëshe theksi bie në zanoren e tretë, pra kemi theksim proparoksiton. Kur ndryshon gjatësia e fjalës gjatë fjalëndryshimit ose fjalëformimit, duke i prapangjitur formante gramatikore, theksi rregullohet automatikisht në të njëjtën largësi: në rrokjen e tretë numëruar nga fundi i fjalës. Krahaso: në maqedonishte *uçënik, uçënikot, uçënicite* “nxënës, nxënësi, nxënësit”; *uçënička, uçëničkata, uçëničkite* “nxënëse, nxënësja, nxënëset”; *uçitel, učitelot, učitelite* “mësues, mësuesi, mësuesit”; *prodavaç, prodávaçi, prodaváçite* “shitës, shumë shitës, shitësit” etj.). Pra, gjatë shtimit të numrit të rrokjeve tek e njëjta fjalë

Në fjalorët terminologjikë gjejmë edhe më shumë lëshime natyrash të ndryshme, veçmas pasaktësi në gjetjen e termit përkatës në shqip, gabime drejtshkimore, largësi të mëdha rreshtash sa për të shtuar faqe etj. Me të drejtë një fjalor duhet të emërtohej ndryshe nga titulli që ka: Fjalori Terminologjik Juridik (jo në trajtë të shquar Fjalori, por Fjalor e dy fjalët që pasojnë të shkruheshin me shkronja të para të vogla).<sup>22</sup> Mendojmë se duhet të quhej “Fjalor maqedonisht-shqip i termave juridikë”.

### **Gjykojmë se në të ardhmen duhet të shtrohen detyra të tjera më të mëdha edhe në fushën e leksikografisë**

Përmbledhtas, veprimtaria kryesore leksikografike në Maqedoni duhet përqendruar në disa fusha:

1. Të shfrytëzohen të arriturat e leksikografisë shqipe e të huaj, në veçanti përvoja praktike e teorike e leksikologëve e leksikografëve tanë të shquar.
2. Duhet të vijojë puna e hartimit të fjalorëve dygjuhësh shqip-maqedonisht e anasjelltas, sidomos në pasurimin e fjalorëve tani më të botuar tani më me punë ekipore.
3. Të përpilohen fjalorë cilësorë terminologjikë dygjuhësh fushash të ndryshme.
4. Të vilet materiali dialektor, veçmas pasuria leksikore e frazeologjike dhe në bazë të punimeve të mëparshme si dhe materialit të siguruar, të hartohet një fjalor fjalësh krahinore si dhe një fjalor frazeologjik i nga të folmet shqipe në Maqedoni. Siç dihet, dialektet e shqipes kanë qenë dhe vijojnë të mbeten ende burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare me fjalë e frazeologji popullore, kuptime e ngjyrimë fjalësh, mjete shprehëse si dhe për zhvillimin e normës leksikore. Ka edhe shumë fjalë e shprehje të tjera nga dialektet që

---

(me prapashtesa të ndryshme) theksi e ndërron rrokjen, gjithnjë për ta ruajtur pozitën e caktuar të theksit: në rrokjen e tretë nga fundi i fjalës. Kështu, në maqedonishte, e theksuar gjithnjë mbetet rrokja e tretë nga fundi, me pak përjashtime të tipit *godináva* “sivjet” < *ovaa gódina* [ovagódina] “këtë vit, sivjet” etj., ku theksohet rrokja e dytë; ose te disa fjalë të huazuara nga frëngjishtja, si *byró*, *depó* etj. te të cilat ruhet theksi fundor nga gjuha dhënëse). Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, 2020, f. 195.

<sup>22</sup> Titulli në formën origjinale është kështu: Afrim Osmani, *Терминологи Правен Речник - Fjalori Terminologjik Juridik*, Furkan ISM, Shkup, 2004.

mund të hyjnë në leksikon e gjuhës letrare, sepse e pasurojnë atë, zëvendësojnë fjalët e huaja, sjellin nuanca e ngjyime emocionale etj. Nevoja e gjurmimit, mbledhjes dhe e studimit të leksikut dialektor e krahinor të shqipes me të drejtë konsiderohet si e domosdoshme.

5. Duhet qëmtuar edhe leksiku në krijimtarinë popullore dhe në letërsinë artistike.
6. Të zgjerohen e të thellohen vëzhgimet për marrëdhëniet e shqipes në fushën e leksikut e të frazeologjisë me gjuhët sllave, në veçanti me maqedonishten.
7. Të themelohet sektori i Leksikografisë në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve ose edhe më mirë të themelohet një Institut Albanologjik në Maqedoni. Në të të nis puna për një kartotekë të leksikut të shqipes, për të vjelë e regjistruar lëndën leksikore e frazeologjike nga goja e popullit dhe nga botimet.

Këto punë madhore kërkojnë përkrahjen e organeve shtetërore, bashkërendimin e gjuhëtarëve të Maqedonisë dhe bashkëpunimin e specialistëve dhe institucioneve arsimore e shkencore në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

Realizimi i tyre kërkon një zgjerim, thellim, ngritje të mëtejme të punës kërkimore, zhvillimin e një veprimtarie të programuar mirë si dhe bashkërendimin sa më të mirë të punës së specialistëve.


### **Bibliografia**

- Mile Qorvezirovski – Lutvi Rusi, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Prosvetno Dello, Shkup, 1967.
- R. Çadri, *Fjalor shqip-maqedonisht*, Албанско-македонски разговорник, Tiranë, 1995.
- Adnan Agai – Kimete Agai, *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, 1996.
- Haki Ymeri – Petar Atanasov - Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht*, Dav Mari, Kumanovë, 1997.
- Adnan Agai – Kimete Agai, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Meshari, Shkup, 1999.
- Jani Thomai, Xhevat Lloshi, Rusana Hristova, Kosta Qiriazhi, Ana

- Melonashi, *Fjalor frazeologjik ballkanik*, Dituria, Tiranë, 1999.
- Halit Burrniku, *Fjalor tematik shqip-anglisht-maqedonisht*, 1999.
- Haki Ymeri – Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Logos-A, Shkup, 2000.
- Qemal Murati, *Fjalor ideomatik shqip-maqedonisht*, 2003.
- Ilija Strashevski, *Fjalor maqedonisht-shqip, shqip-maqedonisht*, 2004.
- Afrim Osmani, *Fjalor terminologjik juridik*, Furkan, ISM, Shkup, 2004.
- Adnan Agai – Kimete Agai, *Fjalor shqip-maqedonisht*, Meshari, Shkup, 2005.
- Mustafa Ibrahim, *Fjalor bashkëbisedues maqedonisht-shqip*, Interlingua, Shkup, 2005.
- Shaban Prevalla, *Fjalor afarist maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht*, Veles, 2007.
- Haki Ymeri – Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Menora, Shkup, 2008.
- Ismail Zejneli, Jeton Shasivari, *Fjalor juridik shqip-maqedonisht*, 2008.
- Azis Pollozhani, *Fjalor i frazeologjizmave të mjekësisë* (doracak për punonjësit shëndetësorë dhe për pacientët), 2009.
- Ismet Osmani, *Fjalor i terminologjisë juridike shqip-maqedonisht* (për nevojat e studentëve, në dorëshkrim), Shkup, 2008.
- Vebi Rrustemi, *Fjalor shqip-maqedonisht për fillestarë*, Shkup, 2011.
- Haki Ymeri – Bina, *Fjalor shqip-maqedonisht*, Shkup, 2012.
- Институт за македонски јазик, *Толковен речник на македонскиот јазик, том I (А-Ж)*, Скопје, 2003; *Толковен речник на македонскиот јазик, том II (З-К)*, Скопје, 2005; *Толковен речник на македонскиот јазик, том III (Л-О)*, Скопје, 2006.
- Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
- Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.

## 1.6. FJALORI SHQIP-MAQEDONISHT I PROFESOR HAKI YMERIT

Fjalori shqip-maqedonisht i profesorit Haki Ymeri - Bina (botuar nga Logos-A, Shkup, 2012) për nga madhësia me 976 faqe, është vepër e vëllimshme leksikografike në kuadrin e fjalorëve dygjuhësh shqip-maqedonisht në Maqedoni. Me hartimin dhe botimin e këtij fjalori dygjuhësh shqip-maqedonisht jepet edhe një ndihmesë e madhe në krijimin e urave lidhëse ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve, në njohjen e ndërsjellë të gjuhëve dhe të kulturave të këtyre dy popujve të gadishullit Ilirik. Kjo vepër e rëndësishme leksikografike pasuron fondin e fjalorëve dygjuhësh të shqipes e të maqedonishtes.



Fjalorit shqip-maqedonisht të 2012-ës i paraprijnë edhe dy fjalorë të tjerë: Haki Ymeri, Patar Atanasov, Zihni Osmani, Fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht, shtëpia botuese “Davmari”, Kumanovë, 1996 me një gramatikë të shkurtër të shqipes, dedikuar kryesisht nevojave të nxënësve dhe të studentëve; Haki Ymeri, Zihni Osmani, Fjalor maqedonisht-shqip botuar në Shtëpinë botuese “Logos-A, me 41 000 fjalë dhe ribotuar në Shtëpinë botuese “Menora”, Shkup, më 2008, në formë të përmirësuar dhe të zgjeruar deri më 50. 000 fjalë.

Autori i këtij fjalori, Haki Ymeri është profesor universitar në pension, studiues i shqipes dhe leksikograf i zellshëm. Jeton dhe vepron në Shkup.<sup>23</sup> Në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit

<sup>23</sup> Haki Ymeri lindi më 21 mars të vitit 1937 në Kumanovë. Shkollën fillore dhe gjimnazin i kreu në vendlindje më 1957 (të mesmen). U regjistrua në grupin matematikë-fizikë të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Shkup. Diplomoi në afat të caktuar dhe punoi në Shkollën Normale “Liria”, që u riemërua në “Zef Lush Marku” (shkollë për përgatitjen e kuadrit mësimor) të Shkupit, në shkollën fillore “Bajram Shabani” të Kumanovës, në shkollën fillore “Liria” të Shkupit, në gjimnazin “Zef Lush Marku” të Shkupit, si dhe në Entin për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit në Shkup, si këshilltar pedagogjik. Në këtë periudhë bashkëpunoi me revistat dhe gazetatat pedagogjike në të cilat shkruante për mënyrën e mësimdhënies së matematikës, por

të Filologjisë “Bllazhe Koneski” të Shkupit punoi plot 16 vjet ku edhe u pensionua me titullin e profesorit ordinar. Në këtë kohë ligjëroi lëndët e: Fonetikës së gjuhës shqipe, Dialektologjisë shqiptare, Historisë së gjuhës shqipe, një kohë të shkurtër edhe kursin e Teorisë dhe praktikës së përkthimit.

Shkroi një varg punimesh shkencore, që arrijnë mbi 60 njësi bibliografike. Krahas kësaj pune, mori pjesë edhe në shumë seminare, konsultime, simpoziume e konferenca shkencore vendore e ndërkombëtare në Shkup, në Tiranë, në Shkodër, në Prishtinë, në Tetovë e gjetiu. U pensionua më vitin 2001.

### **Bibliografia e përzgjedhur:**

1. *Përdorimi i drejtë i disa termave matematikore*, Shkëndija, Prishtinë, 15.10.1978, nr. 15-16.
2. *Përpunimi i lektyrës shkollore - Dita e Re të Esad Mekulit*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1980.
3. *Relacionet matematikore dhe zbatimi i tyre në gjuhë*, Flaka e Vëllazërimit (Pedagogu në katër numra ), Shkup, 1980.
4. *Veçoritë morfologjike të së folmes shqipe të Kumanovës* (rezyme e punimit të magjistraturës), Jehona 1-2, Shkup, 1982.
5. *Shkalla e realizimit të programit mësimor të gjuhës shqipe në klasën e tretë*, Jehona nr. 8, Shkup, 1983.
6. *Shkalla e realizimit të programit mësimor të gjuhës shqipe në klasën e katërt*, Jehona nr. 9-10, Shkup, 1984.
7. *Shkalla e realizimit të programit mësimor të gjuhës shqipe në klasën e pestë*, Jehona nr. 2, Shkup, 1985.
8. *Patronimet dhe mikrotoponimet e Rajonit të Lipkovës*, Jehona nr. 3, Shkup, 1985.
9. *Sintaksa e gjuhës shqipe*” (në bashkautorësi). “Prosvetno dello”, Shkup, 1985.

---

edhe studioi gjuhën dhe letërsinë shqipe, të cilën e mbaroi me shumë sukses, për të magjistruar dhe doktoruar më vonë në fushë të gjuhësisë.

10. *Etimologjia e errët e një toponimi*, Rilindja, Prishtinë, 25.02.1988.
11. *Doracaku linguistik (i Ahmet Hajdarit) dhe zbatimi praktik i tij*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 18.6.1989.
12. *Baza dialektore e gjuhës së Naim Frashërit*, Jehona nr. 1, Shkup, 1991.
13. *Diftongu dytësor i grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore*, Jehona nr. 3, Shkup, 1994.
14. *Gjuhësia ballkanike e prof. Shaban Demirajt*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 6.10.1994.
15. Demiraj, Shaban, *Балканска лингвистика* (Ballkanska lingvistika, përkthim nga shqipja në maqedonisht), Logos A, Shkup, 1994.
16. *Gjuhësia ballkanike e prof. Shaban Demirajt* (recension), Jehona nr. 1, Shkup, 1995.
17. *Veçoritë sintaksore të së folmes shqipe të Markova Rekës* (në bashkautorësi me Zihni Osmanin), Shqyrtime albanologjike nr. 1, Shkup, 1995.
18. *Mikrotoponimia e rajonit të Markova-Rekës*, Shqyrtime albanologjike, nr. 1, Shkup, 1995.
19. *За едно јазично совпаѓање на фонетско рамниште помеѓу албанскиот и македонскиот јазик*, AShAM, tryezë e rrumbullakët “Gjuhët në truallin e Republikës së Maqedonisë”, Shkup, 10.01.1996.
20. *Латинската консонантна група “ct” во албанскиот јазик* (Latinskata konsonantska grupa “ct” vo albanskiot jazik), Takimet Romano-Ballkanike, Shkup, 27 dhe 28.04.1995.
21. *Kontribut i madh i dialektologjisë shqiptare në rrjedhat bashkëkohore të studimeve gjuhësore*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 18.02.1996.
22. *Kontribut i rëndësishëm i gjuhësisë shqiptare*, Rilindja, 19.04.1996.
23. *Mbi një bashkëpërkim mes gjuhës shqipe dhe asaj maqedonase në fushën e fonetikës*, Studime filologjike, 1-4; Tiranë, 1996, f. 69-73.
24. *Olivera Jashar - Nasteva dhe kontributi i saj në fushë të albanistikës* (Kontribute të albanologëve të huaj për studimin e gjuhës shqipe), Simpozium i mbajtur në Shkodër, në dhjetor të vitit 1996, botuar në “Gustav Majer 1850-1900”, Shkodër, 1996, f. 83-92.





25. *Dy sistemet fonologjike të së folmes shqipe të Markova-Rekës*, Jehona 4-5, Shkup, 1997.
27. *Një përkitje ndërgjuhësore ballkanike në fushë të prozodisë*”, Shqyrtime albanologjike 3/1997, f. 43-50.
28. *Fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht* (në bashkautorësi), Kumanovë, 1997.
29. *Dy fjalë për lexuesin parathënie e romanit “Haxhi Llojo”* të Reshad Kadiqit, Llogos-A, Shkup, 1998.
30. *Gjuhësia ballkanike e prof. Shaban Demirajt*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 10 .1994.
33. *Kontribut i madh i dialektologjisë shqiptare në rrjedhat bashkëkohore të studimeve gjuhësore*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 18.02.1996.
34. *Një kontribut i rëndësishëm i gjuhësisë shqiptare*, Rilindja, 19.04.1996, Tiranë
35. Redakturë profesionale e monografisë “*E folmja e shqiptarëve të Ukrainës*”, Shkup , 1996.
36. *Për një kontribut të rëndësishëm në fushë të albanistikës*, Jehona nr. 1, 1997.
37. *Dy sistemet fonologjike të së folmes shqipe të Markova-Rekës*, Jehona 4-5, Shkup, 1997.
38. *Strukturat zanore ua, ie dhe ye në gjuhën e Naim Frashërit*, në *Годишен зборник, книга 23, Скопје*, 1997, f. 83-87.
39. *Veçoritë morfologjike të së folmes shqipe të Markova Rekës*, Shqyrtime albanologjike 4, Shkup, 1998, f. 33.
40. *E folmja shqipe e Karshiakës* (monografi prej 288 faqesh), Shkup, 1998.
41. *Dy fjalë për Fjalorin e antonimeve të prof. Miço Samarës*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000.



42. *Mbi një bashkëpërkim gjuhësor mes gjuhës shqipe dhe asaj maqedonase në fushën e fonetikës*, Studime filologjike, Tiranë, 1996, f. 69.
43. *Për një alfabet më praktik*, Shqyrtime Albanologjike 5, Shkup, 1999.
44. *Fjalor maqedonisht-shqip*, Logos-A, Shkup, 1999.
45. *Para ribotimit të Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe*, Jehona, Shkup, 2008.
46. *Албанскиите лексички елементи во илтриитомниот Речник на македонскиот јазик I, II и III том* (Albanskite leksiçki elementi vo tritomniot Reçnik na makedonskiot jazik I, II i III tom, simpozium në Institutin e Gjuhës Maqedonase në Shkup)
47. *Një rregull drejtshkrimore lidhur me [ë]-në paratheksore te fjalët e prejardhura*, Konferenca Shkencore “Dyzet vjet të shqipes standarde – arritje dhe probleme aktuale” , Prishtinë, 7 - 8 dhjetor 2012.

Edhe pas pensionimit, prof. Hakiu është mjaft aktiv në veprimtarinë intelektuale, duke marrë pjesë në konferenca shkencore e botuar artikuj me vlerë për shqipen. Ai shquhet sidomos në leksikografi, duke botuar deri më tani **tre fjalorë dygjuhësh shqip-maqedonisht** e anasjelltas:

1. Haki Ymeri, Petar Atanasov, Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht*, Davmari, Kumanovë, 1996.
2. Haki Ymeri - Zihni Osmani, *Fjalor maqedonisht-shqip*, Logos-A, Shkup, 2000.
3. Haki Ymeri - Bina, *Fjalor shqip-maqedonisht*, Logos-A, Shkup, 2012, 980 faqe.

Pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit përdorimi i shqipes u shtri dukshëm në përdorim zyrtar në Maqedoni si dhe u shtua interesimi i maqedonasve për ta mësuar shqipen. Fjalorët paraprakë nuk mund të plotësonin kërkesat e kohës, andaj u ndje nevoja që të hartohet një fjalor më i pasur. Na mungonte një fjalor i tillë i tipit të mesëm, para së gjithash për të lehtësuar përkthimin nga shqipja në maqedonisht, sidomos në administratën shtetërore e publike dhe në kuvendin e Maqedonisë.

Rrjedhimisht, ky Fjalor jo vetëm që ka vlerë të madhe praktike, por mund të shërbejë edhe si lëndë e vlefshme për të hulumtuar e studiuar lidhjet e shqipes dhe të maqedonishtes në fushën e leksikut si dhe të fjalësit në mesin e gjuhëve ballkanike. Për këtë punë madhore, autori ka konsultuar një mal fjalorësh terminologjikë, frazeologjikë, fjalorësh shpjegues, enciklopedikë, dygjuhësh e shumëgjuhësh në shqip e në disa gjuhë të tjera.

Fjalori shqip-maqedonisht i prof. Hakiut është fryt i punës sistematike e të palodhshme shtatëvjeçare. Rëndom, sipas praktikës së përgjithshme, fjalorë përpilojnë një grup autorësh që punojnë në institute leksikografike, ndërsa prof. Hakiu falë punës vetëmohuese ka arritur të na japë një fjalor të vëllimshëm me rreth 1000 faqesh.

Ky fjalor për nga madhësia është i pari i këtij lloji ndër veprat leksikografike në Maqedoni. Ai pason Fjalorin maqedonisht-shqip të autorëve Mile Qorvezirovski e Lutfi Rusi, botuar më vitin 1967, i cili luajti një rol të rëndësishëm kulturor për një kohë relativisht të gjatë; Fjalorin dykahësh maqedonisht-shqip dhe shqip-maqedonisht me nga 13.000 fjalë në çdo kah, i punuar si një fjalor shkollor, Fjalorët maqedonisht - shqip dhe shqip - maqedonisht të Adnan dhe Kimete Agait; Fjalorin maqedonisht – shqip të Haki Ymerit – Zihni Osmanit, Logos-A, Shkup, 2000 me 42. 000 fjalë, të ribotuar në formë të përmirësuar në shtëpinë botuese "Menora"- Shkup.

Fjalori shqip - maqedonisht i profesorit Haki Ymeri - Bina plotëson kërkesat e një numri të madh përdoruesish të sferave të ndryshme profesionale, të përkthyesve nga shqipja në maqedonisht, të studentëve dhe të intelektualëve shqiptarë ose të tjerëve që e njohin gjuhën e sotme shqipe dhe që kanë nevojë ta flasin e ta shkruajnë drejt shqipen e maqedonishten. Kjo kërkesë dita-ditës po rritet, krahas me demokratizimin e jetës, jo vetëm në Maqedoni, por edhe më gjerë në nënqiellin e Ballkanit, mbi të gjitha në Republikën e Shqipërisë, me të cilën lidhjet tradicionalisht të mira midis dy popujve po begatohen ditë e për ditë. Ky realitet e rrit jo vetëm vlerën praktike të fjalorëve të këtillë, por pa mëdyshje, zgjon edhe interes shkencor, meqenëse me këta fjalorë plotësohet lidhja ndërleksikore e të dy gjuhëve, e cila paraqet edhe bërthamën e unionit gjuhësor ballkanik. Vështruar nga ky aspekt, vlera e këtij fjalori është shumëdimensionale.

Fjalori në fjalë përfshin pjesën e tërësishme të leksikut të përdorshëm të gjuhës së sotme shqipe. Në të, përveç fjalëve me

kuptime të rëndomta dhe atyre me ngjyrim ekspresiv, janë futur edhe frazeologjizma, po edhe ndonjë dialektizëm, krahinorizëm e arkaizëm, por të cilat mendojmë se janë me interes gjuhësor. Fjalori përfshin edhe ndonjë fjalë ndërkombëtare, rëndom ato që kanë përdorim shumë të gjerë në shqipen dhe që janë përfshirë në Fjalorin Shpjegues të Gjuhës Shqipe.

Fjalët janë radhitur sipas alfabetit të shqipes. Këtu janë përfshirë edhe në sasi fjalësh të leksikut bisedor, ndonjë arkaizëm, historizëm e arkaizëm, dialektizëm e krahinorizëm, një numër i madh frazeologjizmesh dhe idiomash që pasqyrohen në shtyp dhe në letërsinë artistike. Përveç kësaj, janë dhënë edhe një sasi e konsiderueshme termash profesionalë e shkencorë, që kanë denduri të madhe përdorimi. Në shumë raste fjalët janë pasqyruar edhe me ngjyime karakteristike, si ato keqësuese, zvogëluese, përkëdhelëse, zmadhuese etj.

Në fund të Fjalorit janë dhënë edhe emrat gjeografikë në shqipen me barasvlerësit në maqedonishte, veçmas emrat që nuk përkojnë fonetikisht.

Siç shkruan edhe në Parathënien e Fjalorit, ndihmesë të vlefshme në përzgjedhjen dhe përpunimin e materialit leksikor autorit i kanë ofruar disa kolegë e miq, veçmas: prof. Miço Samara, akademik Bahri Beci (punonjës të Institutit të Gjuhës Shqipe të Tiranës), dr. Asllan Hamiti e dr. Ajten Qamili (mësimdhënës në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit), dr. Zekirija Ibrahimimi e mr. Hidajete Azizi (punojnës në Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni), profesori i kimisë Burhanxhait Nebiu, profesor i Akademisë së dikurshme Pedagogjike në Shkup, studenti i diplomuar në grupin e përkthimit Qamuran Ismaili e shumë të tjerë, të cilëve autori u shpreh falënderime për ndihmën e dhënë. Ndhimesë profesionale kanë dhënë edhe dr. Snezhana Vellkovska (këshilltare shkencore e Institutit të Gjuhës Maqedonase “Kërste Misirkov” të Shkupit dhe redaktore e Fjalorit shpjegues të maqedonishtes, si dhe nga profesor Trajko Stamoski (ish-këshilltar shkencor e drejtor i Institutit të Gjuhës Maqedonase në Shkup).

Gjatë hartimit të Fjalorit, prof. Hakiu është konsultuar me shumë intelektualë, profesionistë fushash të ndryshme, veçmas me zotëri Bahri Islamin, ish-gjykatës i Gjyqit Kushtetues të Maqedonisë, juristin Numan Limani, profesoreshën e muzikës në Akademinë e Muzikës në Prishtinë, mr. Seniha Spahiu, dr. Xhemaludin Idrizin, profesor në Universitetin e

Evropës Juglindore, shkrimtarin dhe publicistin Rexhep Zllatku etj., që dhanë ndihmesë në ngritjen e cilësisë së Fjalorit.

Burim kryesor i paraleles shqipe të fjalorit, përkatësisht i korpusit të shqipes ishte në radhë të parë Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, 1980; Fjalori i gjuhës shqipe, 2006 si dhe Fjalori i gjuhës shqipe, 1954 të botuar nga Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë në Tiranë si dhe fjalorë të tjerë dygjuhësh shqip - gjuhë e huaj.

Fjalori përshkohet nga një stil shkencor leksikografik, me një gjuhë të pasur dhe përkthime të qëlluara e tekst të ndërlidhur për lakmi. Një punë e tillë, dëshmon jo vetëm formimin e gjerë e të shëndoshë teorik, praktik dhe gjuhësor e metodologjik, veçmas leksikologjik e leksikografik, por edhe aftësinë e gjykimit të drejtë dhe kreativitetin e autorit.

Me këtë fjalor, hartuesi dëshmon zell dhe përkushtim të madh në leksikografinë dygjuhëshe shqip - maqedonisht e anasjelltas. Profesor Hakiun e falënderojmë dhe e përgëzojmë për këtë vepër të rëndësishme për leksikografinë dygjuhëshe dhe përgjithësisht për gjuhësinë shqiptare. Autorit i urojmë suksese të tjera në veprimtarinë leksikografike.

## 1.7. NDIHMESA TË AKAD. JANI THOMAIT NË FUSHËN E LEKSIKUT DIALEKTOR

Është kënaqësi që jemi mbledhur këtu, në Korçë në një Konferencë Shkencore Ndërkombëtare në të cilën shënojmë 75-vjetorin e lindjes dhe veprimtarinë gjysmëshekullore shumë të frytshme të akademik Jani Thomai.

Akademiku i nderuar është një nga figurat më të shquara të shkencës shqiptare, sidomos në fushën e leksikologjisë, leksikografisë, të frazeografisë e të semasiologjisë.

Nga studimi mbi leksikun dialektor dhe krahinor në shqipen e sotme të studiuesit dhe pedagogut të fjalës shqipe përvijohen dy porosi udhërrëfyese, largpamëse e dobiprurëse për gjuhën dhe kombin tonë:

*Porosia e parë:* Vetëdijësimi ynë për shfrytëzimin e leksikut dialektor e krahinor si burim kryesor për pasurimin e fjalësit të shqipes letrare. Thjesht, vepra del me parimin se lënda gjuhësore (fjalët dhe tipat fjalëformues) nuk duhet “importuar” pa nevojë nga gjuhët e tjera të Evropës e të botës, kur kemi “prodhimin tonë” e mund ta gjejmë gjithandej ku flitet shqipja dhe në letrat shqipe.

*Porosia e dytë:* Leksiku është sfera më e lëvizshme e gjuhës. Pasuria leksikore e pashtershme e shqipes dhe pak e shfrytëzuar deri më tani duhet të jetë burimi më i rëndësishëm për pastrimin nga elementi i huaj dhe për pasurimin e shqipes standarde me njësi leksikore, semantike e stilistike. Në procesin e standardizimit të mëtejshëm e të modernizimit të shqipes, për ta bërë atë të aftë që të përmbushë nevojat e shumëllojshme të një shoqërie të zhvilluar dhe për të konkurruar me sukses me gjuhët më të zhvilluara të botës, prirja kryesore duhet të jetë thjeshtimi i formave gramatikore dhe zgjerimi i fondit leksikor me burim anas (dialektor e krahinor).

Në veprën “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme” prof. Jani Thomai, si një profesionist i rrallë, shfrytëzon të arriturat më të reja në këtë fushë dhe ato i shpie përpara. Në qëndrimin për dialektizmat e krahinorizmat, për leksikun dialektor e krahinor, për dialektet e të folmet, për gjuhën letrare e për probleme të tjera teorike kyçe jo vetëm që është mbështetur në të arriturat shkencore të kohës, që dalin nga një varg punimesh dialektologjike, leksikologjike, në punime për gjuhën letrare etj. por ato me një rreptësi shkencore i analizon dhe i saktëson, madje shfrytëzon edhe të arriturat teorike e praktike të gjuhëve

të tjera, veçmas të frëngjishtes e të rusishtes. Vepra shquhet me shembuj të shumtë që ka sjellë autori. Pothuaj se gjysmën e tekstit të studimit e zënë fjalët dialektore e krahinore dhe gjegjëset e tyre në shqipen standarde.

Në këtë monografi, të ndarë në pesë kapituj, autori jep ndihmesa të çmuara: I. Rreth koncepteve e termave “dialektizëm” e “krahinorizëm”. II. Për leksikun dialektor e krahinor të shqipes dhe shtresimin e tij. III. Rreth leksikut dialektor e leksikut të gjuhës letrare. IV. Për fushën e përdorimit të dialektizmave e të krahinorizmave. V. Rreth trajtimit leksikografik të dialektizmave dhe të krahinorizmave, për ta pasuruar studimin me Treguesin e shembujve dhe me Bibliografi të pasur.

Dialektizmave e krahinorizmave leksikorë në shqipen nuk i është kushtuar ndonjë studim i veçantë edhe pse deri më tani janë botuar disa fjalorë krahinorë visesh të ndryshme, monografi përshkruese për shumë të folme shqipe ku bashkë me sistemin fonetik e fonologjik bëhet fjalë edhe për leksikun e të folmes përkatëse. Po kështu, nuk mungojnë edhe punimet me vlerë që shtjellojnë çështje lidhur me nevojën e vjeljes së leksikut dialektor e krahinor si burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes së sotme dhe si lëndë për hartimin e fjalorit të madh, për sinonimet, antonimet dhe homonimet në gjuhën shqipe, elementet e huaja leksikore në shqipen dialektore e letrare etj. Shtrirjes territoriale me izoglosa të veçanta të leksikut dialektor e krahinor i është kushtuar edhe vëllimi i dytë i Atlasit dialektologjik të shqipes.

Sipas njohurive tona, akademik Jani Thomai ka shkruar monografinë e parë më të plotë e me prurje të reja për leksikun dialektor e krahinor në gjuhën e përbashkët kombëtare.

Pas një trajtimi të shumanshëm të termave “dialektizëm” e “krahinorizëm”, analizës dhe sintezës së përkufizimit të deritashëm të tyre, ngjashmërisë dhe dallimit etj., akademik Thomai përfundon: “Mund të pranojmë me marrëveshje një kriter dallues të përafërt ndërmjet dialektizmave e krahinorizmave: kur fjala, që nuk e ka gjuha letrare, gjendet vetëm në një të folme ose në të folmet vetëm të një krahine, të merret si krahinorizëm; kur fjala gjendet në tërë dialektin ose në disa të folme të një dialekti (kuptohet, që mund të jenë edhe të krahinave të ndryshme), të merren si dialektizëm.”

Prof. Thomai pranon tri kritere për të përcaktuar karakterin dialektor a krahinor të fjalëve:

a) Kriteri i grupimit paradigmantik, d.m.th. kur fjala është dysor

a sinonim dialektor i qartë i një fjale tjetër që është pranuar si e normës letrare të tipit: *uzdajë* – shpresë, *pendël*, *shpendël* – pupël, *thi*, *guc* – derr; *gjã*, *hajvan* - kafshë; *kaposh/kokosh*, *knus* – këndes, gjel; *kallamboq/kollomoq* – misër; *gjiton*, *kojshi*, *komshi* – fqinj; *konop*, *tërkuzë* - litar etj.

b) Kriteri gjuhësor-fjalëformues, pasi cilësohen si dialektore a krahinore edhe variantet fjalëformuese (veç varianteve fonetike) që nuk janë normë letrare, si p.sh. në Has, në Shkrel e gjetkë për të treguar banorët e një vendi u shtojnë emrave të vendeve vetëm nyjën e përparme *i: i shaljan*, *i hazjan*; *i shkrel*, *i hot*, *i kastrat*. Në Gjilan të Kosovës banorët e fshatrave thonë jam (ai është) *i Godenve*, *i Shurdhanve*, *i Dunavve*, *i Biçakve*, *i Çelikve* (në kuptimin banor i fshatit Goden, Shurdhan, Dunav, Biçak, Çelik). Në të folmen e fshatit Brezë të Karadakut të Shkupit për formën standarde “çka” përdorin krahinorizmin mjaft të përhapur në shumë të folme të tjera të gegërishtes qendrore *xhit*, ndërsa për “diçka” thonë formën e përngjitur *dixhit*.

Në Veri kemi formime fjalësh me prapashtesën –shëm, në Jug me –uar: *i punueshëm* – *i punuar*, *i dëgjueshëm* – *i dëgjuar*, *i kuptueshëm* – *i kuptuar*, *i thyeshëm* – *i thyer* ... kuptohet që të dyja format janë normative dhe se ka dallim kuptimor ndërmjet formave të fjalëve me –shëm nga ato me –uar. Fjala vjen, kur themi se materiali që gjendet brenda një pakoje është e thyeshme, d.m.th. atë duhet bartur me kujdes se mund të thyhet, ndërsa nëse themi se diçka është e thyer kuptojmë se tani më veprimi ka mbaruar. “Dialektet e të folmet kështu përbëjnë një pasuri të pamatshme jo vetëm me njësi leksikore, por edhe me tipa e mjete fjalëformuese të specializuara për kategori gramatikore, klasa leksikore ose fusha konceptore të veçanta.”

c) Kriteri i fushës leksikore ose i fushës tematike (emrat e bimëve, të kafshëve, të shpendëve, të orendive shtëpiake, të veshjeve, të veglave të bujqësisë e të zejtarisë etj., kur janë lokale ose kur ndryshojnë mjaft nga një krahinë në tjetrën).

“Dialektet e të folmet kështu përbëjnë një pasuri të pamatshme jo vetëm me njësi leksikore, por edhe me tipa e mjete fjalëformuese të specializuara për kategori gramatikore, klasa leksikore ose fusha konceptore të veçanta.” Gjerësia e shtresës leksikore e krahinore, që përfshihet në rrethin e gjuhës letrare, sa vjen e rritet. Në këtë brez bëhet “fermentimi” i nevojshëm, gjatë të cilit fjalët krahinore fitojnë vlera të reja në atë shkallë sa bëhen “mbidialektore”, pra, nga krahinorizma



bëhen ish-krahinorizma në gji të gjuhës letrare.

Babai i fjalës shqipe në studimin e tij vend të posaçëm i kushton edhe sinonimisë dialektore. Për këtë me të drejtë përfundon se: “Sinonimia leksikore është mundësi gjuhësore nxitëse edhe për thithjen e fjalëve nga të folmet. Shtresa më e gjerë e fjalëve dialektore e krahinore përbëhet nga ato fjalë që kanë hyrë ose mund të hyjnë në gjuhën letrare si sinonime leksikore të fjalëve më të përgjithshme a të dialektit tjetër, duke sjellë jo vetëm larmi, por edhe pasurim me nuanca kuptimore, ngjyresa emocionuese etj. (tipi *piskamë, ushtimë, jehonë, dashakeq, keqdashës, cep, kënd, rrok, i rremë, rrekem* etj.)”.

Shtresën kryesore të leksikut të shqipes së sotme standarde e përbëjnë fjalët e shprehjet ***që i takojnë gjithë truallit gjuhësor të shqipes***, të cilat nuk mund të cilësohen më si të këtij a si të atij dialekti. Kjo shtresë përfshin pjesën kryesore të fjalëve e të shprehjeve të mbarë shqipes, pa të cilën nuk mund të merret me mend jeta e gjuhës së një kombi. Ballafaqimi i leksikut të dialektit të Veriut me dialektin e Jugut brenda gjuhës kombëtare krijon një raport të veçantë leksemash, që hetohet burimi dialektor e që krijojnë çifte sinonimike, si: *fshat – katund, vajzë – çikë, qumësht – tambël; fqinj, gjiton – kojshi, komshi; nxjerr – qes, ftoj – thirr, derr – thi, kyç – çelës, litar – konop, tërkuzë; rrugë – udhë, kokë – krye, kurriz – shpinë, hap – çel, tërë – gjithë, gjalpë – tëlyen, mëmëdhe – atdhe, ngordhë – cofë, dehem – pihem, dyzet – katërdhet, tigan – fultere, fërtere; fshehurazi - tinëz, gënjeshtër – rrenë, kafshë – gjã, hajvan; mbyll – mshel, rrogoz – hasër, këpucë – kundra, shportë – kosh, kopsht – bahqe, patate – kompir, misër – kallamoq, sopatë – sakicë, kotec – koçak, këndez – knus, gjel; kërric, pulisht – përlak, kec – edh, bushtër – kuçkë, lingua – zagar, luleshtrydhe – dredhëz, xhaxha – mixhë, fik (zjarrin) – shkym (zjarrin), çlodhem – pushoj, dem – m(ë) zat, ajër – frymë, eja – hajde, buf – hut; tregoj, rrëfeje – kallëzoj, shikoj - kqyr etj.*

Në konkurrencën normative – pohon Thomai - një (ose dy) mund të mënjanohet, por më e zakonshmja është ngulitja si dysorë leksikore, që në shumë raste është arritur përfundimisht, sikurse *hap – çel, ngre – çoj, kokë – krye, kurriz – shpinë, def – dajre, rrok – kap, sjell – bie, sjell – godit, sos – mbaroj, spec – piperkë, trangull – kastravec* etj., që mund të thuhet se janë barasvlerës si nga kuptimi, ashtu edhe nga shtrirja në përdorim.

Në të folmet shqipe ka edhe shumë fjalë të njëjta, por me variante



fonetike të dallueshme, të tipit *borë, bor, vdorë, xborë, zborë; shtëpi, shpi, shpaj/shpoj/shpëj; lëshoj, lshoj, shloj; fëmijë, fmi, fmajë; syri, sÿni, sajni; punoja, punonja, punojsha, punojshna* etj.

Përveç zhvillimit të brendshëm e të mëvetësishëm gjuhësor, në degëzimin dialektor deri diku kanë ndikuar, sidomos në leksikun dhe në sintaksën e të folmeve anësore, gjuhët e huaja në kontakt. Kështu, ndikimi i gjuhëve sllave është më i madh në të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut, në kosovarishte e shqipen e Malit të Zi; në Shqipërinë e Jugut vërehet më shumë ndikimi i greqishtes, në pjesën e bregdetit veriperëndimor është më i fuqishëm ndikimi i italishtes etj. Të tilla janë sllavizmat: *brazdë, zheg, flad, mraz, torishtë, voz, llovaçkë, potvërd, okolla, apet (opet)* etj. orientalizmat: *aksham, asker, azgan, badihava, begenis, çarshi, çoban, dost, gajle, haber, hyzmeqar, kollaj, sabah, sebeb, tuxhar, vakt* etj.

Rrugët e hyrjes dhe të përdorimit të turqizmeve akad. Jani Thomai i paraqet në një skemë me katër tipa, përkatësisht **turqizma**:

a) të zëvendësueshëm (*javash – ngadalë, karshi – kundrejt, bile – madje, qoshe –*

kënd, *bosh - i zbrazët* etj.);

b) si leksik special (historizmat, etnografizmat);

c) me ngjyresa emocionuese (negative) e stilistike:

ç) si dialektizma e krahinorizma.

Përgjithësisht është konstatuar se shumë huazime leksikore nëpër të folme kanë mbetur si historizma a arkaizma, të gjitha këto me emëruesin e përbashkët si krahinorizma.

Ndarja fetare e shqiptarëve (në islamë, ortodoksë e katolikë) nuk ka lënë gjurmë të thella në ndryshueshmërinë gjuhësore të tyre, përveç në emrat vetjakë dhe në fondin e fjalëve që lidhen me ceremonitë, zakonet e kulturën fetare përkatëse.

**Dialektet e shqipes kanë qenë dhe vijojnë të mbeten ende burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të gjuhës letrare** me fjalë e frazeologji popullore, kuptime e ngjyryme fjalësh, mjete shprehëse si dhe për zhvillimin e normës leksikore. Veprimi pasurues i të dy dialekteve mbi leksikun e gjuhës letrare është i barabartë. Pasuria leksikore e frazeologjike e shqipes, vlerësohet si pasuri e përbashkët kombëtare, pavarësisht nga burimi dialektor.

Gjuha letrare merr prej dialekteve çdo fjalë e shprehje që i duhet për të plotësuar sistemin dhe që i sjell asaj një pasurim të

vërtetë. Kështu, janë bërë pronë e gjuhës standarde një varg fjalësh e shprehjesh nga dialekti i Veriut, si *arushë, argëtoj, befas, cucë, diktoj, doke, fatos, bjeshkë, kacafytem, zanë, i zymtë, zeje, pushtoj, burrneshë, pushtoj, akullnajë, kodër pas bregut* etj. Disa fjalë madje ruajnë edhe trajtën fonetike dialektore, si: *amtare, zanore, zanë, shmang, farefisni, besëtytni, rrënojë, dashnor, shtambë, ranishte, bërthamë, krenar, synoj, barnatore, dhanore, mbeturinë* etj.

Ka edhe shumë fjalë e shprehje të tjera nga dialektet që mund të hyjnë në leksikun e gjuhës letrare, sepse e pasurojnë atë, zëvendësojnë fjalët e huaja, sjellin nuanca e ngjyrimë emocionale etj. Mjafton të përmendim këtu pasurimin e gjuhës standarde nga dialekti i Veriut me vargje sinonimesh të tipit: *grunishtë-grunore-grunajë* “arë e mbjellë me grurë”, *tamblak* “qengj pirës”; *tamblatore, tamblore, tamëltore* “lopë që jep shumë qumësht”; *tambloriz, tamëloriz* “oriz me qumësht”, *lule a bar tamblë; drynoj* “mbyll me dry”, *shpeshtinë* “pyll i dendur”, *shterpni* “të qenit shterp” etj.

Kolosi i fjalës shqipe sjell qindra shembuj dialektizmash ose krahinorizmash që s’e kanë ende një sinonim të mirëfilltë në gjuhën letrare (me kuptime ose nuanca kuptimore të veçanta) dhe që mund të përgjithësohen lehtë e të hyjnë në gjuhën letrare, si: *angërduf* “ai që fryhet e kapërdiset si gjel deti; ai që mbahet më të madh”; *ankojë* “njeri që qahet e ankohet vazhdimisht”, *cikon* “nxjerr lëng (pema)”, *defatore* “grua që i bie defit, *cucërrohem* “mblidhem shuk, bëhem grusht (nga frika etj.)”, *cukëlan* “që i ka rënë leshi vende-vende (për bagëtinë)”, *cullohem* “bëhem si fëmijë”, *eracak* “që nuhat mirë, që i bie në erë gjahut shpejt (zakonisht për qenin)”, *faran* “misër i farës”, *gërdhajë* “pjesët e padobishme të një fruti (pjesa e brendshme e frutit (p.sh. mollës) që nuk hahet bashkë me farat)” e një varg fjalësh të tjera.

“Të tilla fjalë e kuptime fjalësh ndër të folme ka me mijëra. Kartoteka e leksikut të shqipes -thotë Thomai - (KLSH) përmban shumë prej tyre, por ende ka shumë të tjera të pambledhura, që janë pasuri e çmuar e gjuhës dhe që mund të pasurojnë më tej gjuhën letrare kombëtare. Prandaj, me gjithë ndërlikimet që ka, studimi i kësaj shtrese është me rëndësi të veçantë. Studimi i tipave të dialektizmave e të krahinorizmave dhe i ndërthurjes së faktorëve gjuhësorë e jashtëgjuhësorë, karakterizimi i historisë së fjalëve dhe i gjendjes së sotme, përcaktimi i marrëdhënieve me shtresat e tjera leksikore, sidomos me leksikun e gjuhës letrare, zbulimi i vlerave dhe i fushave të përdorimit, dallimi i elementeve

vetjake nga huazimet, shtresimet nga pika të ndryshme vështrimi e çështje të tjera që janë objekt i këtij punimi, nuk marrin fund këtu, ato presin të çohen më tej me punime të tjera.”

**Gjuhëtari ynë i shquar në rrafshin kombëtar e ballkanik leksikon dialektor e krahinor e vështron edhe në krijimtarinë popullore dhe në letërsinë artistike.** Ja se si shprehet ai në monografinë “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme”: “Dihet që populli është krijuesi i gjuhës në tërësi, por te leksiku dialektor e krahinor dora e tij duket më e afërt, më e drejtpërdrejtë, gjë që ka sjellë për këtë një emërtim më të përgjithshëm: *leksik popullor*.... Si një nga burimet më të mëdha e më të sigurta për pasurimin e gjuhës letrare, në mos më kryesori, ai nuk mund të cilësohet sipas vendit që ka në shtresat leksikore të gjuhës, por sipas vlerave të paçmueshme, reale e potenciale, që janë shumë herë vendimtare në drejtimin e zhvillimeve gjuhësore, pa përmendur këtu fusha të tilla të gjera, si krijimtaria gojore popullore, letërsia artistike ..., në të cilat leksiku dialektor e krahinor ka, veç vlerave, edhe mbivlera, që s’i ka leksiku i përgjithshëm ose leksiku i gjuhës letrare. Këtu duhet të kujtojmë edhe aftësinë e madhe depërtuese të leksikut dialektor e krahinor në çdo “enë gjaku” të gjuhës letrare, madje deri në terminologjinë tekniko-shkencore.”

Ai identifikon dhe na sjell shumë fjalë me burim dialektor e krahinor në veprat e autorëve të vjetër, që nga Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, nga vepra të letërsisë së Rilindjes shqiptare etj., duke u mbështetur edhe në studimet e gjuhëtarëve të tjerë, veçmas të prof. Eqrem Çabejt, Androkli Kostallarit, Aleksandër Xhuvanit, Xhevat Lloshit etj.

Është e njohur se para formimit të shqipes standarde (në Kongresin e Drejtshkrimit, Tiranë, 1972) pothuajse të gjitha veprat e shkrimtarëve tanë janë shkruar në gjuhën dialektore a krahinore, shpeshherë me përpjekje për një gjuhë mbidialektore a mbikrahinore. Por, edhe pas formimit të gjuhës standarde shqipe, përdorimi i fjalëve dialektore e krahinore në letërsinë artistike është i lejueshëm: asaj i jep një ngjyrim popullor, bisedor. Fjalë të këtilla gjejmë edhe në shumë vepra të shkrimtarëve bashkëkohorë (si te veprat e Gjergj Fishtës, Lasgush Poradecit, Jakov Xoxës, Mitrush Kutelit, Dritëro Agollit e të shumë shkrimtarëve të tjerë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në diasporë).

Dialektizmat e krahinorizmat në një tekst letrar përfshihen për

qëllime stilistike. Ato shpesh i përdorin shkrimtarët për tipizimin e gjuhës së personazheve dhe për karakterizimin e mjediseve përkatëse në veprat letrare. Funkcionet që marrin krahinorizmat janë jo të pakta: për përshkrimin e peizazhit të fshatit ose të qyteteve të tjera, për riprodhimin e mjedisit, jetës familjare, për individualizimin ose tipizimin e personazhit (sepse shkrimtari e lidh personazhin për një të folme a krahinë, për një grup shoqëror, profesional ose kulturor) si dhe për efekte lirike a komike. Në prozën e Mitrush Kutelit, p.sh. krahinorizmat janë përdorë për të arritur efekte të diskajshme: si shfaqje e një gjuhe pa prestigj, inferiore që pasqyron mungesën e zhvillimit, për të dhënë humor e satirë, dhe në skajin tjetër, për të shprehur dinjitetin e jetës popullore, të banorëve të lashtë, të vlerave folklorike e burimore.

Me ngulitjen e normës së gjuhës standarde, krahinorizmat bëhen identifikues të përkatësisë territoriale të folësit e personazhit, evokojnë veçantinë e kulturës materiale e shpirtërore të tyre.

Profesori ynë i nderuar analizon krahinorizmat në veprat letrare të disa shkrimtarëve që kanë krijuar në gjuhën letrare, si Mitrush Kuteli, Shefqet Musaraj, Jakov Xoxa e Dhimitër Shuteriqi si dhe të disa shkrimtarëve që kanë vepra me bazë dialektore, veçmas poezinë e Enver Gjerqekut.

**Kontribut të madh mjeshtri i fjalës shqipe ka dhënë edhe në studimin e shkallës dhe të mënyrës së pasqyrimin të dialektizmave dhe të krahinorizmave në fjalorët shpjegues normativë të shqipes,** në përcaktimin e parimeve të përgjithshme të përfshirjes së tyre në këta fjalorë, në vlerësimet shkencore për fjalorët e deritashëm krahinorë si dhe në përfaqësimin e dialektizmave e të krahinorizmave në fjalorët dygjuhësh shqip – gjuhë e huaj ose anasjelltas.

Si leksikolog dhe leksikograf më i njohur shqiptar, me një përgatitje të jashtëzakonshme teorike dhe me përvojën e madhe praktike, ka arritur të na japë zgjidhje konkrete leksikografike. Ndërveprimi gjuhë shqipe – dialekt – gjuhë standarde, veçmas në fushën leksikore, përbëjnë një nga problemet më kryesore e nga më të vështirat. Çdokush që do të vë detyrë vetes të hartojë ndonjë fjalor krahinor, fjalor shpjegues normativ ose fjalor dygjuhësh shqip – gjuhë e huaj apo anasjelltas vështirë se do të bëjë një punë të suksesshme pa konsultuar me vëmendje prurjet praktike e shkencore të akademik Jani Thomait.

Akademik Thomai shpreh bindshëm disa nga veçoritë themelore të normës letrare në leksik:

a) Veçori e përgjithshme e normës letrare në leksik, në krahasim edhe me atë të nënsistemeve të tjera, është, siç dihet, gjerësia relative e veprimit të saj, që lejon praninë e dysorëve e madje të vargjeve normative, ku bëjnë pjesë, si gjymtyrë të barasvlershme, edhe fjalë dialektore a me burim dialektor. Dysorë e vargje të tilla, si: *fshat – katund – hap – çel, kokë – krye, udhë – rrugë, shpinë – kurriz, i shkathët – i zhdërvjellët, gjel – këndes – kokosh, vajzë – çupë – cucë* etj., fjalorët shpjegues të shqipes i japin si të rrafshit normativ, duke vënë, pa dyshim, në vendin e parë një të njërën fjalë, dominanten, që është më e përgjithshme, më asnjane, më e zhvilluar semantikisht, më e ngulitur në përdorim.

b) Si veçori e dytë e normës leksikore mund të përcaktohet perspektiva e saj e hapur, lëvizja dhe zhvillimi dinamik i pandërprerë, ndryshe nga sistemi fonetik ose struktura morfologjike, që, pas një precipitimi normativ, stabilizohen, fiksohen, duke pakësuar vazhdimisht variantet e dysorët, ndërkohë që në sistemin leksikor variantet nuk pakësohen, madje edhe mund të shtohen, pasi gjuha letrare kërkon një leksik të pasur, të larmishëm, me shumë sinonime.

c) Veçori tjetër e normës letrare në leksik është përshtatja me kërkesat e stileve në një shkallë më të gjerë se mjetet e nënsistemeve të tjera (më afër qëndron sintaksa). Kjo lejon që edhe në fjalorin shpjegues kombëtar leksiku dialektor të zërë vend më të gjerë, shumë herë jo si normë e përgjithshme, por me vlera stilistike të veçanta dhe me prirjen drejt ngulitjes si normë stilistike. Kalimi nga norma stilistike te norma e përgjithshme letrare është një rrugë që i çon edhe i rrënjos shumë fjalë dialektore në fondet leksikore të gjuhës letrare.

Babi i fjalës shqipe bën edhe një analizë statistike të njëjësive leksiko-semantike krahinore në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” me përfundimin se “sasia e fjalëve dhe e kuptimeve të karakterizuara si krahinore në FGjSSh nuk është e madhe. Për një fjalor shpjegues kombëtar të shqipes së sotme, të tipit të mesëm, me karakter normativ, por edhe synime informuese, kjo sasi mund të ishte edhe më e madhe, gjë që do t’i shërbente edhe më mirë sistemit leksikor e stilistik të gjuhës letrare. Fjalët e kuptimet krahinore u takojnë të folmeve të ndryshme të shqipes, të Veriut e të Jugut, përfshirë edhe të folmet arbëreshe.”

**Shkencëtari ynë me të drejtë e konsideron si të dobishme vazhdimin dhe intensifikimin e gjurmimit, mbledhjes dhe të studimit të leksikut dialektor e krahinor të shqipes**

“Fjala shqipe - thotë profesori - është një nga krijesat e pavdekshme

të popullit, e cila, duke kapërcyer shekujt, ka hyrë në kohën tonë më e pastër e më e fuqishme, sepse në të krijuesi i madh popull ka vënë dorën e dashurinë e vet. Gjuhëtari e gjurmoi me ngulm dhe ia zbuloi vlerat, shkrimtari e lëmoi dhe e zbukuroi, poeti e futi në këngë dhe ia shtoi forcën. Në fjalën shqipe ka hyrë e ngjeshur tërë jeta shumëshekullore e popullit tonë të lashtë e luftarak, kultura e tij e gjerë dhe e ruajtur mirë, një histori e lavdishme plot beteja. Tek ajo janë kthyer përherë sytë e brezave e kanë gjetur armë të fuqishme për mbrojtjen e njëjtësisë së vet si popull e komb.

Shkencëtari i fjalësit të shqipes edhe pse u jep përgjigje të merituar shumë çështjeve, ai përsëri lë të hapura disa probleme që duhet zgjidhur në të ardhmen. Shtresa leksikore e dialektizmave dhe e krahinorizmave, ose leksiku dialektor e krahinor, përbën një fushë të gjerë e të ndërlikuar në sistemin e gjuhës kombëtare dhe një çështje të vështirë për studimet gjuhësore. Megjithatë, leksikologu ynë arrin që edhe këtyre çështjeve të ndërlikuara t’u japë përgjigje shkencore. “Që tek emërtimet e përdorura deri më sot për këtë shtresë fjalësh, si “lokalizma, regjionalizma, idiomatizma” dhe “dialektizma” - fjalë dialektore e “krahinorizma” - fjalë krahinore, së bashku me konceptet që përfaqësojnë, shfaqen paqartësi ose qëndrime të ndryshme, që është edhe shprehje e një gjendjeje të paarrirë studimi”. Leksikografi ynë i njohur me këtë studim çon përpara përkufizimet dhe saktësimet e koncepteve dhe termeve “dialektizëm” e “krahinorizëm” si dhe sjell një fond shumë të pasur fjalësh dialektore e krahinore.

“Njohja e lëndës dialektore është ende e pamjaftueshme dhe jo e thelluar, megjithë punën e madhe që është bërë për grumbullimin e mbledhjen e saj; pra punimi pasqyron shkallën e sotme të njohjes së leksikut dialektor a krahinor... Do të duhen gjurmime të veçanta për çdo fjalë, që i zbulon kufijtë e shtrirjes së saj (edhe sipas kuptimeve që ka), për të thënë pastaj një mendim më të sigurt. Kjo ndjekje deri në fund e izoglosave, që është detyrë e Atlasit dialektologjik”, tani më u përmbush.

“Veç njohjes së pamjaftueshme të lëndës, vështirësi krijohen edhe për shkak të zbrazëtive të mëdha në studimin e leksikut dialektor e krahinor, qoftë të karakterit dialektologjik e historiko-gjuhësor, qoftë të karakterit leksikologjik. Pa mohuar arritjet e shënuara, që përmenden në këtë punim, - shprehet Thomai, - duhet thënë që vetë karakteri i ndërlikuar i problemeve, të cilat lidhen me leksikun dialektor e krahinor,

hap shtigje për interpretime të ndryshme, për pohime a mohime të diskutueshme, në gjuhësinë tonë e në gjuhësi të tjera. “Në monografitë dialektore vëmendje më e madhe i kushtohet përshkrimit të veçorive fonetike-fonologjike e morfologjike, ndërsa përciptas përshkruhet leksiku i të folmes, duke hartuar rëndom një fjalor të varfër, ndërsa fusha sintaksore pothuajse mungon fare.

Për studimet e mëtejme të hapur shumë shtigje të reja kërkimi, duke thënë se “Dëshirojmë që këto e çështje të tjera, që lidhen me leksikun dialektor, të bëhen objekt studimesh më të hapëta e më të thelluara.”

Monografia “Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme” është literaturë e patjetërsueshme për të gjithë leksikografët, leksikologët, dialektologët dhe albanologët në përgjithësi, sepse vepra ka vlerë të shumanshme dhe hap horizonte të reja për gjuhën kombëtare në përgjithësi, duke vështuar në rrafshin leksikor marrëdhëniet dialekt – krijimtari popullore – krijimtari letrare – shqipe standarde - planifikim të shqipes.

“Fjalës shqipe i janë përkushtuar breza të tërë luftëtarësh e atdhetarësh, dijetarësh e dashamirësish të gjuhës amtare. Gjuha shqipe ka heronjtë e dëshmorët e vet. Nuk ka vepër shkrimtari të mirë, - thotë profesori, - që të mos ketë nxjerrë në dritë një numër fjalësh e shprehjesh të rralla e me vlerë të burimit popullor. Leksiku shqip dialektor është në bërthamën e leksikut popullor.

Gjurmimi, mbledhja e studimi i fjalës shqipe me kohë është kthyer në detyrë jo vetëm shkencore, por edhe atdhetare...”

Këtë veprimtari shkencore dhe atdhetare të gjurmimit, mbledhjes, regjistrimit dhe të studimit të fjalës e të frazeologjisë shqipe po e bën si rrallëkush heroi i gjuhës shqipe, akademik Jani Thomai.

### **Literatura:**

AShASH, *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, pjesa II, Napoli, 2008.

Ashta, Kolë, *Mbi mbledhjen e landës leksikore për fjalorin e madh të shqipes*, në BShSh, 1952, IV.

Beci, Bahri, *E folmja e Shkrelit*, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971.

Dizdari, Tahir, *Fjalor i turqizmeve në shqipe*, Tiranë, 2005.



- Dhrimo, Ali – Tupja, Edmond – Ymeri, Eshtref, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2002.
- Goçi, Ibrahim, *Antonimet e gjuhës shqipe*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1985.
- Hamiti, Asllan, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014.
- Hoxha, Shefqet, *Vëzhgime mbi të folmen e Vilë-e-Kalisit të Lumës*, në DSh III, 1975.
- Ibrahimi, Mustafa, *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*, Shkup, 2007.
- Islamaj, Shefkije, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, 1985.
- Murati, Qemal, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.
- Nushi, J., *Fjalë popullore nga Myzeqeja*, 1991.
- Shehu, Hajri, *Fjalët dhe shprehjet popullore – burim i pashtershëm për pasurimin e leksikut të shqipes së sotme*, në GjJ, 1988, 2. *Burimet e gjurmimit të leksikut popullor*, në GjJ, 1989, 3.
- Thomai, Jani, *Çështje të leksikut potencial në gjuhën shqipe*, në GjJ, 1986, 2; *Rreth vlerave të fjalëve në gjuhën shqipe*, në GjJ, 1989, 2; *Rreth leksikut dialektor e krahinor*, në GjJ, 1989, 4;
- Thomai, Jani, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999; *Fjalori i fjalëve e i shprehjeve popullore*, Tiranë, 1982;
- Thomai, Jani, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, AShSh, IGjL, Tiranë, 2001.
- Zymeri, Abdullah, *Fjalor i fjalëve të rralla*, Rilindja, Prishtinë, 1979.



## 1.8. NGJASHMËRI FONETIKE E FONOLOGJIKE TË SHQIPES ME MAQEDONISHTEN<sup>24</sup>

### Përmbledhje

Ndërmjet shqipes dhe maqedonishtes si gjuhë indoevropiane, flektive dhe ballkanike është e natyrshme të ketë bashkëpërkime në të gjitha rrafshet gjuhësore.

Sipas klasifikimit morfologjik të gjuhëve, shqipja dhe maqedonishtja janë gjuhë flektive, por dallohen në atë se shqipja është gjuhë analitike-sintetike, ndërsa maqedonishtja është gjuhë analitike (nuk ka lakim emrash, por funksioni i emrit në fjali shprehet me konstruktin parafjalë + një emër në formë të ngurosur në njëjës a në shumës, në trajtën e pashquar a në të shquarën).

Dukuritë përbashkëta janë shtuar edhe për shkak kontaktit shumëshekullor në hapësirat ballkanike, duke formuar bashkë me greqishten, rumanishten dhe turqishten që flitet ndër ne një lidhje gjuhësore ballkanike, si dhe nën ndikimin e gjuhëve të tjera, e në radhë të parë të latinishtes, të greqishtes, të turqishtes; ndërsa në shekujt e fundit nën ndikimin e fuqishëm të gjuhëve neolatine, kurse në periudhën më të re nën ndikimin e anglishtes.

Pra, për arsye të faktorëve historikë, gjeografikë dhe gjuhësorë ndërmjet këtyre dy gjuhëve janë krijuar shumë ngjashmëri në të gjitha sferat gjuhësore: në sferën fonetike-fonologjike, në sferën e gramatikës (morfologji dhe sintaksë), në sferën leksikologjike dhe në sfera të tjera.

Është e njohur se si shqipja, ashtu edhe maqedonishtja kanë trashëguar një sasi të konsiderueshme fjalësh (shqipja mbi 2500 fjalë) nga gjuha mëmë indoevropiane, 5 fonema zanore /a, e, i, o, u/ aq sa i ka edhe maqedonishtja (a, e, i, o, u), një numër të madh fonemash bashkëtingëllore etj.

Ndërmjet këtyre dy gjuhëve deri më tani janë dëshmuar një numër i madh i paralelizmash, siç janë:

- theksi dinamik (në gjuhën maqedonase është i përcaktuar – në

---

<sup>24</sup> Kumtesë e lexuar dhe e botuar në përmbledhjen e punimeve “Shqipja e sotme dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera”, Universiteti “Ukshin Hoti”, Prizren, Meshari, Prizren, 2019, f. 9-26.

rrokjen e tretë, ndërsa në gjuhën shqipe është i papërcaktuar – zakonisht në njërin nga dy rrokjet e fundit dhe i palëvizshëm në paradigmat e eptimit);

- defonologjizimi i gjatësisë së zanoreve në të dy gjuhët standarde;
- kanë vetëm zanore gojore në shqiptimin letrar;
- i përkasin tipit të gjuhëve me shqiptim të tendosur (respektivisht nuk kanë diftongje fonematike);
- përkatësia e gjuhës shqipe dhe maqedonase në tipin e gjuhëve joakomoduese (pa modifikim të rëndësishëm kombinator dhe pozicional të fonemave);
- shqiptimi i një gjysmëvokali të reduktuar ëë];
- të dy gjuhët kanë shkrim fonetik (maqedonishtja shkruhet me alfabetin cirilik, ndërsa shqipja me alfabetin latin të përshtatur);
- drejtshkrimi fonetik është parimi themelor për shkrimin e të dy gjuhëve etj.

Në këtë punim do të shqyrtojmë disa dukuri të përbashkëta ndërmjet shqipes e maqedonishtes në fushën e fonetikës e të fonologjisë, si *ndërrimet morfonologjike të fonemave, përngjashmimi i tingujve, njëjtësimi në zëshmëri, rënia dhe shtimi i tingujve* si dhe *konsonantizimi i zanores [i] të patheksuar në [j]*. Jemi mbështetur në njohjen e mirë edhe të maqedonishtes, në përgatitjen solide profesionale, veçmas në tekstin iniversitar të Fonetikës e të fonologjisë, të gërshetuar me krahasime të shpeshta e të botuar në shqip e në maqedonisht si dhe në shfrytëzimin e literaturës tjetër. Kemi përdorur metodën e përshkrimit, analizës, sintezës, konkretizimit, krahasimit etj.

**Fjalët kyçe:** ngjashmëri, fonetike, fonologjike, gjuhë ballkanike, indoevropiane, flektive.

Për ballkanizëm konsiderohet nyja postpozitive (shqip: djal-**i**, maqedonisht: дечко-**то**), formimi i kohës së ardhme me pjesëzën: shqip: *do* – maqed.: *ќе* (qe); me prejardhje nga folja: shqip: *dua* – maq.: *сакa* (saka): *do të punoj* – maq. *ќе работам* (qe rabotam); rimarrja e kundrinës me ndihmën e formave të shkurtra të përemrave: shqip *E mora librin* – maq. *Ја зегов книгата* (*Ja zedov knjigata*); mospërdorimi i paskajores dhe zëvendësimi me lidhoren: në gegërishten *Duhet me shkue* – ndërsa në toskërishten e pranuar për formë standarde *Duhet të shkoj* – maq. *Треба да одам* (*Treba da odam*); mënyra e njëjtë e formimit të numrave prej 11 deri më 19: *një+mbë* (< mbi)+*dhjetë* > *njëmbëdhjetë* – maq.

*еден+над+десяти* > *единадесят* (eden+nad+deset > edinaeset); të dy gjuhët kanë një numër të madh leksemash të përbashkëta etj.<sup>25</sup>

Përveç këtyre veçorive të përbashkëta që u përmendën, ndërmjet gjuhës shqipe dhe maqedonase ka edhe paralelizma të tjerë në fushën e fonetikës e të fonologjisë, respektivisht se në të dy gjuhët veprojnë ligje të njëjta ose të ngjashme tingullore, siç janë ndërrimet tematike të fonemave në rrënjën e fjalës, përngjashmimi, rënia dhe shtimi i tingujve, konsonatizimi i zanores së mbyllur [i] (maq. [и]) në pozitë të patheksuar etj.

### 1. Ndërrime morfonologjike të fonemave

Në gjuhën shqipe dhe maqedonase, si edhe në gjuhët e tjera indoevropiane, kanë ndodhur ndërrime të caktuara tingujsh, zakonisht në mes apo në fund të fjalës, që në rrjedhë të kohës janë fonologjizuar dhe morfologjizuar. Ndërrimet e fonemave nistore në të dyja gjuhët janë më të rralla, sepse me ndërrimet e tilla do të errësohej apo do të humbej kuptimi i fjalës. Ndryshimet e këtilla fonematike të një fjalë e njëjtë luajnë rol morfologjik, ngase shërbejnë për të formuar dhe për të njohur kategoritë e caktuara gramatikore, siç janë: forma e shumësit, koha, aspekti dhe veta të folja e të ngjashme. Ndërrimi i këtillë tematik i fonemave (në gjuhën maqedonase është i njohur si reduktim i tingujve) në gjuhën shqipe është ndërrimi i bashkëtingëlloreve jociellzore me ndonjë tjetër qiellzore, e cila është e njohur si palatalizim.

Në gjuhën shqipe më së shpeshti palatalizohen bashkëtingëlloret /k/ ~ /q/, /g/ ~ /gj/, /ll, l, r/ në /j/, ndërsa vërehet edhe ndërrimi i zanoreve /e, ë/ në /i/, /a/ në /e/, si dhe ndryshimi i /a/ dhe /e/ respektivisht /je/ në /o/ të cilat janë të njohura me termin apofoni (gjermanisht: umlaut). Krahaso format e njëjësit me të shumësit:

a) /k/ ~ /q/: *plak* ~ *pleq*, *ujk* ~ *ujq*, *armik* ~ *armiq*, *bllok* ~ *blloqe*, *rrezik* ~ *rreziqe*, *park* ~ *parqe* etj.

b) /g/ ~ /gj/: *zog* ~ *zogj*, *breg* ~ *brigje*, *burg* ~ *burgje*, *shteg* ~ *shtigje*, *lëng* ~ *lëngje*, *treg* ~ *tregje* etj.

c) /ll, l, r/ ~ /j/: *buall* ~ *buaj*, *kungull* ~ *kunguj*, *portokall* ~ *portokaj*, *shekull* ~ *shekuj*, *mashkull* ~ *meshkuj*, *yll* ~ *yje*, *pyll* ~ *pyje*, *muskul* ~ *muskuj*, *kalë* ~ *kuaj*, *lepur* ~ *lepuj*, *flamur* ~ *flamuj*, *bir* ~ *bij* etj.

ç) /e, ë/ ~ /i/: (ne) *jemi* ~ (ju) *jini*, *kemi* ~ *kini*, *flet* ~ *flisni*, *pres* ~

<sup>25</sup> Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 71-199.

*prisni, fle ~ flini, lë ~ lini, vë ~ vini, zë ~ zini* etj.

d) Me ndërrimin e /a/ - së në /e/ e bëjnë shumësin një numër i konsiderueshëm emrash, si: *dash ~ desh, plak ~ pleq, natë ~ net, ka ~ qe, djalë ~ djem, asht ~ eshtra* etj.

dh) Me shndërrimin e /a/-së ose /e/ (**je**) në /o/, e cila është e njohur si apofoni, një numër i konsiderueshëm foljesh e bëjnë të kryerën e thjeshtë (aoristin), si: (unë) *dal ~ dola, marr ~ mora, (unë) hedh ~ (unë) hodha, djeg ~ dogja, sjell ~ solla, pjek ~ poqa, heq ~ hoqa* etj. Të dy zanoret që marrin pjesë në ndërrimet e këtilla janë të theksuara.

Shqipja është një ndër gjuhët më morfonologjike të Evropës, ndërsa maqedonishtja si edhe gjuhët e tjera sllave janë më pak morfonologjike.

Në eptimin emëror dhe foljor (lakim dhe zgjedhim) në gjuhën shqipe janë vërejtur 58 ndryshime të fonemave, të cilat shërbejnë si mjete për t'i shprehur kategoritë morfolgjike të emrit, të mbiemrit dhe të foljes. Pra, në gjuhën shqipe ka mbi 3000 folje me ndërrime tematike të bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve. Numri më i madh i këmbimeve në rrënjën e fjalës shërbejnë si mjete plotësuese gramatikore, për arsye se të njëjtët paraqiten së bashku me mbaresat. Në lidhje me këtë, ndërrimet shërbejnë kryesisht si mjete për të formuar dhe për të identifikuar temat e fjalës: vallë është në njëjës apo në shumës, rasë e drejtë apo e zhdrejtë, formë e shquar apo e pashquar, gjinia mashkullore apo femërore.<sup>26</sup>

Edhe në gjuhën maqedonase gjatë formimit të formës së shumësit apo gjatë krijimit së formave të reja të fjalëve nga e njëjta rrënjë, ndodh shpeshherë të kemi ndërrime tematike të fonemave. Dukuri morfonologjike mjaft e shpeshtë është ndërrimi i bashkëtingëlloreve prapagjuhore /k, g/ dhe glotales /h/ në njërën nga paragjuhoret /c, ç, sh, z, v, s/. Për shembull:

a) /k/ ~ /c/: *јунак ~ јунаци, звук ~ звуци, волк ~ волци, ѓразник ~ ѓразници, внук ~ внуци, ученик ~ ученици, војник ~ војници, врсник ~ врсници, верник ~ верници, ѓаѓник ~ ѓаѓници* etj.

b) /h/ ~ /s/: *усѓх ~ усѓеси, ...*

c) /k/ ~ /ç/: *око ~ очи*; dallim i temës në vetën e parë nga veta e dytë dhe e tretë në aorist (unë) *реков ~ (ti, ai, ajo) рече*.

ç) /v/ ~ /s/: *Влав ~ Власи*.

d) /g/ ~ /z/: *миѓинѓ ~ миѓинзи, ѓолоѓ ~ ѓолози*.

dh) /t/ ~ /c/: *деѓѓе ~ деѓѓа*.

<sup>26</sup> Rami Mamushaj, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989, f. 202.

e) /v/ ~ /sh/: *yvo ~ yvuu* etj.

Alternimi i /t/ ~ /q/ dhe i /d/ ~ /gj/ te foljet identifikon formën e kryer të foljes nga forma përkatëse e pakryer (маq. свршена ~ несвршена форма): *файти ~ фака, врати ~ врака, илати ~ илака, ирати ~ ирака, сеити ~ секава, најде ~ наоџа, роци ~ раџа, љоџоци ~ љоџаџа* e të ngjashme.<sup>27</sup>

Opozicionin /k/ ~ /ç/, /g/ ~ /zh/ në gjuhën maqedonase realizohet edhe te foljet /k, g/ janë fonema që ndërtojnë aoristin dhe pjesoren e aoristit). P.sh.: (ai, ajo pjek– toj, taa) *џече ~ (unë poqa – jas) џеков, џекол* (јас сум пекол, ти си пекол – unë kam pjekur, ti ke pjekur); *сече ~ секов, секол; рече ~ реков, рекол; облече ~ облеков, облекол; сџруже ~ сџруџав, сџруџал; служи ~ слуџав, слуџал* e të tjera.<sup>28</sup>

Ndërmjet ndryshimeve morfologjike të fonemave bashkëtingëllore dhe zanore në shqipen dhe në maqedonishten ka një lidhje shumë të ngushtë. Pra, në eptimin emëror ndryshimi i /a/ ~ /e/ kryhet së bashku me /k/ në /q/ (plak ~ pleq), ndryshimi i /e/ ~ /i/ paralelisht me /g/ ~ /gj/ (shteg ~ shtigje, breg ~ brigje) etj. Këto ndryshime të përbashkëta historike dhe fonetike të bashkëtingëlloreve dhe zanoreve, të cilat kanë lënë gjurmë të konsiderueshme në mbarë shqipen janë rezultat i procesit asimilues prapavajtës në takim. Siç dihet, /i/-ja si e mbyllur dhe e përparme në fundin absolut të fjalës (edhe sot gjallon në disa të folme gege: njëjës ~ shumës: lepër ~ lepri, kunjëll ~ kungji) ka modifikuar edhe zanoret edhe bashkëtingëlloret me një artikulum më të përparmë dhe më të mbyllur që në rrjedhë të kohës të shndërrohen në bashkëtingëllore të mirëfillta qiellzore, respektivisht në zanore gjysmë të mbyllura apo të mbyllura. Edhe në maqedonishten është pranuar se shkaktar i ndërrimeve fonemore është përngjashmimi prapavajtës në kontakt i zanoreve të përparme, sidomos i zanores [i] (маq. и).

Të folurit drejtohet nga kundërshtia e përhershme ndërmjet nevojës për të këmbyer informata nga njëra anë, dhe përpjekjes së njeriut që ta zvogëlojë sa më tepër veprimin mendor dhe fizik nga ana tjetër. Pra, parimi themelor gjatë radhitjes së tingujve në fjalë dhe në fjali te të gjitha gjuhët e botës është ekonomizimi i gjuhës dhe lehtësimi i shqiptimit.<sup>29</sup>

<sup>27</sup> Блаже Конески, *Грамаџика на македонскиоџ љитџераџурен јазик* ( I, II), Shkup, 1976, f. 137.

<sup>28</sup> Блаже Конески, *Грамаџика на македонскиоџ љитџераџурен јазик* (I, II), Shkup, 1976, f. 136.

<sup>29</sup> Andre Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983, f. 229.

Kështu, për shkak të natyrës së tij, njeriu gjatë të folurit sa më me pak mund synon që të arrijë efekte maksimale. Për këtë arsye, gjatë ligjërimit të lidhur ne mundohemi sa më tepër që është e mundur t'u ikim atyre lëvizjeve artikuluese të cilat nuk janë të domosdoshme për të formuar fotografinë akustike të fjalës. Për shembull, nëse në të njëjtën fjalë kemi në takim dy bashkëtingëllore a zanore të njëjta apo të ngjashme, si: *në arrittë, e gjetë e mira, kënddrejtë, nënndarje, mossulmim, i paaftë, joobjektiv, i njëqindtë, i njëmendtë*; në gjuhën maqedonase: *оитиаму, одделение, бессоница, беззаконие, осуммина, најјасен, зайовегила, вооитиито, координација, собраа* dhe të ngjashme), atëherë zakonisht ata tinguj të njëjtë apo të ngjashëm nuk i shqiptojmë në tërësi ose i shqiptojmë së bashku si një tingull të vetëm më të gjatë.

Ndonjëherë për ta lehtësuar ligjërimit, ndërmjet një grupi bashkëtingëlloresh apo të zanoresh ndërpusim një tingull joetimologjik. Pra, është e njohur se shumë më lehtë i shqiptojmë fjalët kur në to kemi një zanore + një bashkëtingëllore ose anasjelltas; ndërsa grupet e bashkëtingëlloreve dhe të zanoreve janë më të vështira për nyjetim.

Grupet e tingujve të vështirë për nyjetim si maqedonasit, ashtu edhe ne shqiptarët kemi prirje t'i ndryshojmë në katër mënyra:

- a) me përngjashmim të plotë apo të pjesshëm;
- b) me mosshqiptimin e ndonjë tingulli, respektivisht me shkurtimin e fjalës;
- c) me ndërputjen e një bashkëtingëlloreje ndërmjet një grupi zanoresh ose një zanoreje ndërmjet dy bashkëtingëlloresh;
- ç) me konsonantizimin e zanoreve të mbyllura.

## 2. Përngjashmimi i tingujve

Me përngjashmim (asimilim) nënkuptojmë dukurinë fonetike të lehtësimit të shqiptimit kur nga dy tinguj të ndryshëm fitohet një apo dy tinguj të njëjtë. Asimilimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve si në shqipen, ashtu edhe në maqedonishten mund të jetë i plotë dhe jo i plotë, progresiv dhe regresiv, me kontakt të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Kjo dukuri është pak e pranishme në ligjërimit letrar, ndërsa shumë shpesh në ligjërimit bisedor dhe në të folmet popullore.

Në gjuhën standarde shqipe një numër i vogël i formave të asimiluara të fjalëve janë bërë normative, si: *ndëgjoj > ddëgjoj > dëgjoj*; *mbrenda > bbrenda > Brenda*; *mbasi > bbasi > pasi*; *mbas > bbas > pas*

etj. Shumë shpesh shqiptohen në formë të asimiluar, respektivisht bie [j]–ja te fjalët: [lagja] < *lagja*; [ndërgjegja] < *ndërgjegja*; [paisje] < *pajisje*; [paqa] < *paqja*; edhe pse shkruhen në formën e drejtë.<sup>30</sup>

**Njëjtësimi në zëshmëri.** – Dukuria më e shpeshtë e përngjashmimit të bashkëtingëlloreve sipas zëshmërisë, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën maqedonase, por edhe në gjuhët e tjera, është *njëjtësimi në zëshmëri*. Siç dihet, kur janë në takim një bashkëtingëllore e zëshme me një të shurdhët apo anasjelltas, atëherë të dyja shqiptohen ose si të zëshme ose si të shurdhëta. Nga pikëpamja fiziologjike, tendosja dhe dridhja e tejzave të zërit (te bashkëtingëlloret e zëshme) përkundër labërgimit dhe mosdridhjes së tyre (te bashkëtingëlloret e shurdhëta) për një kohë shumë të shkurtër (për disa të qindta të sekondës) nuk mund të realizohet.

Rregulli kryesor për përshtatjen e tingujve në takim sipas zëshmërisë në të dy gjuhët është se bashkëtingëllorja e zëshme dhe e pazëshme në kontakt të drejtpërdrejtë njëjtësohen në zëshmëri.<sup>31</sup>

Drejtskrimi i gjuhës shqipe nuk e parasheh këtë dukuri. Kështu:<sup>32</sup>

<b>Zëshmimi i bashkëtingëlloreve</b>		
	<i>shkruhet</i>	<i>shqiptohet</i>
[s] > [z]	s'di	z'di
	s'dua	z'dua
	s'dëgjoj	z'dëgjoj
	s'guxoj	z'guxoj
	s'gjej	z'gjej
	s'vjen	z'vjen
	asgjë	azgjë
	mesditë	mezditë
	mesdhetar	mezdhetar
[k] > [g]	ekzistencë	egzistencë
	ekzekutiv	egzekutiv
<b>Shurdhimi i bashkëtingëlloreve</b>		
	<i>shkruhet</i>	<i>shqiptohet</i>
[d] > [t]	i njëmendtë	i njëmenttë
	e argjendtë	e argjenttë
	i njëqindtë	i njëqinttë
[b] > [p]	absolut	apsolut
	absolvent	apsolvent
	abstenim	apstenim

<sup>30</sup> Normative janë format e fjalëve të shkruara me shkronja të pjerrëta.

<sup>31</sup> Блаже Конески, *Грамајтика на македонскиот литературен јазик* (I, II), Shkup, 1976, f. 125.

<sup>32</sup> Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup; 2005,



Drejtskrimi i gjuhës maqedonase përgjithësisht e normon njëjtësimin në zëshmëri, si: *близок – блиска* ‘i afërt – e afërt’, *жежок – жешка* ‘i nxehtë – e nxehtë’, *сладок – слајка* ‘i ëmbël – e ëmbël’, *леб – лейче* ‘bukë – bukë (zvogëluese)’, *свајт – свадба* ‘krushk – dasmë’, *срејте – средба* ‘takoj – takim’, *јосјин – јозба* ‘mysafir – gosti-a’ etj.<sup>33</sup>

Siç mund të shihet nga shembujt e dhënë, edhe në gjuhën shqipe edhe në atë maqedonase, njëjtësimi sipas zëshmërisë kryhet sipas bashkëtingëllores së dytë: nëse ajo është e pazëshme, atëherë edhe ajo para saj bëhet e pazëshme, e nëse ajo është e zëshme, atëherë edhe ajo para saj bëhet e zëshme, përkatësisht:

a) nëse një bashkëtingëllore e zëshme gjendet para një të pazëshmeje, atëherë e zëshmja do të zëvendësohet me korresponduesen e saj të pazëshme. Për shembull: *врабец – врајче* ([b > p]), *низок – ниска* ([z > s]); *јредјријатије – јрејјријатије* *ојкине – ојкине*, *ојскокне – ојскокне*, *ојјука – ојјука*, *ојјаму – ојјјаму*, *јрад – јрајче* ([d > t]) etj.

b) nëse një bashkëtingëllore e shurdhët gjendet para një të zëshmeje, atëherë ajo zëshmohet në çiftin përkatës të zëshëm: *свајт > свадба > свадба*, *ојкине – ојкине* ([t > d]); *јосјин > јосјба > јозба*, *сјрада > зјрада*, *сјирам > зјирам*, *сјружи > зружи* ([s > z]) etj.

Në maqedonishten te parashtesat që mbarojnë me **-d** (p.sh. *од, јред, јод, над, зад*) shurdhimi rregullisht regjistrohет edhe në të shkruarit, si: *јрејјсегатјел, јојсили, ојсјрани* etj. (pret+sedatel, pot+sili, ot+strani). Kur në përbërjen e fjalës në kufirin e parashtesës dhe të rrënjës takohen dy bashkëtingëllore të njëjta, pas njësimi të zëshmëri përfitohet një bashkëtingëllore e vetme: *исече* (из-сече), *исјине* (из-стине), *исекне* (из-секне), *расече* (раз-сече), *расије* (раз-сипе), *бесмјен* (без-смјен), *ојамна* (од-дамна) e të ngjashme.<sup>34</sup>

Në gjuhën maqedonase dhe në të folmet toske bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës rregullisht shqiptohen si të pazëshme (ndërsa sipas normave drejtskrimore shkruhen si të zëshme). Për shembull: *јрајт* (por, kur nuk ndodhet në fundin absolut të fjalës, atëherë shqiptohen si të zëshme: *градот*), *мрас* (por *мразот*), *брек* (por *брегот*); në dialektin

2011, 2020; f. 180.

<sup>33</sup> Блаже Конески, *Грамајтика на македонскиот*... f. 125.

<sup>34</sup> Блаже Конески, *Грамајтика на македонскиот литературен јазик* (I, II), Shkup, 1976, f. 126-127.



jugor të shqipes: *zok* (por zogu), *brek* (por bregu), *vënt* (por vëndi), *mënt* (por mëndja) etj.<sup>35</sup>

Në drejtshkrimin e të dy gjuhëve nuk shënohet shurdhimi i bashkëtingëlloreve në pozitë fundore absolute të fjalës. Shembuj fjalësh në ligjërimin e folur dhe në ligjërimin e shkruar për shqipen kemi dhënë në dy tabelat e mëparme. Po sjellim edhe disa shembuj nga maqedonishtja:

<i>shqiptohet</i>	<i>shkruhet</i>	<i>kuptimi</i>
леп	леб	bukë
граф	грав	fasule
роп	роб	rob
зит	зид	mur
дап	даб	lis, dushk
млат	млад	i ri
зап	заб	dhëmb

Në gjuhën shqipe përdorimi i një parashtese të vetme në tri variante fonetike me **sh-/zh-** ose **ç-** nistore, kushtëzohet nga zëshmëria e tingullit pasues. Dihet se normë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore është që bashkëtingëllorja e shurdhët [**sh**] të përdoret para bashkëtingëlloreve të shurdhëta: *shfaq, shfryj, shkoq, shkul, shthur*; [zh]-ja e zëshme përdoret para bashkëtingëlloreve të zëshme: *zhvendos, zhduk, zhdedh, zhgënjej*; ndërsa [ç]-ja përdoret para zanoreve dhe sonanteve (me disa përjashtime): *çarmatos, çnderoj, çliroj* etj.<sup>36</sup>

### 3. Rënia e tingujve

Gjatë të folurit ndodh që një tingull apo një grup tingujsh ngandonjëherë të mos i shqiptojmë. Rënia e këtillë ndodh për shkak të ekonomizimit të të folurit, respektivisht për arsye të zvogëlimit të lëvizjeve artikuluese. Zakonisht fjalët e gjata i shkurtojmë me anë të shkurtesave. Kështu, ato fitohen me shkurtimin e fjalëve të veçanta apo me përdorimin e fonemave nistore të një emërtimi të përbërë,<sup>37</sup> si: TV (televizioni), PTT (posta, telegrafi, telefoni), foto (fotografi), emrat e gjata të shteteve (ShBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës), institucionet (AShAK – Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës), emrat e partive politike e të ngjashme.

<sup>35</sup> Jorgji Gjinari – Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997.

<sup>36</sup> Atanas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 117-118.

<sup>37</sup> *Правойис на македонскиој лийтературен јазик*, Shkup, 1988, f. 62.

Edhe emrat vetjakë si te shqiptarët, po ashtu edhe te maqedonasit, përveç formës së tyre të plotë, përdoren edhe në forma të shkurta. Format e shkurta të emrave personalë përdoren për arsye shoqërore (me qëllim që të shprehet afërsi, dashuri, përkëdheli, dashamirësi), po edhe për arsye gjuhësore (që t'u largohemi emrave të gjatë që janë të vështirë për shqiptim). Për shembull: Dan < Ramadan, Buqe < Burbuqe, Bejt < Bejtullah, Fat < Fatime, Lut < Lutfi, Gona < Antigona, Xen < Shkëlzen, Kim < Shkëlqim, Hristo < Hristijan, Mile < Millutin, Kate < Katerina, Nina < Aleksandrina, Dime < Dimitar, Kosta < Kostantin etj.

Normë drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore në gjuhën shqipe është rënia e [ë]-së së patheksuar tek emrat dhe te mbiemrat që mbarojnë me **-ël, -ër, -ërr, -izëm, -azëm** gjatë lakimit, kur pas tyre shtohet ndonjë zanore. Për shembull: emrat në emërore në formën e pashquar: pupël – forma e shquar *pupla* (i, e, një) *puple, puplës, puplën, puplat, puplave, puplash*; vegël – *vegla*; ajër – *ajri*, dimër – *dimri*, drapër – *drapri*, dhëlpër – *dhëlptra*, ëndërr – *ëndërria*, vjehërr – *vjehërria*, ateizëm – *ateizmi*, socializëm – *socializmi*, sarkazëm – *sarkazmi*, mbiemra: i ëmbël – *i ëmbli*, i vogël – *i vogli* etj.

Gjithashtu, [ë]-ja bie edhe te mbiemrat që mbarojnë përfundojnë me prapashtesën **-ëm, -shëm**, si: i jashtëm – *i jashtëmi*, i sotëm – *e sotme*, i vetëm – *i vetmi*, i ardhshëm – *e ardhshme, i ardhshmi*, i besueshëm – *e besueshme, i besueshmi*, i shijshëm – *e shijshme, i shijshmi* etj.<sup>38</sup>

Kjo zanore bie edhe në fjalët e përbëra kur fjala e parë mbaron në [ë], ndërsa fjala e dytë fillon me zanore. Për shembull: *bashkatdhetar* (bashkë+atdhetar), *gjithashtu* (gjithë+ashtu), *i gjithanshëm* (i gjithë+anshëm), *bashkautor* (bashkë+autor) etj.

Elizion të [ë]-së së patheksuar kemi edhe te pjesëza **të**, te nyjat e përparme **të, së**; si dhe te trajtat e shkurta **më, të**. Në vend të zanores që bie shkruhet apostrofi: *Duhet t'i ndihmosh shokut* (Duhet të i ndihmosh), *t'i dha* (të i dha), *m'i dha* (më i dha) etj.

Në gjuhën standarde shqipe zanorja e patheksuar [ë], karakterizohet si zanore e paqëndrueshme, e lëvizshme, që shpeshherë nuk shqiptohet e ndonjëherë as nuk shkruhet, por edhe në gjuhën maqedonase rënia e zanoreve është një dukuri e shpeshtë. Është konstatuar se në gjuhën letrare maqedonase si zanore të paqëndrueshme paraqiten [e, o, a]. Kështu, në disa mbaresa dhe prapashtesa ato humben. Kështu, tek emrat që në njëjës mbarojnë në **-ец, -ел, -ен, -еп** etj. (me

<sup>38</sup> *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974, f. 49-50.

disa përjashtime) në formën e shumësit bjerret zanorja [e]: старец – *сѳарци*, скакулец – *скакулци*; петел – *ѳейѳли*, чевел – *чевли*, чешел – *чешли*; ражен – *ражни*, скорен – *скорни*, министер – *минисѳри*, магистер – *маѳисѳри* etj.

Zanorja [o] bie te mbiemrat që mbarojnë në gjininë mashkullore në mbaresat **-ок** dhe **-ол** (me disa përjashtime), si: близок – *блиска* – *блиско* – *блиски*, низок – *ниска* – *ниски*, сладок – *слаѳѳка* etj.

Zanorja [a] bjerret në njëjësin dhe shumësin e gjinisë femërore dhe asnjane te mbiemra që mbarojnë në gjininë mashkullore me prapashtesën **-ар** (ar): добар – *добра* – *добро* – *добри*, храбар – *храбра* – *храбро* – *храбри* etj. Në fjalët e huaja që kanë prapashtesën **-изам** (izam), [a]-ja humbet në formën e shquar: комунизам – *комунизмоѳи*, социјализам – *социјализмоѳи*, идеализам – *идеализмоѳи* si dhe në fjalë të tjera. Fjalët me prejardhje të huaj, si: *metar*, *kilometar*, *teatar* (metar, kilometar, teatar) e të ngjashme, përveç në formën e shquar, në të gjitha format e tjera e humbin [a]-në: *metri*, *kilometri*, *teatri* (metri, kilometri, teatri).<sup>39</sup>

Disa grupe bashkëtingëlloresh kanë qenë dhe janë të mundimshme për nyjetim, ndaj edhe i janë nënshtruar procesit të përngjashmimit. Ato janë shpërbërë e thjeshtuar në mënyra të ndryshme, duke iu përshtatur modelit të pranueshëm të kombinimit të tingujve në rrokje.<sup>40</sup> Për shqiptim më të lehtë dhe bukurtingëllim, në maqedonishten grupet e bashkëtingëlloreve **здј**, **стј**, **стл**, **стн** (zdj, stj, stl, stn) nuk shqiptohet dhe rrjedhimisht nuk shkruhet bashkëtingëllorja e ndërmjetme. Prandaj kemi: *ѳрозје* (khs. грозд+је), *лисје* (khs. лист+је), *жалосна* (khs. жалост+на), *радосна* (khs. радост+на), *миłosна* (khs. милост+на), *свесна* (khs. svest+на), *ѳосна* (khs. post+на) etj.<sup>41</sup>

Edhe sot, si në gjuhën maqedonase, po ashtu edhe në gjuhën shqipe vërehet prirja e shkurtimit të fjalëve, sidomos në ligjërimin joletrar. Shikuar nga pikëpamja dialektore, në dialektin e Veriut kjo dukuri është shumë më e shpeshtë sesa në dialektin Jugor të shqipes. Në të folmet e maqedonishtes perëndimore kjo prirje realizohet me mosqiptimin e disa bashkëtingëlloreve, respektivisht [j, x, v] (j, h, v) në pozitë ndërzanore, që ka për rrjedhojë takimin e dy zanoreve, si për shembull: глава > *ѳлаа* > *ѳла.*; снаха > *снаа* > *сна.*; таја > *ѳаа* > *ѳа.*; змији > *змии* > *зми.*;

<sup>39</sup> Блаже Конески, *Грамаѳѳика на македонскиоѳи ѳитературен јазик* (I, II), Shkup, 1976, f. 89- 94.

<sup>40</sup> Блаже Конески, *Исѳорија на македонскиоѳи јазик*, Shkup, 1986, f. 22.

<sup>41</sup> Блаже Конески, *Грамаѳѳика...* f. 133.

товар > *шоар* > *шо<sup>a</sup>р*, лебови > *лебои* > *лебој*, волови > *волои* > *волој* etj.<sup>42</sup> Mosshqiptimi i [h]-së në të folmet toske dhe përgjithësisht në maqedonishte është dukuri e përbashkët mjaft e përhapur, si: toskërisht: *ënë* < hënë, *duan* < duhan, *i letë* < i lehtë, *kra* < krah; maqedonisht: *рана* < храна, *артија* < хартија, *возду* < воздух etj.

Në gjuhën shqipe kur kemi dy rrokje të njëjta në një fjalë të vetme, shpeshherë rrokja e patheksuar bie. Haplologjia shpeshherë vërehet në ligjërimin e shkujdesur, kur në vend të formës së drejtë të trajtës së pashquar njëjës, tek emrat femërorë që mbarojnë me *-e* të patheksuar (të tipit lule, anije, fitore, mësuese, ...) në rasat e zhdrejta: gjinore, dhanore dhe rrjedhore, me përsëritje të rrokjeve **-jeje**, përdoren gabimisht format e rasave të drejta (emërore e kallëzore) vetëm me rrokjen **-je**, si p.sh.: duhet (*i*) *një nxënëseje* – dhe jo (*i*) *një nxënësje*, duhet (*i*) *një artisteje* – dhe jo (*i*) *një artistje*, duhet (*i*) *një çështjeje* – dhe jo (*i*) *një çështje*...<sup>43</sup>

#### 4. Shtimi i tingujve

Si rrjedhim i ndërveprimit në nyjëtimin e tingujve fqinjë, sidomos në ligjërimet dialektore e gjysmëdialektore, në fillim, në mes ose në fund të fjalës mund të lindin tinguj joetimologjikë, më shpesh si elemente që lehtësojnë kalimin nga një nyjëtim në tjetrin.

Dukuri e përbashkët fonetike e shqipes, maqedonishtes po edhe e gjuhëve të tjera është shtimi i tingujve për lehtëshqiptim. Siç dihet, në gjuhën shqipe, si edhe në gjuhë të tjera vështirësia që krijohet në shqiptimin e dy zanoreve të njëpasnjëshme më së shpeshti shmanget me ndërhyrjen e një tingulli bashkëtingëllor, rëndom [j, h, v] (të tipit: *kala* – *kala-j-a*; *ide* – *ideja*, *mësoj* – *mëso-h-em*, *male* – *male-v- e...*; ndërsa ndërmjet dy e më tepër bashkëtingëllorëve ndërfitet një zanore, zakonisht [i, ë] (*dit* – *dit-ë-t*, *bujq* – *bujq-i-t*, *nxënës* – *nxënës-i-t*,...).

#### 5. Konsonantizimi i zanores [i], respektivisht [u] në [j]

Një dukuri tjetër fonetike e cila është e përbashkët për shqipen

<sup>42</sup> Блаже Конески, *Историја на македонскиот јазик*, Shkup, 1986, f. 27.

<sup>43</sup> Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011; f. 185-186.

dhe maqedonishten dialektore e standarde është konsonantizimi i zanores së patheksuar [i] në [j], veçmas në pozitë fundore të fjalës. Kjo dukuri shpjegohet me ngjashmëritë nyjetimore ndërmjet [i]-së dhe [j]-së. Në të dyja gjuhët dukuria e konsonantizimit haset më së shpeshti kur në fund të fjalës kemi zanore të theksuar + [i] ose [и] të patheksuar, të tipit, në shqip: *babai* > *babaj*, *vëllai* > *vëllaj*, *punoj* > *punoj*, *ai* > *aj* ... në maqedonisht: *крои* > *крој*, *брои* > *број*, *твои* > *твој*, *кои* > *кој*, *некои* > *некој* ku në rrokjen fundore formohet një sekuençë diftongore.<sup>44</sup>

## 6. Përmyllje

Në fushën e fonetikës e të fonologjisë ndërmjet shqipes e maqedonishtes kemi një varg paralelizmash, siç janë:

- theksi dinamik (në gjuhën maqedonase është i përcaktuar – në rrokjen e tretë, ndërsa në gjuhën shqipe është i papërcaktuar – zakonisht në njërin nga dy rrokjet e fundit dhe i palëvizshëm në paradigmën e eptimit);

- defonologjizimi i gjatësisë së zanoreve në të dy gjuhët standarde;

- të dyja gjuhët kanë vetëm zanore gojore në shqiptimin letrar;

- i përkasin tipit të gjuhëve me shqiptim të tendosur (respektivisht nuk kanë diftongje fonematike);

- përkatësia e gjuhës shqipe dhe maqedonase në tipin e gjuhëve joakomoduese (pa modifikim të rëndësishëm kombinator dhe pozicional të fonemave);

- shqiptimi i një gjysmëvokali të reduktuar ëë];

- të dy gjuhët kanë shkrim fonetik (maqedonishtja shkruhet me alfabetin cirilik, ndërsa shqipja me alfabetin latin të përshtatur);

- drejtshkrimi fonetik është parimi themelor për shkrimin e të dy gjuhëve etj.

Në këtë punim shqyrtoam disa dukuri të përbashkëta ndërmjet këtyre gjuhëve në fushën e fonetikës e të fonologjisë, si *ndërrime morfonologjike të fonemave, përngjashmimi i tingujve, njëjtësimi në zëshmëri, rënia dhe shtimi i tingujve si dhe konsonantizimi i zanores [i] të patheksuar në [j]*.

<sup>44</sup> Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup; 2005, 2011, 2020; f. 94-95.

**Literatura:**

- Demiraj, Shaban, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.
- Demiraj, Shaban, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.
- Demiraj, Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.
- Dodi, Atanas, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
- Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1974.
- Gjinari, Jorgji – Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997.
- Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup; 2005, 2011, 2020.
- Хамити, Аслан, *Фонетика и фонологија на албанскиот јазик*, Shkup, 2011.
- Mamushaj, Rami, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989.
- Martine, Andre, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Prishtinë, 1983.
- Nasteva, Jashar – Olivera, *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998.
- Конески, Блаже, *Грамаџика на македонскиот литературен јазик* (I, II), Shkup, 1976.
- Конески, Блаже, *Историја на македонскиот јазик*, Shkup, 1986.
- Правоиџ на македонскиот литературен јазик*, Shkup, 1988.

## 2. GJUHA E VEPRAVE LETRARE

### 2.1. FUNKSIONI I LETËRSISË PËR RUAJTJEN DHE ZHVILLIMIN E KULTURËS GJUHËSORE TË KOMBIT<sup>45</sup>

Gjuha është një oqean i pafund me pasuri e mundësi të pashterrshme, mirëpo aftësia dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj pasurie te njerëzit është e shumëllojshme.

Gjuha është materiali që përdor artisti letrar, ashtu siç janë ngjyrat për piktorin, glina, mermeri etj. për skulptorin, materiali ndërtimor për arkitektin etj. Në çdo vepër letrare shkrimtari bën zgjedhje të ligjërimin nga pafundshmëria e gjuhës. Mund të thuhet se ***gjuha e letërsisë është një shndërrim specifik i gjuhës së përditshme në gjuhën e artit letrar.*** Gjuha e letërsisë artistike mbështetet në aftësinë që të shprehet në mënyrë të figurshme – tërthorazi, në aftësinë e të shprehurit me emocion, në aftësinë e gjuhës për shprehje imagjinative, të bukur; në aftësinë për të sajuar rimën, harmoni e tingëllim të këndshëm, muzikor etj.

Se si do të shërbehet shkrimtari me këto mundësi të pashtershme të gjuhës, në radhë të parë varet nga shkalla e njohjes dhe e zotërimit të asaj gjuhe. Po ashtu, stilin e një ligjërimi letrar të cilitdo shkrimtar e përcakton edhe formimi arsimor e letrar i tij, bindjet, temperamenti, karakteri, përvoja dhe pikëpamjet e tij për botën dhe jetën. Prandaj për dikë thuhet se është më i qartë dhe më i lehtë në të rrëfyer, e për dikë themi se është më i rëndë, më konfuz; për dikë se është me temperament të butë, me emocione të qeta në të shprehur, e për dikë tjetër themi se është më i rrëmbyer, më dinamik, më eksploziv etj.

Fjalët e gjuhës së përgjithshme në komunikimin joletrar zakonisht përdoren me kuptimin e vet themelor a kryesor, por në artin letrar ato zgjerohen me kuptime të tjera leksikore, marrin domethënie të re që e nxisin dhe e emocionojnë lexuesin. Zotërimi i fjalës, i fshehtësisë dhe i mundësisë së çdo fjale për të shprehur kuptime të ndryshme figurative, përveç kuptimit të tyre të përmë, është parakusht i domosdoshëm për

<sup>45</sup> Kumtesë imja e botuar në AKTET, Revistë Shkencore e Institutit Alb-Shkenca, vëll. VI, 4, Shkup, 2013, f. 380-384 ([www.alb.shkenca.org](http://www.alb.shkenca.org); ISSN 2073-2244).

shkrimtarin. Fjala duhet ta emocionojë lexuesin, duke i sjellë përfytyrime të ndryshme. Shkrimtari duhet të jetë mjeshtër i fjalës dhe ta shfrytëzojë atë si gurrë e pashtershme për shumëkuptimësi. Pra, varësisht nga konteksti ku shkrimtari do ta vendosë fjalën, ajo duhet të ofrojë kuptime të ndryshme, porosi të ndryshme, vlera të ndryshme.

Gjuha në letërsinë artistike jo vetëm mishëron një përmbajtje, jo vetëm kumton një informacion letrar, por edhe synon të ketë ndikim estetik, të ngjallë ndjenjën e së bukurës. Prej këtej rrjedhin një varg karakteristikash, që e dallojnë ligjërimin artistik deri në atë shkallë, sa është pohuar që këtu kemi të bëjmë me një gjuhë tjetër. Para së gjithash, kjo do të thotë se shkrimtari, së bashku me idealin e vet artistik, ka edhe idealin gjuhësor.

Letërsia është arti i fjalës në kuptimin e një pune mjeshtërore me visarin gjuhësor. Artisti i fjalës krijon e derdh objekte estetike gjuhësore. Letërsia na jep modelet e gjuhës më të lëvruar, modelet më të bukura të ligjërimin, ajo përbën *shfaqjen estetike të shqipes*. Zbulimi i fuqive shprehëse të shqipes përbën një nga ndihmesat e shkrimtarëve tanë për kulturën shqiptare. Veprat letrare nuk shkruhen që të ndikojnë drejtpërdrejt mbi të folurit e njerëzve. Ato shkruhen për t'u përkapur (perceptuar) si një tërësi të një bote letrare dhe jo si modele për t'i ndjekur në jetën e përditshme. Ndikimi është i tërthortë. Duke qenë krijime artistike me lëndë gjuhësore, ato i japin lexuesit një pasuri të brendshme, i ngulitin modele eprore, që i shërbejnë si kuota krahasimi për nivelin e vet. Në këtë kuptim, letërsia është edhe një *shkollë e gjuhës*, një nga mjetet kryesore për edukimin me kulturë të lartë të shprehjes dhe të shijes estetike, sidomos për t'i dhënë brezit të ri qysh herët format më të çmueshme të përvojës gjuhësore që ka grumbulluar tradita shqiptare.

Edhe në artin letrar, fjalitë që radhiten njëra pas tjetrës kanë kuptimet e zakonshme të shqipes (për ta perceptuar lexuesi përmbajtjen letrare), por ato kanë edhe *domethënien letrare artistike*. Teksti letrar ka të paktën dy rrafshë kuptimore, ndërsa disa herë edhe më shumë. Këtu fshihet *mundësia e disa interpretimeve të një veprë*, e disa mënyrave të ndryshme të të kuptuarit të saj nga njerëz të ndryshëm (sipas përvojës e kulturës së tyre) dhe nga epoka të ndryshme.

Ligjërimi i letrarëve është ***të folur i emocionuar me përpunim artistik***. Autori kurdoherë përpiqet që nëpërmjet organizimit stilistik të japë një përshtypje, një atmosferë, një ndjenjë dhe të arrijë një efekt.

Nuk është kurrfarë rastisje që ne, gjatë leximit të një veprë



letrare, duke ndjekur fatin e një personazhi, dëshpërohem, pikëllohem, revoltohem deri në atë masë sa jemi në gjendje të ndërmarrim veprime konkrete, pa e kursyer fare veten. Shembuj të këtillë që e emocionojnë lexuesin ka në secilën letërsi kombëtare. Bie fjala, letërsia jonë e Rilindjes Kombëtare, dukshëm dhe me sukses është inkuadruar në rrjedhat demokratike për mobilizimin e masave të gjera popullore drejt çlirimit dhe pavarësisë kombëtare. Kjo forcë mobilizuese shpesh ka qenë shumë më efikase sesa shkrimet, thirrjet dhe apelet e drejtpërdrejta politike dhe luftarake drejtuar popullit.

Në letërsi gjen shfaqje më të qartë e më të qenësishme natyra kombëtare e gjuhës. Krahas funksioneve të tjera, *letërsia ka edhe funksionin e ruajtjes e të zhvillimit të kulturës gjuhësore të kombit*. Shkrimtari rritet e ushqehet me gjeninë e gjuhës amtare dhe është vegël e saj për ta mbajtur atë me gjallëri të pashuar, për ta përtërirë e për ta çuar më tej.

Kultura gjuhësore e letërsisë artistike ndikon në evoluimin e gjuhës në tërësi. Ngulitja e normës, standardizimi do të thotë në një kuptim ngadalësim i zhvillimit të vetvetishëm gjuhësor. Letërsia dhe gjuha e gjallë e folur e kompensojnë këtë shmangie nga ecuria spontane. Letërsia luan rol të veçantë për *marrëdhëniet e gjuhës së normuar me format e tjera, sidomos jostandarde*, të trajtës së shkruar me trajtën e folur. Nëpërmjet letërsisë artistike jo vetëm zgjerohen mundësitë shprehëse të shqipes, por edhe përtërihen ato, shtjellohen më tej ose edhe krijohet diçka e re. Një vepër letrare është edhe një qëndrim ndaj gjuhës për kohën e vet, të parë me syrin e artistit të fjalës. Letërsia shfrytëzon *të gjitha mundësitë e organizimit të gjuhës në stile*.

Siç dihet, gjuha standarde e normuar përcaktohet nga kodifikimi, d.m.th., duke përzgjedhur midis variacionit bëhet e njësuar; ndërsa teksti letrar është *heterogjen nga ana gjuhësore*. Në faqet letrare, të gjitha përdorimet gjuhësore kanë rrugë të hapur, deri edhe shtrembërimet individuale. Në letërsi shfrytëzohen të gjitha mundësitë shprehëse të shqipes, qoftë edhe ato që dalin jashtë normës letrare, si: ligjërimet historike, krahinore, vetjake, shoqërore, kulturore etj.

Gjuha e letërsisë artistike është shumë më e gjerë sesa gjuha standarde. Fjalët në letërsinë artistike mund të zhvishen nga kuptimi themelor dhe të risemantizohen përmes motivimit tekstos. Shkrimtari ka liri të madhe në përdorimin e gjuhës: ai ka nevojë për një elasticitet dhe zgjerim gjuhësor, për fond të madh fjalësh e zgjerime kuptimore të tyre,

për ndërtime të shumta gjuhësore, për një sintaksë shumë fleksibile, pra për një kod shumë më të hapët sesa korniza e gjuhës standarde.

***Arsyeja e kapërcimit të konvencioneve gjuhësore në letërsi është motivimi artistik.*** Shkelja e normave të shqipes standarde në letërsinë artistike pa motivim artistik sjell të meta stilistike, duke e bërë të papëlqyeshme gjuhën për lexuesin. Motivimi artistik u lejon shkrimtarëve ta kapërcejnë rrethin normativ. P.sh. një vepër mund të shkruhet edhe në gjuhën e pesë shekujve më parë, ose edhe në një dialekt me synime të veçanta, ashtu siç ka shkrimtarë që shkruajnë në dy gjuhë njëherësh (arbëreshët e Italisë, p.sh. botojnë poezi në dy gjuhë paralelisht shqip – italisht). Në rastin e fundit kemi të bëjmë me marrëdhëniet e letrarit me auditorin (lexuesit) dhe jo me gjuhën standarde shqipe.

Megjithëkëtë, krahas lirisë së madhe gjuhësore të shkrimtarëve, laramania në gjuhën e letërsisë artistike është e nevojshme që të ketë një forcë bashkuese, që të mos lejojë të lindë ndonjë efekt i padëshirueshëm shpërbërës gjuhësor e kombëtar.

***Vepra letrare është edhe krijim artistik edhe krijim gjuhësor,*** një eksplorim i mundësive të shqipes. Kjo prirje krijuese gjuhësore e shkrimtarëve nuk lidhet vetëm me krijimin e fjalëve të reja, sepse shumica e tyre janë neologjizma stilistike, por edhe me të gjitha fushat e tjera të gjuhës.

Shkrimtarët ndikojnë me përdorimin e veçantë të mjeteve, me lidhjet e ndërthurjet e fjalëve, me kuptimin e ngjyrimet e reja, me dendurinë e ndryshuar të përdorimit, me sintaksën e shndërruar, me organizime dytësore të elementeve të gjuhës që ngjallin efekte estetike, me vlerësimin e anës tingullore, të ritmit, të lidhjeve të papritura, të shprehshmërisë së figurshme e simbolizuese (ironike) dhe deri të lojës gjuhësore.

Natyrisht, krijimtaria letrare nisët nga funksioni themelor i mjeteve gjuhësore, por edhe punon për t'u dhënë atyre rol shprehës e artistik. Të gjitha këto arrihen jo me fjalë e forma të veçanta, por më tepër me mënyra tërthore, që mishërohen në organizimin dytësor. Rezultati që arrihet është një ndikim i fuqishëm mbi ndjeshmërinë e lexuesit, mbi përfytyrimin e shijen e tij, duke e bërë ta pranojë vetvetiu se diçka është thënë më bukur, sesa do ta thoshte ai vetë.

Veprat letrare nuk bëjnë çmos që të shkëputen nga përdorimi i ngulitur i gjuhës; por, përkundrazi, pasuria e gjuhës kombëtare mbetet një visar i pashtershëm për të arritur efekte shprehëse artistike, me këtë

edhe vetë letërsia shtresohet në vlerat kulturore të shqipes.

*Në letërsi riprodhohet vetë gjuha.* Letërsia jep procesin e komunikimit gjuhësor, tipat e ligjërimit, gjuhën e grupeve shoqërore, profesionale, të moshave të ndryshme, variantet krahinore e letrare.

Shkrimtarët mbajnë qëndrim vlerësues ndaj ligjërimit, i çmojnë ose i përçmojnë fjalët e tipat e shprehjes, përkrahin një shije a modë gjuhësore ose e satirizojnë atë. Nga kjo pikëpamje, shkrimtarët janë edhe “gjuhëtarët” më të mirë, regjistruar, pasurues e lëvruar, dobiprurës të shumanshëm.

Si përfundim, letërsia shqiptare luan një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kombëtar, në qytetërimin e tij krahas popujve të tjerë të Evropës, veçmas në ngritjen e përgjithshme të kulturës gjuhësore të kombit, në pasurimin dhe në përsosjen e shqipes në shkallë të njëjtë me gjuhët më të lëvruara të botës.

#### **Literatura:**

Hamiti, Asllan – Sopaj, Nehas (2004), *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar*, Prosvetno Dello ShA, Shkup.

Hamiti, Asllan (2018), *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-stil, Shkup.

Lloshi, Xhevat (1999), *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë.

## 2.2. GJATËSIA E ZANOREVE NË “GJELLËN E SHËN MËRIS S’VIRGJËR“ TË JUL VARIBOBËS<sup>46</sup>

Kur flasim me një ritëm (tempo) të caktuar, tingujt nuk i shqiptojmë me të njëjtën gjatësi, për shkak të faktorëve të ndryshëm. Gjatësia (kuantiteti) e tingujve, si kohë e nevojshme për nyjetim, në gjuhësinë tonë ka zgjuar interesim të madh. Në përshkrimet e të folmeve shqipe, ku më shumë e ku më pak, çështja e gjatësisë së tingujve ka qenë temë e pashmangshme. Edhe në disa shkrime të hershme shqipe, gjatësia e zanoreve është shënuar. Zanoret e gjata janë regjistruar me dyfishimin e shkronjës që përfaqëson zanoren ose me shënimin e një vize mbi zanoren përkatëse.

Në këtë kumtesë të shkurtër do të përiqem të trajtoj gjatësinë e zanoreve në “Gjellën e Shën Mërisë Virgjër” të Jul Varibobës në përqasje me gjuhën e sotme shqipe (standarde dhe dialektore).

Siç dihet, gjatësia e tingujve mund të jetë:

a) gjatësi fonetike (që varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë), dhe

b) gjatësi fonologjike (që nuk varet nga faktorët pozicionalë e kombinatorë, por ajo ka karakter të qëndrueshëm dhe shërben për dallimin e kuptimit të fjalëve ose të formave gramatikore).<sup>47</sup>

Gjatësia fonologjike e zanoreve është tipar i vokalizmit të gegërishtes.<sup>48</sup> Porse kjo vihet re edhe në disa krahina skajore të

---

<sup>46</sup> Kumtesë imja e prezantuar dhe e botuar në Aktet e Simpoziumit Ndërkombëtar për Arbëreshët, Tetovë, 28-29 prill 2008, Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë, 2011, f. 331-338.

<sup>47</sup> Gjatësia mund të varet edhe nga veçoritë e vetë tingullit, d.m.th. të jetë tipar i tij. Kështu, zanoret janë më të gjata se bashkëtingëlloret. Por edhe brenda secilës klasë kemi dallime. Zanoret e mbyllura janë më të shkurtra se të hapurat, bashkëtingëlloret mbylltore më të shkurtra se shtegoret etj. Në shumë gjuhë të botës kjo lloj gjatësie ka vlerë fonologjike, d.m.th. dy tinguj që dallohen vetëm nga gjatësia (njëri i shkurtër, tjetri i gjatë formojnë dy fonema të ndryshme). Me vlerë fonologjike e përdorin gjatësinë e zanoreve anglishtja, gjermanishtja, finlandishtja, arabishtja etj. Në estonishte dhe italishte gjatësia e bashkëtingëlloreve ka vlerë fonologjike. Shih: Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 90-91.

<sup>48</sup> Me metodën e fonetikës eksperimentale prof. Bahri Beci në të folmen e Shkodrës ka analizuar një numër të madh fjalësh njërrrokëshe e shumërrrokëshe në rrethime të ndryshme të zanoreve. Sipas kësaj monografie, zanoret e shkurtra shqiptohen në intervalin prej 20 deri më 8 të qindta të sekondës, ndërsa të gjatat midis 42–20 qs. Vlerësim i përgjithshëm është se raporti i gjatësisë fizike të zanoreve të gjata

toskërishtes, si në Labëri, në Bregdet dhe në çamërishten. E gjejmë dhe tek Arbëreshët e Italisë e të Greqisë së sotme. Kjo dëshmon se dallimi i zanoreve sipas kuantitetit, përkatësisht kundërvënia fonologjike zanore të shkurtra ~ zanore të gjata ka qenë i mbarë shqipes. Por, në një periudhë të hershme të zhvillimit kjo në dialektin e Jugut është mënjeluar e ka mbetur vetëm në Veri.

Mungesa e zanoreve të gjata në pjesën më të madhe të të folmeve toske, nga kjo pikëpamje, shihet si një inovacion, zhvillim i këtyre katërpesë shekujve të fundit, meqë arbëreshët e shpërngulur nga Toskëria e kanë pasur dhe e ruajnë ende gjatësinë e zanoreve, ashtu si të folmet periferike.

Gjatësia e tingujve të shqipes së sotme (dialektore dhe standarde) është përzjerje e sistemit të vjetër me gjatësi fonologjike të zanoreve me tipin e ri të gjatësisë së shkaktuar nga faktorë të jashtëm fonetikë (gjatësi fonetike). Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e gjatësisë. Kjo tregon se shqipja në çështjen e gjatësisë së zanoreve gjendet në një fazë kalimtare: toskërishtja dhe shqipja standarde kanë evoluar në tipin fonetik të gjatësisë, ndërsa gegërishtja (edhe pse me mbizotërim të gjatësisë fonetike) ende e ruan tipin fonologjik të gjatësisë. Edhe atje ku ruhet dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve në sajë të traditës, vlera fonologjike po zbehet. Në mjaft krahina të gegërisë gjatësitë e tilla janë rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

Toskërishtja dhe gjuha standarde shqipe ka gjatësi zanoresh të tipit fonetik. Zanoret e gjata janë nuanca kombinatorë dhe përgjithësisht mungon kundërvënia fonologjike të shkurtra ~ të gjata.

Sistemi fonetik i gjuhës letrare, edhe pse përbëhet vetëm nga një seri zanoresh gojore me gjatësi të kushtëzuar fonetike, i plotëson funksionet e veta të gjuhës. Funksionin kuptimdallues të zanoreve të gjata ajo e mbulon në të shumtën e rasteve me mjete të tjera fonetike e gramatikore. Kështu, mbajtja e zanores /ë/ të patheksuar në fund të fjalës zhduk homofoninë ndërmjet emrave të gjinisë femërore e atyre të gjinisë mashkullore (*plakë ~ plak*), shumësit nga forma e njëjësit (*shok*

përkundër zanoreve të shkurtra në të folmen e Shkodrës, si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes, është 2:1. Me fjalë të tjera, zanorja e shkurtër është njëmorëshe, ndërsa e gjata dymorëshe. Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995, f. 232. Po i njëjti autor konstaton se në shqipen standarde raporti ndërmjet zanoreve të theksuara e të patheksuara është 10/7 në artikullin *Sistemi fonologjik ...*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 93-109.

~ *shokë*) etj.<sup>49</sup>

Në bazë të kundërvënies fonologjike të gjatësisë së zanoreve (e shkurtër ~ e gjatë) te pak çifte minimale fjalësh edhe në shqipen standarde bëhet dallimi kuptimor i fjalëve, khs. *dhe* (lidhëz) ~ *dhe:* (emër), *bar* (lokal i vogël ku pihet në këmbë) ~ *ba:r* (bimë njëvjeçare), *para* (parafjalë) ~ *para:* (paraja, emër) etj.<sup>50</sup>

Në “Gjellën e Shën Mërisë Virgjër” (1762) Jul Variboba<sup>51</sup> zanoret e gjata, të cilat i gjejmë në fillim, në mes dhe në fund të vargut, i shënon me një vizë mbi shkronjën përkatëse. Nga shkrimet e Varibobës lidhur me gjatësinë e zanoreve mund të nxirren disa rregulla.<sup>52</sup> Gjatësia e zanoreve te ky autor varet nga:

- a) karakteri i rrokjes: e hapur ose e mbyllur,
- b) vendi i theksit (të theksuarat janë më të gjata se të patheksuarat),
- c) rrethimi tingullor (para sonoreve zanoret janë të gjata),
- ç) ruajtja apo rënia e [ë]-së së patheksuar fundore dhe
- d) numri i fonemave në një fjalë.

a) Zanoret në rrokje të hapur janë më të gjata sesa zanoret në rrokje të mbyllur.<sup>53</sup> P.sh.:

<sup>49</sup> Sigurisht, gjuha letrare ka edhe raste ku nuk mund të zhdukë homofoninë, p.sh. forma e foljes *ha* për të tri vetat e numrit njëjës të kohës së tashme (në geg. unë *ha:*, ti *ha*, ai *ha*), por fjalët e këtilla nuk e vështirësojnë komunikimin. Jorgji Gjinarri – Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, Tiranë, 1997, f. 201-210.

<sup>50</sup> Shih: Bahri Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike*, SF 1, Tiranë, 1985, f. 104.

<sup>51</sup> Jul Variboba, *Gjella e Shën Mërisë s'Virgjër* (1762), botim kritik dhe përkthim italisht me CD-ROM bashkëngjitur nga Vincenzo Belmonte, Rubbettino, 2005.

<sup>52</sup> Gjatësia mund të varet edhe nga veçoritë e vetë tingullit, d.m.th. të jetë tipar i saj. Kështu, zanoret janë më të gjata se bashkëtingëlloret. Por edhe brenda secilës klasë kemi dallime. Zanoret e mbyllura janë më të shkurtra se të hapurat, bashkëtingëlloret mbylltore më të shkurtra se shtegoret etj. Në shumë gjuhë të botës kjo lloj gjatësie ka vlerë fonologjike, d.m.th. dy tinguj që dallohen vetëm nga gjatësia (njëri i shkurtër, tjetri i gjatë formojnë dy fonema të ndryshme). Me vlerë fonologjike e përdorin gjatësinë e zanoreve anglishtja, gjermanishtja, finlandishtja, arabishtja etj. Në estonishte dhe italishte gjatësia e bashkëtingëlloreve ka vlerë fonologjike. Shih: Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002, f. 90-91. Në shqipen vlerë fonologjike ka vetëm gjatësia e bashkëtingëlloreve dridhëse /t/ ~ /rt/, si në çiftet minimale leksikore: ara ~ arra, ruaj ~ rruaj etj.

<sup>53</sup> Në fund të fjalës në rrokje të hapur /a/-ja e theksuar në shqipen standarde ka një gjatësi që nuk lidhet me natyrën e bashkëtingëlloreve që i paraprijnë. Ja disa shembj: ata (10 qs.), këta (9-10 qs.), disa (7-8 qs.), tha (9-10 qs.), dha (10 qs.), ha (9-11 qs.), vëlla (8-9 qs.), tra (11 qs.). Po sjellim edhe disa shembuj me /i/ fundore: ti (7 qs.), (unë)

- 9 Cili njeri s̄a e lart jē  
 10 s̄a ghraxje kē mund' numëronj'?  
 11 Vetëm Zotin t'e dī vandin,  
 12 jatër gjugh' s'dī t' e këndonj'.

- 4036 Dēti i pat timūr,  
 4037 u piks porsa e pā,  
 4038 suvala si një gūr  
 4039 për t' Arbëresht u thā.

b) Zanoret e theksuara janë më të gjata se gjegjëset e tyre të patheksuara.<sup>54</sup>

- 28 Sënd' Ana e mīr ndë pjeqērī.  
 29 Kūr ti u leve, e qiell e dhē

- 767 E kaciqen me ktē dhī  
 768 e suall kī buzëzī.

- 351 Ti, Shën Mērī, ule ata sī,  
 352 zure fill e thē rruzār'.

- 2171 U e dī se ke stolī,  
 2172 ma për sot lei ndë shtëpī.

- 245 Ea ti ja nxjër këtë kardaxhī,  
 246 Këtë mērī çë mua më mbā;  
 247 Ti kombatīre, se, kom' a dhire,  
 248 Mëngu tort ai shum' kā.

- 73 Se kā një zëmër u xhenerār  
 74 Kī ill i qār, kī vasalē.

c) Zanoret që gjenden para bashkëtingëlloreve të tingullta

---

vi (7 qs.), teneqexhi (10 qs.), pi (14 qs.), rri (15 qs.), shtëpi (11 qs.), liri (10 qs.), dhi (13 qs.), mulli (9 qs.) etj. Shih: B. Beci, *Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare* ..., f. 105.

<sup>54</sup> Raporti ndërmjet gjatësisë së zanoreve të theksuara me gjegjëset e tyre të patheksuara në shqipen standarde është 10/7 të qindta të sekondës.

(sonoreve: [r, rr, l, ll, j, m, n, nj]) janë më të gjata sesa ato që përdoren përpara bashkëtingëlloreve të tjera.

- 1015 U së jam zëmër e lë.  
 1016 Kūj ja kē gjith kto gharē?
- 1124 Sīt e tū etc.  
 1224 Sā e ëmbël më jē,  
 1225 sā pjetat mbë zëmër kē,
- 1234 Jē ti ëm', o, sā fanmīr!,  
 1235 se tēn' Zo'n e kē për bīr.
- 1368 Jemi ndë një dēēt] të zī,  
 1369 kējo jet' ë nj'ushtērī.
- 1536 Trīdhjet e trī vjet'  
 1537 si njerī me nē mbet.
- 1598 Si dhimoni jē i zī,  
 1599 jē një mostēr, një stihjī.
- 1602 Çë vëlen se kē belic,  
 1603 kē stolī e kē rrëkic'?  
 1604 Tīj të ghān krimbat të gjall',  
 1605 kūr ti bën mëka'n'mortāll.  
 1606 O, të dije, i thell', i zī,  
 1607 sā Zotīn të kā mbī sī!
- 1626 Kūr ti ghraxjen e kē,  
 1627 s'kē bëzonj mbī dhē.  
 1628 Çë bulār, çë rregjērī?  
 1629 Mblidhje s'kē për mosnjerī.  
 1630 Lē të kēn rrgjënd' e ār  
 1631 qindinār edhe milār.
- 1654 U t'e vura atē kurōr  
 1655 me kta gjēmba farmēkōr.



ç) Kur kemi rënien e ëë]-së fundore, zanorja paraprirëse shqiptohet e gjatë:

- 115     sā ai bīr të t'rrie mīr,  
 119     Vjen' edhe ōr' çë nget me dōr  
 225     Si kā të më jēt sot kī llatin:  
 269     A sā jān' e sa vanë  
 270     E sā të vinjën e të jën.  
 561     Paq e gas paçin e gharē  
 562     Njerëzit e mīr mbī dhē.  
 627     Mīr se erth kī regj i rī,  
 628     mīr se erth për gjithnjerī,  
 3003    Kush' na e thot me sā të qār,  
 3004    kūr pā linār, me shī, me bōr  
 3005    nat' më u nis e u gramis  
 3006    e Shën Mëria me djal' mbë dōr?

d) Sa më e shkurtër të jetë fjala, zanoret kanë kushte për shtrirje më të madhe dhe anasjelltas, sa më e gjatë të jetë fjala mundësia e shtrirjes së zanoreve zvogëlohet. P.sh.:

- 271     E kī bambin kā të t'rroj  
 272     E të sallvonj pjazmën e dhē'n.

Në katër vargjet në vijim për shkak të rimës kemi katër rrokje të mbyllura në përbërjen e të cilave kemi zanore /u:/ të gjatë dhe sonoren /r/, përkatësisht në vargun e parë dhe të tretë rrokjen – mūr, ndërsa në vargun e dytë dhe të katërt rrokjen – gūr:

- 597     Oj Bambin, çë jē amūr,  
 598     ndë kjo zëmër ë një gūr,  
 663     Kā t' erth gjith kī amūr

664 për njeri'n zëmërgūr?

983 Dua të jap edhe sinjall,

984 se t'e njoghsh pā pār:

Ndarjen e mësipërme e kemi bërë për qëllime shpjegimi, por siç mund të shihet, këto rregullsi paraqiten njëherazi në të gjitha vargjet dhe janë zbatuar me përpikëri të rrallë. Këtu kemi të bëjmë me gjatësi jofonologjike ndërmjet zanoreve normale që zhvillohen plotësisht dhe zanoreve të shtypura, të penguara në zhvillimin e tyre me nisjen e bashkëtingëllores vijuese. Ndaj, në arbërishten e Varibobës (si dhe në shqipen standarde) gjatësia dhe shkurtësia e zanores është tipar i bashkëlidhjes së fonemave në vargun e ligjërimit.

Edhe pas afro 260 vjetësh (1762), po të krahasohet gjatësia e zanoreve të teksteve të Varibobës me hulumtimet e fonetikës eksperimentale për shqipen e sotme letrare, mund të konstatohet se kriteret e dallimit të gjatësisë së zanoreve nga Variboba janë plotësisht të qëlluara.

13 Cili njeri sã e lart jē  
14 sã ghraxje kē mund' numëronj'?  
15 Vetëm Zotin t'e dī vandin,  
16 jatër gjugh' s'dī t' e këndonj'.

30 Sënd' Ana e mīr ndë pjeqëri.  
31 Kūr ti u leve, e qiell e dhē

75 Se kã një zëmër u xhenerār  
76 Kī ill i qār, kī vasalē.

120 Vjen' edhe òr' çë nget me dōr

226 Si kã të më jēt sot kī llatin:

249 Ea ti ja nxjër këtë kardaxhī,  
250 Këtë mērī çë mua më mbā;  
251 Ti kombatīre, se, kom' a dhire,  
252 Mēngu tort ai shum' kã.

- 273 E kī bambin kā të t'rronj  
 274 E të sallvonj pjazmën e dhē'n,  
 275 A sā jān' e sa vanë  
 276 E sā të vinjën e të jën.
- 353 Ti, Sën Mērī, ule ata sī,  
 354 zure fill e thē rruzār'.
- 563 Paq e gas paçin e gharē  
 564 Njerëzit e mīr mbī dhē.
- 599 Oj Bambin, çë jē amūr,  
 600 ndë kjo zëmër ë një gūr,
- 629 Mīr se erth kī regj i rī,  
 630 mīr se erth për gjithnjerī,
- 665 Kā t' erth gjith kī amūr  
 666 për njerī'n zëmërgūr?
- 769 E kaciqen me ktë dhī  
 770 e suall kī buzëzī.
- 985 Dua të jap edhe sinjāl,  
 986 se t'e njoghsh pā pār:
- 1017 U së jam zëmër e lē.  
 1018 Kūj ja kē gjith kto gharē?
- 1226 Sā e ëmbël më jē,  
 1227 sā pjetat mbë zëmër kē,
- 1236 Jē ti ëm', o, sā fanmīr!,  
 1237 se tēn' Zo'n e kē për bīr.
- 1370 Jemi ndë një dēët] të zī,  
 1371 këjo jet' ë nj'ushtëri.

- 1538 Trīdhjet e trī vjet'  
 1539 si njerī me nē mbet.
- 1600 Si dhimoni jē i zī,  
 1601 jē një mostër, një stihjī.
- 1608 Çë vëlen se kē belic,  
 1609 kē stolī e kē rrëkic'?'  
 1610 Tij të ghān krimbat të gjall',  
 1611 kūr ti bën mëka'n'mortāll.  
 1612 O, të dije, i thell', i zī,  
 1613 sā Zotīn të kā mbī sī!
- 1632 Kūr ti ghraxjen e kē,  
 1633 s'kē bëzonj mbī dhē.  
 1634 Çë bulār, çë rregjērī?  
 1635 Mblidhje s'kē për mosnjerī.  
 1636 Lē të kēn rrgjënd' e ār  
 1637 qindinār edhe milār.  
 1656 U t'e vura atē kurōr  
 1657 me kta gjëmba farmëkōr.
- 2173 U e dī se ke stolī,  
 2174 ma për sot lei ndē shtëpī.

Në të gjitha vargjet e “Shën Mërisë Virgjër”, shkrimtari ynë arbëresh Jul Variboba me përpikëri bën dallimin ndërmjet zanoreve të shkurtra e të mesme, duke mos u shënuar asnjë shenjë diakritike, dhe zanoreve të gjata, duke shënuar një vizë mbi shkronjën përkatëse. Me këtë dëshmohet se klasiku ynë i letërsisë arbëreshe ka pasur edhe një përgatitje të lartë gjuhësore, në veçanti si njohës i shkëlqyer i variacioneve të gjatësisë së zanoreve.

Me variacionet e zanoreve të shkurtra e të gjata, të rrokjeve të theksuara e të patheksuara, të rënies dhe të shtimit të tingujve (sepse ashtu tingëllojnë më bukur) si dhe me orkestrimin e të gjitha mjeteve të tjera fonetiko-fonologjike vargjet e Varibobës fitojnë harmoni ritmike, bukurtingëllim dhe muzikalitet. Ai me mjeshtëri të rrallë ka arritur t'i

gërshetojë efektet e natyrës bukurtingëlluese me përmbajtjen, porosinë kuptimore të fjalës e të vargut dhe me këtë ka arritur efekte të fuqishme emocionale, kuptimore e imagjinative. Me fjalë të tjera, mjetet shprehëse fonetiko-fonologjike të arbërishtes në vargjet e Varibobës janë në funksion të vlerave artistike.

### **Përfundim**

Me një saktësi të jashtëzakonshme Variboba i dallon dhe i shkruan zanoret e shkurtra dhe zanoret e gjata. Njësia prozodike e kohëzgjatjes së nyjetimit të zanoreve në shkrimet e Varibobës modifikohet nga konteksti. Gjatësia e zanoreve të ky autor varet nga:

- a) karakteri i rrokjes: e hapur ose e mbyllur,
- b) rrethimi tingullor (para sonoreve zanoret janë të gjata),
- c) vendi i theksit (të theksuarat janë më të gjata se të patheksuarat),
- ç) ruajtja apo rënia e [ë]-së së patheksuar fundore.

Me variacionet e zanoreve të shkurtra e të gjata, të rrokjeve të theksuara e të patheksuara, të rënies dhe të shtimit të tingujve (sepse ashtu tingëllojnë më bukur) si dhe me orkestrimin e të gjitha mjeteve të tjera fonetiko-fonologjike vargjet e Varibobës fitojnë harmoni ritmike, bukurtingëllim dhe muzikalitet. Ai me mjeshtëri ka arritur t'i gërshetojë natyrën bukurtingëlluese me përmbajtjen, porosinë kuptimore të fjalës e të vargut dhe me këtë ka arritur efekte të fuqishme emocionale, kuptimore e imagjinative. Me fjalë të tjera, mjetet shprehëse fonetiko-fonologjike të arbërishtes në vargjet e Varibobës janë në funksion të vlerave artistike.

Organizimet fonetiko-fonologjike çojnë te një orkestrim tingullor i thënieve. Variacionet e gjatësisë së zanoreve në vargjet e Varibobës kanë vlerë ekspresive-impresive.

### 2.3. VLERA EKSPRESIVE-IMPRESIVE E TINGUJVE NË POEZITË “ANËS LUMENJVE” DHE “RENT, OR MARATHONOMAK” TË FAN NOLIT<sup>55</sup>

Gjuha është një oqean i pafund me pasuri e mundësi të pashterrshme, mirëpo aftësia dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj pasurie të njerëzimit është e shumëllojshme. Vepra letrare është edhe krijim artistik edhe krijim gjuhësor, një eksplorim i mundësive të shqipës. Kjo prirje krijuese gjuhësore e shkrimtarëve nuk lidhet vetëm me krijimin e fjalëve të reja, sepse shumica e tyre janë neologjizma stilistikë, por edhe me të gjitha fushat e tjera të gjuhës.

Shkrimtarët ndikojnë me përdorimin e veçantë të mjeteve, me lidhjet e ndërthurjet e fjalëve, me kuptimin e ngjyrimet e reja, me dendurinë e ndryshuar të përdorimit, me sintaksën e shndërruar, me organizime dytësore të elementeve të gjuhës që ngjallin efekte estetike, me vlerësimin e anës tingullore, të ritmit, të lidhjeve të papritura, të shprehshmërisë së figurshme e simbolizuese (ironike) dhe deri të lojës gjuhësore.

Siç duhet, thëniet kanë vlerë kuptimore dhe vlerë stilistike. Me fjalë të tjera, thëniet (fjalët, fjalitë) kanë tri vlera:

- a) vlerën logjike apo objektive;
- b) vlerën shprehëse (ekspresive), dhe
- c) vlerën impresive a synimin e vetëdijshëm të emetuesit që të ndikojë të marrësi; qoftë në mënyrë estetike, qoftë humoristike, qoftë satirike, apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Tingujt e veçuar nuk kanë kuptim, por kur përbërja tingullore përkon me kuptimin e fjalës, atëherë tingujt fitojnë vlera shprehësie (vlera estetike).

Është përdëftuar se tingujt në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në sistemin tonë nervor si dhe në shqisat tona, madje marrin vlera emotive dhe estetike. Të përshtatshëm për nyjëtim dhe të këndshëm për dëgjim (bukurtingëllues) janë padyshim ata tinguj që formohen në mënyrë të thjeshtë dhe të lehtë (zanoret dhe sonoret), ndërsa më pak të këndshëm janë tingujt që nyjëtohen rëndë (bashkëtingëlloret e zhurmëta).<sup>56</sup>

---

<sup>55</sup> Artikull i botuar në përmbledhjen e punimeve të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Fan S. Noli në 130-vjetorin e lindjes (1882-2002)”, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, 2012, f. 261-268.

<sup>56</sup> Antica Antoš, *Osnove lingvističke stilistike*, Školska knjiga, Zagreb, 1974, f. 34.

Vlera ekspresive-impresive e tingujve zbatim më të gjerë gjen në poezi. Kjo arrihet sidomos kur ka një lidhje ndërmjet tipareve nyjëtimore e akustike të tingujve me kuptimin e fjalës që e shprehin. Për poetët zanoret e përparme ngjallin përshtypjen e haresë, të lehtësisë, të qartësisë e të lirizmit; /o/-ja të gjerësisë, të hapësirës e të lartësisë; /a/-ja të peshës, rëndësisë; /u/-ja të thellësisë, errësirës e deri të frikës. Në gjuhën shqipe dridhëset (sidomos shumëdridhësja /rr/-ja) më mirë i përshtaten fjalëve që emërtojnë gjëra të vrazhda: *horr, varr, derr, ferr* etj; lëngëzoret /l, ll, j/ për të shprehur dritë, lehtësi, fluturim, vazhdimësi; prapagjuhoret /k, g/ dhe laringalja /h/ i përgjigjen më shumë mundimit, përpëlajtjes, trokitjes, rënies së shiut (tak, trak, dëng), buzoret për shpërthimet dhe goditjet me jehonë të mbytur (bam, bum, bëlldum, buf) etj.

Edhe në përdorimin e gjithëmbarshtëm të ligjërimit shfrytëzohen vlerat ekspresive dhe impresive të tingujve. Edhe njeriu i rëndomtë i shfrytëzon këto. Bie fjala, në të folurit tonë emrat e njerëzve në familje i përdorim me prapashtesa zvogëluese (*zemrush, babush* ose *bush, Limçe* < *Lirim*); emrat vetjakë për përkëdheli i përdorim të shkurtuar (Dilaver, Dilair > *Dil*; Ramadan > *Dan*, Rrahman > *Man*, Luljeta > *Loli*, Rrezarta > *Arta*), jo vetëm për ekonomizimin e të folurit, por edhe për arsye se ashtu tingëllojnë më bukur, derisa edhe me cungime e ndërrime të ndryshme tingullore të tipit të gjuhës fëminore, si *Bala* < *Bardha* (me ndërrim të /r/-së në /l/ dhe shmangie të /dh/-së, meqë kjo formë është më bukurtingëlluese), ose me mënjanimin e keqtingëllimit përmes ndërftjes së tingujve bukurtingëllues [v, j, h] midis dy zanoresh, si *shkovi, punovi, msovi* për “shkoi, punoi, mësoi” etj.

Loja me shqiptimin shfrytëzohet shpesh për humor, p.sh. për fjalën *burrë* thuhet se ka burra me një dhe me dy /r/: *bura* dhe *burra*. Kohën e fundit nusët gjithnjë e më shumë po e zgjasin /rr/-në kur e shqiptojnë emrin vjehërr: *Hëh, vjehrrrrra!*, për të shprehur vrazhdësi, urrejtje e ironi; ndërsa dhëndurët po e zbusin në *vjehër*, për të asocuar butësi.<sup>57</sup>

Po kështu, jo rastësisht tridhjetë vjetët e fundit në shumicën e emrave vetjakë, që u jepen fëmijëve tanë, zanoret /e, i, a/ në ndërthurje me sonantet /r, l, n, m/ janë përbërësit tingullore kryesorë (khs. Urim, Lirim, Artan, Arta, Alma, Arben, Erton, Agron etj.).

Madje edhe disa fjalë, të cilave nuk ia dimë kuptimin, na ngjallin

<sup>57</sup> Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, kreu IV – Fonostilistika, Tiranë, 1999, f. 54-63.

një përshtypje ose ndjenjë me tingëllimin e këndshëm të tyre. Siç dihet, përsëritja e bashkëtingëlloreve e zanoreve të njëjta asocon njëtrajtësinë, butësinë, qetësinë. Kështu, edhe stërgjyshet, gjyshet e nënat tona kanë përdorur e po përdorin bukurtingëllimin, sidomos në ninulla:

*nina nana more birë,  
flij se gjumi të ban mirë,  
të ban mirë e të rahaton,  
trupin ty ta pushon...*

që edhe pse foshnja nuk e di kuptimin, megjithatë me këtë kumbim të këndshëm tingujsh qetësohet, rehatohet, e ndjen veten të sigurt e fle.

Tingujt ndikojnë për të krijuar një atmosferë rreth kuptimit, anasjelltas, edhe kuptimi ndikon për mënyrën e perceptimit të tingujve. Shoqërimet tingull-kuptim quhen simbolizëm tingullor, kur vendosen qëllimisht për të arritur efekte të ndryshme. Më shpesh kjo arrihet nëpërmjet grumbullimit të tingujve, që me përshtypjen e tyre mbështesin ose përforcojnë kuptimin e fjalëve.

### **Natyra ritmike-bukurtingëlluese e poezive të Nolit**

Vlera ekspresive dhe impulsive e tingujve varet nga një sërë faktorësh, si: nga kuptimi i fjalës, nga mënyra e artikulimit të tingullit, nga kombinimi i tyre me tinguj të tjerë, nga denduria e shfaqjes në një tekst, nga pozicioni ndaj theksit, rrokja, rima, ritmi, intonacioni etj. Edhe pse ka çështje universale në përcaktimin e kësaj vlere, megjithatë mund të thuhet se në gjuhë të ndryshme, te autorë të ndryshëm kjo vlerë është e ndryshueshme dhe vlerësimet për të janë mjaft subjektive.

Noli me mjeshtëri të rrallë në krijimet letrare në vargje ka shfrytëzuar natyrën dhe mundësinë e tingulljve, si fonostilema për të sajuar ritëm, harmoni ritmike, bukurtingëllimin (eufoninë) dhe muzikalitetin e zërit. Organizimet fonetiko-fonologjike te Noli janë të një shkalle të lartë, aq sa çojnë te një orkestrim tingullor i thënieve.

Te veprat në vargje, natyra ritmike shprehet dukshëm dhe luan rol të rëndësishëm në vlerën e përgjithshme të veprës. Prandaj organizimi dhe sistemimi harmonik i njësisive të gjuhës: i tingujve, i rrokjeve të theksuara e të patheksuara, morfemave, fjalëve, fjalive dhe vargjeve, është anë e rëndësishme e vlerës së përgjithshme të veprës letrare. Noli të gjitha këto efekte të natyrës bukurtingëlluese i ka vënë në funksion të vlerave artistike. Të gjitha mjetet stilistike arrin t'i orkestrojë me



përmbajtjen, porosinë kuptimore të fjalës, të vargut dhe të vjershës në tërësi, dhe me këtë ka arritur efekte të fuqishme emocionale, kuptimore e imagjinate.

Për të vështruar vlerën ekspresive-impresive të tingujve në poezitë “Anës Lumenjve” dhe “Rent, or Marathonomak” të Fan Nolit u shërbyem me të dhëna statistikore mbi dendurinë e përdorimit të fonemave (grafemave) në këto dy poezi:

Denduria e përdorimit të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve					
Nr.	grafema	Rent, or Marathonomak	%	Anës Lumenje	%
1.	a	113		97	
2.	e	97		128	
3.	ë	49		98	
4.	o	70		31	
5.	i	71		62	
6.	u	43		53	
7.	y	13		10	
	Gjithsej zanore	456	Gjithsej zanore	479	
8.	b	15		22	
9.	c	1		4	
10.	ç	12		16	
11.	d	23		25	
12.	dh	10		14	
13.	f	14		7	
14.	g	13		8	
15.	gj	6		9	
16.	h	36		37	
17.	j	32		40	
18.	k	51		25	
19.	l	25		22	
20.	ll	5		1	
21.	m	51		32	
22.	n	65		79	
23.	nj	4		11	

24.	p	34		50	
25.	q	16		4	
26.	r	106		104	
27.	rr	9		4	
28.	s	25		98	
29.	sh	11		13	
30.	t	72		64	
31.	th	19		3	
32.	v	18		18	
33.	x	1		1	
34.	xh	0		2	
35.	z	4		4	
36.	zh	1		0	
	Gjithsej bashkët.	698	Gjithsej bashkët.	717	
Gjithsej zanore e bashkëtingëllore		1154	Gjithsej zanore e bashkëtingëllore		1196

Poezitë e Nolit rëndom kanë një brendi, një ngjarje, një ndodhi.<sup>58</sup> Nolin në kulmin e mendimit demokratik e gjejmë te poezia me gjurmë autobiografike **“Rent, or Marathonmak!”** (1930).

*Rent, or rent, rent e u thua  
Se u çthur ordi e huaj,  
Se betejën e fituam  
Dhe qytetin e shpëtuan!  
Rent, or rent,  
Rent, or Marathonmak!  
.....  
Rent kudo, dyke bërtitur,  
Nëpër shekuj faqe-ndritur,  
Se i vogli shtrin viganin  
Dhe i shtypuri tiranin,  
Veç e tok,  
Tok, or Marathonmak!*

Te figura e rendësit të madh heroik të Maratonës së lashtë, poeti paraqiti lajmëtarin e fitores së shpejtë të vegjëlisë. I portretizuar me

<sup>58</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Alb-as, Tiranë, 2000, f. 65.

mjeshtri të rrallë poetike. Maratonomaku del si njeriu, që energjinë, fuqinë dhe zemrën ia kushton fitores. As etja e madhe, as lodhja kapitëse nuk e ndalin që të arrijë dhe të japë lajmin e fitores. Ai vazhdon vrapimin, duke i kaluar të gjitha pengesat dhe ëndjet vetjake që e joshin, derisa më në fund arrin të lajmërojë për fitoren dhe bie pa frymë përdhe. Nga një dramatikë jetësore, Noli nxjerr e sforcon ideologjinë e vet të fitores: devotshmëria për idenë paguhet me jetën.

### Por, si e shpreh këtë nga pikëpamja fonostilistike?

Përsëritja e fjalëve në një tekst rrjedhimisht sjell edhe përsëritjen e përbërësve tingullorë të atyre fjalëve, e me këtë shtohet denduria e përdorimit të tingujve të caktuar që ngjallin efekte estetike. Kështu, në vjershën e vet më të dashur “Rent, or Marathonomak” fjala **rent** është përdorur 8 herë, **lark** – 6 herë, **Marathonomak** – 12 herë. Po kështu, edhe përsëritja e shpeshtë e rrokjeve të njëjta ngjall efekt akustik. Bie fjala, rrokjen **re** e kemi 17 herë, **er** – 7 herë, **et** – 9, **on** – 18, **or** – 16 etj.<sup>59</sup>

Për të zhdukur hiatin, përkatësisht për të shënuar rëniën (elizionin) e ë-së fundore te fjalët e patheksuara kur fjala pasuese nis me zanore, Noli përdor apostrofin: në poezinë Rent, or Marathonomak 27 herë, ndërsa në Anës Lumenjve 19 herë. Për efekte të tilla stilistike, me të drejtë shkrimtarët, veçmas poetët edhe pas Kongresit të drejtshkrimit shpeshherë nuk zbatojnë normat e prera të standardit.

Poezinë e Nolit e karakterizon vargu gjithmonë ritmik e i rimuar, tetë, dhjetë e dymbëdhjetërrokësh, ku dominon katrena, apo strofa safike.<sup>60</sup> Iera ekspresive-impresive e tingujve shtohet edhe me shfaqjen e tyre në pozicione të njëjta a të ngjashme të fjalës. P.sh. në strofën:

*Nëna, motra, nusja dalin,  
Ngrehin krahët të të ndalin,  
Mos, se s’janë veç Najada  
Magjistrica dhe Driada;  
Lark, or lark,  
Lark, or Marathonomak.*

5 fjalë mbarojnë me /a/ në rrokje fundore të hapur; **nëna, motra, nusja,**

<sup>59</sup> Fan. S. Noli, *Rent, or Marathonomak*, prill, 1930.

<sup>60</sup> Sabri Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*, Alb-as, Tiranë, 2000, f. 65.

**Najada, Magjistrica**; shumë fjalë me /a/ në rrokje parafundore: **dalín, ndalín, krahët, s’janë, Najada, Driada** etj., duke krijuar asonancë të fuqishme (përsëritje të zanoreve të njëjta).

Të gjithë tingujt nistorë të strofës të sapolexuar janë sonorë, duke formuar çifte të njëjta: **n, n; m, m; l, l**. Po të shikojmë edhe tingujt nistorë të të gjitha fjalëve të kësaj strofe, po kështu do të vërejmë një harmoni tingullore me mbizotërimin e sonanteve [**l, m, n**], përkatësisht në vargun e parë: **l, n, m, n, d**; në vargun e dytë: **n, k, t, t, n**; në vargun e tretë: **m, s, s, v, n**; në të katërtin: **m, dh, d**; në të pestin: **l, o, l**; në të gjashtin: **l, o, m**.

Në këtë strofë me mbizotërim të tetërrokëshit (4 vargjet e para janë 8-rrokëshe, vargu i pestë 3-rrokësh, i gjashti është 7-rrokësh) me gjithsej 106 tinguj – fonema, 20 janë zanore /a/, d.m.th. rreth 20 % e tingujve. Nga ana tjetër mbizotëron kombinimi i /a/-së me tinguj sonorë: 11 herë me **n**-në, 9 herë me **r**-në, 3 herë **m**-në.

Në të vërtetë, në gjithë poezinë “Rent, or Marathonomak” /a/-ja paraqitet më së shpeshti, përkatësisht 113 herë në 1154 tinguj – fonema (grafema). Përsëritja shumë e shpeshtë e /r/-së (106 herë) tregon mundim, përpëlitje për jetë a vdekje, ndërsa /th/-ja (që përdoret 19 herë) përforcon e stilizon këmbëngulësinë e vrapuesit për të arritur në cak.

Përsëritja e fjalëve në një tekst, rrjedhimisht sjell edhe përsëritjen e përbërësve tingullorë të atyre fjalëve, e me këtë shtohet denduria e përdorimit të tingujve të caktuar që ngjallin efekte estetike, si në vargjet:

*Pres një shenj’ e pres një dritë,  
Pres me vjet’ e pres me ditë,*

Padyshim, poezia “**Anës lumenjve**” është njëra nga krijimet më të bukura të Nolit. Është e njohur se ajo trajton kryesisht dy tema: gjendjen e mjeruar të vendit nën thundrën zogiste dhe domosdonë e një revolucioni popullor. Poeti, me zemër të plasur, flet për të këqijat që e kanë goditur popullin, për varfërinë dhe paditurinë e madhe; kujton me pikëllim dhe zemërim zgjedhën e egër shumëshekullore të atdheut përmes antitezash më tronditëse e më të fuqishme në letërsinë shqiptare:

*Ku e lam’ e ku na mbeti  
vaj-vatani mjer - mileti?*

*Anës detit i pa larë,  
anës dritës i paparë,  
pranë sofrës i pangrënë,  
pranë dijes i panxënë,  
lakuriq e i dregosur,  
trup e shpirt i sakatosur!*

### **Por, ç'vlerë ekspresive-impresive kanë tingujt në këtë poezi?**

Asonanca dhe aliteracioni, që janë shumë të shpeshta në dy poezitë në fjalë të Nolit, në të shumtën e rasteve ndeshen së bashku. Ato janë edhe elemente të ndërtimit të ritmit, të intonacionit të vargut dhe të kuptimit të vargut.

Në poezinë “Anës Lumenjve” fjala **anës** përdoret 17 herë, fjalëza (lidhëza ftilluese) **se ...** në fillim të rreshtit a të fjalisë përdoret 22 herë, **pa** – 12 herë, prapashtesa **-ës** – 29 herë, prapashtesa **-ur** – 20 herë, prapashtesa **-osur** -10 herë. Në strofën:

*Se ç'e shempnë derbederët,  
Mercenarët dhe bejlerët,  
Se ç'e shtypnë jabanxhinjtë,  
Se ç'e shtryhnë fajdexhinjtë,  
Se ç'e pren'e se ç'e vranë,  
Ç'e shkretuan anembanë,  
Nënë thundrën e përdhunës  
Anës Vjosës, anës Bunës.*

me gjithsej 125 tinguj, mbizotëron e-ja aq sa 26 prej tyre janë të tilla. Katër rreshta të kësaj strofe fillojnë me shprehjen **se ç'e ...** Përdorimi i shpeshtë i e-së, bashkë me tingujt **s** (10 herë), **ç** (6 herë) në kombinim me tingujt **sh, th, dh, xh** si dhe togjet e bashkëtingëlloreve të vështira për nyjëtim: **mpn, rb, jl, pn, nxh, sht, shtr, thn, jd, njt, vr, pr, shkr, mb, ndr, rdh** përforcojnë imazhin e shfrytëzimit shumëshkull të tokave shqiptare nga derbederët, mercenarët, bejlerët, jabanxhinjtë, fajdexhinjtë “ç'e shkretuan anembanë, nënë thundrën e përdhunës”.

Po kështu, edhe në këtë poezi të mrekullueshme, përsëritja e shpeshtë e rrokjeve të njëjta ngjall efekt akustik. Bie fjala, rrokjen **re** e gjejmë 17 herë, **er** – 7 herë, **et** – 9 herë, **on** – 18 herë, **or** – 16 herë etj.

Për të shprehur gjëra negative, të këqija e të dëmshme, Noli përdor fjalë me disharmoni tingullore, ku kuptimi i fjalëve përforcohet edhe me imazhin akustik:

*Çakërdisur, batërditur,  
Përpëlitur dhe zalisur...*

### **Përfundim**

Shenja gjuhësore është një mpleksje e shfaqjes tingullore dhe kuptimit të fjalës. Ekzistimi i varianteve të ndryshme tingullore për të njëjtin kuptim dhe zgjedhja e variantit më të përshtatshëm mundëson ekzistimin e vlerës afektive të fjalës e të tingullit.

Edhe denduria (frekuenca) e përdorimit dhe përndarja (distribucioni) e tingujve në fjalë kanë vlerë bukurtingëlluese (eufonie) apo keqtingëlluese (kakoфонie) të ligjërimit. Siç dihet, ligjërimi është më i lehtë e më bukurtingëllues kur pas një zanoreje shqiptojmë një bashkëtingëllore e anasjelltas, pas një bashkëtingëllores shqiptojmë një zanore. Ndërsa, grupet prej dy e më tepër zanoresh a bashkëtingëlloresh janë më të vështira për nyjëtim dhe më të pakëndshme për dëgjim. Këtë vlerë ekspresive-impresive të tingujve të shqipes si rrallëkund e gjejmë në krijimtarinë poetike të Nolit, qoftë në poezitë origjinale, qoftë në ato të përkthyerat.

Mjeshtri i vargënimit, Fan Noli këtë e arrin veçmas:

- a) duke përdorur fjalë me tinguj bukurtingëllues e kombinime të këndshme tingullore për ta shprehur të mirën;
- b) duke përdorur fjalë me tinguj keqtingëllues e kombinime çakorduese për të shprehur të keqen;
- c) duke bashkëpërputhur me mjeshtëri të rrallë përmbajtjen (kuptimin) që shprehin vargjet e tij me mjetet fonostilistike të shqipes (harmoninë e disharmoninë vokalike e konsonantike, onomatopenë, asonancën, aliteracionin, ritmin, rimën e muzikalitetin e vargjeve).

Kur ky poet i pavdekshëm shpreh diçka të këndshme, të mirë, të pëlqyeshme, të hareshme ... përzgjedh variantin më të mirë nga fondi ekzistues i fjalëve apo edhe krijon ndonjë fjalë të re me tinguj e kombinim tingujsh eufonikë. Nga ana tjetër, kur shpreh gjëra të këqija,

të ashpra, të vrazhda, të errëta... përdor tinguj e fjalë me kombinime tingujsh me nyjëtim kompleks e të pakëndshëm për veshin.

Në çdo vepër letrare shkrimtari bën përzgjedhje të ligjërit nga pafundshmëria e gjuhës. Veprimtaria letrare e Nolit, si edhe i shkrimtarëve të tjerë shqiptarë, duhet parë jo vetëm nga pikëpamja letrare, por edhe nga pikëpamja e gjuhës dhe e stilit.

### **Literatura:**

Antoš, Antica, *Osnove lingvističke stilistike*, Školska knjiga, Zagreb, 1974.

Hamiti, Asllan, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Shkup, 2005, 2011, 2020.

Hamiti, Sabri, *Letërsia moderne shqiptare*, Alb-as, Tiranë, 2000.

Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Tiranë, 1999.

Materiale nga *Interneti* për Fan Nolin.

Noli, S. Fan, *Anës lumenjve, Rent, or Marathonomak*.

Vuletić, Branko, *Fonetika književnosti*, Zagreb, 1976.

Vuletić, Branko, *Gramatika govora*, Zagreb, 1980.

## 2.4. GJUHA E JOSIF BAGERIT DHE E FOLMJA E REKËS



**JOSIF BAGERI**



Shkrimtari rritet e ushqehet me gjeninë e gjuhës amtare dhe është vegël e saj për ta mbajtur atë me gjallëri të pashuar, për ta përtërirë e për ta çuar më tej. Siç dihet, veprat letrare realizohen nëpërmjet gjuhës, prandaj ato duhet të jenë jo vetëm objekt studimi letrar, por edhe gjuhësor. Gjuha e veprës së Josif Bagerit paraqet interes jo vetëm për dialektologjinë shqiptare, historinë e gjuhës shqipe, por edhe për kulturën tonë kombëtare në përgjithësi.

Veprimtaria politike, gjuhësore, letrare e publicistike e Josif Bagerit nga këndvështrimi i kohës dhe i rrethanave kur jetoi e veproi, ka vlerë të madhe. Të përkujtojmë se pikësynimi kryesor i Bagerit, si edhe i Rilindësve të tjerë ishte: çlirimi nga robëria Osmane, ngritja e vetëdijes kombëtare dhe formimi i shtetit, emancipimi i përgjithshëm, përpilimi i një alfabeti të përbashkët dhe i një gjuhe të njësuar kombëtare, hapja e shkollave dhe hartimi i teksteve në gjuhën amtare, arsimimi dhe përhapja e dijes.

Josif Bageri (1870-1915) nga Reka e Epërme e Gostivarit<sup>61</sup> është një ndër figurat më të shquara të Rilindjes sonë kombëtare. Ai ishte poet me talent të rrallë, prozator që shkroi shumë tregime (sidomos për fëmijë), gazetar dhe publicist si dhe atdhetar i flaktë, i cili tërë jetën dhe veprën ia kushtoi çështjes kombëtare shqiptare.<sup>62</sup>

Të dhënat biografike të autorëve, janë mjaft të rëndësishme për të analizuar veprimtarinë e tyre e veçmas gjuhën dhe stilin. Pikërisht

<sup>61</sup> Emrin e Josif Bagerit e mban edhe një shoqatë mjaft e suksesshme: **Shoqata për kulturë, art dhe shkencë “Josif Bageri” në Tetovë**. Misioni themelor i shoqatës është që t’ia japë vendin e merituar për kontributin që ka dhënë Josif Bageri. Për këtë shih në postën elektronike: shoqata\_josif.bageri@hotmail.com, shoqata\_josif.bageri@hotmail.de.

<sup>62</sup> Shoqata për kulturë, art dhe shkencë “Josif Bageri” me seli në Tetovë ka botuar edhe një doracak të vlefshëm për jetën dhe veprimtarinë e Josif Bagerit. Atë mund ta gjeni në adresën elektronike: <http://www.zhurnal.mk/Josi-Bageri-doracak-shqip.pdf>



për këtë, e shohim të udhës të paraqesim shkurtimisht jetëshkrimin e tij. Josif Bageri u lind në vitin 1870 në fshatin Nistrovë, i cili në atë kohë administrativisht i takonte sanxhakut të Dibrës, kurse tani – rrethit të Gostivarit. Fëmijërinë dhe një pjesë të rinisë e kaloi në vendlindjen e tij. Për shkak të rrethanave politike të asaj kohe, Josifi nuk pati mundësi të fillojë shkollimin në moshën e duhur. Leximin dhe shkrimin shqip e përvetësoi në Sofje në moshën 17-vjeçare. Atje jetoi si mërgimtar, ku për një kohë të gjatë punoi si këpucar.

Krahas kësaj pune, në Sofje, Josifi prej vitit 1887 u inkadrua edhe në lëvizjen kombëtare shqiptare. Në këtë kohë, Sofja ishte e stërmbushur me atdhetarë, të cilët i ndiqte pushteti osman, për shkak të veprimtarisë patriotike.

Më 1 janar të vitit 1893 në Sofje u themelua shoqëria shqiptare “Dëshira”, ndërsa Josifi ishte njëri ndër themeluesit dhe aktivistët më të shquar të saj. Nga fundi i vitit 1899 shkoi në Stamboll për të vizituar poetin tonë të madh Naim Frashërin, i cili ishte shumë i sëmurë dhe dergjej në shtrat. Takimi me Naimin i la mbresa të mëdha. Ndikimi i tij ishte jashtëzakonisht i madh te Josifi, sa që pas vdekjes së Naimit shkroi edhe poezi për të.<sup>63</sup>

Gjatë periudhës së viteve 1905-1907 Josifi ndihmoi shumë në përhapjen e arsimit shqip ndër masat popullore. Ishte luftëtar i denjë për gjuhën dhe shkollën shqipe dhe si rezultat i saj, në shtator të vitit 1908 në fshatin e tij të lindjes hapi edhe një shkollë shqipe.

Në maj të vitit 1910, në Sofje fillon të botojë gazetën me titull “Shqypeja e Shqypnisë”, e cila luajti një rol të madh në përhapjen e arsimit dhe në trajtimin e çështjes kombëtare. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, Bageri kthehet në Shqipëri dhe vendoset në Durrës. Atje qeveria e emëron redaktor të revistës “Ushtima e Krujës”. Në vitin 1915, gjatë një udhëtimi të mundimshëm nga Durrësi për në Sofje, i lodhur e i rraskapitur fizikisht ndërroi jetë në Prishtinë.

Josif Bageri punoi shumë për çështjen shqiptare. Punoi pa u lodhur, duke lënë pas shumë shkrime të botuara e të pabotuara: poezi e prozë, platforma politike, artikuj, komente, reagime, klithje politike etj. Gjatë veprimtarisë së tij pati një bashkëpunim të ngushtë me dibranët: Said Najdenin e Jashar Erebarën, me Atanas Albanskin nga Reka e Epërme, me Nikolla Ivanajn, Luigj Gurakuqin dhe shumë atdhetarë

<sup>63</sup> Të dhëna nga Interneti: <http://fryma.blogspot.com/2010/08/ze-i-ndergjegjesimit-josif-bageri.html>

të tjerë. Personaliteti dhe veprat e tij politike, letrare e publicistike meritojnë respekt të lartë.<sup>64</sup>

Një bashkëpunëtorit dhe mikut të tij të ngushtë, atdhetarit dhe mësuesit të zellshëm, që vdekja e hershme e ndau nga jeta, Spiro Garo nga Toskëria, i kushtoi një elegji me dhjetë strofa. Ne po shkëpusim tri strofa nga kjo “*piramidë*” shokut tim, siç e titullon Bageri:

***Një peramid shukut imë.***

*Kom detyr un me përmend,  
Për një vlla bashk-punonjës;  
Në këtë vend ku jom gjendun,  
Si punëtor dhe si shkronjës.*

.....

*Ky trim emën t’bukur kishte:*

***Spiro Garo, patriot!..***

*Ah! ky shqyphtar i gjall ishte, -  
Po n’qiell ky gjindet sot...*

.....

*Ky trim i vërtet shqyphtar!*

*I lindun në Toskëni;*

*Po kish zon një udh të mbâr,  
Se punonte për Shqypni.<sup>65</sup>*

Sigurisht se në gjuhën e Bagerit përveç traditës së shkrimit të letrave shqipe në toskërisht, e veçmas gjuha dhe stili i Naimit, ndikim të madh pati edhe idiolekti i Spiros.

Në internet ka disa të dhëna jetëshkrimore e vlerësuese të veprimtarisë së Josif Bagerit. Për gjuhën e Bagerit deri më tani janë botuar disa studime e artikuj. Për të kemi punimin me vlerë të dr. Petro Janurës, “Josif Jovan Bageri”, Jehona 7-8, Shkup, 1976; Zymbyle Zeneli, “Josif Bageri dhe veprimtaria e tij për çlirimin kombëtar” në “Ushtima e maleve”, Peshkopi, 1978; monografinë e Shaqir Beranit “Gjuha e Josif Bagerit”, Prishtinë, 1988; prof. Remzi Nesimi “Rreth disa tipareve karakteristike fonetike e morfologjike në veprat e Josif Bagerit”, Çështje gjuhësore, Shkup, 1997 e ndonjë punim tjetër; ndërsa për të folmen e Rekës kanë shkruar Sejfedin Haruni “E folmja shqipe e

<sup>64</sup> [http://sq.wikipedia.org/wiki/Jovan\\_Josif\\_Bageri](http://sq.wikipedia.org/wiki/Jovan_Josif_Bageri)

<sup>65</sup> Josif Bageri, *Kopësht malsori*, Sofje, 1910, f. 73.

Rekës së Epërme të Gostivarit”, Shkup, 1994; Feim Reçani, “E folmja e Rekës së Epërme” etj.

Regjioni i Rekës së Epërme shtrihet në Maqedoninë veriperëndimore, midis Gostivarit, Dibrës e më thellë dhe përfshin rrjedhën e sipërme të lumit Radikë.<sup>66</sup> Përgjatë luginës së Radikës dhe në shpatet e tij shtrihen 16 fshatra të banuara me popullsi shqipfolëse. Fshatrat e Rekës së Epërme janë: Beliçica (15 shtëpi, 90 banorë), Bibaj (20 shtëpi, 110 banorë), Bogdi (35 shtëpi, 260 banorë), Grekaj (20 shtëpi, 99 banorë), Kiçinica (10 shtëpi, 54 banorë), Krakornica (40 shtëpi, 240 banorë), Niçpuri (15 shtëpi, 75 banorë), Nistrova (45 shtëpi, 315 banorë), Nivishta (15 shtëpi, 75 banorë), Rimnica (45 shtëpi, 280 banorë), Senca (50 shtëpi, 300 banorë), Tanushaj (50 shtëpi, 310 banorë), Vau (80 shtëpi, 380 banorë), Vallkavia (30 shtëpi, 200 banorë), Vërbani (90 shtëpi, 480 banorë) dhe Zhuzhnja (23 shtëpi, 102 banorë). Numri i shtëpive dhe i banorëve të këtyre fshatrave është sipas regjistrimit të vitit 1971. Sipas regjistrimit të vitit 1981 ky numër është më i vogël.<sup>67</sup> Në 16 fshatrat e përmendura jetonin afër 3.400 banorë, por tani ky numër është zvogëluar dukshëm. Popullsia flet shqip dhe është e besimit islam e ortodoks, por rekasit nuk kanë pasur as grindje e as mosmarrëveshje të karakterit fetar.<sup>68</sup>

Ja se si e përshkruan Bageri Rekën në poezinë e gjatë me 18 strofa “Reka e Dibres dhe rronjësit e sajë”:

***Reka e Dibres dhe rronjësit e sajë.***

*Tetëmbëdhjet copë*

*Katunde ka në Rekë*

*Po gjindja e ksajë*

*Jon gjyku për fjekë.*

.....

*Kta kështu po rrojn:*

*Gjith në mundime*

*Dhe n’gurbet kta shkojn,*

*Të kërkojn fitime.*

.....

Bageri vendlindjes së tij ia kushton edhe poezinë “*Reka vendi im*”:

<sup>66</sup> Sejfedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994, f. 7.

<sup>67</sup> Po aty, f. 7.

<sup>68</sup> Po aty, f. 9-10.

***Reka vendi imë.***

*Rekë, o zembra e Shqypnîs!*

*Ti je vendi i trimnîs,*

*Ndon se je kodra e vrima, -*

*Besa ti ke rrit shum trima:*

*Burra t'fôrt e të môshëm*

*Dhe në korp shum të bôshëm...*

Banorët e Rekës së Epërme edhe në të kaluarën edhe tani shtegtojnë me familje e grupe-grupe në vende të ndryshme të Maqedonisë, si në qytetet Gostivar, Dibër, Tetovë, Shkup, Veles e gjetiu, në fshatrat: Koritë, Sedllarevë, Gurgurnicë (komuna e Tetovës), Patishka Rekë, Nerez (rrethi i Shkupit), Jabollçishtë e Epërme dhe Jabollçishtë e Poshtme e Velesit etj.

E folmja e Rekës është mjaft konservatore (ruajtëse). Ajo përfshin një kurorë katundesh, duke filluar nga Korita, Gurgurnica, Sallareva; disa fshatra të Karshiakës së Shkupit (Gerçecin, Nerezin, Sveta Petkën, Çiflikun, Patishka Rekën), e deri në Jabollçishtë të Velesit. Katundet e rrethit të Shkupit e të Velesit të populluar me banorë të Rekës, edhe pse të muslimanizuar, sot janë dëshmi e gjallë që në vete ruajnë po ato karakteristika etnike e gjuhësore, si të banorëve të paktë që ende kanë mbetur në Rekën e Epërme.

Edhe pse janë arritur rezultate të lakmueshme në studimin e të folmes së Rekës dhe të gjuhës së Bagerit, megjithatë hulumtimet gjuhësore, etnografike, historike e kulturore për këtë dhe autorë të tjerë si dhe për të folmet shqipe duhet vazhduar edhe më tej.

Në këtë artikull nuk mëtojmë të shterojmë ndërlidhjen e gjuhës së Josif Bagerit me të folmen e vendlindjes së tij, por do të përpiqemi të vëmë në spikamë disa përfaqje të gjuhës së tij me të folmen e Rekës dhe përpjekjet e autorit për të krijuar një gjuhë të përbashkët standarde. Pikëmbështetje kryesore për gjuhën e Josif Bagerit kemi veprën e tij ***“Kopësht malsori – msime të shqyptarueta dhe vjersha”*** prej Josif Jovan Bagerit, Sofje, 1910 si dhe botimet e deritashme që na kanë rënë në dorë për Bagerin, ndërsa për të folmen shqipe të Rekës jemi mbështetur në monografinë e Sejfedin Harunit dhe në monografinë e Haki Ymerit për të folmen shqipe të Karshiakës.<sup>69</sup>

Përmbledhtas mund të thuhet se baza e gjuhës së Bagerit është

<sup>69</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997.

e folmja e vendlindjes së tij, e ngritur në normën letrare të kohës dhe e gërshetuar me elemente të toskërishtes. Me fjalë të tjera, gjuhën e Bagerit e karakterizojnë:

- a) tipare fonetike e fonologjike, morfologjike e leksikore të të folmes së Rekës, të cilat mbizotërojnë;
- b) tipare dialektore të të folmeve të tjera gege, që bashkëpërkojnë veçmas me të folmen e Dibrës, Gostivarit e të Kërçovës;
- c) Veçori gjuhësore mbikrahinore e mbidialektore me disa elemente të toskërishtes;
- ç) Përpyjekja e autorit për të shkruar në një gjuhë të përbashkët letrare.

### Shkrimet e Josif Bagerit karakterizohen nga këto tipare:

Bageri përdor alfabetin fonetik të Manastirit (një fonemë – një shkronjë). Zanoret e gjata që krijojnë kundërvënie fonologjike me zanoret gjegjëse të shkurtra në të folmet e gegërishtes, autori i shënon me dyzimin e tyre: *jee, biir, fee, ree, ngree, tyy, syy, aar, muu* etj.,<sup>70</sup> si në fjalët: dituria ruan *feen* (f. 50), mbi ju kishte ah një *ree!*... f. 50, po t'pa *fën* kjo, e habitën!... f. 50, sepse ren, ja ku e ke *ngree* f. 50, po nuk jon *themelii!*... tjerat gjuh që s'i *dii*; e veta është *themelii*, t'cilën msojm n'vogëlii! (f. 49), mal me *eer* f. 52, çbon si *jee?* përse kryet nuk e *ngree*, f. 53; Un thitha ngjitë *tuu*, dhe s'më ke *mbarrtuu!*, Ti gjith një po qân për *muu!*...Po mû fati, ku më *pruu?*... Vetëm un me *tyy*, - Apet jom pa *syy!* (f. 53).

Ai ka përdorur edhe shenja diakritike të posaçme për të shënuar zanoret hundore, si në fjalët *ârdh, âsht, pûn, drû, âsht, mâll, ân* etj.

Ndonjëherë, në vend të shkronjës <ë> përdor <ə>-në e përmbysur (e quajtur shkronja shwa indoevropiane, sipas gramatikës hebraike), si në fjalët *zembër, shqypətari, mundən, tə vərtetən* (f. 76), *Dibrəs, rronjəsit e sajə* (f. 71), *nə mos bofsh mir, pər* etj.<sup>71</sup>

Mospërdorimi i shpeshtë i <ë>-së së patheksuar në trup të fjalës është dukuri mjaft e shpeshtë te ky autor, kuptohet sipas shprehisë nyjetimore të folësve gegë, si: *jet, dor, këmb, kënk, jon, rrojn, djal, fjal, pun, kta* < këta, me *msu* < me mësue, *mdhenj* < mëdhenj, *gzohu, gzohet*

<sup>70</sup> Remzi Nesimi, *Rreth disa tipareve karakteristike fonetike e morfologjike në veprat e Josif Bagerit*, Çështje gjuhësore, Shkup, 1997, f. 150.

<sup>71</sup> Për ekonomizim shkrimi, pas shembujve të sjellë do të shënojmë vetëm faqen ku janë gjetur fjalët e shënuara në veprën “Kopësht malsori”.

< gëzohu, gëzohet; *lulzohet* < lulëzohet etj.

Si duket, nën ndikimin e gjuhës së Naimit, të gjuhës së bashkëpunëtorit të tij toskë dhe të vetëdijes së lartë për nevojën që të shkruajmë në një gjuhë të përbashkët të gjithë shqiptarët, <ë>-në e gjejmë të shkruar edhe në pozicion fundor, si në fjalët *javë, amë, gojë, ujë, atë, e gjallë, vonë* e madje edhe në disa fjalë ku nuk përdoret as në të folmet toske, si *emnatë, gjithkujë, malli imë, kësajë, e sajë* etj.

Dukuri fonetike mjaft e shpeshtë në veprat e Bagerit, e cila ka përhapje të gjerë në të folmet e gegërishtes, është buzorëzimi i [ë]-së hundore të mbarë gegërishtes në [ö], si: *tombël* “tambël” f. 50, mbarre *kom* < kam (f. 53), *çbon* < ç’ban (f. 53), me i *lon* < me i lãn, me *dhon* (< me dhãn), po *bojn* (< po bãjn), me m’*bo* nder < me m’ba nder (f. 53), kan *thon* (< kan thãn), s’të *lon* (< s’të lãn), *rônd* (< rand), fmia ime të gjith *jôn* (< fëmijë të mi të gjithë janë, f. 54), *Shkupnjonët* (< shkupnjänët) të gjitha format në poezinë Shqyptarët e Shkupit; *Monastir* (< Manastir) në poezinë “Kushtrimi i shqyptarvet në Monastir”. Por, duhet thënë se ka mjaft fjalë të pabuzorëzuara, si *asht, gja, e ambël, amë* etj.

Siç dihet, të folmet e gegërishtes qendrore, ku bën pjesë edhe e folmja e Rekës së Epërme, përgjithësisht zanoren e buzorëzuar [y] e zhbuzorëzojnë në [i] e më pas e kanë diftonguar në variante të ndryshme diftongjesh: [ai], [ei], [oi], [ëi]. Krahaso: shtëpi > shpi > shpâ, shpëi, shpôi, shpêi. Në të folmen e Rekës si dhe në gjuhën e Josifit, zanorja [y] ruhet si e tillë, si në fjalët *tryes* < tryezë, *gënjyet* < gënjyet, *Tyrkî* < Turqi, *kjytet* < qytet, *ky* njeri, *ty*, mbi *ty* o *Natyrë*; por edhe buzorëzimi i [i]-së në [y]: *ajy* që s’di mësim, *ajy, ay* < ai, *shqyptar* < shqiptar, *Shqypnia* < Shqipëria etj.

Po kështu, shkrimet e Rilindësit tonë dallohen me ruajtjen e zanoreve të theksuara në formë të padiftonguar [i] dhe [u]: ata i *mîr*, f. 49, *fëmia, trima, rrit, shu:m* etj.

Togjet e zanoreve *ue, ae, oe, ie, ye* që në shumicën e të folmeve gege janë monoftonguar, në shkrimet e Bagerit këto togje na dalin të ruajtura, si *durue, vorfnue, rrzue, muert vesht, ti thuesh, grue, kohët e kalueta, vendue, gjykue, perëndue, me mbarue, ruejtësvet, të biesh, t’kiesh, kie dâl, i ndëgjuet, ki provuet, fillue, vllaznue, s’duen, me kushtruem; hae, thae, lae; roe, droe, bie, kie, diell, kryet, je kthyer* etj., por më rrallë edhe në formë të reduktuar, si me *mu*, n’vise t’*huja*.

Togjet e bashkëtingëlloreve *mb, nd* ruhen si në të folmen e Rekës, ashtu edhe në shkrimet e Bagerit, ndonjëherë edhe në fjalët ku sot

përdoren me bashkëtingëllore të thjeshta, që njihet si veçori e të folmeve toske, si në fjalët *mbret, ka mbet, argjand-dashës, zembër, me përmend, ende, vendi, mëndashi, pa vendue, ande, përande, i zembëruet, mbas, krymbi, mbeshillet, lombë, i lindun, mbaron, mbân, një udh të mbâr, tënden, mb'udh, mb'uj, të mdhoja* etj.

### **Tipare të gjuhës së Bagerit që nuk përkojnë me të folmen e Rekës**

Ndër veçoritë më karakteristike të së folmes së zonës së Rekës së Epërme është afrikatizimi i qiellzoreve /q, gj/ në /ç, xh/ dhe evoluimi i mëtejme në shtegoret frikative /sh, zh/: qafë > çaf > shaf; gjarpën > xharpën > zharpun. Në veprat e Josif Bagerit në asnjë rast nuk pasqyrohet kjo dukuri fonetike.

Në shkrimet e Bagerit ruhet togu i vjetër *kl* te fjalët *bulk, ulk* edhe pse në të folmet shqipe *l*-ja është qiellzorëzuar në *j*: *bujk, ujk*.

### **Tipare mbikrahinore e mbidialektore të gjuhës së Josifit**

Përdorimi i përemrave lidhorë të lakueshëm *i cili, e cila* që siç dihet janë veçori vetëm e gjuhës letrare, meqë nuk përdoren në asnjë të folme popullore. Te Bageri i gjejmë të përdorura pa nyjën *i, e, të*: Dhe kështu na kjonkemi t'gënjyet dhe kot u munduem për vllaznimin dhe bashkimin e ktyne popujve rronjës në Tyrkî, *cila* nuk është tjetër përveç se ajo e vjetra (f. 76). Ma i miri mësim asht ajy, *cili* ep leje njeriut. Ja kthej cucës, *cila* e pa se u bo e art... Se s'ditkam të shkruiej e të lëçiti, përende nuk na duhesh! Ne na duhet njeri, *cili* të dinte me leçit dhe me shkruiejt mir e bukur (f. 12), E lëçiti letrën, *cilën* e ama ja kishte dërgue. Nisi për në atënit, *cilës* ju kish afërue me ndihmën e plakut shpëtimtar (f. 13), djaloshi, *cili* i tha plakut (f. 13) etj.

### **Elemente të toskërishtes në gjuhën e Bagerit**

Si në variantet fonetike të fjalëve, ashtu edhe në leksikun e Josif Bagerit vërehen disa elemente të toskërishtes. Të tilla janë:

- Përdorimi i *ë*-së së theksuar në vend të *a*-së hundore të mbarë gegërishtes: *prëndëvera, dituria, një, dhëmbët, ka dhën, gjë, çysht, të lësh, nxënës, të nxësh, kënkën, këmbë, rrënja* etj.
- Jo pak emra vepruesish autori i përdor me prapashtesën toske



-onjës e jo me -ues: *mësonjës, këpuc-mbaronjës, shkronjës, përtonjës* etj.

- Elemente të toskërishtes janë edhe fjalët e shprehjet atë “baba”, *biir i âtës*, f. 50, *msonjëtores, dëbor*, s’kupton *dot*, të tëra paratë, forma e shumësit *grekër* etj.

Në veprën e Bagerit pasqyrohen edhe mjaft veçori karakteristike **në fushë të morfologjisë**. Shumica e tyre përkohet me të folmen e Rekës. Të tilla janë:

- Ruajtja e gjinisë asnjëse te disa emra: *kryet*: Prej kti uji *kryet lani* (f. 20), *ujët, drithët, plehët*.
- Nën ndikimin e së folmes së vendlindjes, autori e përdor rasën vendore, e cila në shqipen standarde dhe në shumë të folme shqipe është shkrirë në rasën kallëzore (përveç në toskërishten veriore): *në shpullët, në thembrët, në plagët, në obort, në dhomët, në kupët, në kodrët, në baltët, në dorët* etj.
- Emrat e lakimit të dytë, përkatësisht emrat mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëlloret -k, -g, -h dhe me zanore të theksuar, në të folmen e Rekës shquarsinë e bëjnë me mbaresën -u. Kështu i shkruan edhe Bageri: *plaku*, përveç në pak raste me mbaresën -i: *barki, plehi, ahi*.
- Përdorimi i përemrit vetvetor *i, e vet* që e ka edhe e folmja e vendlindjes së tij. P.sh.: Shqypeja e mbaron furrikun *e vet* në ata skepat e melevet mdhej, ku këmb e njeriut smundën me shkel (f. 6). Po më e bukura është ajo, që ruen zot e furrikut *vet*, bijt e Shypënis (f. 6).
- Formimi i mbiemrave dhe formave të pashtjelluara të disa foljeve të zgjedhimit të parë me elementin -t: *ka shkuet, me kapërcyet* është veçori dalluese e të folmes së Rekës së Epërme. Në disa raste si mbiemrat, ashtu edhe format e pashtjelluara Bageri i përdor si në të folmen e vendlindjes: *i drejtuët, t’mbuluët, e kthyet, me gënjyet, i vyet, tuj u gëzuet, tuj kënduet, tuj zhvilluet, pa martuat* etj.
- Foljet e zgjedhimit të parë Bageri i përdor si në gegërishten letrare të kohës së tij: *me fitue, me mbarue, me thye, me shkruë, me shkue, me hy*.
- Të pakryerën e foljeve autori e përdor me -nj, si në të folmen e Rekës: *kishnja, mblihdje, hanje, rrënonin* etj.



- Në veprën e Bagerit shfaqet përdorimi paralel i lidhore dhe i paskajores. P.sh.:  
... Muert vesht fortshum mir se ç’domi *me thon* ... (f. 78, paskajore gege)  
... Ju athere lypën *të përpiqi* pa mprajtim *ta përndani* (f. 78, lidhore) kët marre-vesht si ju gjith këtë që kemi shkrue për *me u knaq* (f. 78, paskajore gege).
- Përdorimi i përcjellores në formën gege: *tuj leçit* gjith këta thona, pralla e vjerrsha (duke lexuar të gjitha këto thënie, përralla e vjersha); se fëmija *tuj u gëzuet* (se fëmija duke u gëzuar, f. 11), tuj e ngjat fjalën (duke e zgjatur fjalën, f. 11), tuj e këshillue (duke e këshilluar, f. 12). Gjithkush e dî, se teja bon dom *tuj brit* e *tuj prish* petkat (robot) e leshta (f. 17).

Josif Bageri u kujdes që të mos përdorë fjalë të huaja të panevojshme, sidomos nga gjuhët sllave. Por, ka qenë e pamundur t’u shmanget plotësisht atyre, duke pasur para sysh huazimet jo të pakta nga gjuhët sllave në të folmen e Rekës si edhe qëndrimin e tij të gjatë në Bullgari. Në shkrimet e tij gjejmë fjalët *kartiçkë* “kartolinë”, *brig* “kokëçarje”, *rikatën* “pëllet”, *kalket jam i falunderit* nga maq. sum blalagodaren në vend “jam mirënjohës”.

Në gjuhën e Bagerit hetohet edhe një ndikim i herëpashershëm sintaksor i gjuhëve sllave, sidomos në përdorimin në anasjellë (inversion) të emrit e mbiemrit: Më të *nesërmen dit* ... Ku kishte dhe të *tjera tesha* të bukura, ... Në të *këtilash strajcash* rron teja... Asht më *e forta shpez*. E zgidhi të *skllavnuetin djalosh*. *Mâ t’madhe çpërbles* ... Cila është *e vërteta miqësi* (f. 24). Hekuri asht më *i nevojshmi metal*. Kush është *mâ i madhi besëtar* i njeriut në kët jet (f. 24). Guri i kërqelt është mjaft i *përhapun mineral*. Mos’ me ndiejt *mâ të këtilla fjalësh*. *Të blejtunat ragullia*, f. 23. *I treti mik* (f. 25). Dalin të *dëmshmit krimba*. *Ma i miri mësim* (f. 23). Për të zëvendësuar ndonjë huazim krijon fjalë nëpërmjet kalkimit, si *smunëtore* për “spital” nga bollnica, *gjahtore* për “pushkë gjahu” sipas fjalës llovaçka, *gjashtore* për allti etj.

Si të gjithë Rilindësit e tjerë, ashtu edhe Josif Bageri bëri mjaft përpjekje për ta pasuruar fjalorin e shqipes me fjalë e shprehje të reja. Me interes janë fjalët *leçit* “lexoj”, *lëçitës* “lexues”, *pjektore* “furrë”, *krimbaleshët* “krimbat e mëndafshit”, *prrallet* “bën shaka”, *gjallim* “jetë”, *shurdhëti* “qetësi”, *rronjës* “banor”, f. 71; *çgjumi* ju prej gjumit

“zgjohuni” (f. 72), qëllimi yn është të *çgjumim* kombin prej gjumit rënd (f. 78); *lakmonjës* “lakmues”, *argjand-dashës* “argjenddashës, lakmitar i madh për pasuri”, *njëgjakës* “i të njëjtit gjak, familje, farefis”, *njeridashës* “humanist”, *shëmbëllej* (lypet t’i shëmbëllej) “shëmbëllej” f. 23 në “Kopësht malsori”, *ragulli* “gjëra, tesha, plaçka” f. 23, *prapças* “mbrapsht”, f. 23, si dhe format *falënderje* “falënderim”, *shoktarnisht* “shoqërisht”, *ngushti* “ngushticë”, *shtyptori* “shtypshkronjë”, *pëpleh* “plehëroj”, të përplehun *rishtas* “të plehëruar rishtas”, *grykatore* “gryq”, *grykator* “grykatës” (f. 24), *msimtoje* “mësonjëtoje, shkollë” (f. 25, 49); *msojs* “mësues” (f. 49), *mbi emën* “mbiemër”, *mprajtim* “pushim” (f. 78), *trumba* me dhen “tufa me dhen” (f. 52); I del përpara *msonjëtorit* në dhomët *shkrimtoje*, aty ku shkruente fëmin për nxënës, tuj ju kqyr dëshmiat, cilat i kishin marr para çlodhjes për vitin e mësimit që shkoj. (f. 11), Të shkojne për promje në *msimtojet promtare* (Të shkojnë në mbrëmje në shkollën e natës, f. 12), Kta *ujnanje* pika pika (Këto ujëra pika-pika, f. 20) etj.

Se sa e vlerëson Bageri shkollimin në gjuhën amtare, pasurimin dhe ruajtjen e saj flet bindshëm poezia e tij:

***Eni të gjith në msimtoje***

*Eni fëmî dôr për dore!*

*Na të shkojm në msimtoje;*

*Gjuhën hôll e mîr ta m’sojm:*

*Amë e âtë na të ndërojm ...*

Si përfundim, në shkrimet e Bagerit pasqyrohet e folmja e Rekës e shekullit XIX dhe e fillimit të shekullit XX, e pasuruar me elemente mbikrahinore e mbidialektore. Shqipja e Bagerit është e kuptueshme, e shkruar me kujdes e dashuri. Në të hetohet edhe përkrahja e nevojës së formimit të shqipes standarde.

**Literatura:**

Bageri, Josif, *Kopësht malsori*, Sofje, 1910.

Berani, Shaqir, *Gjuha e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988.

Haruni, Sejfedin, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit*, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1994.

Nesimi, Remzi, *Rreth disa tipareve karakteristike fonetike e morfologjike në veprat e Josif Bagerit*, në Çështje gjuhësore, Shkup, 1997.

Ymeri, Haki, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkupi, Shkup, 1997.

[http://sq.wikipedia.org/wiki/Jovan\\_Josif\\_Bageri](http://sq.wikipedia.org/wiki/Jovan_Josif_Bageri)

<http://fryma.blogspot.com/2010/08/ze-i-ndergjegjesimit-josif-bageri.html>

[shoqata\\_josif.bageri@hotmail.com](mailto:shoqata_josif.bageri@hotmail.com), [shoqata\\_josif.bageri@hotmail.de](mailto:shoqata_josif.bageri@hotmail.de).

<http://www.zhurnal.mk/Josi-Bageri-doracak-shqip.pdf>



### 3. PRURJE ALBANOLOGJIKE

#### 3.1. NDIHMESA E PROFESOR EQREM ÇABEJT NË STUDIMIN E MARRËDHËNIEVE TË SHQIPES ME GJUHËT SLLAVE<sup>72</sup>

Profesor Çabej, pa dyshim, është figura më e shquar në fushën e gjuhësisë shqiptare. Ai është më i madhi albanist kombëtar, madje më i madhi i dijes sonë.

Siç dihet, veprimtaria e albanistit tonë të madh është e shumanshme. Ai ka trajtuar çështje të historisë së gjuhës shqipe, të dialektologjisë shqiptare, të etimologjisë, të etnogjenezës, të etnokulturës shqiptare, të ballkanistikës, të indoevropianistikës, të folklorit, të letërsisë shqiptare etj. Për gati gjysmë shekulli ai bëri studime, botoi e dha mësim në fushën e gjuhësisë shqiptare. Në shkrime të shumta "vërtetoi në mënyrë bindëse origjinën ilire të gjuhës shqipe dhe autoktoninë e popullit shqiptar".

Profesor Çabej ndihmesë të madhe ka dhënë edhe në studimin e marrëdhënieve të shqipes me gjuhët sllave. Ai me saktësi shkencore flet për dyndjen e sllavëve në Ballkan, për mbretërinë bullgare dhe serbe gjatë mesjetës si dhe shtrirjen e tyre në tokat shqiptare.

Kontaktet shumëshekullore sllave - shqiptare kanë lënë gjurmë edhe në gjuhë. Me lidhjet historike e gjuhësore sllavo-shqiptare, përveç Çabejt, janë marrë një varg dijetarësh, historianë e gjuhëtarë, ndër të cilët shquhen historiani rus V. Makushev, Konstantin Jireçeku, Sufflay, Miklosichi etj. që hodhën themelet e studimeve sllavistike në lidhje me shqipen. Punën e tyre e vazhduan dhe e çuan më tutje dijetarë, si Gustav Meyeri, Max Vasmeri, Stefan Mlladenovi, Afanasij M. Selishçevi, Norbert Jokli, Stewart Manni, Petar Skoku, Henrik Bariqi, Ivan Popoviqi, Agnia Desnickaja, Gunar Svane etj. Çabej është objektiv dhe i përmend autorët që janë marrë me këtë çështje, pavarësisht nga qëndrimi që kanë pasur ata ndaj shqiptarëve dhe gjuhës shqipe.

Huazimet sllave në shqipen që sjell prof. Çabej përfshijnë fusha

<sup>72</sup> Kumtesë imja në "Konferencën IV shkencore Eqrem Çabej – figura që shkëlqeu në studimet albanologjike", Tetovë, 19-20 dhjetor 2008.

të ndryshme të botës materiale e shpirtërore. Shumica e tyre gjallojnë edhe sot e kësaj dite në të folmet shqipe, ndërsa ndonjë nga to ka përdorim të kufizuar, tani vetëm në të folmet shqipe të Maqedonisë, Kosovës, Preshevës e Malit të Zi. Ndonjëra prej tyre është bërë pronë edhe e shqipes standarde.

Eqrem Çabej në “*Studime etimologjike në fushë të shqipes*” trajton rreth 612 sllavizma të shqipes, 165 prej të cilave sillen për herë të parë. Po sjellim disa nga huazimet më të përhapura sllave në gjuhën shqipe: emrat *strehë, pod, prag, grazhd, stol, oborr, kosh, kovë, koritë, sitë, brazdë, sanë, rrepë, kastravec, govedar, stopan, zhabë, sokol, ezh, piavicë, mrezhë, opingë/opangë, zakon, porotë, rob, plaçkë, carinë, porez, gjobë, probatim e pobratim, koskë e koc, vërsnik*; foljet *vadit, prashit, vozit, darovit, gostit, godit, çudit* etj.

Një interes të veçantë, - shkruan prof. Çabej, - paraqet pyetja se nga cilat gjuhë sllave burojnë sllavizmat e shqipes. Shumë fjalë, si *kulaç, kosh, koritë, glinë, gërmadhë, mrezhë, vllak, zakon* kanë formë të njëjtë në gjuhët sllave jugore, prandaj nuk mund të dihet se cila është gjuha dhënëse. Në pajtim me rrethanat historike, me përhapjen dikur të ndikimit bullgar në Shqipëri të Mesme e Jugore e të sferës serbe në Shqipërinë e Epër (veçmas në Kosovë e Mal të Zi - shënimi ynë), në vijë të përgjithshme mund të thuhet se huazimet sllave që gjenden në dialektet e atyre krahinave janë marrë prej bullgarishtes (dhe prej maqedonishtes - shënimi ynë), sllavizmat e gegërishtes veriore prej serbishtes.

Përveç përndarjes së huazimeve sllave sipas rrethanave historike dhe gjuhëve në takim, prof. Çabej gjen edhe argumente gjuhësore atëherë kur trajta serbe dallon nga forma e bullgarishtes ose e maqedonishtes. Me të drejtë konstaton se e njëjta fjalë në dy forma: *opangë* në gegërishten veriore dhe *opingë* në gegërishten jugore dhe në toskërishten rrjedhin nga format *opanak, opanok* të serbishtes, përkatësisht *opinok* të bullgarishtes (e të maqedonishtes – shënimi ynë). “Një tjetër mundësi dallimi na japin fjalët që përmbajnë refleksin e tingullit *dj* të sllavishtes së vjetër. Këtë tingull serbishtja e shqipton si *đ* (gj), ndërsa bullgarishtja (e maqedonishtja) e ka zhvilluar në *zhd*. Prandaj sllavizmat e shqipes që paraqiten në atë formë janë serbizma, ato me *zhd* janë bullgarizma. Kështu, e njëjta fjalë sllave ka hyrë në shqipen në dy trajta, si *megje* ‘kufi’ prej serbishtes e si *mezhdë* prej bullgarishtes (dhe maqedonishtes). Përdorimi i asaj trajte në Veri e i kësaj në Jug dëfton pajtimin e plotë të rrethanave fonetike e të kushteve historike.”

Gjuhëtari ynë i madh shprehu edhe bindjen se gabimisht janë marrë për sllave prej shumë dijetarësh fjalët *baltë*, *daltë*, *gardh*, për të cilat thotë se i përkasin fondit autokton.

Ai përveç fjalëve me burim nga serbishtja e bullgarishtja (dhe maqedonishtja), që janë më të vonshme, pranon të ketë edhe një shtresë më të hershme të huazimeve sllave në shqipen, nga sllavishtja e vjetër, siç është fjala *grusht*.

Një tjetër çështje me rëndësi që shtron Çabej është përndarja gjeografike e huazimeve sllave brenda shtrirjes territoriale të shqipes. Sipas tij duhen veçuar elementet me një përdorim të kufizuar nga ato që kanë një përhapje më të përgjithshme. Ai thotë “kjo punë gjer më sot nuk është kryer”. Pyetjes se në cilat krahina ndihet më fort ndikimi i sllavishtes, Çabej i jep një përgjigje të qëndrueshme edhe për kohën e sotme. Ky ndikim është më i madh në “krahinat ku marrëdhëniet e shqiptarëve me sllavë kanë qenë më të gjata e më intensive, sidomos dialektet që kanë qenë e vazhdojnë të jenë edhe sot në kontakt me sllavishten. Këto janë sidomos disa krahina periferike, si Malësia e Shkodrës, Luma, Kosova, Dibra, ana e Korçës“. Këtij përcaktimi të saktë të përhapjes gjeografike të sllavizmave leksikore të shqipes mund t’i shtojmë Maqedoninë, Malin e Zi, Preshevën e Bujanovcin. “Relativisht më pak sllavizma, thotë Çabej, ka Labëria e Shqipëria e Mesme”.

“Në disa nga këto krahina periferike ndikimi i sllavishtes ka shkuar gjer në prekjen e sistemit fonetik e vise-vise edhe morfologjik të dialekteve të tyre.

1. Nga fonetika hyn këtu rënia e [h]-së nistore në disa anë të Kosovës, në Dibër e në Korçë me rrethe.” Në dialektologjinë shqiptare është e ditur se të folmet e Kosovës e ruajnë mirë [h]-në në të gjitha pozicionet e fjalës, ndërsa në të folmet e toskërishtes dhe në të folmet shqipe të Maqedonisë kjo glotale shqiptohet mjaft dobët ose nuk shqiptohet fare. Kjo dukuri duket qartë edhe tek emrat vetjakë, si: *Isen* (< Hysen), *Asan* (< Hasan), *Alit* (< Halit), *Raman* (< Rrahman), *Memet* (< Mehmet) etj. Mosshqiptimi i kësaj bashkëtingëlloreje është tipar fonetik edhe i maqedonishtes dialektore, ndërsa disa forma fjalësh pa [h] janë pranuar si normative në këtë gjuhë.

2. Në sistemin morfologjik për ndikim të sllavishtes prof. Çabej e merr zhdukjen e trajtës së lidhores dhe zëvendësimin e saj me atë të dëftores në të folmet e Kosovës dhe të Maqedonisë, në fraza si: *ai do të shkon* (për ai do të shkojë), *ai të vjen* (për ai të vijë).

Të folmet shqipe në Maqedoni përdorin dendur lidhoren e mjaft rrallë paskajoren (*do të shkoj dhe kam me shkue*). Në të vërtetë, në formën lidhore këtu në vend të /ë/-së përdoret /e/-ja ose pjesëza *të* + forma e mënyrës dëftore e kohës së tashme e vetës së tretë njëjës, si p.sh. (thuhet) *të shkoje* ose *të shkon*, *të punoje* ose *të punon*, *të mësoje* ose *të mëson* (< normative: të shkojë, të punojë, të mësojë) etj. Në maqedonishte lidhорja formohet me pjesëzën *ke* (qe = do) + folja në mënyrën dëftore: *jac ogam – jac ke ogam* (jas odam – jas qe odam) ‘unë shkoj – unë do të shkoj’, *ūuu oquuu – ūuu ke oquuu* (ti odish – ti qe odish) ‘ti shkon – ti do të shkosh’.

Pra, nuk përjashtohet mundësia e ndikimit të maqedonishtes në njësimin e formës së lidhores ma atë të dëftores në të folmet shqipe në Maqedoni, por kjo mund të jetë shkaktuar edhe nga rrafshimi i formave të lidhores me dëftoren nëpërmjet analogjisë.

3. Zëvendësimi i foljes ndihmëse *kam me jam* në gegërishten veriore, në *jam shkue* (< kam shkue), *jam ka:n* (< kam qenë) etj. nën ndikimin e serbishtes (*otisha sam, bio sam*) si dhe në disa të folme shqipe në Maqedoni nën ndikimin e maqedonishtes (*sum odel, sum bil*).

Prof. Çabej në bashkautorësi me të madhin Aleksandër Xhuvani na kanë lënë trashëgim një studim të mirëfilltë edhe për parashtesat e prapashtesat në gjuhën shqipe, në tërësinë e të cilave gjejmë edhe disa prapashtesa sllave që janë bërë prodhimtare në gjuhën shqipe. Të tilla trajtohen prapashtesat *-avec, -çinë, -ec, -en, -icë, -iç(ë), -injë, -ishtë, -nik, -vinë* etj.

Çabej heton gjurmë sllave edhe në toponiminë e Shqipërisë: “Për hir të plotësisë duhet thënë se qëndrimi i sllavëve në Shqipëri ka lënë gjurmë edhe në toponimi. Ai konstaton se “si në të tjera anë të Ballkanit, në Greqi, Traki, Maqedoni etj., edhe në Shqipëri ka një tok emra katundesh, malesh, fushash e luginash, lumenjsh etj. që janë të burimit sllav“. Është pranuar edhe nga studiues të tjerë se me burim sllav janë emrat *Zadrimë, Çermenikë, Dumbre, Zagorje, Berat, Mokër* etj.

Prof. Çabej ndikim sllav vëren edhe në folklorin shqiptar, sidomos në disa figura të besimit popullor. Burim sllav ka besimi i ngjalljes së të vdekurit, figurë që ka emra sllave, sipas krahinave vurrkollak (sllav. *вълкодлак* ‘ujk’) ose lugat. Edhe emri i dhampirit, reflekton sllavishten vampir. E gurrës sllave, - thotë Çabej, - është edhe lubia (një eufemizëm nga *ljubiti* ‘me dashtë’ si dhe buba e gogoli me të cilin trembin fëmijët.



Si problem për të zgjidhur në të ardhmen për etnografinë e folklorin shqiptar autori shtron “nëse bashkë me këta emra edhe besimi është i ardhur prej sllavësh, apo ka ekzistuar më parë besimi në vend, dhe figurat e vendit kanë marrë emrin e huaj”.

Huazimi gjuhësor nuk është i njëanshëm. Albanologu ynë i shquar bën fjalë jo vetëm për huazimet e shqipes nga gjuhët e tjera, por edhe për elementet e shqipes në gjuhët e tjera të Ballkanit: “Nuk ka dyshim se gjuha shqipe shumë më tepër ka marrë prej gjuhëve fqinje sesa u ka dhënë atyre, e kjo ka lidhje me gjithë zhvillimin historik e kulturor të popullit shqiptar. Megjithatë një histori e gjuhës shqipe do të dilte mjaft e njëanshme, po të këqyrej vetëm se ç’ka hyrë aty nga gjuhët e tjera. Për të pasur një ide më të plotë e më të drejtë të marrëdhënieve ndërgjuhësore, duhet shikuar edhe ana e përkundërt e këtij procesi huazimesh, të shihet pra edhe ajo pjesë që shqipja u ka dhënë gjuhëve fqinje”.

“Kur të vështrohen marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje në tërësinë e tyre, do të pranohet që roli dhënës i kësaj gjuhe ndaj atyre është çmuar disi nën shkallën reale që i përket, dhe që dijen këtu e presin detyra të reja në të ardhmen. Më anë tjetër, elementet e shqipes që kanë shkuar në gjuhët fqinje, janë me rëndësi edhe për vetë historinë e kësaj gjuhe, për arsye se ato kanë ruajtur në ato idioma shpeshherë trajta më të vjetra, të cilat në gjuhën vetë që i dha, në shqipen, humbën me kohë dhe u zëvendësuan me të vjetra.”

“Bazat historike e kulturore për një të tillë ndikim nga ana e shqipes nuk mungojnë. Shqiptarët kanë ruajtur kulturën e vjetër të Ballkanit më mirë nga çdo tjetër popull i kësaj zone... Nga ky origjinalitet i disa anëve të jetës shqiptare kuptohet mirëfilli pse disa nga elementet e kësaj kanë depërtuar te popujt fqinj. Ndër këto ka elemente si të kulturës materiale si të jetës shpirtërore... Nga sfera sociale le të përmendim që fjala *besë* ka hyrë pothuajse në gjithë gjuhët ballkanike, duke përfshirë dhe turqishten.”

Ndikimi i shqipes, - shkruan Çabej, - u ka shtrirë edhe mbi gjuhët sllave, po gjer më sot mungon një studim përmbledhës mbi këtë temë. Me rastin e 100-vjetorit të lindjes, prof. Çabejn mund ta informojmë se hulumtimet e marrëdhënieve gjuhësore të shqipes me sllavishten jugore dita ditës po zgjerohen dhe po thellohen, bashkë me studimet albanologjike në përgjithësi dhe tani më janë arritur rezultate të lakmueshme. Dobiprurëse në këtë fushë janë studimet e akademik

Olivera Jashar - Nastevës, Rexhep Ismajlit, Idriz Ajetit, Xhelal Yllit, Anila Omarit, Bahri Becit, Qemal Muratit, Remzi Nesimit, Agim Poloskës etj.

Xhelal Ylli, bie fjala, në monografinë “Elementet sllave të gjuhës shqipe, pjesa e parë, huazimet leksikore sllave”, duke u mbështetur në studimet e deritashme dhe në bazë të vjeljes së materialit leksikor në territorin e Shqipërisë dhe analizës etimologjike të tyre, nxjerr një inventar absolut (që përfshin tërësinë e huazimeve leksikore sllave në gjuhën shqipe) prej 1000 sllavizmash dhe një inventar relativ (fjalët sllave në një areal të caktuar) prej më së shumti 430 sllavizma. Nga ky hulumtim rezulton se “zonat me inventar relativ më të madh i përkasin kryesisht Shqipërisë Juglindore e asaj Veriore, ndërsa inventari relativ më i ulët, 180-200 sllavizma, gjenden në Shqipërinë Qendrore”.

Përcaktimi i inventarit absolut dhe relativ i huazimeve sllave në të folmet shqipe të Maqedonisë, Malit të Zi, Preshevës e Bujanovcit si dhe në të folmet e Kosovës, ku kontaktet shqiptaro-sllave kanë qenë dhe ende janë më intensive është një punë e dobishme që duhet të bëhet në të ardhmen.

Ka shumë të drejtë prof. Çabej që thotë se “në elementet që kanë marrë gjuhët sllave prej shqipes duan dalluar dy shtresa. Njëra, më e lashtë dhe gjeografikisht më e përhapur, përfshin disa fjalë, që përveç se në gjuhët sllave të Ballkanit kanë shkuar dhe në rumanishten e me anë të kësaj gjuhe edhe në disa vise të Evropës lindore jashtë Ballkanit.

Tjetra shtresë është më e re, dhe gjeografikisht më e kufizuar. Përfshin fjalët shqipe që kanë hyrë në serbokroatishten e bullgarishten (si dhe maqedonishten, shënimi ynë), sidomos në ato dialekte të këtyre gjuhëve që gjenden afër truallit të shqipes, pra më fort në Mal të Zi, Serbi e Maqedoni. “Ai sjell një numër të madh albanizmash, si *bajgë*, *balgë*; *baltë*, *gardh*, *shyt*, *shut*; *vatër*, *votër*; *katund*, *kopil*, *barzast* prej i bardhë, *ugiç* prej oqiç, *çeno* prej qen, *mazga* < mushkë, *utina* < hut, *karpa* < karpë, shkëmb; *bersi*, *birsa* prej bërsi, *çupa* prej çupë, *dashko* prej dash, *zhallo* < zallë; *brina* ‘vend thikë, brinjë; breg, buzë, zgrip’ si edhe emër mali në Mal të Zi *Brina*’ nga shqipja brinjë; *bunja*, *bun* ‘kasolle primitive, shtëpizë e ndërtuar me gur prej foljes së shqipes *buj* ‘kaloj natën diku për të fjetur’ *oluk*, *uluk* prej shqipes *lug-u* në turqishten dhe nga kjo pastaj në gjuhët ballkanike me formën turke *uluk* etj.

Çabej formësoi qartë teorinë albanistike. Kësisoj, ai gjuhësinë shqiptare e vuri në hullinë e arritjeve gjuhësore evropiane të kohës.

Metoda bashkëkohore e kërkimit që gërshetuar me gjenialitetin e tij. Ai e quan gjuhësinë një shkencë ekzakte, nuk jep mendime pa analiza të hollësishme. Edhe kur është pothuajse i sigurt ai thotë që unë kam këtë hipotezë, po duhen bërë studime të mëtejshme.

Albanologu ynë kishte një formim klasik të shëndoshë, njëjtte me themel klasikët e mëdhenj që nga antikiteti. Punoi pa u lodhur për shqipen në të gjitha fushat, edhe për shqipen letrare. Pjesëmarrja e tij ndër vite në diskutimet për drejtshkrimin ka ndihmuar në shumë raste për të bërë zgjedhjet e duhura.

Çabej ka edhe vepra që nuk janë botuar deri më sot, si p.sh. teza e doktoratës e vitit 1933, një studim për arbëreshët e Italisë, përkthyer nga gjermanishtja si dhe një numër punimesh të shpërndara nëpër periodikët e kohës. Botimi i plotë i veprave të Çabejt është një nevojë e ngutshme jo vetëm për t'i bërë nder albanistit më të madh, por edhe nga shkak se studimet e tij janë me vlerë themelore për kulturën shqiptare.

Profesor Çabej i dha një shtysë të fuqishme studimeve albanologjike, duke përcaktuar përfundimisht vendin që zë gjuha e lashtë shqipe në familjen indoevropiane. Në këtë drejtim, vepra e tij përbën një vazhdim të punës së Gustav Meyer-it, Norbert Jokl-it dhe shumë albanologëve të tjerë. Rezultatet shkencore të tij përfaqësojnë vlera referuese ndër shumë vepra të rëndësishme të albanologjisë dhe të gjuhësisë së krahasuar.

Vepra e Çabejt është nga ato që koha nuk ua bjerr, por ua shton vlerat. Duke lexuar shkrimet e këtij albanologu të madh, jo vetëm që njihemi me të vërtetat shkencore për shqipen dhe shqiptarët, por ato do të na shërbejnë edhe si udhërrëfytes për punën tonë dhe të gjeneratave që do të vijnë.

### **Literatura:**

Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976.

Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore IV*, Prishtinë, 1987.

A. Xhuvani – E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Dr. Eqrem Çabej, Studime gjuhësore III, Prishtinë, 1976.

Olivera Jashar – Nasteva, *Fjalë shqipe në gjuhët e fshehta maqedonase*, Gjuha maqedonase, viti III, nr. 3, 4, 5-6, Shkup, 1953. *Ndikimi i maqedonishtes në të folmet shqipe dhe turke në Maqedoni*, Gjuha

- maqedonase, viti VIII, libri. 2, Shkup, 1957. *Kontaktet e të folmeve maqedonase me të folmet shqipe*, GJA nr. 19, Prishtinë, 1989. *Shfaqja e diglosisë dhe bilinguizmit në RS të Maqedonisë*, Gjuha shqipe, nr. 3, Prishtinë, 1990. *Kontaktet gjuhësore në hapësirat ballkanike*, Shkup, 1998.
- Rexhep Ismajli, *Disa fjalë shqipe në maqedonishte*, GJA nr. 1, Prishtinë, 1972.
- Idriz Ajeti, *Studime leksikore shqiptare-sllave*, GJA, nr. 2, Prishtinë, 1968. *Marrëdhëniet gjuhësore sllavo-shqiptare, III*, Prishtinë, 1985.
- Xhelal Ylli, *Rreth inventarit absolut dhe relativ të huazimeve leksikore sllave në gjuhën shqipe*, Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë 16-31 gusht 1995, Eurorilindja, Tiranë, 1995, f. 183-188.
- Bahri Beci, *Marrëdhëniet e hershme shqiptaro-sllave në dritën e të dhënave të dialektologjisë sonë historike*, Shqiptarët e Maqedonisë, Shkup, 1994, f. 39 -50.
- Qemal Murati, *Huazimet maqedonase në gjuhën shqipe*, Jehona 2, Shkup, 1985. *Huazimet shqipe në maqedonishten*, Gjurmime albanologjike (SShF) 14-1984, Prishtinë, 1985.
- Elementet e shqipes në gjuhët sllave jugore*, Prishtinë, 1990.
- Remzi Nesimi, *Disa elemente shqipe në të folmet e maqedonishtes përëndimore*, Gjuha shqipe, nr. 2, Prishtinë, 1986.
- Agim Poloska, *Interferenca leksikore e të folmes shqipe dhe maqedonase të Prespës* (punim magjistrature), Shkup, 1988. *Interferenca leksikore e shqipes dhe maqedonishtes dialektore* (disertacion doktorati), Shkup, 1996.
- Christian Gut, *Kontakte linguistike midis shqipes dhe maqedonishtes*, GJA, III, Prishtinë, 1975.
- Safet Hoxha, *Elemente leksikore të shqipes në disa të folme të maqedonishtes*, BShUT, nr. 1, Shkodër, 1984.
- Erik Hemp, *Marrëdhëniet gjuhësore maqedonase - shqipe*, Seminari VII i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës maqedonase, Ohër, 28-31. 08. 1974, Shkup, 1975.

Mojsi Lutfiu, *Ndikimi reciprok i gjuhëve sllave dhe i shqipes në të folunit e Dibrës*, Përparimi, nr. 1-2, Prishtinë, 1962.

Jollanda Mindak, *Paralele morfosintaksore ndërmjet maqedonishtes perëndimore dhe shqipes*, Literaturen zbor, nr. 5-6, Shkup, 1990.

Xhelal Ylli, *Rreth inventarit absolut dhe relativ të huazimeve leksikore sllave në gjuhën shqipe*, Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë 16-31 gusht 1995, Eurorilindja, Tiranë, 1995, f. 186-187.

### 3.2. STUDIMET E PROFESOR SELMAN RIZËS PËR FONETIKËN DHE DREJTSHKRIMIN E SHQIPES<sup>73</sup>

Profesor Selman Riza (1909-1988) është atdhetar, pedagog dhe gjuhëtar i njohur. Ai me të drejtë çmohet si njëri ndër intelektualët e shquar shqiptarë të shekullit XX. Siç dihet, profesor Selmani pati një jetë shumë të vështirë me plot vuajtje në burgje dhe internime, i penguar në veprimtarinë shkencore dhe botuese në kushte dhe rrethana të përjashtimit absurd. Por, edhe pse në kushtet e përndjekjes politike gjatë gjithë kohës, tërë jetën ia kushtoi çlirimit kombëtar, shkencës albanologjike dhe ngritjes së përgjithshme kulturore të kombit tonë. (Citojmë) *“Gjithmon’ e-jetës kam synue e do të synonj me kontribuue, makar modestisht, në mposhtjen e kompleksit t’inferioritetit të bashkëkombasvet ndaj Ballkanasvet tjerë.”*

Ai është një ndër gjuhëtarët e rrallë shqiptarë që ka studiuar tërë strukturën e gjuhës shqipe, në rrafshin historik dhe bashkëkohor. Vepra shkencore e prof. Selam Rizës shtrihet në shumë lëmi, siç janë gramatika, tekstologjia, terminologjia, kritika gjuhësore, historia e gjuhës, gjuhësia e përgjithshme, gjuha letrare etj. Me veprimtarinë patriotike, pedagogjike e shkencore gjuhëtari ynë ka dhënë ndihmesë të madhe për të ngritur gjithnjë e më lart piramidën e përbashkët kombëtare.

Shkrimet e prof. Rizës janë tejet përmbajtjesore. Për të zbërthyer mendimet e teksteve të tij duhet një përkushtim i madh mendor e profesional dhe një përqendrim i veçantë. Pikërisht për këtë arsye, në kumtesën tonë të shkurtër kemi parapëlqyer të citojmë thëniet e tij e jo t’i përflasim ato.

Profesor Selman Riza veprat e tija i shkruan në një gegërishte letrare dhe është ithtar i saj, ose siç e quan një *“gegënishte e re ose pangegënishte”* në bazën e së cilës do të qëndrojë e folmja e Shkodrës, e gërshetuar edhe me elemente gjuhësore të elbananishtes dhe të kosovarishtes.

Në *“Parëthânjen e përbashktë”* të *“Tri monografinave albanologjike”* profesor Riza thotë: *“Leximi i këtyre tri monografinave albanologjike do të jetë i vështirë për këta dy shkaqe. Për shkak*

<sup>73</sup> Artikulli i botuar në përmbledhjen e punimeve Konferenca Shkencore Ndërkombëtare *“Profesor Selman Riza dhe albanologjia”* – me rastin e 100-vjetorit të lindjes (1909-2009); Korçë, 4 dhjetor 2009, f. 53-59.

*të trajtimit, me një rigorizëm pak a shumë shkencor, të landëvet të tyne dhe për shkak të shqipes sime që është një gegënishte e ré: pan/ gegërishtja e themeluese prej meje. Në vënd që për të parështrve dhe për ligjë këtë pangegënishte, të shërbehesha prej shkodranishtes o prej së kështuquajtunës gjuhë së mesëme, jam shërbye shí prej përftesës sime. Jam sjellë kështu për të vù kombinatën t'ime linguistike në provën e yjarmit që është përdorja praktike. Shpresonj që këjo sjellje e ime po n'atë kohë guximtare dhe e ndershëme, do të më fitojë dashamirësinë e save ndër në janë studjantarë seriozë dhe lexues të durueshëm...”*

Profesor Riza dallon qartë togun semantik, si bashkim tingujsh që ka një kuptim të caktuar nga togu tonik, si bashkim tingujsh që shqiptohen me një theks të vetëm, pra tani që e quajmë fjalë fonetike. Ai dallon për mrekulli fjalët e theksuara nga fjalët e patheksuara, duke vënë në dukje se e njëjta fjalë mund të jetë herë e theksuar e herë e patheksuar, varësisht nga roli që ka në fjali. Po kështu, autori ynë qartë dallon se zanoret dhe fjalët e theksuara kanë prirje të ruhen të plota, ndërsa të patheksuarat pësojnë një dobësim tingullor, sidomos në gegërishten. (citojmë) *“Së këndejmi vjen vetvetiu që edhe alterasjonet fonetikë do të jenë shumë më të shenjueshëm në gegërishte se sa në toskërishte. Ky ndryshim kryedialektuer është madje kaq me rëndësi sa që mund të thuhet se ndërmjet dy kryedialektevet të shqipes, në fonetikë, kemi soll dy të vetëm ndryshime kryesorë: rhotacizmen e toskënishtes me pasojën e çndërhundësimit të vetëtingujvet edhe të stërfuqishëmin theksim të gegënishtes me pasojën, përgjithësisht, të dobësimit tingullor e, veçanërisht, të zhdukjes, ose gati, të ë-s.”* Me një saktësi shkencore profesor Selman Riza shpjegon bindshëm edhe trajtat e plota të theksuara të përemrave vetorë dhe dëftorë krahas trajtave të shkurtra të patheksuara të tyre.

*“Shqipja e këtyre tri monografinave përmban zgjidhjen e problemit t'ânë gjuhësuer, zgjidhje e cila ví(l)en aktualisht vetëm për Gegëninë, kurse virtualisht dhe për Shqipninë. Në praktikë dështimi i së kështuquejtunës gjuhë së mesëme për t'u bënë letrarishtja e Shqipnisë dhe në teori konsideratat linguistike, folkloristike dhe letrare përmbi kryedialektin jugor të shqipes, më dhanë shkas që këtë problem ta zgjidhi aktualisht vetëm për Gegëninë. Toskët, pos atyne t'Italisë, përdorin, që prej më se një gjysmë qindvjetshi e tëhu, një të bashktë gjuhë shkrimi kurse për Gegët e bashkta gjuhë shkrimi është ende sot e kësaj dite fort larg së qenuri një punë e kryene, Gegët, po thom, deri*



*sot, kanë folë vetëm për një problem gjuhësuer Shqiptar dhe jo për një problem gjuhësuer Gegë“.*

Konstatimi se gegërishtja është më e larmishme sesa toskërishtja e ka frymëzuar prof. Rizën për të sajuar një gegërishte letrare. Edhe në krijimin e gegërishtes letrare profesor Riza dëshmon se ka një përgatitje të lartë teorike. Ai ka një mendim të drejtë se jo vetëm ndërmjet dy dialekteve të shqipes, si variante territoriale të një gjuhe të përbashkët, por edhe ndërmjet gjuhëve indoevropiane ka shumë brumë gjuhësor të përbashkët. Duhet bërë përzgjedhja e materialit gjuhësor me një arsytim të rreptë shkencor, duke pranuar vetëm gjërat që sjellin diçka të re për nga vlera e tyre shenjuese ose gramatikore.

Në bazën e pangegërishtes letrare ai përfshin elementet e përbashkëta gjuhësore të mbarë shqipes (gegësishtes e toskërishtes), disa elemente të njësuara gege dhe në disa raste nga ndonjë e folme e veçantë gege. (Citojmë) “*Ndëngegënishtja jugore do të japë bashkëtingujt (sot: bashkëtingëlloret) qiellzorë q dhe gj; dhe vetëtingullin (sot: zanoren) e gjysmëzâshëm ê (sot ë); veriperëndimorja, vetëtingullin e ndërhumshëm: â, të cilin dy tjerët kanë tejtrajtue në: ô, si dhe imperfektin më: -nja; verilindorja do të japë dezinencën: -n të participavet t’adjektivuen etj. etj.*” Profesor Selmani për gegërishten letrare propozon edhe dy inovacione të guximshme: emrat ambigjenë të ruajnë gjininë e njëjësit edhe në shumës (p.sh. ai shkruan “inovacion të guximshëm”) dhe të mos përlligjet rimarrja e kundrinës.

Periodha prej vitit 1956-1967 është periodha më frytëdhënëse në veprimtarinë shkencore të Prof. Selman Rizës. Në këtë periodhë të shkurtër rreth 11-të vjeçare dha shumë për shkencën shqiptare.

Veprat e veta prof. Selman Riza i shkroi në kohën kur ende mungonte një drejtshkrim i njësuar i shqipes dhe është e arsyeshme që edhe ai të kishte pikëpamjet e veta. Gjithsesi vlen të vëmë në pah një gjë: në vitet e vona të jetës së vet, Selman Riza, në një numër të vogël faqesh të shkrimeve të tij ka bërë ndryshime, duke pranuar për një pjesë të mirë zgjidhjet e Kongresit të Drejtshkrimit, me një përjashtim, i cili përbën një qëndrim shkencor konsekuent të tij: mospranimin e ambigjinitë, pra ruajtjen e gjinisë mashkullore edhe në shumës, tek emrat me shumës në-e (*male të lartë, mendime të drejtë*).

Ai ka qenë i mendimit se me bashkëveprimin e mëpastajmë të gegërishtes letrare dhe të toskërishtes letrare, me përzgjedhjen e elementeve të përbashkëta në bazë të kritereve të shëndosha shkencore



të krijohej shqipja standarde: “për të sendërtuar një gjuhë të bashktë shkrimi për mbarë Gegëninë” dhe ku është e mundur të njëjtësimi e të gjegjësimi të drejtpërdrejtshëm me toskënishten letrare“.

*“Porse mue m’është mbushë mendja se edhe me Shkodrën kryeqytet, shkodranishtja, prap se prap, nuk do të kishte mundë me u bâ letrarishtja e Shqipnisë. Po për ç’farë shkaku vallë? Për shkakun madhuer t’ekzistencës së një toskënishtje popullore, folkloristike dhe letrare, e cila gjindet së gjithash kaq larg prej shkodranes... letrarishten e njëjtë për krejt Shqipninë do ta bâjë të mundëshme vetëm e vetëm një gegërishte e afëruene prej toskërishtes.“*

*“Me caktue në praktikë drejtëshkrimin e shqipes është një punë edhe me zgjidhë në teori problemin gjuhësuer të Shqipnisë... nuk është një punë tjetër. Madjë i pari hap i madh drejtë së bashkës gjuhë shkrimi qe aj që gjuhëtarët dhe shkrimtarët e Shqipnisë bënë në vitin 1908 në qytetin e Monastirit tue themelue të sodshëmen abecë të shqipes. Këtë vepër kushtuar drejtshkrimin, autori e shkruan jo në shkodranishte e as në elbasanishte, por në një gjuhë shumë të përafërt me shqipen e sotme letrare”.*

Në monografinë për drejtshkrimin, autori dallon qartë tejtshkrimin (transkriptimin) nga drejtshkrimi (ortografia). (citojmë) *“Me tejtshkrue të folunët do të thotë me tejtmbartë atë tingullisht prej goje në kartë. Në fillet e saj tejtshkrimi dhe drejtshqiptimi ishin një, ndërsa më vonë u dalluan, sipas autorit, për tri shkaqe:*

*“1. tue grupue tingujt jo simbas veshit por simbas mëndjes, jo simbas akustikës por simbas logjikës;*

*2. tue mos shenjue gjithëmonë ndryshimet tingullorë që mund të pësojë një fjalë ... më një fjalë;*

*3. tue u shtëmângë vetëdijtunisht e qëllimisht prej shqiptimit populluer.”*

Problemet e shkrimit të fjalëve njësh, ndaras ose me vizë në mes sipas prof. Rizës lindin në rend të parë nga *“grupzimi i tingujvet jo simbas veshit por simbas mendjes – për të cilët tejtshkrimi i drejtëpërdrejtshëm dhe drejtëshkrimi tingulluer janë në ndryshim e madjë në kundërshtim njëni me tjetrin...”*

Gjuhëtari ynë i shquar që atëherë na bën me dije se është e pamundur që të shënohen as edhe me drejtshkrimin që për bazë ka parimin fonetik të gjitha nuancat tingullore të të folurit. Pra, shkronjat përfaqësojnë fonemat e gjuhës e jo tingujt e panumërt të ligjërimin.

(Citojmë) *“Edhe me të vërtetë, edhe drejtëshkrimi më tingulluer, edhe alfabeti më i diferencuen i botës nuk mund të shenjojë çdo ferk të hollë të shqiptimit, nuk mund të pasqyrojë me besniki absolute gjendjen tingullore të një gjuhe së gjallë. Me besnikinë absolute, me të cilën, për shëmbëll, regjistrohet zâni i këngëtarit prej fonografit. Sidomos për sa përket vetëtingujvet (tani: zanoreve), do vû ré se çdo shkronjë përfytyron vetëm typin themeluer të çdo vetëtingulli. Në shqipe, e-ja, fjala vjen, mund të jetë e thekësue e e pathekësue, gojore e hundore, e shkurtë, e mesëme e gjatë; e mbylltë e e haptë...”* Pikërisht për këtë, disa popuj, si grekët e lashtë, zanoret e shkurtra i shkruanin me shkronja të posaçme, ndërsa të gjatat me shkronja të veçanta. Kjo u qëndroi provave të mëvonshme të fonetikës tradicionale dhe eksperimentale si dhe të fonologjisë.

Përveç parimit fonetik që është mbizotërues në shkrimin e shqipes, prof. Selman Riza shpjegon bindshëm edhe zbatimin e parimit morfologjik. (Citojmë) *“Drejtëshkrimi tingulluer që po aj tingull të shenjohe gjithëmonë e gjithëkund nepërmjet po t’atij shenji, analiza logjike kërkon që po ajo fjalë të përfytyrohet kurdo e kudo nepërmjet po t’atij përfytyrimi.”*

Si njohës i 12 gjuhëve, profesor Riza flet edhe për dallimin ndërmjet gjuhës popullore dhe gjuhës letrare, për mospërputhjen ndërmjet tejtshkrimit të gjuhës popullore dhe drejtshkrimit të letrarishtes së dy gjuhëve klasike: greqishtes e latinishtes si dhe problemet që kanë anglishtja e frëngjishtja për shkak të drejtshkrimit etimologjik a historik.

Në çështjen e drejtshkrimit të shqipes prof. Selman Riza pasi përligj pohimin se drejtshkrimi i shqipes është fonetik në toskërishten letrare e do të jetë edhe në pangegërishten e tij, shqyrton tri çështje kryesore të drejtshkrimit në të dy dialektet (citojmë):

*“I. - hiati dhe mjetet e ndryshëm për menjanimin e tij;*

*II. – ndërhumdësija, toniciteti dhe gjatësija e vetëtingujvet dhe shenjimi i tyne me anë të thekësavet të ndryshëm;*

*II. – vetëtingulli: ë.”*

Toskërishtja letrare për Rizën ka një drejtshkrim tipik tingullor. Këtë e mundësuan disa rrethana të volitshme: se të folmet toske janë mjaft unike, se Dangëllia pati fatin të lind dy shkrimtarët e njohur Naim e Sami Frashëri, që shkruan vepra me vlerë me zbatimin e drejtshkrimit tingullor, me një fjalor dhe stil popullor. (Citojmë) *“...në Toskëni leximi i shijuen i një vepre letrare është një punë që bâhet dhe prej një filloristi, që*

*mos thom edhe prej një ish-analfabeti, Shka nuk mund të thuhet kurrqysh, për shëmbëll, për shumicën e madhe të prodhimevet të Shkodranëve, tek të cilët klasicizma, që të most hom rhetoricizma, greko-latine e sidomos latine ka ushtruar një të rrastë influence antikvizuese e aristokratizuese jo vetëm në poezi por edhe në prozë.”*

Gjuhëtari ynë është i mendimit se edhe gegërishtja letrare duhet të mbështetet në një drejtshkrim tingullor, por për të zbatuar këtë parim dalin shumë vështirësi, sidomos në shkrimin e dytingujshave (togjeve të zanoreve) *ue, ye, ie* si *uë, yë, ië* apo si të monoftonguar në zanore të gjata *ū, ŷ, ī*. Problem të veçantë do të paraqiste shkrimi i ë-së, meqë në gegërishte nuk përdoret në rrokje të theksuar, ndërsa në rrokje të patheksuar ka denduri të rrallë përdorimi. Rënia e saj në pozitë fundore ka shkaktuar zgjatje kompensatore të zanores paraprirëse, prandaj në gegërishte ajo do të shënonte se zanorja paraprake nuk është e shkurtër, por e gjatë ose së paku e mesme.

Profesor Selman Riza studion edhe disa dukuri fonetike në shqipen, siç janë hiati dhe mjetet e ndryshme për mënjanimin e tij, epenteza, elizioni, krasisi (shkriçja), vetitë nyjetimore, akustike e funksionale të tingujve si dhe mënyra e shënimit grafik të tyre, për zanoren *ë* në shqipen, evoluimin e *ë*-së në toskërishten letrare etj. Për shpjegimin e këtyre dukurive autori sjell shumë shembuj nga të folmet gege e toske si dhe nga shkrimet shqipe. Këto dukuri janë shpjeguar aq bindshëm saqë edhe tani i qëndrojnë kohës.

Prof. Selma Riza propozon të shënohet theksi te çiftet e fjalëve të tipit *drejtóri – drejtori* për të mënjanuar dykuptimësinë. Lidhur me zanoren *ë* që atëherë prof. Riza me të drejtë ka konstatuar se: *“jo vetëm si shkronjë për shkak të dypikëshit por edhe si tingull për shkak të një ndëgjueshmenije që ndërron gjatë një shkalle së gjânë, vetëtingulli ë përmbân problemin kryesorë të çështjes gjuhësore të Shqipnisë.”*

Fonema /ë/ në gjuhën shqipe ka shumë larmi timbresh, në rrokje të theksuar nuk e gjejmë në gegërishte (sepse kemi /â/ ose /ê/ hundore), ndërsa në pozicion të patheksuar ka përdorim shumë të dendur në toskërishten, ndërsa përdorim të rrallë në gegërishten: në të folmet e Veriut nuk e gjejmë as në pozitë nistore e as në pozitë fundore.

Gjuhëtari ynë për shkrimin e /ë/-së jep edhe disa zgjidhje përgjithësuese, duke u përpjekur të mbajë një baraspeshë ndërmjet drejtshkrimit etimologjik a historik dhe tejtshkrimit të drejtpërdrejtë të shqiptimit popullor. *“Po u pranua këjo zgjidhje e ime e problemit*

*kryesuer të drejtëshkrimit të shqipes, atëherë n'orthografinë e shqipes do të kemë prû siguri e njëjtësi me një pikë rreth së cilës, deri sod, sikurse pamë pak prandej, kanë mbretnue dyshimi pothuejse në të gjithë shkrintarët e gjuhëtarët t'anë dhe ndryshimi prej njënit te tjetri e madje prej një faqe në tjetrën po t'atij shkrintari o gjuhëtari t'anë."*

Në përfundimin e studimit për drejtshkrimin e shqipes vetë prof. Selmani pohon se (citojmë): *"Nuk po më rrihet pa pohue qysh tash se mue nuk po don me mu dukë e mundshëme as madje e dëshërueshëme që orthografija e gjuhës sonë të fiksohet me përpikërinë pedante, me rreptësinë rigoriste..."*

Riza është i vetëdijshtëm se për gjithë shqiptarët duhet të kemi një gjuhë letrare të njësuar. Por, si do të arrihet kjo?

1. ... *tue u njëjtësue: do të njëjtësojmë gegërishten letrare me toskërishten letrare tue mënjanue evolutat partikulariste (të pjesshme);*

2. ... *tue u gjegjësue, pra duke gjetur format e barasvlershme morfologjike. Duke parë dualizmin dialektor dhe njëjtësinë e shqipes: (citojmë) "ndryshimet ndërmjet toskërishtes letrare dhe pangegënishtes letrare do të jenë të një natyre vetëm e vetëm fonetike".* Me mënyrën gjenetike, historike - ,thotë autori, - themelohet bindja e njëjtësisë së shqipes. Me mënyrën përshkruese, përkatësisht numëruese stërmadhohet përshtypja e dualizmës dialektale. (citojmë) *"Në konkluzion mund të thuhet prâ se ndërmjet toskërishtes letrare dhe pangegënishtes të sendërgjuene prej meje nuk do të ketë ndonjë ndryshim të një natyre morfologjike o syntaktike".*

*"Bashkëpunimi i ndëngegënishtevet do të siguronte mundësinë të mëdha për të sajue një gegërishte letrare diku krejt të njëjtë dhe diku drejtë për së drejti të gjegjshme me toskërishten letrare"*

*"Toskënishtja letrare ka të drejta të fituese, të cilat mund të nderohen më një masë të gjânë në saje të rrethanës që gegërishtja letrare është ende e papërcaktuene përfundimtarisht; rrethanë, këjo, prej së cilës duhet me u shërbye tue trajtue një gegërishte letrare që të jetë gati gati pasqyrimi besnik i toskërishtes letrare."*

Këtë paraqitje tonë të shkurtër do ta përmbyllim me një poezi kushtuar të pavdekshmit Selman Rizës:

Prof. Selman Riza (1909-1988)

"Dardani e vjetër  
Kosovë e Re!

Ke qen' shqiptare  
Shqiptare je.  
Dimën e verë  
Sa t'jetë jeta  
Ka me përshëndet  
Me "Tungjajeta" ...  
- Prof. Selman Riza.

### **Bibliografia**

- Riza, Selman, *Vepra 1*, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Drejtëshkrimi në vetëveti*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996
- Riza, Selman, *Parëthânje e përbashktë*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Dialekti letrar i Shkodrës*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman,, *Parëthânje*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Drejtëshkrimi në vetëveti*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Drejtëshkrimi i shqipes*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Vetëtingulli ë në shqipe*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Meritat e kësaj zgjidhjeje së problemit kryesuer të drejtëshkrimit të shqipes*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Konkluzjon*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.
- Riza, Selman, *Introduktë*, Vepra 1, AShAK, Prishtinë, 1996.

### 3.3. NDIHMESA E PROF. SHABAN DEMIRAJT PËR BALLKANOLOGJINË<sup>74</sup>

*Djersa e mendjes është më e dobishmja.*

Kam nderin dhe kënaqësinë të shkruaj pak fjalë për njërin nga albanologët më të shquar të kohës, përkatësisht për prof. Shaban Demirajn. Veprimtaria e tij është shumëplanëshe: pedagog, studiues i shqipes, hartues tekstesh mësimore, ballkanolog, përkthyes, akademik, laureat i disa çmimeve kombëtare.

Akademiku Shaban Demiraj është një nga figurat më të shquara të albanologjisë, të shkencës e të kulturës shqiptare në përgjithësi. Ai ka botuar shumë studime, monografi dhe artikuj për gjuhën shqipe, për historinë dhe gramatikën e saj, për figura të shquara të kulturës shqiptare, për gjuhët ballkanike si dhe gjuhët e tjera indoevropiane, me theks të veçantë mbi marrëdhëniet e tyre me gjuhën shqipe.

Ky kolos i madh i dijes albanologjike, përveç punës së frytshme pedagogjike në studimet themelore e pasuniversitare, veprimtarisë hulumtuese e organizative në fakultete, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, pjesëmarrjeve në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, na la trashëgim shumë studime me vlera kapitale për gjuhën e kombin: 19 vepra shkencore në shqip e në gjuhë të huaja (11 pa ndonjë bashkëpunim me të tjerë dhe 8 në bashkautorësi); 10 tekste mësimore për shkollën e lartë dhe 9 gramatika e libra të gjuhës shqipe për shkolla të mesme (4 pa ndonjë bashkëpunim me të tjerë dhe 5 në bashkautorësi); 7 transkribime dhe përshtatje veprash letrare, 3 vepra të përkthyer nga anglishtja në shqip, 255 artikuj a kumtesa etj.<sup>75</sup>

Shkrimet e profesor Shabanit shquhen për akribi shkencore, maturi e mjeshtëri të rrallë. Përveç në shqip, shumë nga veprat e prof. Shabanit janë botuar edhe në disa gjuhë të botës, si në anglisht, gjermanisht, italisht, maqedonisht. Veç kësaj, ka marrë pjesë në shumë kongrese, simpoziume e takime ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, akademik Demiraj zë vend qendror në shkencat albanologjike, me prurje

<sup>74</sup> Kumtesë e lexuar në Konferencën shkencore me temë boshte “Shaban Demiraj - figurë e shquar e shkencave albanologjike dhe e arsimit kombëtar”, Akademia Shqiptare e Shkencave dhe e Arteve, Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare, Tiranë, 24 janar 2015. Punimi u botua edhe në Skupi, vëllimi 8, ITShKSh, Shkup, 2015, f. 153-158.

<sup>75</sup> *Bibliografia e botimeve të profesor Shaban Demirajt*, AShAK, Studime 21- 2014, f. 400-418 (version i plotësuar nga Bardhyl Demiraj).

të vlefshme në studimet ballkanologjike e në gjuhësinë krahasuese indoevropiane.

Profesor Demiraj i dha një shtysë të fuqishme studimeve albanologjike. Vepra e tij përbën një vazhdim të punës së Gustav Meyer-it, Norbert Jokl-it, Eqrem Çabejt, Selman Rizës dhe shumë albanologëve të tjerë. Rezultatet shkencore të këtij gjuhëtari të njohur shqiptar, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë gjatë viteve 1993-1997, përfaqësojnë vlera referuese ndër shumë vepra të rëndësishme të albanologjisë, të gjuhësisë ballkanike e evropiane.

Në një intervistë akademik Shaban Demiraj tha: *"Parimi im është: "puno dhe hesht", i dua heronjtë e heshtur, prej të cilëve ke ç'të marrësh e të përfitosh pa qenë të njohur në politikë apo gjetkë"*. "Gramatika historike", e botuar e përmbledhur edhe në gjermanisht nga Akademia e Austrisë, "Fonologjia historike e shqipes", "Prejardhja e shqiptarëve", "Gjuha shqipe dhe historia e saj", botuar edhe nga Universiteti i Kalabrisë, "Gjuhësi ballkanike" botuar edhe në maqedonisht e shumë e shumë vepra me vlerë të qëndrueshme profesorin e nderuar, bashkë me prof. Eqrem Çabejn, e vënë në pedestalin më të lartë të shkencëtarëve shqiptarë e që përbëjnë çiftin më të spikatur me prurje albanologjike.

Akademik Demiraj ndihmesë të madhe ka dhënë edhe në fushën e ballkanologjisë:

a) së pari, me studimet e thelluara për gjuhën shqipe, që mund t'u shërbejnë si mbështetje e sigurt referuese jo vetëm tani, por edhe në të ardhmen ballkanologëve e indoevropianistëve për të krahasuar gjuhët e tjera të lidhjes gjuhësore ballkanike me shqipen; dhe

b) së dyti, me hartimin e veprës sintetizuese për gjuhët ballkanike: *Gjuhësi ballkanike*, Logos-A, Shkup, 1994, 276 faqe (me përmbledhje në anglisht) dhe *Balkanska lingvistika*, Logos-A, Shkup, 1994, 294 faqe (me përmbledhje në anglisht).<sup>76</sup>

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqiptare e Fakultetit të Filologjisë "Bllazhe Koneski", që bën pjesë në kuadrin e Universitetit Publik "Shën Cirili e Metodi" në Shkup (Maqedoni) pati nderin dhe kënaqësinë të përkujdesej për botimin në shqip e në maqedonisht të veprës kapitale "Gjuhësi ballkanike". Në parathënien e librit, të titulluar "Dy fjalë", akademik Demiraj thotë:

*"Duke pasur parasysh zhvillimin e studimeve krahasuese mbi gjuhët ballkanike sidomos pas botimit të veprës së Kristian Sandfeldit*

<sup>76</sup> Шабан Демирај, *Балканска лингвистика*, Логос-А, Скопје, 1994.




*më 1930, m'u duk e arsyeshme të përgatis për lexuesin shqiptar një vepër sintetizuese mbi gjuhësinë ballkanike, ku pasqyrohen edhe ndihmesat e gjuhëtarëve të ndryshëm në këtë fushë studimesh. Hartimi i një vepre të tillë ishte i nevojshëm edhe për të vënë në dukje në mënyrë më të plotë se deri sot të dhënat e shqipes, që dëshmojnë për tiparet ballkanike të saj. Por hartimi i kësaj vepre paraqiste edhe vështirësi të shumta, që kishin të bënin jo vetëm me përzgjedhjen e lëndës, por edhe më shumë me shpjegimin e çështjeve në mënyrë sa më të argumentuar. Uroj që kjo vepër të ndihmojë sadopak për zhvillimin e mëtejshëm të studimeve krahasuese në fushën e ballkanistikës.*

*Me këtë rast, e quaj për detyrë të falënderoj nga zemra Dr. Remzi Nesimin për interesimin e madh, që ka treguar për botimin e kësaj vepre, si edhe për korrektimin e bocave të saj. Një falënderim të përzemërt u shpreh edhe recensuesve: Dr. Luan Starova, Dr. Jorgji Gjinari dhe Dr. Seit Mansaku”.*

Këtë vepër madhore për gjuhësinë ballkanike në maqedonisht e përktheu dr. Haki Ymeri, pedagog dhe leksikograf i njohur në hartimin e fjalorëve shqip-maqedonisht e anasjelltas.

Më 08. qershor 1995 në lokalet e Fakultetit të Filologjisë në Shkup, u bë përrurimi i kësaj vepre (botuar në shqip e në maqedonisht). Ne patëm rastin e kënaqësinë të takonim drejtpërdrejt prof. Shabanin. Të gjithë, pa dallim moshe e përkatësie etnike, nxitonim e donim të pozicionohemi sa më pranë për ta parë, përshëndetur, për ta firmosur (nënshkruar) librin, për të dëgjuar e mësuar diçka nga ky yll i shkencës shqiptare. Ai rrezatonte butësi, çiltërsi, qetësi, modesti, dashamirësi, optimizëm, kulturë, humanizëm, dituri, maturi e thellësi mendimi. Bota u bë imja kur prof. Demiraj me buzëqeshje firmosi librin që kisha siguruar atë ditë.

Përrurimi u bë në praninë e një numri të madh pedagogësh të fakultetit (shqiptarë, maqedonas e të tjerë), intelektualë e shkencëtarë të shumtë, studentë dhe dashamirës të tjerë të librit e të kulturës në përgjithësi. Në fillim fjalën e mori dekani i fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski”, prof. Atanas Vangellov, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i



uroi mirëseardhje akademikut Shaban Demiraj e më pas veprën që promovohet e vlerësoi lart. Fjalë miradije tha edhe prof. Haki Ymeri,



duke e cilësuar si vepër kapitale për gjuhësinë. Fjalë rasti mbajti edhe prof. Petar Atanasov (rumunolog). Ai ndër të tjera tha se akademik Shaban Demiraj me këtë vepër ka bërë një punë kolosale për gjuhësinë ballkanike. Në fund fjala iu dha edhe akademik Shaban Demirajt, i cili pasi u falënderua për punën e respektin që kanë treguar ndaj tij e veprës tha se libri “Gjuhësi ballkanike” është rezultat i një pune shumëvjeçare. Edhe kësaj radhe, si gjithnjë me modesti, tha: *“nuk pretendoj se çdo gjë e kam zbërthyer përfundimisht. Më tepër këtë duhet kuptuar si një përpyetje për t’i shtruar çështjet më kryesore me të cilat preokupohet gjuhësia ballkanike, që pastaj gjuhëtarët të merren më hollësisht.”*


Edhe nga gjuhëtarët maqedonas “Gjuhësia ballkanike” e akademik Shaban Demirajt e përkthyer në maqedonisht është vlerësuar lart dhe sot e kësaj dite shërben si vepër referuese, si për qëndrimin e drejtë dhe shpjegimin shkencor të çështjeve, ashtu edhe për faktin se në dallim nga disa studiues të tjerë, autori pranon se maqedonishtja është gjuhë sllave më vete. Jo vetëm për këtë vepër, por edhe për veprimtarinë e pasur shkencore kolegët tanë u mahnitën kur panë një mal veprash të albanologut tonë, të ekspozuara në dollapët e bibliotekës së Katedrës dhe me një lakmi të paparë shprehën dëshirën të kishin edhe ata një studiues kaq të madh.

Hartimi i një vepre të tillë nga një gjuhëtar shqiptar me përgatitje të lartë shkencore, me njohjen 14 gjuhëve (ballkanike e joballkanike) ishte i nevojshëm jo vetëm për të plotësuar mungesën e një vepre sintetizuese objektive, pa paragjykime e pa ngjyrimë politike për gjuhët e popujt ballkanikë; por edhe për të çuar përpara studimet në këtë fushë, për të plotësuar ose për të saktësuar të dhënat e pakta që jepeshin nga disa studiues të huaj për shqipen dhe për shqiptarët.

Kjo vepër madhore shpreh pikëpamjet e një dijetari shqiptar për rolin e madh që ka pasur gjuha shqipe në krijimin e dukurive të përbashkëta në gjuhët ballkanike, rol i cili jorrallë i është mohuar shqipes në disa artikuj krahasues autorësh të huaj.

Akademiku ynë ka bërë përzgjedhjen e duhur të lëndës dhe në mënyrë të argumentuar i shpjegon çështjet. Ato janë bindëse, të qëndrueshme saqë vështirë se mund të mos pranohen. Libri plotëson e kapërcen studimet e derisotme për gjuhësinë ballkanike.

Studimi përmbledhës e për gjendjen e sotme shterues “Gjuhësi ballkanike” është ndarë në XII krerë. Në fillim jepet historiku i studimeve, duke veçuar ndihmesën e Kopitarit, Mikloshiçit, Vaigandit, Sandfeldit,



Selishçevit, rrethit gjuhësor të Pragës etj. Se çfarë temash të diskutueshme, me teza të ndryshme e shpeshherë kundërthënëse, të errëta, me shumë të panjohura e tejet të vështira për të dhënë arsyetime bindëse e argumente shkencore të qëndrueshme ka trajtuar prof. Demiraj në veprën “Gjuhësi ballkanike”, mund të shihet nga pasqyra e lëndës së kësaj vepre. Të tilla janë, si përpjekjet për shpjegimin e burimit të ballkanizmave: teza e ndikimit të greqishtes, të latinishtes, të substratit. Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi:

popujt dhe gjuhët që fliteshin në Gadishullin Ballkanik para dyndjes së fiseve indoevropiane; grekët e vjetër dhe gjuhët e tyre; fqinjët veriorë të grekëve – maqedonët dhe gjuha e tyre; fqinjët veriperëndimorë të grekëve – të ashtuquajturit epirotë dhe gjuha e tyre; ilirët – shtrirja e tyre tokësore; gjuhët e viseve lindore të Ballkanit – trakishtja, dakomizishtja dhe karakteri i tyre satem; gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik pas pushtimit romak.<sup>77</sup>

Pas vrojtimit të gjendjes së sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik (f. 49-70) dhe të dhënave të shumta për shqipen, greqishten e re, rumanishten, bullgarishten, maqedonishten e serbokroatishten, një kapitull i veçantë (kreu IV) i kushtohet bashkëpërkimeve ndërmjet gjuhëve ballkanike në fushën e fonetikës, duke shtjelluar gjerësisht theksin në gjuhët ballkanike, shfaqjen e zanores /ë/ në këto gjuhë si dhe dukurinë e rotacizmit në toskërishte krahasuar edhe me atë të rumanishtes. Në krerë të veçantë shtjellohen bashkëpërkimi i rasave gjinore e dhanore në gjuhët ballkanike, prapavendosja e nyjës shquese, format e kohës së ardhme, rimarrja e kundrinave, mënjanimi i paskajores, disa bashkëpërkime të tjera midis gjuhëve ballkanike, duke veçuar në kapitull më vete bashkëpërkimet midis shqipes dhe rumanishtes, për të vazhduar në kreun e fundit për bashkëpërkimet në fushën e fjalorit në gjuhët ballkanike.

Çfarëdo që do të përpiqemi të themi për të përshkruar çështjet

<sup>77</sup> Shaban Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Logos-A, Shkup, 1994, f. 6-13.

që shtjellon akademik Shaban Demiraj në këtë vepër do dilte e mangët, andaj kujtoj se pasqyra e lëndës është treguesi më i mirë i saj:

**Kreu I.** Hyrje. *Nga historiku i studimeve:* Ndhmesat e B. J. Kopitarit. Ndhmesat e Fr. Mikloshiçit. Ndhmesat e Balkan komission-it të Vjenës. Ndhmesat e G. Weigand-it. Ndhmesat e Kr. Sandfeldit. Ndhmesat e A. Selishçevit. Rrethi gjuhësor i Pragës. Kongreset e AIESEE-së. Përpjekjet për shpjegimin e burimit të ballkanizmave: teza e ndikimit të greqishtes, të latinishtes, të substratit. Si duhet vështruar problemi i burimit të ballkanizmave në gjuhët e ndryshme ballkanike? Parime dhe vërejtje të përgjithshme.

**Kreu II.** *Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik në lashtësi:* Popujt dhe gjuhët që fliteshin në Gadishullin Ballkanik para dyndjes së fiseve i.e. Gadishulli Ballkanik dhe gjuhët ballkanike. Grekët e vjetër dhe gjuha e tyre. Dokumentimi shkrimor dhe evolucioni i greqishtes. Ndarja dialektore e greqishtes së vjetër. Pozita e greqishtes në rrethin e gjuhëve i.e. Sistemi fonetik dhe struktura e saj gramatikore. Çështje që mbeten për t'u sqaruar. Fqinjët veriorë të grekëve - maqedonët dhe gjuha e tyre. Fqinjët veriperëndimorë të grekëve - të ashtuquajturit epirotë dhe gjuha e tyre. Ilirët - shtrirja e tyre tokësore. Gjuha e ilirëve - *kentum* apo *satem?* - dhe çështja e vazhdimësisë ilire-shqiptare. Gjuhët e viseve lindore të Ballkanit - trakishtja, dakomizishtja dhe karakteri i tyre *satem*. Gjendja gjuhësore e Gadishullit Ballkanik pas pushtimit romak.

**Kreu III.** *Gjendja e sotme gjuhësore në Gadishullin Ballkanik:* Gjuhët që fliten sot në Gadishullin Ballkanik. *Shqipja:* Ku flitet? Emërtimi gjuhë *e arbëneshe/ e arbëreshe* dhe *shqipe*. Burimi i gjuhës shqipe dhe dokumentimi i saj shkrimor. Shqipja gjuhë i.e. dhe veçoritë e saj kryesore. Ndarja dialektore e shqipes. Dukuritë ballkanike kryesore të saj. *Greqishtja e re:* Ku flitet? Emërtimet *elinë* dhe *grekë*. Greqishtja e shkruar. Sistemi fonetik dhe struktura gramatikore e saj. Dukuritë ballkanike kryesore të greqishtes. *Rumanishtja:* Ku flitet? Burimi dhe vendi i formimit të saj. Dokumentimi shkrimor. Sistemi fonetik dhe struktura gramatikore. Ndarja dialektore. Dukuritë ballkanike kryesore. *Gjuhët sllave të Ballkanit:* Evolucioni i tyre në truallin ballkanik. a) *Bullgarishtja:* Ku flitet? Emërtimi i saj. Dokumentimi shkrimor dhe periodizimi. Sistemi fonetik dhe struktura gramatikore. Ndarja dialektore dhe dukuritë ballkanike kryesore. b) *Maqedonishtja:* Ku flitet? Emërtimi i saj. Sistemi fonetik, struktura gramatikore dhe ndarja dialektore. Dukuritë ballkanike kryesore. c) *Serbokroatishtja:* Ku flitet?

Emërtimi i saj. Serbët dhe kroatët në rrjedhën e shekujve. Dokumentimi shkrimor. Tiparet gjuhësore kryesore.

**Kreu IV.** *Disa bashkëpërkime në fushën e fonetikës.* Nga historiku i çështjes. Ndihmesa e Mikloshiçit. Ndihmesa e Havranekut. Gjendja e sotme e studimeve. Theksi në greqishte, në rumanishte, në bullgarishte e maqedonishte, në shqipe. Risitë kryesore në fushën e theksimit. Mënjanimi i dallimeve kuantitative në sistemin e zanoreve në gjuhët ballkanike dhe në gjuhën shqipe. Shfaqja e zanores *ë* në gjuhët ballkanike; në rumanishte, në shqipe. *Ē*-ja e theksuar e toskërishtes. Zanorja *ë* në bullgarishte. Rotacizmi në toskërishte. Çështja e lidhjes së rotacizmit të toskërishtes me atë të rumanishtes.

**Kreu V.** *Bashkëpërkimi i rasave gjinore dhe dhanore.* Nga historiku i çështjes. Si paraqitet kjo dukuri në greqishte; në shqipe?; paranyjzimi i gjinore në shqipe dhe sqarimi historik përkatës; në rumanishte; paranyjzimi i gjinore në rumanishte; në bullgarishte e maqedonishte. Përdorimi i dhanores së përemrave vetorë edhe me vlerë gjinoreje në disa gjuhë ballkanike. Si paraqitet kjo dukuri në gjuhën shqipe? Shpjegimet e ndryshme për bashkëpërkimin e rasave gjinore e dhanore: hipoteza e substratit; hipoteza e ndikimit grek; hipoteza e ndikimit latin. Si duhet shpjeguar kjo dukuri?


**Kreu VI.** *Prapavendosja e nyjës shquese.* Në cilat gjuhë del nyja shquese e prapavendosur? Nga historiku i studimit të kësaj dukurie ballkanike (hipotezat e ndryshme). Koha e shfaqjes së nyjës së prapme: në gjuhët sllave të Ballkanit; në rumanishte; në gjuhën shqipe. Mendimet e ndryshme për shfaqjen e nyjës së prapme në gjuhët ballkanike: mendimi i Reichenkron-it; hipoteza e burimit sllav; hipoteza e ndikimit latin; hipoteza e ndikimit grek; hipoteza e substratit; hipoteza e ndikimit të shqipes mbi rumanishten. Si duhet shpjeguar lindja e nyjës së prapme shquese në shqipe dhe rumanishte?

**Kreu VII.** *Format e kohës së ardhme.* Nga historiku i çështjes. Konsiderata të përgjithshme mbi format e kohës së ardhme në gjuhët i.e. Formimi i kohës së ardhme nëpërmjet foljeve ndihmëse “dua” dhe “kam” në gjuhët ballkanike: në greqishte; në gjuhët sllave të Ballkanit; në bullgarishte e maqedonishte; në serbokroatishte; në rumanishte; e ardhmja e së shkuarës dhe e ardhmja e përparme në rumanishte; në gjuhën shqipe (tipat e ndryshëm); tipi me “do”, shtrirja gjeografike dhe vjetërsia; e ardhmja e ndërtuar me ndihmësen “kam” në gjuhën shqipe. Cili tip i së ardhmes është më i hershëm në shqipe? Mendimet

e ndryshme mbi burimin e së ardhmes me ndihmësen “dua” në gjuhët ballkanike; teza e Sandfeldit dhe ajo e Weigand-it etj. Si duhet sqaruar çështja për gjuhët e ndryshme të Ballkanit?

**Kreu VIII. Rimarrja e kundrinave:**

Nga historiku i trajtimit të kësaj dukurie ballkanike. Rimarrja e kundrinës së drejtë të shprehur nëpërmjet vektorëve të dy vetave të para, përkatësisht nëpërmjet fjalësh të tjera në gjuhën shqipe. Rimarrja e kundrinës së zhdrejtë në shqipe. Si shprehej më parë kundërvënia *remë ~ temë* në gjuhën shqipe?



Faktori kryesor që i ka dhënë shkas rimarrjes së kundrinave dhe koha e shfaqjes së kësaj dukurie në shqipe. Rimarrja e kundrinave në rumanishte dhe koha e shfaqjes së saj. Vështrimi i kësaj dukurie në evolucionin e saj historik. Rimarrja e kundrinave në bullgarishte e maqedonishte dhe koha e shfaqjes së saj. Rimarrja e kundrinave në greqishte dhe koha e shfaqjes së saj. Mendimet e ndryshme mbi burimin e kësaj dukurie në gjuhët ballkanike:

mendimi i Mikloshiçit dhe i Leskien-it mbi ndikimin e substratit. Mendimi i Ilievskit. Mendimi i Boissin-it për shqipen. Mendimi i Budagovit për rumanishten. Mendimi i Lopashovit. Teoria e gjymtyrimit aktual të fjalisë. Si duhet shpjeguar kjo dukuri në gjuhët ballkanike dhe në gjuhët romane perëndimore.

**Kreu IX. Mënjanimi i paskajores:** Paskajorja në gjuhët ballkanike dhe i.e. (konsiderata të përgjithshme). Mënjanimi i paskajores: në greqishte; në gjuhët sllave të Ballkanit; në rumanishte.

Çështja e paskajores në gjuhën shqipe; forma e pashtjellë e tipit *me ba* dhe ajo e tipit *për të bërë*. Mendimet e ndryshme mbi mënjanimin e paskajores në gjuhët ballkanike: hipoteza e trako-shqipes (Weigand, Gabinskij etj.); teza e ndikimit grek (Sandfeld etj.); hipoteza e ndikimit latin (Reichenkron); mendimi për një zhvillim paralel. Si duhet shpjeguar kjo dukuri për gjuhët ballkanike në përgjithësi dhe për gjuhën shqipe në veçanti?

**Kreu X. Disa bashkëpërkime të tjera midis gjuhëve ballkanike:** Numërorët 11 - 19. Forma e vetës së tretë njëjës të foljes “kam” në përdorim pavetor. Forma analitike e së kryerës me ndihmësen “kam” në

disa gjuhë ballkanike; mendimet e ndryshme për burimin e saj. Habitorja e shqipes dhe “mënyra e ritregimit” në bullgarishte e maqedonishte - pikat e takimit dhe mendimet e ndryshme mbi burimin e tyre.

**Kreu XI.** *Bashkëpërkime midis shqipes dhe rumanishtes:* Bashkëpërkimet kryesore. Bashkëpërkimet e vjetra leksikore midis këtyre dy gjuhëve dhe mendimet e ndryshme mbi burimin e këtyre bashkëpërkimeve. Si duhet parë kjo çështje? Përemrat dhe ndajfoljet e tipit *kush-do, ku-do* etj., *ndo-kush, ndo-kund* etj., *di-kush, di-ku* etj., përkatësisht *cine-va, unde-va* etj., *ori-cine, ori-unde* etj., *neucare* etj. Ndërrimi i gjinisë së disa emrave jo-frymorësh në shumës. Nyjat e përparme në shqipe dhe rumanishte; ndryshimet midis tyre. Si duhet shpjeguar ky bashkëpërkim? Prapavendosja e përcaktorëve të pavetëmjaftueshëm. Disa përdorime tipike të pjesores së shkuar pësore në këto dy gjuhë.

**Kreu XII.** *Disa bashkëpërkime në fushën e fjalorit në gjuhët ballkanike:* Trajtimi i kësaj çështjeje deri sot dhe si duhet vështruar ajo. Huazimet nga greqishtja e vjetër, e mesmja dhe e reja. Huazimet latine. Vjetërsia e huazimeve latine në shqipe. Huazimet sllave të periudhave të ndryshme. Huazimet prej burimi turk. Disa prapashtesa turke në gjuhët e Ballkanit.

Në fund të librit gjejmë: Përmbledhje në gjuhën anglishte. Bibliografi. Treguesi i autorëve të cituar. Treguesi alfabetik i çështjeve.

Vepra ka edhe një përmbledhje në anglisht në më shumë se 30 faqe (f. 201-234) ku në mënyrë të ngjeshur janë paraqitur të arriturat e këtij studimi krahasues.

Parimi i objektivitetit të njohjes shkencore kërkon nga studiuesit ndershmëri dhe dashuri ndaj të vërtetës. Saktësia në shkencë kushtëzohet nga një numër idesh operative dhe analitike-sintetike. Idetë e qarta dhe të përcaktuara mirë janë parakusht për punë të suksesshme hulumtuese. Në shkrimet e prof. Demirajt dalin në shesh aftësia e tij e jashtëzakonshme për të vëzhguar, për të analizuar dhe për të gjykuar. Stili i tij karakterizohet nga objektiviteti, të shprehurit e drejtë logjik, nga saktësia e përdorimit të termave, nga qartësia e thënies si dhe nga sistematizimi i çështjeve të trajtuara. Ai siguronte e shfrytëzonte të gjitha të dhënat e rëndësishme që ishin të vlefshme për objektin në shqyrtim. Në cilëndo temë që trajton, i pashmangshëm qe historiku i studimeve për temën përkatëse, duke konsultuar, sjellë, analizuar e sintetizuar autorë të shumtë jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj.



Me studimet e tij jo vetëm që kemi prurje të reja në fushën e albanologjisë, por ky dijetar e mjeshtër i madh i fjalës shqipe ka ngritur edhe shkallën e lëvrimin të gjuhës, sidomos stilin e mirëfilltë shkencor në fushën e gjuhësisë shqiptare. Në stilin e tij shkencor shprehen shumë mirë tiparet e ligjërimit libror, duke na lënë modele të variantit standard të shqipes së shkruar. Si specialist i fushës, stilin e mirëfilltë shkencor e ndërton me përkufizime, klasifikime, teza e hipoteza, përfundime etj., të shoqëruara me aparaturë shkencore, përkatësisht me citate, referime, shpjegime, shënime, bibliografi etj., duke lënë shtegun hapur për studime të mëtejme në ndriçimin e çështjeve që ende nuk kanë gjetur përgjigjen përfundimtare.

Tekstin e “Gjuhësisë ballkanike”, si edhe të gjitha studimet e tjera të akademik Shabanit, i përshkon objektiviteti dhe rreptësia shkencore. Shkrimet e profesorit janë disa nga veprat më të mira albanologjike që e ngritën në një shkallë të re cilësore gjuhësinë shqiptare dhe mendimin shkencor.

Në to pasqyrohet jo vetëm puna këmbëngulëse dhe kultura e gjerë, por edhe përkushtimi i jashtëzakonshëm shkencor dhe logjika e argumentit, forca krijuese dhe origjinaliteti i spikatur, qëndrimi kritik e parimor. Ato shënojnë arritje shumëplanëshe, qortojnë një numër tezash e hipotezash të hedhura përpara tij nga studiues të ndryshëm dhe shtrojnë një numër jo të vogël tezash të reja vetjake, të argumentuara me një logjikë të pakundërshtueshme.

Me veprimtarinë shkencore, akademiku ynë dha ndihmesë të madhe për të ndriçuar shumë çështje të errëta të gjuhësisë shqiptare e ballkanike, për të hedhur dritë mbi dukuri të përbashkëta gjuhësore e kulturore midis popujve ballkanikë si dhe për të ngritur shkencat albanologjike krahas studimeve të tjera në gjuhësinë evropiane.

Vepra e akademik Shaban Demirajt është nga ato që koha nuk ua bjerr, por ua shton vlerat. Duke lexuar shkrimet e albanologut e ballkanologut të madh, jo vetëm që njihemi me të vërtetat shkencore për shqipen dhe shqiptarët, për popujt dhe gjuhët e Ballkanit, por ato na shërbejnë edhe si pika referimi e udhërrëfytes për punën tonë dhe të gjeneratave që do të vijnë.

Prof. Shaban Demiraj vetëm fizikisht u nda nga ne, por ai do të jetojë derisa të ketë shqiptarë e gjuhë shqipe. ***Ai është i pavdekshëm!***

**Literatura:**

Selmani, Ahmet, *U promovua libri “Gjuhësi ballkanike” i Shaban Demirajt*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 09. 06. 1995, f. 3.

*Bibliografia e botimeve të profesor Shaban Demirajt*, AShAK, Studime 21- 2014, f. 400-418 (version i plotësuar nga Bardhyl Demiraj).  
(c\_15\_demiraj\_and\_erebeitraege)

Demiraj, Shaban, *Gjuhësi ballkanike*, Logos-A, Shkup, 1994.

Демирај, Шабан, *Балканска лингвистика*, Логос-А, Скопје, 1994.



### 3.4. VEPRIMTARIA SHUMËPLANËSHE E AKADEMIK IDRIZ AJETIT<sup>78</sup>

*Të nderuar pjesëmarrës të Konferencës,  
Kolegë e miq,*

Kam kënaqësinë që në emrin tim dhe në emër të Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare të Shkupit t’Ju përshëndes dhe t’Ju uroj punë të mbarë.

Është detyrë sa shkencore aq edhe kulturore e kombëtare të organizohen tubime për veprimtarët tanë të shquar. Me këtë Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” po jep një ndihmesë të madhe për të ndriçuar veprimtarinë shumëplanëshe të akademik Idriz Ajetit.

Prof. Idriz Ajeti është gjuhëtar, shkencëtar, pedagog, themelues e udhëheqës i institucioneve të larta arsimore e shkencore të Kosovës, pishtar i përhapjes së dijes e të përparimit, figurë qendrore në ngritjen e kuadrove shqiptare në ish-Jugosllavi, në përpjekjet për përafrimin e shqipes, duke vendosur në kreun e piramidës shqipen standarde.

Shpresoj se në këtë Konferencë Shkencore Ndërkombëtare që po mbajmë sot në 97-vjetorin e lindjes së akademik Idriz Ajetit, jo vetëm që do të përditësohen, do të ndriçohen e do të vështrohen nga shumë pikëpamje veprat e këtij kolosi të madh të shkencës dhe të kulturës shqiptare, por do të ketë edhe prurje të reja albanistike.

Urojmë punë të frytshme dhe suksese të mëtejme në realizimin e detyrave të reja që shtron koha e sotme, shkenca jonë e re.

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Për jetën dhe veprimtarinë e frytshme të prof. Idriz Ajetit në Wikipedia do të gjejmë këto të dhëna: lindi në fshatin Tupallë të Komunës së Medvegjës më 26 qershor të vitit 1917. Shkollën fillore e mbaroi në Banjën e Sijarinës më 1930, të mesmen e kreu në Shkup më 1938. Po atë vit u regjistrua në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Zagrebit – në Degën e romanistikës. Studimet i mbaroi pas luftës, në vitin 1949 në

---

<sup>78</sup> Kuntim i mbajtur e punim i botuar në përmbledhjen e kumtesave “Konferencë Shkencore kushtuar akademik Idriz Ajetit”, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Prizren, 2015, f. 17-32.

Fakultetin e Filozofisë të Beogradit. Që atëherë e deri në vitin 1953, me cilësi profesori të gjuhës shqipe, punoi në gjimnazin e Prishtinës. Nga viti 1953 deri në vitin 1960, me cilësi lektori, jepte mësim në Degën e Albanologjisë të Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Beogradit. Në vitin 1958 mbrojti disertacionin e doktoratës me temën: *Zhvillimi historik i së folmes geqe të shqiptarëve të Zarës së Dalmacisë*. Që nga viti 1960, një herë docent, pastaj profesor inordinar dhe nga viti 1968 profesor ordinar, jep mësim në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit të Filozofisë të Prishtinës.

Iu dhanë disa shpërblime e dekorata, ndër të cilat edhe Shpërblimi i 7 Korrikut dhe ai i KAÇKJ. Presidenti Ibrahim Rugova e dekoroi me Medaljen e Artë të Lidhjes së Prizrenit, ndërsa me rastin e 90-vjetorit të lindjes, Presidenti Fatmir Sejdiu e dekoroi me Çmimin Presidencial për Studiues. Hetimi i dialekteve nga pikëpamja diakronike, pastaj trajtimi i dokumenteve të moçme gjuhësore të shkruara me alfabetin arabo-turk dhe më në fund studimi i marrëdhënieve të ndërsjella shqiptare-serbe – janë troje të interesimit shkencor të Idriz Ajetit. Merret edhe me çështje të gjuhës së sotme shqipe. Qe iniciator i shumë konsultave dhe bashkëmarrëveshjeve gjuhësore ku u kërkuan shtigje të reja për njësimin e gjuhës shqipe dhe të drejtshkrimit të saj. Hartoi tekste shkollore për nxënës të shkollave të mesme dhe për studentë të Degës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Me nismën e tij, pas hapjes së Fakultetit të Prishtinës (1960), u nxor revista shkencore *Gjurmime albanologjike* (1962) e më 1974 u organizua Seminari i Kulturës Shqiptare për albanologë të huaj. Gjatë vitit 1969-1971 ishte drejtor i Institutit Albanologjik, më 1971-73 ishte dekan i Fakultetit Filozofik, në vitet 1973-75 rektor i Universitetit të Prishtinës. Pas zgjedhjeve paralele të vitit 1998 për Kuvendin e Republikës së Kosovës, zgjidhet kryetar i parë i tij nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në vitet 1979-1981 dhe 1996-1999 ishte kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.<sup>79</sup> Redaksia e botimeve “Rilindja” në Prishtinë më 1982, 1985, 1989 ka botuar veprën e plotë në katër vëllime: dr. Idriz Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes, I, II, III, IV.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës botoi në Prishtinë në pesë vëllime shkrimet e prof. Ajetit: Vepra 1 (1997, 175 faqe), Vepra 2 (1998, 303 faqe), Vepra 3 (1998, 301 faqe), Vepra 4 (2001, 294 faqe),

<sup>79</sup> [http://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz\\_Ajeti](http://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz_Ajeti)

Vepra 5 (2002, 288 faqe). Edhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë më vitin 2005 ribotoi në një libër të veçantë (prej 491 faqesh) disa vepra të zgjedhura të akademik Idriz Ajetit me titull “Studime dialektore dhe etimologjike”, me një parathënie të akademik Shaban Demiraj. Në fund të librit janë dhënë biografia dhe bibliografia e profesorit tonë të nderuar.<sup>80</sup> Marrë në përgjithësi, veprimtaria shkrimore e akademik Ajetit është shumë e vëllimshme, që shtrihet në më shumë se 1360 faqe tekst.

Prof. Idriz Ajeti gjithë qenien e tij intelektuale ia kushtoi arsimit, shkencës, gjuhës e kulturës shqiptare, me një fjalë kombit të vet. Dituritë e fituara në disa nga qendrat më të përparuara të kohës, si në Shkup, ku kreu shkollën e mesme, studimet e larta për gjuhësi në Zagreb (Kroaci) e më pas në Padovë (Itali) pranë albanologut K. Taljavini, për t’u diplomuar në Beograd për romanistikë, ku u thellua për albanologji tek Henri Bariçi<sup>81</sup> i vuri në funksion të shkencës albanologjike e ardhmërisë së kombit.

Prof. Ajeti është një ndër figurat më të shquara të kombit, figurë madhore e albanistikës, ballkanologjisë, shkollimit shqiptar, e shkencës dhe e kombit. Puna e tij e palodhshme është shumëplanëshe:

a) ai me sukses zhvilloi veprimtari pedagogjike: mësimdhënës në shkollë të mesme, në studimet universitare, pasuniversitare.

b) dha ndihmesë të çmueshme në ngritjen e kuadrit arsimor e shkencor: udhëheqës shkencor e anëtar në komisione për vlerësimin e mbrojtjen e magjistraturave e tezave të doktoratit, sa që prof. Ajeti mund të llogaritet se është udhëheqës shkencor i kuadrit albanologjik të Kosovës e më gjerë. Kam pasur fatin që edhe unë të jem student i prof. Ajetit në studimet pasuniversitare në Universitetin e Prishtinës.

c) ndihmesë të madhe ka dhënë në fushën e studimeve albanologjike, duke u bërë studiuesi më i dalluar i gjysmës së dytë të shekullit XX në mesin e shqiptarëve të Jugosllavisë së dikurshme, me këtë edhe njëri ndër gjuhëtarët më të mirë të kombit.

ç) ai është njëri ndër themelvënësit e shqipes standarde, me përkrahjen që i dha njësimi të gjuhës dhe bashkë me të edhe njësimi të kombit në Konsultën e Prishtinës më 1968.

d) puna e tij qe vendimtare edhe në themelimin dhe ngritjen e institucioneve universitare dhe albanologjike në gjysmën e dytë të shekullit XX në Kosovë.

<sup>80</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, ASHSh, Tiranë, 2005, f. 483-491.

<sup>81</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *Fjalor enciklopedik shqiptar I*, Tiranë, 2008, f. 30.

dh) me veprimtarinë shoqërore po kështu ka dhënë ndihmesë të rëndësishme në themelimin e revistave shkencore (“Gjurmime albanologjike”), seminareve e konferencave albanologjike etj. Një kohë të gjatë ka qenë kryetar i Kuvendit të Kosovës, ndërsa edhe tani në moshë të shtyrë është mjaft vital dhe aktiv me detyrë nderi të rëndësishme si njëri ndër bashkëkryetarët e Këshillit Ndërkademi për gjuhën shqipe.

Është e vetëkuptueshme se në një artikull përgjithësues të tipit të këtillë nuk mund të ndriçohen as për së afërmi asnjë nga këto veprimtari të shumanshme të akademikut tonë të nderuar, por shpresojmë se në artikujt e tjerë të konferencës kushtuar Idriz Ajetit do të thuhet më shumë për ndihmesën e vyer të profesorit.

Shekulli XX për shqiptarët në përgjithësi e për ata në trojet e ish-Jugosllavisë në veçanti, qe një periudhë vendimtare për të marrë njërën nga këto rrugë: për të mbijetuar gjuha dhe kombi ose për t’u asimiluar e tretur. Pikërisht për këtë arsye, shumë intelektualë tanë u dashtë të vënë gjithë qenien e tyre në shërbim të mbijetesës kulturore. Në plejadën e këtyre veprimtarëve prin prof. Ajeti.

Pas Luftës së Dytë Botërore në trojet e ish-Jugosllavisë, si edhe në shumë vende të tjera, mbizotëronte analfabetizmi. Andaj, jo rastësisht Ajeti përhapi dritën e diturisë si profesor i gjuhës shqipe në gjimnazin e Prishtinës (1949-1953), si lektor në Universitetin e Beogradit (1953-1960), profesor në Universitetin e Prishtinës, dekan i Fakultetit të Filozofisë (1971-1973), rektor i Universitetit të Prishtinës (1973-1975). Dr. Idriz Ajeti ushtroi edhe shumë detyra të tjera të rëndësishme me një profesionalizëm të lartë shkencor e organizativ dhe me përgjegjësi shoqërore e kombëtare. Ishte dekan i Fakultetit të Filozofisë (1971-1973), rektor i Universitetit të Prishtinës (1973-1975), kryeredaktori i parë i “Gjurmimeve albanologjike” (1962), drejtor i Institutit Albanologjik (1969-1971), drejtor i Seminarit Ndërkombëtar të Gjuhës, të Letërsisë dhe të Kulturës Shqiptare, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (1979-1981 dhe 1996-1999).<sup>82</sup>

Prof. Idriz Ajeti u formua në rrjedhat teorike të avancuara të gjuhësisë krahasuese dhe në praktikën filologjike shkencore të kohës së tij, duke ecur sidomos në gjurmët e albanologëve dhe ballkanologëve të mirënjohur Petar Skok, Henrik Bariç, Karlo Taljavini.<sup>83</sup> Studimet e romanistikës, njohja e thellë e shqipes, e gjuhëve sllave, e turqishtes

<sup>82</sup> <http://botasot.info/dokumentare/76165/trmULTe/>

<sup>83</sup> Murat Blaku, *Veprimtaria shkencore akademik Idriz Ajetit*, Dr. Idriz Ajeti, Studime

i mundësuan profesorit tonë të na japë studime serioze, me vlerë të qëndrueshme që i sigurojnë një vend të denjë në historinë e gjuhësisë sonë.

Prof. Ajeti me të drejtë është quajtur, cilësuar e vlerësuar si: “veprimtar i shquar dhe ambasador i gjuhës shqipe në Gadishullin Ilirik, ndër emrat më të njohur në fushën e linguistikës dhe ambasador i kulturës shqiptare, profesor dhe albanolog i njohur në vend dhe jashtë, ndër lisat e lartë të kulturës dhe të fisnikërisë shqiptare, prijatar në shumë fusha të albanologjisë, frymëzues dhe prind shpirtëror i nxënësve e studentëve të tij të shumtë, mik i dashur i zemrës i kolegëve e i bashkëpunëtorëve, personalitet i madh i kombit, fenomen i rrallë i dijes shqiptare, i papërsëritshëm në jetën shkencore, dijetar dhe studiues i thellë i dijeve të albanologjisë, profesor me dinjitet të rrallë, njeri e dijetar me plot kuptimin e fjalës.<sup>84</sup>

Për prurjet albanistike dhe përgjithësisht për ndihmesën e tij për kulturën kombëtare janë dhënë edhe këto epitete: rrallëkush i ka dhënë aq shumë kombit dhe vendit të vet, dijetar i përkushtuar për të vërtetën shkencore, nga ata burra që u ka peshë fjala, është nga ata dijetarë që i hedhin hapat me kujdes e nuk shkelin në truall të pasigurt. Ai ka shkruar gjithnjë thjesht e qartë dhe me fuqi bindëse, si dijetar i vërtetë. Veprat e tij shkencore kanë sjellë pasurim e përparim cilësor në studimet për gjuhën shqipe dhe në disa aspekte edhe në ballkanologji. I. Ajeti është një përmendore e gjallë e fisnikërisë së shpirtit, e burrërisë dhe e mençurisë së kombit shqiptar, institucion më vete i albanologjisë, figurë markante e albanistikës dhe e rezistencës shqiptare” e shumë e shumë epitete të tjera.

Studiuesi Begzad Baliu në artikullin e vlefshëm “Profesor Idriz Ajeti dhe albanologjia në 90-vjetorin e lindjes së profesor Idriz Ajetit” me të drejtë thotë se studimeve albanologjike të profesor Idriz Ajetit mund t’u qasemi në disa anë:

- duke sheshuar biografinë shkencore të Profesor Ajetit, në të cilën puna e tij prej albanologu përvijohet thellësisht dhe merr jo vetëm pjesën më të madhe të moshës së tij edhe ashtu të gjatë, por edhe anët më të ndritshme të saj;
- duke rindërtuar formimin dhe ngritjen e institucioneve albanologjike të gjysmës së dytë të shekullit XX, në themelimin e të cilave Profesor

---

gjuhësore në fushë të shqipes I, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 6.

<sup>84</sup> [http://www.zemrashqiptare.net/news/id\\_30474/Tefik-Selimi:-Profesor-Idriz-Ajeti](http://www.zemrashqiptare.net/news/id_30474/Tefik-Selimi:-Profesor-Idriz-Ajeti)

Ajeti është fjala e parë;

- duke identifikuar arritjet më të rëndësishme të studimeve albanologjike të kësaj kohe;
- duke diskutuar projektet fundamentale të albanologjisë së shekullit XX , në të cilat Profesor Ajeti del bardi i tyre;
- duke bërë kërkime në shtypin shkencor të institucioneve shkencore dhe universitare, në të cilat ai kudo është kryeredaktori i parë për këto botime;
- duke regjistruar një numër të madh projektesh të magjistraturave e doktoratave, ku Profesor Idriz Ajeti, njëherë na del mentor, herën tjetër mentor në kontekstin metodologjik e orientues, e më tej edhe mentor moral;
- duke përcjellë popullarizimin e albanologjisë në revistat, vëllimet dhe botimet enciklopedike shkencore të kohës edhe në qendrat më të mëdha shkencore, ku Profesor Ajeti nxjerr krye në radhën e përfaqësuesve të saj, dhe më në fund;
- duke parë atakimet dhe mbrojtjen e albanologjisë në institucionet më të larta shtetërore e politike në momentet nyje të saj, Profesor Idriz Ajeti del madje në funksion të dyfishtë. Më parë thuhej objekt dhe subjekt, ndërsa këtu po e përveçoj në synimin e kumtesës sonë: albanolog dhe njëkohësisht institucion i saj.<sup>85</sup>

Siç dihet, prof. Idriz Ajeti ka botuar një varg librash, monografish, artikujsh e kumtesash, të shkruara me kompetencë dhe akribi shkencore.<sup>86</sup> Një pjesë të artikujve e studimeve, sigurisht për të përhapur të vërtetën shkencore jo vetëm ndër shqiptarë, por edhe te popujt e tjerë, prof. Ajeti i botoi jo vetëm në shqip, por edhe në gjuhë të tjera, si në serbokroatisht, frëngjisht etj. Nga pikëpamja e kohës, do të çmonim shumë punë të guximshme mbrojtjen e prejardhjes së shqipes nga ilirishtja, të ndikimit të shqipes në serbishten e në gjuhët e tjera sllave etj.

Ky dijetar i shquar, falë vendosmërisë shembullore për të depërtuar gjithnjë e më thellë në të panjohurat e gjuhës shqipe dhe të historisë së saj, është bërë prej kohësh një ndër përfaqësuesit më në zë të albanologjisë jo vetëm në nivel ndërshqiptar, por edhe në nivel ndërkombëtar. Dhe vlera e ndihmesave të tij të shumta rritet edhe më

---

<sup>85</sup> Begzad Baliu, *Profesor Idriz Ajeti dhe albanologjia në 90 vjetorin e lindjes së profesor Idriz Ajetit*, në <http://264517.forumromanum.com/>

<sup>86</sup> Shaban Demiraj, *Parathënie*, Studime dialektore dhe etimologjike, Tiranë, 2005, f. VI.

tepër, po të kihen para sysh rrethanat historike, në të cilat ai u desh të arsimohej e të punonte.<sup>87</sup> Dhe mund të pohohet pa mëdyshje se zhvillimi i tij ka shkuar paralelisht me zhvillimin e arsimit, të shkencës e të kulturës në ish-Jugosllavi si dhe me vetë zhvillimin e Kosovës. Idriz Ajeti në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore iu desh të merrej me një veprimtari shumëplanëshe – arsimore, shkencore dhe organizuese.<sup>88</sup>

Veprimtaria shkencore e akademik Idriz Ajetit është e shumanshme. Gjurmimet e tij u përkasin fushave të ndryshme të gjuhësisë, por ndihmesë të madhe ka dhënë në fushën e: a) dialektologjisë, b) historisë së gjuhës, c) leksikologjisë, ç) morfologjisë, d) onomastikës dhe dh) ballkanologjisë.

Studimet dialektologjike të shqipes kanë përjetuar disa faza zhvillimi, por në përgjithësi dy prej tyre veçohen si më kryesore:

- 1) periudha para Luftës së Dytë Botërore dhe
- 2) periudha pas Luftës së Dytë Botërore.

Fazën e parë të studimeve dialektologjike të shqipes e karakterizojnë përshkrime kryesisht informative dhe të dhëna për të folmet e diasporës dhe të trevave më skajore të shqipes, pa kriter a plan të caktuar studimi, kryesisht nga gjuhëtarë të huaj.

Në fazën e dytë të studimeve dialektologjike, që nis nga vitet '50 të shekullit XX gjuhëtarët shqiptarë ndërmorën një punë të organizuar, me një program të gjerë, dhe përgjithësisht këtë fazë e karakterizon studimi i organizuar dhe sistemor i tyre (në fillim nga Instituti i Shkencave i R. së Shqipërisë, më pas nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, sektori i Gramatikës dhe i Dialektologjisë - Tiranë), në radhë të parë i atyre të trungut apo të trojeve brenda kufijve të shtetit shqiptar dhe në trevat shqiptare me vijimësi të pandërprerë truallësore në ish-Jugosllavi. Pishtar i studimeve dialektologjike në Kosovë është prof. Idriz Ajeti, jo vetëm me punimet e botuara në këtë fushë, por edhe me kërkimet dialektore që janë organizuar një kohë të gjatë nga Instituti Albanologjik i Prishtinës nën drejtimin e këtij kolosi të shqipes.

Dialektologjia aktuale e historike, historia e gjuhës së shkruar në përgjithësi e sidomos e gjuhës së shkruar me alfabet arab në Kosovë në veçanti, morfologjia historike e shqipes dhe problemet e diskutueshme të saj, historia e leksikut, me theks të veçantë në interferencat e dyanshme gjuhësore të shqipes me gjuhët sllave të jugut, onomastika mesjetare dhe

<sup>87</sup> Shaban Demiraj, *Parathënie*, Studime dialektore dhe etimologjike, Tiranë, 2005, f. I.

<sup>88</sup> Shaban Demiraj, *Parathënie*, Studime dialektore dhe etimologjike, Tiranë, 2005, f. II.



e mëvonshme, kontributi i shkrimtarëve (Fan S. Noli, Pjetër Bogdani, Konstantin Kristoforidhi, Naim Frashëri, Sami Frashëri), e gjuhëtarëve shqiptarë (Eqrem Çabej, Selman Riza, dhe i albanologëve të huaj (Henrik Bariq, Holger Pedersen, Petar Skok, Carlo Tagliavini, Vaclav Cimohovski, Claus Haebler, Marko la Piana, Vojislav Dançetović, Radosav Boshković, Glisha Elezović, Vuk Karaxhiq, Bllazhe Koneski), për studimin e shqipes, kritika e recensione për vepra të botuara e disertacione doktoratash të kohës (Rexhep Ismajli, Fadil Raka, Qemal Murati), problemet aktuale të shqipes si dhe njësimi dhe normimi i saj janë fushat studimore kryesore që tërhoqën vëmendjen shkencore të akademik Idriz Ajetit.

Nga fusha e dialektologjisë historike si dhe nga dialektologjia e kohës, studime me vlerë të prof. Ajetit janë: Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës në fillim të shekullit XIX (1960), Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëneshëve të Zarës (1961), Mbi gjuhën e Divanit të Sheh Maliqit (1966), Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjërimeve shqiptare të Kosovës (1969), Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit (1969), Tipat e *l*-së në dialektet shqiptare të Brisk-Shestanit të Krajës, “Djali plëngprishës” në të folurit shqip të Istrisë, Gjuha e “Divanit” të Sheh Maliqit.

Veprimtaria e tij nuk do të kishte marrë ato përmasa dhe nuk do të kishte qenë aq e suksesshme, në rast se ai nuk do të kishte pasur mbështetjen e vazhdueshme dashamirëse nga intelektualët shqiptarë rreth tij. Siç dihet, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore ndaj shqiptarëve në trojet e ish-Jugosllavisë nga qarqet sllave është ndjekur një politikë e vazhdueshme asimiluese, represive me një gjenocid të paparë. Falë punës këmbëngulëse, largpamëse e kombëtare të veprimtarëve tanë u mposht analfabetizmi, u ngrit vetëdija kombëtare, u hapën shkolla, u hartuan tekste, u zhvillua letërsia e arti në përgjithësi, u arritën rezultate të lakmueshme në të gjitha fushat e shkencës. Prishtina është bërë sot edhe një qendër e rëndësishme albanologjike, krahas Tiranës e vendeve të tjera. Midis këtyre studiuesve një vend nderi dhe prej pionieri zë pa dyshim akademiku Idriz Ajeti.

Në pjesën më të madhe të studimeve dialektore të shqipes bëhet përkrahimi i të folmeve të caktuara në gjendjen e ruajtur të kohës, ndërsa studimet në dialektologjinë historike të shqipes janë të pakta. Vëzhgimi i të folmeve nga pikëpamja historike, duke u mbështetur edhe në tekste të shkruara, të prof. Ajetit janë gur të rrallë e të çmuar të shkencës albanologjike.



Monografia “*Zhvillimi historik i së folmes gege të arbëreshëve të Zarës*”<sup>89</sup> fillon me një parathënie, ku autori me pak fjalë shpjegon rëndësinë dhe dobinë e studimit të të folmeve e më pas falënderon prof. Henrik Bariqin për insistimin për të studiuar këtë të folme si dhe Josip Relën për përkrahjen e pakursyer. Mirënjohje shpreh edhe ndaj informatorëve, anëtarëve të komisionit dhe ndaj gjithë atyre që kanë mbështetur prof. Idrizin në punën e tij. Që në këtë pjesë kuptohet se materiali është vjelë në mënyrë të drejtpërdrejtë tek arbëreshët e Zarës, por edhe në Krajë (Mal të Zi), në truallin e gjyshërve të tyre.

Në hyrje gjejmë një vështrim mbi dialektet e shqipes, duke u ndalur veçmas në të folmen e arbëreshëve të Greqisë, të të folmeve të diasporës, të Elbasanit, Shkodrës, Zadrimës, Krajës, Ulqinit etj. (f. 5-36).<sup>90</sup> Në këtë vështrim përmbledhës del në pah profesionalizmi, informacionet e plota e të gjithanshme të autorit për gjendjen e studimeve të deriatëhershme.

Në këtë monografi jepet edhe një vështrim kritiko-historik i përpjekjeve të deriatëhershme për studimin e së folmes së Arbëneshit (f. 60-71), për të vazhduar në shpjegimin e prejardhjes së arbëreshëve të Zarës – lidhjes së tyre me truallin e lashtë (Brisku e Shestani). Në kapitullin IV përcaktohet me saktësi pozita e të folmeve të Krajës në strukturën dialektore të shqipes (f. 81-86).

Duke pasur para sysh se studimet për të folmet shqipe në kohën kur prof. Ajeti hartoi këtë monografi gjendeshin në fazën fillestare, është e vetëkuptueshme që autori pati shumë vështirësi. Siç shprehet ai “caktimi i pozitës së të folmeve shqipe të Krajës në gjirin e të folmeve fqinje të shqipes për shumë arsye nuk është punë e lehtë. Së pari se asnjë nga të folmet fqinje të malësorëve shqiptarë nuk është studiuar as deri në atë masë sa të mund të dëshmohet raporti i njëjës së folme ndaj të të folmeve fqinje të Krajës; së dyti se edhe më pak janë studiuar të folmet shqipe të Krajës që të mund të dihet raporti i saj në gjirin e të folmeve të tjera fqinje.”<sup>91</sup>

Edhe këtu rimerren teoritë për dhe kundër autoktonisë së shqiptarëve. Duke përmendur e analizuar shumë teza e kundërteza, autori mban qëndrim kritik ndaj tyre dhe bindshëm arsyeton vijimësinë

89 Idriz Ajeti, *Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra*, Naučno Društvo Bosne i Hercegovine, Djela, Sarajevo, 1961.

<sup>90</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 3-36.

<sup>91</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 81.

ilire-shqiptare. Gjatë leximit të kësaj vepre, na ra në sy konstatimi se të folmet e Krajës, të Briskut e të Shestanit përfaqësojnë tipin më arkaik të të folmeve geqe.<sup>92</sup> Po kështu, pohim me interes është edhe mendimi se “pozita e theksit të kryehershëm luajti rol vendimtar në të gjitha gjuhët..., duke shpjeguar zhvillimin historik të jo pak zanoreve në shqipen nga gjuha mëmë indoevropiane. Më pas, jepen shpjegime e zhvillime tingujsh në rrafshin dialektor të shqipes. Në mes të njërës grup dhe grupit tjetër të të folmeve në fjalë – veçanërisht sot – ka dallime të mëdha. Faktori kryesor që shkaktoi këtë dallim – pa dyshim, thotë prof. Ajeti, është theksi, ndikimi i të cilit në gegërishte qe aq i madh saqë eliminoi të gjitha vokale të patheksuara, prandaj në mënyrë të ndjeshme u largua nga grupi i të folmeve toske. Këtu bën pjesë gjysmëvokali [ë], i cili nën ndikimin e fuqishëm të theksit dinamik për një kohë të shkurtër u zhduk nga grupi i të folmeve shqipe të gegërishtes”.<sup>93</sup> Me rënien e gjysmëvokalit [ë] pasoi dukuria tjetër, me të cilin gegërishtja mori edhe një tipar tjetër karakteristik, zgjatjen kompensatore të zanores paraprirëse.

Në tekstin e mëtejshëm të kësaj monografie shpjegohen dukuria e gjatësisë së zanoreve, e hundorësisë së tyre, togjet e zanoreve e diftongjet. Në shumë vende, Ajeti jo vetëm që jep arsyetime bindëse për këto dukuri, por shpeshherë rimerr mendimet e albanologëve, duke vërtetuar ose kundërshtuar teoritë e tyre. Është për t’u përmendur në këtë rast hetimi i dukurisë së çhundorëzimit të zanoreve në shumë të folme të gegërishtes: denazalizimin e vokaleve e ndeshim në një varg të tërë të folmesh geqe, si në të folmet shqipe në Maqedoni, në të folmen e Preshevës etj. Akademik Idriz Ajeti me të drejtë konstaton se “rëndom thuhet se e folmja e Shkodrës ka mjaft hundorësi sekondare. Më në fund, kjo është njëra ndër çështjet më të ndërlikuara të gramatikës historike të të folmeve geqe, ku numri i shembujve të çhundorëzimit nuk është i vogël. Për të ndriçuar deri diku hundorësinë e tyre, është e nevojshme një analizë e veçantë e çdo zanoreje ose fjale...”<sup>94</sup>

Këtë pohim të saktë e largpamës të prof. Ajetit, nuk e gjejmë jo vetëm në shumicën e përshkrimeve dialektore të mëvonshme, por as edhe në studimet përgjithësuese për të folmet e dialektet e shqipes.

Konstatimi i përgjithshëm se toskërishtja (dhe shqipja standarde)

<sup>92</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 86.

<sup>93</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 86-87.

<sup>94</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 33.

nuk ka fonema zanore hundore është plotësisht i saktë dhe ka karakter universal, ashtu siç është i saktë konstatimi i përgjithshëm se të folmet geqe kanë një inventar vokalik prej dy seri zanore: a) zanore gojore të shkurtra, dhe b) zanore gojore të gjata.

Por, por se të folmet geqe në gjendjen e sotme kanë fonema zanore hundore është i diskutueshëm. Duhet rishqyrtuar vlera fonologjike e zanoreve hundore të gegërishtes. Mendojmë se kundërvënia e gjatësisë së zanoreve dhe hundorësia e tipit fonetik është mbarëdialektore geqe; por, hundorësia në pikëpamje fonologjike nuk ka vlerë absolute. Gjykojmë se hundorësia e zanoreve tani më është defonologjizuar jo vetëm në nëndialektin e gegërishtes jugore, por edhe në shumë të folme të nëndialektit të gegërishtes veriore. Për ta përdëftuar këtë, përkrahimi i sistemit vijor (segmentor, linear) veçmas të të folmeve geqe në të ardhmen duhet bërë si nga aspekti fonetik, ashtu edhe nga ai fonologjik.

Hundorësia e zanoreve në të folmet e gegërishtes ka filluar të lëkundet dhe gjithnjë e më pak mund të gjenden çifte minimale fjalësh, te të cilat një zanore gojore i kundërvihet një zanoreje hundore.

Është e vërtetë se çdo e folme geqe ka zanore të hundorëzuara. Por, për çdo të folme fonemat duhet identifikuar veç e veç nëpërmjet kundërvënive fonologjike (kuptimdalluese ose gramatikore).

Të folmet geqe në çështjen e hundorësisë së zanoreve tani gjenden në një fazë kalimtare. Te të gjitha ka prirje për defonologjizimin e hundorësisë së zanoreve. Në ndërgjegjen e folësve nuk është gjithnjë e qartë vlera e hundorësisë. Në mjaft krahina të Gegërisë dallimi fonemë zanore gojore ~ zanore hundore është rrafshuar. Fjalët janë kthyer në homofone, duke ia lënë kontekstit diferencimin e kuptimit.

Në studimet dialektore të akademik Ajetit shpjegimi i dukurive gjuhësore gërshetohet edhe me disa shpjegime jashtëgjuhësore. Fjala vjen ai në monografinë për të folmen a arbneshëve të Zarës thotë: “unë mendoj se izolimi dhe konfiguracioni i terrenit të Briskut e Shestanit janë njëri ndër shkaqet e ruajtjes së trajtave të vjetra të këtyre të folmeve”.<sup>95</sup>

Ajeti bën edhe një analizë filologjike për “*Djalën plëngprishës në të folët e Istrisë*”, të botuar në origjinal nga Matteo Bartoli në revistën *Studi albanesi I*, 1932. Në bazë të tipareve gjuhësore, ai konstaton se shqiptarët e Istrisë erdhën nga trevat gjuhësore të veriut. Aty hetohet grafia e tekstit, vokalizmin, konsonantizmin dhe gjuhën e tekstit. Më pas hetohet në të folmen e shqiptarëve të Sremit, edhe pse sot atje askush

<sup>95</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 119.

nuk flet më shqip. Në vijim jepen të dhëna për historikun e studimit të të folmeve të Kosovës. Ai fuqimisht kundërshton historiografinë serbe dhe përgjithësisht pseudoshkencën sllave që gjithnjë janë përpjekur e vazhdojnë të thurin mite e të mohojnë autoktoninë e shqiptarëve në Kosovë e trojet e tjera stërgjyshore që mbetën jashtë trungut, përkatësisht në trojet e ish-Jugosllavisë. Në të mirë të tezës së vazhdimësisë ilire – shqiptare e të pranisë së hershme të shqiptarëve në Jugosllavinë e atëhershme, prof. Idrizi përmend udhëpërshkruesin turk Evlija Çelebiu, veprat e Pjetër Bogdanit etj. Ndër studimet me peshë për të folmet e kësaj ane veçon kërkimet e Carlo Tagliavinit, S. Mlladenovit, Petar Skokut etj. Burim i rëndësishëm për studimin e së folmes së Gjakovës është *Fjalori serbisht – shqip* (Srpsko-arnautski rečnik) i Kujunxhiçit, gjakovar, i botuar më 1902.<sup>96</sup>

Shkrimet e gjuhëtarit tonë përshkohen nga një stil shkencor, me një gjuhë të pasur dhe tekst të ndërlidhur për lakmi. Një punë e tillë, dëshmon formimin e gjerë e të shëndoshë teorik, praktik dhe metodologjik të autorit.

Në studimet dialektore të prof. Ajetit sillen përshkrime, shpjegime dhe tëhollime me interes. Ato nuk janë vetëm përshkrime të rëndomta dialektore, por në to gjejmë të gërshetuara analizën e zhvillimit historik dhe të gjendjes aktuale të të folmes, përjasjen me të folmet e tjera gege e veçmas me ato të nëndialektit të gegërishtes veriore, shpjegime teorike, duke u mbështetur në studimet teorike e praktike të albanologëve të huaj e shqiptarë. Në të shpeshherë autori ka rimarrë mendimet e pararendësve, duke dhënë shpjegime e gjykime origjinale, sidomos rreth kronologjisë së mundshme të dukurive fonetike e morfologjike që trajtohen.

## **Përfundim**

Në personalitetin e akademik Ajetit gjejmë të gërshetuara profesionalizmin, akribinë shkencore, sinqeritetin, bujarinë, besnikërinë, zemërgjerësinë, largpamësinë, mirësjelljen e humanizmin.

Me prof. Idriz Ajetin ndërlidhen pothuajse të gjitha veprimtaritë arsimore, shkencore e kombëtare me peshë të shekullit XX të shqiptarët e ish-Jugosllavisë dhe rrjedhimisht edhe të gjithë popullit shqiptar.

Gjuhëtari ynë i shquar i dha një shtysë të fuqishme studimeve

<sup>96</sup> Idriz Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005, f. 36-60.

albanologjike. Vepra e tij përbën një vazhdim të punës së Gustav Meyer-it, Norbert Jokl-it, Eqrem Çabejt, Shaban Demirajt, Selman Rizës dhe shumë albanologëve të tjerë. Në veprat e tij pasqyrohet jo vetëm puna këmbëngulëse dhe kultura e gjerë, por edhe përkushtimi i jashtëzakonshëm shkencor dhe logjika e argumentit, forca krijuese dhe origjinaliteti i spikatur, qëndrimi kritik e parimor. Ato shënojnë arritje shumëplanëshe, qortojnë një numër tezash e hipotezash të hedhura përpara tij nga studiues të ndryshëm dhe shtrojnë një numër jo të vogël tezash të reja vetjake, të argumentuara me një logjikë të pakundërshtueshme. Rrjedhimisht, me veprimtarinë shumëplanëshe, akademiku ynë ka dhënë ndihmesë të madhe për të ngritur gjithnjë e më lart piramidën e përbashkët kombëtare.

Vepra e akademik Idriz Ajetit është nga ato që koha nuk ua bjerr, por ua shton vlerat. Duke lexuar shkrimet e albanologut të madh, jo vetëm që njihemi me të vërtetat shkencore për shqipen dhe shqiptarët, por ato na shërbejnë edhe si udhërrëfyes për punën tonë dhe të gjeneratave që do të vijnë.

Akademik Idriz Ajetin e falënderojmë për kontributin e madh që ka dhënë për të mirën tonë shoqërore, për ngritjen e institucioneve arsimore e shkencore të Kosovës si dhe të bërjes së Kosovës shtet dhe përgjithësisht për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare. Ai ka vënë një gur të rëndësishëm në piramidën e përbashkët kombëtare. Profesorit i urojmë me gjithë zemër jetë të gjatë, shëndet e mirëqenie.

### **Bibliografia:**

- Ajeti, Idriz, *Studime dialektore dhe etimologjike*, AShSh, Tiranë, 2005.
- Ajeti, Idriz, *Istorijski razvitak gegijskog govora Arbanasa kod Zadra*, Naučno Društvo Bosne i Hercegovine, Djela, Sarajevo, 1961.
- Demiraj, Shaban, *Parathënie*, Studime dialektore dhe etimologjike, AShSh, Tiranë, 2005.
- Blaku, Murat, *Veprimtaria shkencore akademik Idriz Ajetit*, Dr. Idriz Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes I, Rilindja, Prishtinë, 1982.
- AShSh, *Fjalor enciklopedik shqiptar 1*, Tiranë, 2008.
- Baliu, Begzad, *Profesor Idriz Ajeti dhe albanologjia në 90 vjetorin e*

*lindjes së profesor Idriz Ajetit*, <http://264517.forumromanum.com/>

Hamiti, Asllan, *Prirja e defonologjizimit të zanoreve hundore në të folmet e gegërishtes*, Java e Shkencës në Kosovë, Prishtinë, 13-16 maj 2014.

<http://botasot.info/dokumentare/76165/trmULTe/>

[http://www.zemrashqiptare.net/news/id\\_30474/Tefik-Selimi:-Profesor-Idriz-Ajeti](http://www.zemrashqiptare.net/news/id_30474/Tefik-Selimi:-Profesor-Idriz-Ajeti)

[http://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz\\_Ajeti](http://sq.wikipedia.org/wiki/Idriz_Ajeti)

<http://www.preshevajone.com/akademik-idriz-ajeti>

<http://www.ashak.org/?cid=1,24,296>

<http://koha.net/arkiva/?page=1,5,104846>

<http://botasot.info/dokumentare/76165/trmULTe/>

### **3.5. PROFESOR REMZI NESIMI RROI PËR TË JETUAR**

Është kënaqësi të shkruash për veprimtarinë pedagogjike, arsimore, shkencore e kulturore të figurave tona të shquara të kohës. Kam pasur fatin të jem student, magjistrant, doktorant e më pas bashkëpunëtor, koleg dhe mik i zotëri Remziut.

Më se gjysmë shekulli, përkatësisht që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar me përkushtim e vetëmohim prof. Remziu ka punuar për ngritjen e përgjithshme arsimore e kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë, për të lëvruar, kodifikuar dhe përpunuar shqipen standarde. Me një fjalë, me veprimtarinë e shumanshme, profesor Remziu dha ndihmesë të madhe për të ngritur gjithnjë e më lart piramidën e përbashkët kombëtare.

Gjuhëtari ynë ka përfaqësuar arritjet shkencore në fushë të shqipes në Maqedoni, duke marrë pjesë aktive në shumë tubime, seminare, simpoziume e konferenca shkencore të organizuara në vend dhe jashtë tij. Kështu, në Kongresin e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, ishte delegat dhe anëtar i komisionit organizues; bashkëkryetar i Konferencës Shkencore për shënimin e 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, që u mbajt në Tetovë, në qershor të vitit 1992; anëtar i Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe (themeluar në 27 tetor 2004 në Tiranë në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës) etj.

#### **1. Të dhëna për jetën dhe veprimtarinë**

E shohim të udhës të shënojmë disa të dhëna bio-bibliografike për këtë personalitet të madh të dijes e të shkencës shqiptare. Remzi Nesimi lindi më 25. 12. 1933 në f. Odër të Tetovës në Maqedoni, ndërroi jetë dhe u varros në vendlindje më 04. 02. 2018. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, ndërsa të mesmen në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” të Tetovës. Në vitin akademik 1955/56 u regjistrua në Fakultetin e Filozofisë në Beograd në Degën e Albanologjisë ku dhe diplomoi. Menjëherë pas kryerjes së studimeve, një vit punoi në Redaksinë e Botimeve NGB “Rilindja” në Prishtinë si lektor – redaktor. Në këtë cilësi ka punuar edhe në Redaksinë e “Flakës së vëllazërimit” deri në tetor të vitit 1962, kur zgjedhet lektor i gjuhës shqipe në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, ku punoi plot dy vjet. Dhjetë vjet (1964 - 1974) punoi pedagog i gjuhës



shqipe në Akademinë Pedagogjike “Klimenti i Ohrit” në Shkup. Nga viti 1975 e deri më 1999 ishte profesor në Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë në Shkup. Nga karakteri është i sinqertë, bujar, besnik, zemërgjerë, human, arsimdashës, largpamës, patriot. Me një vetëdije të lartë kombëtare, i shtyrë nga dëshira e flaktë për arsimimin e shqiptarëve, për disa vite rresht ligjëroi në Universitetin (siç e quanin jolegal) të Tetovës edhe përskaaj rreziqeve e pasojave që mund të kishte asokohe.<sup>97</sup>

Veprimtaria e prof. Remziut është e pasur dhe e shumëllojshme: lektor – redaktor i një numri të madh (afër 30) veprash të ndryshme letrare, shkencore, kulturore si dhe i shumë teksteve shkollore të botuara në Maqedoni e Kosovë.<sup>98</sup> Pothuajse katër dekada ligjëroi gjuhën shqipe në arsimin e lartë. Për nevojat e shkollimit fillor dhe të mesëm në Maqedoni hartoi disa gramatika. Veprimtaria profesionale e profesor Remziut pasqyrohet edhe në mbi 100 artikuj, studime, shqipërime (mbi 20) e monografi me vlerë shkencore. Ka qenë anëtar i Komitetit Republikan të Arsimit e të Kulturës, anëtar i Pleqësisë Republikane Pedagogjike të Maqedonisë, anëtar i kolegjiimit të Redaksisë së “Jehonës” (përgjegjës dhe redaktor i rubrikës së gjuhësisë), anëtar i Këshillit Redaktues të Teksteve Shkollore në gjuhën shqipe në shtëpinë botuese “Prosvetno Dello”, anëtar i Komisionit Republikan për përsosje kërkimore-shkencore të kuadrit, anëtar i Pleqësisë për përkujdesjen dhe zhvillimin e gjuhës letrare në Radio-Televizionin e Maqedonisë, anëtar i Kolegjiimit redaktues i revistës shkencore “Gjurmime albanologjike”, Prishtinë etj.

Si kryetar i Lidhjes së Shoqatave të Arsimitarëve të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Maqedonisë ishte njëri ndër organizatorët kryesorë për përgatitjen e Konferencës Shkencore për shënimin e 20-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit dhe njëri ndër tre bashkëkryetarët e Konferencës. Takimi, në të cilin morën pjesë gjuhëtarët më në zë të Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë, u mbajt në Tetovë në qershor të vitit 1992. Nga shkrimet e prof. Remziut mund të nxirret porosia se jemi një komb, prandaj duhet të kemi një gjuhë të përbashkët. Ai vazhdimisht ka

<sup>97</sup> Asllan Hamiti, *Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11-18.

<sup>98</sup> Agim Poloska, *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19-28.



shkruar e folur për pastrimin, pasurimin dhe, përgjithësisht, për kulturën e gjuhës në Maqedoni e më gjerë.

Për bashkëpunim profesional të frytshëm dhe të vazhdueshëm me institucionet arsimore e kulturore, prof. dr. Remzi Nesimi është nderuar me disa mirënjohje, diploma e medalje.<sup>99</sup> Për ndihmesën e vyer në gjuhësinë shqiptare, prof. Remzi Nesimi u dekorua me dy medalje të arta: (1) në Akademinë solemne kushtuar 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, mbajtur më 16 e 17 nëntor 2012 në Universitetin “Fan S. Noli” të Korçës, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Tiranë) dhe (2) tjetra në Akademinë solemne kushtuar 104-vjetorit të Kongresit të Alfabetit të gjuhës shqipe, organizuar nga shtëpia e kulturës “Koço Racin” mbajtur më 21 nëntor 2012 në Shkup.

## 2. Ndihmesa e prof. Remziut për planifikimin e shqipes

Jo rastësisht prof. Remzi Nesimi moto të referatit të lexuar në Kongresin e Drejtshkrimit,<sup>100</sup> me titull “Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni” kishte vënë thënien e prof. Aleksandër Xhuvanit: *“Njësia e gjuhës është njësia e kombit”*. Në të mund të lexojmë se: *“Sikurse në qendra të ndryshme – në Stamboll, në Bukuresht etj., ashtu edhe në Maqedoni janë bërë mjaft përpjekje për zhvillimin e shqipes letrare. Sidomos një vend të rëndësishëm në këtë proces, përkatësisht në krijimin e alfabetit përfundimtar të shqipes, zë edhe Manastiri, i cili prej kohësh ka qenë qendër e njohur kulture në Gadishullin Ballkanik. Një vit pas mbajtjes së Kongrtesit të Manastirit ..., Shoqëria botuese letrare e po këtij qyteti botoi edhe Abetaren e njëjës nga pedagoget e para të arsimit kombëtar, Parashqevi Qiriazi. Dhe jo vetëm kaq. Në këtë vend e në qendrat e tjera vepruan edhe mjaft shoqëri kulturore; u botuan gazeta, siç janë “Kosova” (1908) e “Shkupi”, që dilnin në Shkup. Por për shkak të rrethanave të njohura historike, për më se 30 vjet, sikurse në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, u shua çdo gjurmë e kultures kombëtare. Vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, krahas me*

<sup>99</sup> Qani D. Mehmeti, *Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115-125.


<sup>100</sup> Mr. Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimin të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.

*hapjen e shkollave në gjuhën shqipe prej fillores e gjer në shkollat e larta, filloi tek ne edhe veprimtaria e gjerë botuese në gjuhën shqipe. “*

*Prof. Remziu në këtë punim me vlerë jep edhe historikun e veprimtarisë botuese, përpjekjet për një shqipe të njësuar në Maqedoni etj.: “Që në vitet e para pas çlirimit të ne u krijuan dy qendra kulture: Prishtina në Kosovë dhe Shkupi në Maqedoni. Në të dyja këto qendra u zhvillua edhe një veprimtari botuese. Përveç shumë teksteve shkollore, në Shkup filloi të dalë “Flaka e vëllazërimit”, në Prishtinë “Rilindja” e më vonë edhe revista e botime të tjera. Ndonëse në këto dy qendra gjer më 1968 u përdor gegërishtja letrare, në pikëpamje ortografike kjo gegërishte nuk ka qenë krejtësisht e njëjtë. Kjo është e kuptueshme kur të marrim parasysh se edhe në Republikën Popullore të Shqipërisë për disa vjet, edhe pas çlirimit, u përdor një drejtshkrim jo i njësuar, sepse njësimi i ortografisë varet edhe nga njësimi i normës së gjuhës së shkruar, e kjo nga vetë kushtet historike të zhvillimit kulturor të një populli”... Ndonëse në Maqedoni, përkatësisht në kryeqendrën e saj, pas çlirimit nuk është mbajtur ndonjë sesion shkencor mbi gjuhën, çështjes së gjuhës letrare gjithnjë i është kushtuar një vëmendje e veçantë. Parimi themelor i ntektualëve tanë gjithnjë ka qenë që të ndiqet ajo ortografi dhe bile edhe ajo gjuhë që përdoret në vendin ëmë... Prandaj në Maqedoni si në shkolla ashtu edhe në teatër, në shtyp e në radio edhe para vendosjes së një gjuhe letrare të njësuar është përdorur gjuha dhe ortografia e variantit letrar verior të mesëm. Përveç faktit që pjesa më e madhe e të folmeve shqipe të Maqedonisë bëjnë pjesë në zonën e Gegërisë së Mesme e një pjesë në dialektin jugor, procesin e njësimimit të gjuhës së shkruar sipas variantit letrar të mesëm e ndihmuan mjaft edhe një numër i madh arsimtarësh ish-normalistë të Elbasanit, si dhe të krahinave të tjera jugore të Shqipërisë që shërbyen vite me radhë në qendra të ndryshme të Maqedonisë – në Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Strugë etj. Për shërbimet e tyre të mëdha të gjithë këta punonjës të zellshëm meritojnë respektin dhe mirënjohjen tone të thellë. E gjithë kjo flet se në Maqedoni, qysh kur filloi të përdoret gjuha letrare, kemi pasur një ecuri paralele si me drejtshkrimin, ashtu edhe me gjuhën letrare të përdorur në vendin ëmë. Në vitet e para u përdor drejtshkrimi që qe përdorur në tekstet gramatikore të profesor A. Xhuvanit, pastaj ortografia që u botua më 1948, drejtshkrimi i vitit 1951 dhe më në fund Ortografia e gjuhës shqipe e vitit 1956... Punonjësit e arsimit dhe të kulturës në Maqedoni,*

*kurdoherë kanë qenë ihtarë për një drejtshkrim të njësuar si dhe për një shqipe të njësishtme letrare kombëtare. Për këtë edhe shtypi ka mbajtur gjithnjë qëndrim korrekt... ”<sup>101</sup>*

### 3. “E folmja e Dervenit” e prof. Remzi Nesimit – monografi shteruese me vlerë të madhe për dialektologjinë shqiptare



Të folmet shqipe në Maqedoni të profesor Remziu kanë zgjuar interes të posaçëm që nga rinia e tij. Punimi i magistraturës “*Veçoritë fonetike të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*” (Beograd, 1971, dorëshkrim) dhe disertacioni i doktoratës “*E folmja e Dervenit*” (Prishtinë, 1988) janë studime të mirëfillta dialektologjike. Niveli i lartë shkencor dëshmohet edhe me studimet e botuara “*Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të*

*Tetovës*”, “*Kategoria e numrit të emrave në të folmen e Dervenit*”, “*Diftongimi i zanoreve të theksuara i dhe u në të folmen e Dervenit*” etj.

Në një periudhë trevjeçare (gjatë viteve 1995–1997) për vjeljen e pasurisë së gjuhës së popullit, zotëri Remziu, në bashkëpunim me disa anëtarë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Shkupit (Haki Ymeri, Zihni Osmani, Agim Poloska, Asllan Hamiti) dhe Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Tiranës (Bahri Beci, Çlirim Bidollari), udhëhoqi një projekt kërkimor-shkencor dhe mblodhi material dialektor në pika të ndryshme të të folmeve shqipe në Maqedoni.

Zelli dhe përkushtimi i madh i prof. Remziut në kërkimet dialektologjike u kurorëzua me botimin e monografisë së mirëfilltë “E

<sup>101</sup> Mr. Remzi Nesimi (Shkup), *Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.

folmja e Dervenit” botuar më vitin 2008 nga Universiteti Shtetëror i Tetovës.<sup>102</sup>

Vepra “E folmja e Dervenit”<sup>103</sup> është një monografi e gjerë përshkuese gjithëpërfshirëse me afër 500 faqe tekst kushtuar një të folmeje të pastudiuar, madje pak ose aspak të njohur më parë në kërkimet dialektologjike. Kjo monografi shteruese plotëson një mungesë të ndjeshme të studimeve dialektologjike për të folmet shqipe në Maqedoni.

Në këtë studim përshkruhet në hollësi e folmja e Dervenit në të gjitha sistemet gjuhësore: në fonetikë e fonologji, në morfologji, fjalëformim, sintaksë, frazeologji dhe leksik, duke hartuar edhe një fjalor dialektor. Në fund janë dhënë tekste autentike, një përmbyllje dhe literatura e konsultuar me mbi 240 njësi bibliografike.

Punimi fillon me një hyrje ku përcaktohet qartë objekti i studimit e më pas përmenden studiuesit që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë bërë fjalë për të folmet shqipe në Maqedoni. “Toponimi *Derven*, - thotë autori -, sikurse edhe toponimet e tjera, si *Derventa* – qytet i vogël në Bosnjë, *Derven* – fshat në Fushë Krujë të Shqipërisë etj., është formuar nga emri i përgjithshëm, përkatësisht nga kompozita *Der-bent* < *der* “derë” + *bent* “lidh”, që në persishte do të thotë ngushticë apo vendkalim në vende malore. Me këtë kuptim përdoret edhe në gjuhët e tjera ballkanike: në greqishte, bullgarishte, serbishte e maqedonishte. Fjala *Derven*, në serbishte e maqedonishte e ka kuptimin edhe fortesë e postërojë në grykë apo në vendkalim malor.”

Me saktësi shkencore janë përcaktuar edhe pozita gjeografike dhe kufijtë e Dervenit. Është vënë re se ai paraqet një tërësi gjeografike, gjuhësore dhe etnografike. Nga të dhënat e shumta që na i sjell autori, u përpoqëm të bënim këto përgjithësime: Derveni shtrihet në një sipërfaqe prej afro 224 km<sup>2</sup> (saktësisht 223.8 km<sup>2</sup>), në një territor me relief të thyer me disa lugina dhe male me maja relativisht të larta, ndërmjet rrjedhës së dy lumenjve – të Treskës në anën jugore dhe të Vardarit në anën veriperëndimore dhe verilindore. Ky territor gjeografik me 27 fshatra shtrihet ndërmjet Shkupit dhe Tetovës, përkatësisht Derveni i Poshtëm me 16 katunde në pikëpamje administrative i takon Shkupit,

<sup>102</sup> Prof. dr. Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, 2008, 495 faqe.

<sup>103</sup> Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, Tetovë, 2008.

ndërsa Derveni i Epërm me 11 katunde i përket Tetovës. Në këtë region jetojnë mbi 30.000 banorë pothuajse tërësisht shqiptarë. Vetëm dy fshatra: Shishova dhe Matka janë me popullsi të përzier, ndërsa 25 vendbanimet e tjera janë të banuara vetëm me shqiptarë.

Popullsia e Dervenit është marrë dhe merret kryesisht me bujqësi dhe blegtori, tregti e kurbet në shtetet e Evropës dhe në republikat e Jugosllavisë së dikurshme. Tani disa janë të punësuar edhe në ndërmarrje e administratë publike në Shkup e në Tetovë.

Materialin dialektor profesori e voli me vrojtim të drejtpërdrejtë në të gjitha pikat e rajonit. Krahas pyetësorëve që ekzistojnë, për dukuritë specifike, sidomos në fushë të fonetikës siç është diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara, qiellzorizimi i /g/-së, grupeve pl, bl, fl; afrikatizimi i /gj/-së dhe i /q/-së etj. dhe për disa çështje të morfologjisë, si për formimin e shumësit tek emrat, për fjalëformimin etj. autori ka përgatitur pyetësorë të veçantë. Në pikat e eksploruara është mbledhur edhe material folklorik si dhe toponimet e vendbanimeve, të cilat janë shfrytëzuar si lëndë gjuhësore.

Sipas tipareve gjuhësore, - me të drejtë konstaton autori -, e folmja e Dervenit i përket të folmeve lindore të gegërishtes qendrore. Këtë të folme, si edhe pjesën më të madhe të të folmeve të arealit të gegërishtes qendrore, e karakterizojnë disa veçori fonetike e morfologjike që e dallojnë nga të gjitha të folmet e tjera shqipe.

Sistemi fonetik i kësaj të folmeje është përshkruar në hollësi. Aty në mënyrë analitike janë shpjeguar theksi, gjatësia dhe hundorësia e zanoreve. Me një saktësi të madhe shkencore është përshkruar çdo zanore e bashkëtingëllore, duke dhënë shembuj të shumtë për dendurinë, përndarjen dhe ndërrimet me tinguj të tjerë. Nga vepra mund të nxjerrim si përfundim se disa veçori të kësaj të folmeje janë mbarëdialektore, por ka edhe nga ato që i përkasin gegërishtes qendrore si dhe një numër dukurish që kanë shtrirje më të kufizuar.

Me interes për t'u përmendur është se dukurinë e shpërbërjes së zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara në këtë të folme, autori e ka shtjelluar më hollësisht se çdokush deri më tani, duke studiuar të gjithat kushtet fonetike: pozicionin në fjalë dhe fqinjësinë me tinguj të tjerë mbi një fond leksikor shumë të pasur. Dukuria është vëzhguar në fjalë shqipe e në fjalë të huaja, në emërvende e në emra njerëzish.

Lidhur me fjalëformimin, pas një analize të gjerë, prof. Remziu konstaton se "si në pjesën më të madhe të të folmeve të tjera, ashtu edhe

në këtë të folme, për formimin e fjalëve të reja përdoren afër një e treta e prapashtesave të gjuhës shqipe dhe të atyre që në gjuhën tonë kanë hyrë nga gjuhët e tjera”.

Nga studimi në fjalë mësojmë se në fushë të sintaksës kjo e folme nuk ka ndonjë dallim qenësor nga të folmet e tjera geqe dhe shqipja dialektore në përgjithësi.

Ky libër paraqet interes edhe me kreun për leksikun dhe shprehjet frazeologjike. Në këtë studim të mirëfilltë dialektor jepen edhe mbi 80 njësi frazeologjike që kanë shtrirje të kufizuar ose që njihen vetëm në të folmen e Dervenit.

Pjesën dërmuese të fondit leksikor, shkruan autori, - e përbëjnë fjalët e burimit që përdoren edhe në të folmet e tjera si dhe në gjuhën letrare, por në këtë të folme hasim edhe një numër të konsiderueshëm elementesh leksikore me prejardhje nga gjuhët orientale si dhe nga maqedonishtja që nuk janë karakteristike për mbarë shqipen. Janë sjellë shumë huazime të tilla nga fusha të ndryshme të jetës, të cilat paraqesin interes si për dialektologjinë ashtu edhe për gjuhësinë shqiptare.

Me interes është edhe fjalori i të folmes së Dervenit i radhitur sipas alfabetit. Aty gjejmë edhe shumë fjalë dhe shprehje të rralla, shumica e të cilave janë specifike vetëm për këtë të folme.

Mund të përfundojmë se në këtë studim sillen përshkrime, shpjegime dhe tëhollime me interes. Ai nuk është vetëm një përshkrim i rëndomtë dialektor, por në të gjejmë të gërshetuara analizën e gjendjes së sotme gjuhësore të të folmes, përqsasjen me të folmet e tjera geqe e veçmas me ato të gegërishtes qendrore, shpjegime teorike, duke u mbështetur në literaturën dialektologjike në përgjithësi dhe atë që lidhen me temën në veçanti. Në të jo rrallë autori ka dhënë shpjegime e gjykime origjinale, sidomos rreth kronologjisë së mundshme të dukurive të ndryshme që trajtohen.

Punimi përshkohet nga një stil shkencor, me një gjuhë të pasur dhe tekst të ndërlydhur për lakmi. Një punë e tillë, dëshmon formimin e gjerë e të shëndoshë teorik, praktik dhe metodologjik të autorit.

Profesor Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i zellshëm i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaja, në



veçanti nga elementet sllave. Çështja e pastërtisë së gjuhës dhe zbatimi praktik i normës letrare përbën boshtin kryesor të gjithë veprimtarisë kërkimore në fushë të shqipes. Me çështje gjuhësore fillon të merret që në vitin 1960, kur në faqet e gazetës “Rilindja” boton tre artikuj lidhur me pastërtinë e gjuhës letrare shqipe. Dy vjet para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, përkatësisht që më 1970 në faqet e gazetës “Flaka e Vëllazërimit” që botohej në Shkup, në shtatë numra të njëpasnjëshëm paraqet dhe arsyeton rëndësinë dhe nevojën e konstituimit të një gjuhe të përbashkët letrare dhe standardizimin e saj.

Profesor Nesimin e falënderojmë dhe e përgëzojmë për kontributin që ka dhënë me veprimtarinë e pasur arsimore, shkencore e kulturore. Ai rroi për të jetuar.

#### 4. Përmyllje

Ndihmesa e prof. Remzi Nesimit (25. 12. 1933 – 04. 02. 2018) për arsimin, shkencën, kulturën, emancipimin dhe përparimin e shqiptarëve është shumë e madhe.

U lind në Odër, Tetovë, ku ndoqi edhe mësimet e para, pas gjimnazit studimet universitare dhe pasuniversitare i kreu në Katedrën e Albanologjisë në Beograd, doktoroi në Universitetin e Prishtinës. Pas përfundimit të studimeve, fillimisht ishte lektor dhe redaktor në Redaksinë e botimeve në Prishtinë, pastaj në Redaksinë e “Flakës së vëllazërimit” në Shkup. Nga viti 1962 filloi veprimtarinë arsimore: lektor i gjuhës shqipe në Katedrën e Albanologjisë në Universitetin e Beogradit, njëmbëdhjetë vjet profesor i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike të Shkupit dhe njëzetepesë vjet në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin e Tetovës dhe në Fakultetin e Shkencave Islame. Remzi Nesimi ishte pedagog i shquar i gjuhës shqipe, i afërt dhe shumë i dashur. Është shembëlltyrë që edukon dhe frymëzon gjeneratat e reja.

Krahas veprimtarisë studimore e shkencore nga fusha e gjuhës shqipe (drejtshkrim, gramatikë, dialektologji, etj.) është autor ose bashkautor i mbi 20 teksteve shkollore, 100 punimeve shkencore, monografive, pjesëmarrjeve në konferenca e shumë veprimtari të tjera. Ishte pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 1972.

Nga karakteri ishte i sinqertë, bujar, besnik, zemërgjerë, human,

arsimdashës, largpamës, patriot. Mbolli e shpërndau dije, arsim, kulturë, shkencë, mençuri, urtësi. Qindra e mijëra studentë, gazetarë, mjekë, teologë, kolegët e Katedrës dhe gjithë intelektualët e tjerë shqiptarë jemi fryt i punës gjysmëshekullore të këtij kolosi të madh të arsimit e të shkencës shqiptare.

Profesor Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i dalluar i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaj.

Më se gjysmë shekulli, përkatësisht që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar me përkushtim e vetëmohim ka punuar për ngritjen e përgjithshme arsimore e kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë, për të lëvruar, kodifikuar dhe përpunuar shqipen standarde.

Nga pjesëmarrja në Kongresin e Drejtshkrimit, nga ligjërimet e shkrimet e prof. Remziut mund të nxirret porosia se jemi një komb, prandaj duhet të kemi një gjuhë të përbashkët. Ai vazhdimisht ka shkruar e folur për pastrimin, pasurimin dhe, përgjithësisht, për kulturën e gjuhës në Maqedoni e më gjerë.

Për veprimtarinë e frytshme dhe të vazhdueshme arsimore, shkencore e kulturore, prof. dr. Remzi Nesimi është nderuar me shumë mirënjohje, diploma e medalje. Falë veprimtarisë së atdhetarëve tanë, ku bën pjesë edhe profesori ynë, ne i kemi bërë ballë politikës asimiluese. Profesori ynë rroi për të jetuar.

Prof. Remzi Nesimi iku në amshim. Por, ai gjithmonë do të mbetet me ne: me bashkëshorten Hatixhen, djalin Ilirin e profesoreshë Valbonën; me studentët e tij, kolegët, me arsimin e me shkencën shqiptare.

Lum ne që të patëm e do të kemi përgjithmonë profesori ynë!  
Prehu në paqe!

### **Literatura e konsultuar:**

Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten – Osmani, Ismet: *Kontributi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia për shqipen standarde*, “Akademi solemne në 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të



- gjuhës shqipe”, Korçë, 16-17 nëntor 2012.
- Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e profesor Remzi Nesimit për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare*, „Filologjia”, Revistë Shkencore Ndërkombëtare për Gjuhësi, Letërsi dhe Kulturë, Viti I, prill, 2013, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2013, f. 101-109.
- Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010, f. 79-84.
- Hamiti, Asllan: *Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11-18.
- Хамити, Аслан: *Научно-образовниот профил на проф. Ремзи Несими*, Годишен Зборник на Филолошкиот факултет “Блаже Конески”, книга 39-40, Скопје, 2014, f. 21-36.
- Mehmeti, D. Qani: *Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115-125.
- Nesimi, Mr. Remzi (Shkup): *Procesi i njësimit të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.
- Nesimi, Remzi: *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997.
- Nesimi, Remzi: *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, 2008.
- Nesimi, Remzi: *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327-352 dhe Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987.
- Nesimi, Remzi, *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972.
- Poloska, Agim: *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19-28.
- Шаини, Флорије: *Ремзи Несими и албанската лингвистика* (punim magjistrature mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup), Shkup, 2012.

5. BIBLIOGRAFIA E PËRZGJEDHUR E PROF. DR. REMZI NESIMIT<sup>104</sup>

1960

- Nesimi, Remzi: *Me diplomue apo me u diplomue*, Rilindja, Prishtinë, 15. 05. 1960, 13.
- Nesimi, Remzi: *Me shërbye apo me përdorë*, Rilindja, Prishtinë, 17. 7. 1960, 12.
- Nesimi, Remzi: *I falënderohem shokut apo e falënderoj shokun*, Rilindja, Prishtinë, 1960, 14.

1962

- Cankar, Ivan: *Teatarski iskri*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1962.

1967

- Nesimi, Remzi: *Mbi përdorimin e presjes në gjuhën shqipe*, Jehona 7, Shkup, 1967.
- Nesimi, Remzi: *Diçka rreth përdorimit të drejtë të paskajores në gjuhën e unifikuar*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup: 4. 04. 1970, 14.

1968

- Nesimi, Remzi: *Disa çështje rreth projektit të drejtshkrimit të shqipes*, Flaka e Vëllazërimit, 01.05. 1968, 12.
- Nesimi, Remzi: *A. Desnickaja - Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 06. 03. 1969, 12.
- Nesimi, Remzi: *Diçka rreth përdorimit të drejtë të paskajores në gjuhën e unifikuar*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 04. 04. 1970, 10.
- Nesimi, Remzi: *Ç'thotë profesori i shqipes*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 29. 01. 1970; 05. 02. 1970; 12. 02. 1970; 19. 02. 1970; 26. 02. 1970; 05. 03. 1970; 12. 03. 1970.

---

<sup>104</sup> Poloska, Agim: *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19-28.

1972

- Nesimi, Remzi: *Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore me mbaresën -e*, Jehona 6, Shkup, 1972.
- Nesimi, Remzi: *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen e Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972, 56-69.
- Nesimi, Remzi: *Procesi i njësimit të shqipes letrare në Maqedoni*, Mësuesi, Tiranë, 3 dhjetor, 1972.
- Nesimi, Remzi: *Disa çështje rreth projektit të drejtshkrimit të saj*, Probleme të gjuhës letrare dhe të drejtshkrimit të saj (Studime dhe artikuj) II, Tiranë, 1972, 419-424.
- Nesimi, Remzi: *Përdorimi i zanores ë në të folmet shqipe të rrethit të Tetovës*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 03. 03. 1972, 11.
- Nesimi, Remzi: *Studime nga dialektologjia shqiptare* (intervistë), Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 03. 03. 1972, 12.
- Nesimi, Remzi: *Për një gjuhë kristale, stabile* (intervistë), Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 10. 12. 1972, 12.

1973

- Nesimi, Remzi: *Procesi i njësimit të shqipes letrare në Maqedoni*, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës shqipes I, (20-25 nëntor 1972), Tiranë, 1973, 281-287; dhe në Studime Filologjike, Tiranë, 119-122.
- Nesimi, Remzi: *Le processus de l'unification de l'albanais litteraire dans la Macedoine*, Le Congres de l'orthographe de la langue albanaise, Tirana, 1973, 285-292.

1976

- Nesimi, Remzi: *Gramatika e gjuhës shqipe për kl. IV fillore* (bashkautor me: Gega, Xhevat - Reka, Hamza), Prosvetno Dello, 1976, 134.
- Nushiq, Branisllav: *Svet*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1976, 108.
- Nushiq, Branisllav: *Dr*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1976.

1977

- Nesimi, Remzi: *Disa veçori strukturore dhe fonetike të toponimeve*

*të rrethit të Tetovës*, 25 години албански јазик на Филолошки факултет во Скопје 1951-1976, Скопје, 1977, 35-42.

- Nesimi, Remzi: *Gjuha jonë*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 03. 04. 1977.
- Nesimi, Remzi: *Doli-dual*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 27. 04. 1977.
- Nesimi, Remzi: *Kam pasur - kam patur*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 29. 04. 1977.
- Nesimi, Remzi: *Punoja - punonja*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 11. 05. 1977.
- Nesimi, Remzi: *Njoh - njohtoj*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 01. 06. 1977.
- Hadžić, Fadil: *Političko venčanje*. Përktheu: Nesimi Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1977.

#### 1978

- Nesimi, Remzi: *Kontributi i Vaso Pashës si gjuhëtar*, Jehona 2, Shkup, 1978, 83-92.
- Nesimi, Remzi: *Mbi disa veçori të sistemit të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (dialektologji), Prishtinë, 1978, 327-352 dhe në Dialektologjia shqiptare V, ASHRPS e Shqipërisë, Tiranë, 1987, 176-203.
- Nesimi, Remzi: *Gramatika e gjuhës shqipe për kl. V filllore*, Prosvetno Dello, Shkup, 1978, 108.

#### 1979

- Nesimi, Remzi: *Gramatika e gjuhës shqipe për kl. VI të shkollës filllore*, Prosvetno Dello, Shkup, 1979, 118.
- Shtainbek, Johan: *Minjtë dhe njerëzit*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1979, 97.

#### 1980

- Nesimi, Remzi: *Aleksandër Xhuvani në vazhden e traditave përparimtare të Rilindjes* (në 100 vjetorin e lindjes), Jehona 2-3, Shkup, 1980, 127-135.
- Nesimi, Remzi: *Prof. Eqrem Çabej - erudit dhe personalitet i shquar shkencor*, Jehona 7, Shkup, 1980, 606-610.
- Nesimi, Remzi: *V. Dançetoviqi dhe veprimtaria e tij pedagogjike e shkencore*, Jehona 3, Shkup, 1980, 35-40.

- Nesimi, Remzi: *Flaka dhe shqipja letrare te ne*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 04. 04. 1980.
- Nesimi, Remzi: *Eqrem Çabej - babai i albanologjisë*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 17. 08. 1980.
- Babić, Lubinka: *Familja blo*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1980, 86.
- Nesimi, Remzi: *Gramatika e gjuhës shqipe për kl. VI* (bashkautor me Hamza Rekën), Prosvetno Dello, Shkup, 1980.

1981

- Несими, Ремзи: *Некои македонски и српско-хрватски калки во средствата за јавно информирање*, Јазикот во јавнатата комуникација, Зборник на трудови поднесени на Конференцијата одржана во Скопје од 21 до 23. 10. 1979 година, Скопје, 1981, 50-55.
- Nesimi, Remzi: *Libër leximi për klasën V të shkollës fillore*, Prosvetno Dello, Shkup, 1981,84.
- Nesimi, Remzi: *Libër leximi për klasën VI të shkollës fillore*, Prosvetno Dello, Shkup, 1981, 92.
- Nesimi, Remzi: *Libër leximi për klasën VII të shkollës fillore*, Prosvetno Dello, Shkup, 1981, 83.
- Nesimi, Remzi: *Libër leximi për klasën VIII të shkollës fillore*, Prosvetno Dello, Shkup, 1981, 104.
- Kameloti, Mark: *Stjuardesat*, Përktheu: Nesimi, Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1981, 84.

1982

- Nesimi, Remzi: *Gramatika e gjuhës shqipe për klasën VIII të shkollës fillore*, Prosvetno Dello, Shkup, 1982, 84.
- Pendovski, Branko: *Pasardhësit*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1982, 96.
- Sekullovski, Klime: *Dituri natyre dhe shoqërie për kl. II*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Prosvetno Dello, Shkup, 1982.

1983

- Несими, Ремзи: *Некои етнографски елементи на албанската народност, Тетово и Тетовско во минатото*, Тетово, 1983, 236-248.

- Turbeshiq, Tomo: *Raspuçin*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Teatri i Kombësive, Shkup, 1983, 79.

1984

- Nesimi, Remzi: *Më tepër kujdes folklorit tonë*, Jehona, Shkup, 1984, 95-100.
- Поповић, С. Јован. *Зла жена*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Prosvetno Dello, Shkup, 1984, 86.

1985

- Filip, Aco: *Bisedë me portrete*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1985, 145.

1986

- Nesimi, Remzi: *Fjalorth shqip - greqisht (albano-eleniko leksikon)*, Shkolla e Lartë Pedagogjike "Skënderbeu", Gjilan, 1986, 104.
- Ивановски, Иван: *Тетипарски искри*. Përktheu: Nesimi, Remzi, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 1986, 160.

1987

- Nesimi, Remzi: *Emrat me dy gjini në gjuhën shqipe*, Jehona 10, Shkup, 1987, 64-73.
- Nesimi, Remzi: *Disa elemente shqipe në të folmet e maqedonishtes Perëndimore*, Çështje të studimeve albanologjike (materiale nga simpoziumi shkencor i mbajtur në Prishtinë më 20 dhe 21 dhjetor 1985) I, IAP, Prishtinë, 1987, 139-150.

1989

- Несими, Ремзи – Шушка, Ѓ.: *Учебник по албански јазик*, Универзитет "Св. Кирил и Методиј", Скопје, 1989, 356.
- Несими, Ремзи: *Некои описувања од литературна норма во емисиите на албански јазик при РТВ Скопје*, Петти Конгрес на друштвата за споредбена лингвистика на Југославија, Упорabno jzikoslovje Saveza drustev za uporebno jezikoslovje, Ljubljana, 1989, 316-325.
- Nesimi, Remzi: *E folmja e Dervenit* (disertacion i doktoraturës), Fondi i Fakultetit Filozofik në Prishtinë, Prishtinë, 1989, 449.
- Nesimi, Remzi: *Fjalë të rralla nga e folmja e Dervenit*, Gjuha shqipe 2, IAP, Prishtinë, 1989, 81-84.
- Nesimi, Remzi: *Disa elemente shqipe në veprat e zgjedhura të*

*Kuzman Shapkarevit, Jehona 6, Shkup, 1989, 45-55.*

- Nesimi, Remzi: *Fjalori i parë shqip-slllovenisht*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 08. 01. 1989.
- Nesimi, Remzi: *Konferencë e rëndësishme shkencore ndërkombëtare kushtuar gjuhës shqipe*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 29. 10. 1989.

1990

- Nesimi, Remzi: *Kategoria e numrit të emrave në të folmen e Dervenit*, Gjurmime albanologjike - seria filologjike 19 - 1989, IAP, Prishtinë, 1990, 151-167.
- Nesimi, Remzi: *Homazh mësuesit të popullit*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 21. 09. 1990, 12.
- Nesimi, Remzi: *Sërish për toponimet*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 26. 10. 1990.
- Nesimi, Remzi: *Disa ndërtime të gabueshme me paskajoren dhe pjesoren*, Jehona 6, Shkup, 1990, 78-86.
- Nesimi, Remzi: *Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore në të folmen e Dervenit*, Gjurmime albanologjike (seria e shkencave filologjike), Prishtinë, 1990.
- Nesimi, Remzi: *Absurdi i një informimi*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 26. 10. 1990, 12.

1991

- Nesimi, Remzi: *Koloriti gjuhësor në poezinë e Naimit*, Jehona 1, Shkup, 1991, 79-89.
- Nesimi, Remzi: *Studimi i shqipes në institucionet e larta dhe hapësira dialektologjike në Maqedoni* (intervistë), Fjala, Prishtinë, 11. 03. 1991, 12.

1992

- Несими, Ремзи: *Учиме македонски* (коавтори: Мишковски, Драган – Велјановски, Војо), Просветно дело, Скопје, 1992, 93.
- Nesimi, Remzi: *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme I* (fonetika, leksikologjia dhe morfologjia), Shkup, Prosvetno Dello, 1992.
- Nesimi, Remzi: *Nuk pajtohem që gjuha shqipe të ketë status inferior* (intervistë), Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 24. 04. 1992, 11.

1993

- Nesimi, Remzi: *Ndikimi i gjuhëve sllave të jugut në strukturat e gjuhës shqipe në masmediumet në Maqedoni*, Flaka e Vëllazërimit, Shkup: 07. 09. 1993, 12.
- Nesimi, Remzi: *Kontributi i Sami Frashërit për gjuhën e shkruar shqipe I, II, III*; Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 15. 12. 1993; 17. 12. 1993; 19. 12. 1993.

1994

- Nesimi, Remzi: *Mjetet e informimit në gjuhën shqipe në Maqedoni*, Shqiptarët e Maqedonisë, Meshihati i Bashkësisë Islame në Maqedoni, Shkup, 1994, 539-544.

1995

- Nesimi, Remzi: *Disa tipare gjuhësore në veprën e Haki Stërmillit*, Jehona, Shkup, 1995.

1996

- Nesimi, Remzi: *Thirrori në lirikën e Naimit*, Jehona 5-6, Shkup, 1996.
- Nesimi, Remzi: *Voisllav Dançetoviqi - pedagog dhe studiues i gjuhës shqipe*, Kontribute të albanologëve të huaj për përvetësimin e shqipes, Universiteti i Shkodrës, Shkodër, 1996.

1997

- Nesimi, Remzi: *Çështje gjuhësore*, Shkupi, Shkup, 1997.

2001 e këndej

- Nesimi, Remzi - Toska, Valbona: *Gramatika e gjuhës shqipe për shkollat e mesme II (sintaksa)*, Shkup, 2001.
- Nesimi, Remzi - Toska, Valbona: *Shqipja standarde dhe gjendja aktuale e përdorimit të saj*, Kolegji Iliria, Prishtinë, 2010.
- Nesimi, Remzi - Toska, Valbona: *Shqipja standarde në Republikën e Maqedonisë*, Konferencë shkencore, Korçë, 2012.



### 3.6. PROFESOR REMZI NESIMI – STUDIUES I TË FOLMEVE SHQIPE NË MAQEDONI

#### Abstrakt

Të folmet shqipe në Maqedoni te profesor Remziu kanë zgjuar interes të posaçëm që nga rinia e tij. Punimi i magistraturës “*Veçoritë fonetike të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*” (Beograd, 1971) dhe disertacioni i doktoratës “*E folmja e Dervenit*” (Prishtinë, 1988) janë studime të mirëfillta dialektologjike. Niveli i lartë shkencor dëshmohet edhe me studimet e botuara “*Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*”, “*Kategoria e numrit të emrave në të folmen e Dervenit*”, “*Diftongimi i zanoreve të theksuara i dhe u në të folmen e Dervenit*” etj.

Në një periudhë trivjeçare (gjatë viteve 1995-1997) për vjeljen e pasurisë së gjuhës së popullit, zotëri Remziu, në bashkëpunim me disa anëtarë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Shkupit (H. Ymeri, Z. Osmani, A. Poloska, A. Hamiti) dhe Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Tiranës (B. Beci, Ç. Bidollari), udhëhoqi një projekt kërkimor-shkencor dhe mblodhi material dialektor në pika të ndryshme të të folmeve shqipe në Maqedoni.

Zelli dhe përkushtimi i madh i prof. Remziut në kërkimet dialektologjike u kurorëzua me botimin e monografisë së mirëfilltë “*E folmja e Dervenit*” botuar më vitin 2008 nga Universiteti Shtetëror i Tetovës. Vepra “*E folmja e Dervenit*” është një monografi e gjerë përshkruese gjithëpërfshirëse me afër 500 faqe tekst kushtuar një të folmeje të pastudiuar, madje pak ose aspak të njohur më parë në kërkimet dialektologjike. Kjo monografi shteruese plotëson një mungesë të ndjeshme të studimeve dialektologjike për të folmet shqipe në Maqedoni.

**Fjalët çelës:** dialektolog, e folme, monografi, projekt, prurje, vlerë

Është nder dhe kënaqësi të thuash diçka për veprimtarinë pedagogjike, arsimore, shkencore e kulturore të figurave tona të shquara. Kam pasur fatin të jem student, magjistrant, doktorant e më pas bashkëpunëtor, koleg dhe mik i zotëri Remziut.

Prof. Remzi Nesimi ishte pedagog i shquar i gjuhës shqipe, i afërt dhe shumë i dashur. Është shembëlltëror që edukon dhe frymëzon gjeneratat e reja. Krahas veprimtarisë studimore e shkencore nga fusha e gjuhës shqipe (drejtshkrim, gramatikë, dialektologji etj.), ai është autor ose bashkautor i mbi 20 teksteve shkollore, 100 punimeve shkencore, monografive si dhe mori pjesë në shumë konferenca e veprimtari të tjera shkencore, pedagogjike, shoqërore e kulturore. Ishte pjesëmarrës i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe më 1972 në Tiranë.

Prof. Remzi Nesimi me një zë të veçantë është përfaqësuar edhe në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar hartuar nga gjuhëtari i shquar Emil Lafe, me këtë tekst: “Nesimi Remzi (1933 – 2018 A.H.). Gjuhëtar, profesor. Lindi në fshatin Odri të Tetovës. Kreu gjimnazin në Tetovë. Ndoqi studimet e larta dhe u diplomua për albanologji në Universitetin e Beogradit (1960); po aty përfundoi edhe studimet pasuniversitare (1971). Mbrojti doktoratën në Universitetin e Prishtinës (1989). Ka punuar si lektor i gjuhës shqipe në katedrën albanologjike të Univesrsitetit të Beogradit (1962-1964), pedagog i gjuhës shqipe në Akademinë Pedagogjike në Shkup (1964-1975), profesor në katedrën e gjuhës dhe letërsisë shqiptare në Universitetin e Shkupit (1975-1999). R. N. Është marrë me studimin e të folmeve shqipe të Maqedonisë, ka shkruar disertacionin e doktoratës për të folmen shqipe të Dervenit dhe ka drejtuar projektin “Të folmet shqipe në Maqedoni”; në këtë kuadër ka hulumtuar edhe ndikimin e shqipes në të folmet e maqedonishtes. R. N. ka shkruar një varg punimesh e artikujsh nga fusha e gramatikës, onomastikës, kulturës së gjuhës etj.; ka botuar përmbledhjen “Çështje gjuhësore” (Shkup 1996); është bashkautor në dy tekste universitare për mësimin e gjuhës shqipe për serbët dhe maqedonasit dhe një vargu tekstesh shkollore për gjuhën e letërsinë shqipe në Maqedoni. Si delagat në Kongresin e Drejtshkrimit (shih) ka mbajtur referatin “Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni.”<sup>105</sup>

Nga karakteri ishte i sinqertë, bujar, besnik, zemërgjerë, human, arsimdashës, largpamës, patriot. Mbolli e shpërndau dije, arsim, kulturë, shkencë, mençuri, urtësi. Qindra e mijëra studentë, gazetarë, mjekë, teologë, kolegët e Katedrës dhe gjithë intelektualët e tjerë shqiptarë jemi fryt i punës gjysmëshekullore të këtij kolosi të madh të arsimit e të shkencës shqiptare.

<sup>105</sup> Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, *Fjalor Enciklopedik Shqiptar (vëllimi III, N-ZH)*, Tiranë, 2009, f. 1837.

Profesor Remziu është pishtar i arsimit të lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni si dhe studiues i dalluar i shqipes. Me punën e frytshme arsimore, shkencore e kulturore ka dhënë ndihmesë shumë të çmuar për përvetësimin e normës letrare në shkollat shqipe, në mediet e shkruara dhe elektronike në Maqedoni dhe përgjithësisht për kultivimin, pasurimin, ruajtjen e pastërtisë së shqipes nga elementet e huaj.

Më se gjysmë shekulli, përkatësisht që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar me përkushtim e vetëmohim ka punuar për ngritjen e përgjithshme arsimore e kulturore dhe të vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar në Maqedoni e më gjerë, për të lëvruar, kodifikuar dhe përpunuar shqipen standarde.

Nga pjesëmarrja në Kongresin e Drejtshkrimit, nga ligjërimet e shkrimet e prof. Remziut mund të nxirret porosia se jemi një komb, prandaj duhet të kemi një gjuhë të përbashkët. Ai vazhdimisht ka shkruar e folur për pastrimin, pasurimin dhe, përgjithësisht, për kulturën e gjuhës në Maqedoni e më gjerë.

\*\*\*

Në këtë kumtesë kemi vëzhguar veprimtarinë shkencore të prof. Remzi Nesimit në fushën e dialektologjisë shqiptare, e veçmas në studimin e të folmeve shqipe në Maqedoninë e Veriut. Jemi përqendruar në studimin *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, në monografinë *E folmja e Dervenit* dhe në projektin kërkimor-shkencor për vjeljen e materialit dialektor të të folmeve shqipe në Maqedoni.

**1. Studimi “Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës”** jo rastësisht u botua nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327-352 dhe u ribotua në Dialektologjia shqiptare V, nga ASHRPS e Shqipërisë, Tiranë, 1987, f. 176-203.

Në këtë studim përshkruhet në hollësi (edhe pse prof. Remziu me modesti e thotë disa veçori) sistemi vokalik i mbi 60 fshatrave të rrethit të Tetovës. Këtu lexuesi që në fillim të tekstit gjen të dhëna të rëndësishme historike, etimologjike, etnografike, sociolinguistike, statistikore, arsimore e ekonomike për Pollogun.

Me kompetencë profesionale e saktësi shkencore përshkruhet theksi, hundorësia e zanoreve, duke trajtuar çdo zanore veç e veç nga pikëpamja nyjëtimore, e këmbimit të tyre. Gjerësisht përshkruhen edhe dukuritë fonetike të të folmes shqipe të rrethit të Tetovës: zhbuzorëzimi, diftongimi, monoftongimi i togjeve të zanoreve, përngjashmimi, shpërngjashmimi, shtimi e rënia e tingujve etj. Kjo mënyrë e tillë e përshkrimit të hollësishëm të sistemit zanor të të folmes së Dervenit ka shërbyer e mund të shërbejë edhe në të ardhmen si model i përshkrimit të tipareve fonetike të të folmeve shqipe.

**2. Vepra “*E folmja e Dervenit*”<sup>106</sup> e prof. Remzi Nesimit** është monografi shteruese me vlerë të madhe për dialektologjinë shqiptare. Në këtë studim përshkruhet në hollësi e folmja e Dervenit në të gjitha sistemet gjuhësore: në fonetikë e fonologji, në morfologji, fjalëformim, sintaksë, frazeologji dhe leksik, duke hartuar edhe një fjalor dialektor. Në fund janë dhënë tekste autentike, një përmbyllje dhe literatura e konsultuar me mbi 240 njësi bibliografike.

Punimi fillon me një hyrje ku përcaktohet qartë objekti i studimit e më pas përmenden studiuesit që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë bërë fjalë për të folmet shqipe në Maqedoni. Me saktësi shkencore janë përcaktuar edhe pozita gjeografike dhe kufijtë e Dervenit. Është vënë re se Derveni paraqet një tërësi gjeografike, gjuhësore dhe etnografike.

Materialin dialektor profesori e voli me vërtetë të drejtpërdrejtë në të gjitha pikat e rajonit. Krahas pyetësorëve që ekzistojnë, për dukuritë specifike, sidomos në fushë të fonetikës, siç është diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara, qiellzorizimi i /g/-së, grupeve [pl, bl, fl]; afrikatizimi i /gj/-së dhe i /q/-së etj. dhe për disa çështje të morfologjisë, si për formimin e shumësit tek emrat, për fjalëformimin etj. autori ka përgatitur pyetësorë të veçantë. Në pikat e eksploruara është mbledhur edhe material folklorik si dhe toponimet e vendbanimeve, të cilat janë shfrytëzuar si lëndë gjuhësore.

Sipas tipareve gjuhësore, - me të drejtë konstaton autori -, e folmja e Dervenit i përket të folmeve lindore të gegërishtes qendrore. Këtë të folme, si edhe pjesën më të madhe të të folmeve të arealit të gegërishtes

<sup>106</sup> Prof. dr. Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, Tetovë, 2008, 495 faqe.

qendrore, e karakterizojnë disa veçori fonetike e morfologjike që e dallojnë nga të gjitha të folmet e tjera shqipe.

Sistemi fonetik i kësaj të folmeje është përshkruar në hollësi. Aty në mënyrë analitike janë shpjeguar theksi, gjatësia dhe hundorësia e zanoreve. Me një saktësi të madhe shkencore është përshkruar çdo zanore e bashkëtingëllore, duke dhënë shembuj të shumtë për dendurinë, përndarjen dhe ndërrimet me tinguj të tjerë. Nga vepra mund të nxjerrim si përfundim se disa veçori të kësaj të folmeje janë mbarëdialektore, por ka edhe nga ato që i përkasin gegërishtes qendrore si dhe një numër dukurish që kanë shtrirje më të kufizuar. Për të përfutur idenë e tipareve fonetike e fonologjike të të folmes së Dervenit, kemi shkëputur disa nga to, si:

1. Diftongimi i /i/-së dhe i /ú/-së theksuar në variantet *ai*, *ei*, *ëi* dhe *oi*: *shpi* > *shpai*, *shpei*, *shpëi*, *shpoi*, përkatësisht *cúcë* > *cú:c* > *cauc* dhe *couc*.
2. Nyjëtimi më i përparmë i mesgjuhoreve /q, gj/ deri në shkallën e afrikatizimit të tyre të plotë në /ç, xh/: *qafë* > *ça:f*; *gjak* > *xhak*.
3. Buzorëzimi i /ã/-së hundore në [õ] të hundorëzuar: *hõ:n* < *hãnë*, *nõn* < *nãnë*, *õ* < *ã:sht* etj.
4. Mosshqiptimi i /ë/-së së patheksuar: *fu:sh* < *fushë*, *mo:ll* < *mollë*, *punt* < *punët*, *kmaish* < *këmishë* etj.
5. Zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/: *di* < *dy*, *ki* < *ky* dhe pastaj kjo /i/ i është nënshtruar ligjeve të diftongimit, sipas modelit *fyt* > *fit* > *fajt*, *sy* > *si* > *saj* etj.
6. Rënia ose këmbimi i zanoreve të patheksuara me /ë/-në: *akëll* < *akull*, *petull* < *petëll* etj.
7. Për shkak të ngarkesës së vogël funksionale të kundërvënies fonologjike të çiftit bashkëtingëllor të dridhëseve /r/ ~ /rr/ është rrafshuar ky opozicion dhe në këtë të folme kemi vetëm fonemën /r/.
8. Grupi bashkëtingëllor [nd] përgjithësisht ruhet i plotë, ndërsa togu [mb] përngjashmohet në [m].
9. Prapagjuhorja /g/ qiellzorizohet në [gj], si edhe grupet e bashkëtingëlloreve [pl], [bl] e [fl]: *plak* > *pqak* > *qak*, *flutur* > *ffutër*, *bletë* > *bgje:t* > *gjet* etj.

10. Monoftongimi i togjeve të zanoreve në një zanore të gjatë dhe aty ku është përftuar /i/-ja e gjatë, ajo i është nënshtruar diftongimit. Kështu, togu zanor [ie] te fjalët e tipit *diell*, *miell* si dhe togu [ie] i përftuar nga zhbuzorëzimi i [ye]-së, si *fyell* etj. monoftongohen në /i:/ të gjatë, e pastaj në shumicën e rasteve shpërbëhet në *aj*: *miell* > *mi:ll* > *maïll*, *fyell* > *fi:ll* > *faïll* etj.; ndërsa togu [ue] është më i qëndrueshëm: *grue*, *ka punaue*, *ka laraue*, por *ka shku*: etj.

Me interes për t'u përmendur është se dukurinë e shpërbërjes së zanoreve /i/ dhe /u/ të theksuara në këtë të folme, autori e ka shtjelluar më hollësisht se çdokush deri më tani, duke studiuar të gjithat kushtet fonetike: pozicionin në fjalë dhe fqinjësinë me tinguj të tjerë mbi një fond leksikor shumë të pasur. Dukuria e fonemave është vëzhguar në fjalë shqipe e në fjalë të huaja, në emërve dhe në emra njerëzish.

Me këtë monografi shteruese edhe sistemi morfologjik i të folmes së Dervenit është trajtuar në hollësi. Nga libri mësojmë se në këtë fushë tipare dalluese janë:

1. Përdorimi i mbaresave vetore në njëjës edhe te shumica e foljeve të zgjedhimit të dytë, sipas tipit: un(e) *shkuli*, taï *shkulën*, ai *shkulën*.
2. Veçori e përgjithshme është përdorimi i qiellzores /j/ në vend të alveolares /n/ në vetën e tretë njëjës në të pakryerën te foljet e zgjedhimit të parë: *punojte*, *shkojte* < *punonte*, *shkonte* e në disa fshatra edhe *punojke*, *shkojke*.
3. Kjo e folme dallohet edhe me ndërtimin e habitores mbi bazën e së tashmes e jo të së kryerës, sipas tipit *punojkam* < *punuakam*, *vaikam* < *ardhkam*.
4. Veçori karakteristike që e dallon këtë të folme nga shumë të folme të tjera është edhe përdorimi i disa foljeve apofonike në të kryerën e thjeshtë në formën e së tashmes, por me togun [ie] të reduktuar në [i:] të gjatë dhe pastaj të diftonguar në [ai]: *mbaïlli*, *mbaïlla* < *mbjell*, *mbolla*, *përcaïlli*, *përcaïlla* < *përcjell*, *përcolla*.
5. Në sistemin emëror veçori tipike është se të gjithë emrat e gjinisë mashkullore, pa përjashtim, shquhen duke marrë mbaresën -i,

ndërsa ata të gjinisë femërore mbaresën *-a*, si *ahi, dushki, maiki, zogi* etj. Rrjedhimisht këtu na dalin vetëm dy lakime: lakimi i parë i emrave të gjinisë mashkullore dhe ai i dytë i emrave të gjinisë femërore.

Lidhur me fjalëformimin, pas një analize të gjerë, prof. Remziu konstaton se “si në pjesën më të madhe të të folmeve të tjera, ashtu edhe në këtë të folme, për formimin e fjalëve të reja përdoren afër një e treta e prapashtesave të gjuhës shqipe dhe të atyre që në gjuhën tonë kanë hyrë nga gjuhët e tjera”.

Ky libër paraqet interes edhe me kreun për leksikun dhe shprehjet frazeologjike. Në këtë studim të mirëfilltë dialektor jepen edhe mbi 80 njësi frazeologjike që kanë shtrirje të kufizuar ose që njihen vetëm në të folmen e Dervenit.

Pjesën dërmuese të fondit leksikor, shkruan autori, - e përbëjnë fjalët e burimit që përdoren edhe në të folmet e tjera si dhe në gjuhën letrare, por në këtë të folme hasim edhe një numër të konsiderueshëm elementesh leksikore me prejardhje nga gjuhët orientale si dhe nga maqedonishtja që nuk janë karakteristike për mbarë shqipen. Janë sjellë shumë huazime të tilla nga fusha të ndryshme të jetës, të cilat paraqesin interes si për dialektologjinë ashtu edhe për gjuhësinë shqiptare.

Me interes është edhe fjalori i të folmes së Dervenit i radhitur sipas alfabetit. Aty gjejmë edhe shumë fjalë dhe shprehje të rralla, shumica e të cilave janë specifike vetëm për këtë të folme.

Mund të përfundojmë se në këtë studim sillen përshkrime, shpjegime dhe tëhollime me interes. Ai nuk është vetëm një përshkrim i rëndomtë dialektor, por në të gjejmë të gërshetuara analizën e gjendjes së sotme gjuhësore të të folmes, përjasjen me të folmet e tjera gege e veçmas me ato të gegërishtes qendrore, shpjegime teorike, duke u mbështetur në literaturën dialektologjike në përgjithësi dhe atë që lidhen me temën në veçanti. Në të jo rrallë autori ka dhënë shpjegime e gjykime origjinale, sidomos rreth kronologjisë së mundshme të dukurive të ndryshme që trajtohen.

Punimi përshkohet nga një stil shkencor, me një gjuhë të pasur dhe tekst të ndërlidhur për lakmi. Një punë e tillë, dëshmon formimin e gjerë e të shëndoshë teorik, praktik dhe metodologjik të autorit.



### **3. Prof. Remziu si udhëheqës i projektit kërkimor-shkencor për vjeljen e materialit dialektor të të folmeve shqipe në Maqedoni.**

Në një periudhë trivjeçare (gjatë viteve 1995-1997) për vjeljen e pasurisë së gjuhës së popullit, zotëri Remziu, në bashkëpunim me disa kolegë të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Shkupit: Haki Ymeri, Zihni Osmani, Agim Poloska dhe Asllan Hamiti si dhe Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë së Tiranës, përkatësisht me prof. Bahri Becin e Çlirim Bidollarin, udhëhoqi një projekt kërkimor-shkencor dhe u mbledh material dialektor në pika të ndryshme të të folmeve shqipe në Maqedoni.

Më kujtohet kur prof. Remziu na tuboi tok në zyrën e tij dhe na shpjegoi për qëllimin, rëndësinë dhe punën në terren që duhej ta bënim për vjeljen e pasurisë gjuhësore të të folmeve tona. Unë, atëherë si asistent (në moshën 35-vjeçare) u ndjeva shumë i nderuar për besimin që kishte profesori tek unë si dhe për gatishmërinë që të isha pjesë e këtij projekti.

Së pari u përcaktuan pikat dialektore që nga pjesa veriore e deri në pjesën jugore të Maqedonisë e më pas përzgjedhëm pyetësin për vjeljen e materialit dialektor në fushën e fonetikës e të fonologjisë, të morfologjisë, të leksikut e të sintaksës së shqipes, përkatësisht po të njëjtin pyetësor që është përdorur për Atlasin dialektor të shqipes, duke e pasuruar atë edhe me pyetje të tjera për të nxjerrë materialin e nevojshëm për të folmet shqipe në Maqedoni, si pjesë përbërëse e grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore.

Materialin e vlinim me pyetje të tërthorta si dhe nga biseda e gjallë, duke marrë shënime si dhe me inçizime zanore. Mbaj mend organizimin e shkëlqyeshëm që e bënte udhëheqësi i projektit, mirësjelljen e tij, korrektësinë, profesionalizmin, mirësinë, korrektësinë e sjelljen shumë humane ndaj nesh si dhe ndaj të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në këtë projekt madhor.

Pata fatin që të mësoj jo vetëm nga leksionet që mbante profesori në fakultet, por edhe nga ekspeditat dialektore në periudhë trivjeçare. Përfitova shumë nga ky projekt, si nga pikëpamja profesionale ashtu edhe në përcaktimin tim që në periudhën e mëpastajme të merrem me dialektologji. Natyrisht se për këtë u jam mirënjohës jo vetëm prof. Remziut, por edhe pjesëmarrësve të tjerë në këtë projekt, meqë mësove



shumë edhe nga prof. Bahri Beci, Çlirim Bidollari, Haki Ymeri, Zihni Osmani po edhe nga kolegët e tjerë.

Si në takimet tona të punës në Fakultet, ashtu edhe gjatë vajtje-ardhjeve, përveç bisedave të rëndomta, trajtoheshin edhe çështje profesionale e shkencore.

Pasi u vol materiali i paraparë dialektor, në marrëveshje të profesorëve të mi me prof. Bahri Becin, atëherë Drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë në Tiranë, përfitova të shkoj në vizitë studimore në këtë Institut. Gjatë këtij qëndrimi dyjavor u njoftova drejtpërdrejt me punën hulumtuese e shkencore si dhe u ndjeva shumë mirë nga mikëpritje vëllazërore nga të gjithë punonjësit, e veçmas nga Ardian Doka e Merita Bruci (tani të dy pedagogë e studiues të afirmuar).

Studimet dialektologjike të prof. Remzi Nesimit kanë shërbyer si material i rëndësishëm për studime përgjithësuese për shqipen, si në tekstet mësimore universitare të Dialektologjisë,<sup>107</sup> ashtu edhe në përfaqësimin e të folmeve shqipe në hartat e Atlasit dialektologjik të gjuhës shqipe, edhe pse në këtë çështje kemi disa vërejtje serioze.

Ndihmesën e prof. Remziut, përfshirë edhe të gjuhëtarëve të tjerë, për studimin e të folmeve shqipe në Maqedoni, rrjedhimisht edhe për dialektologjinë shqiptare në përgjithësi e kemi paraqitur në temën “Gjendja dhe perspektiva e studimeve dialektore në Maqedoni” librin tonë të Dialektologjisë (në bashkautorësi).<sup>108</sup>

Punën e vjeljes së pasurisë gjuhësore, folklorike e etnografike të Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut si dhe studimin e saj, që e filloi, e zgjeroi, e thelloi me shumë prurje të reja prof. Remziu, duhet vazhduar edhe më tej. Për nga detyra që ka, i bie Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve që me një projekt shumëvjeçar së pari të regjistrojë këtë pasuri të çmuar kombëtare që po humbet e tretet, për ta shpëtuar nga zhdukja si dhe për t’ua lënë trashëgim brezave të ardhshëm.

<sup>107</sup> Jorgji Gjinar – Gjovalin Shkurtaç, *Dialektologjia*, ShBLU, Tiranë, 1997 në f. 105 thuhet: “Për të folmet shqipe të Maqedonisë duhen përmendur sidomos ndihmesat e studimet e Remzi Nesimit, Fadil Sulejmanit dhe A. Zenkut.”

<sup>108</sup> Asllan Hamiti – Ajten Qamili, *Dialektologjia e gjuhës shqipe*, Shkup, 2014, f. 92-99.

**Literatura e konsultuar:**

- Hamiti, Asllan – Qamili, Ajten – Osmani, Ismet: *Kontributi i delegatëve të Kongresit të Drejtshkrimit nga Maqedonia për shqipen standarde*, “Akademia jubilarë me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit”, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, 16-17 nëntor 2012, f. 42-48.
- Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e profesor Remzi Nesimit për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare*, „Filologjia”, Revistë Shkencore Ndërkombëtare për Gjuhësi, Letërsi dhe Kulturë, Viti I, prill, 2013, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2013, f. 101-109.
- Hamiti, Asllan: *Ndihmesa e studiuesve të Maqedonisë në fushën e dialektologjisë shqiptare*, Malësia 5, Podgoricë, 2010, f. 79-84.
- Hamiti, Asllan: *Prof. Remzi Nesimi – pedagog, humanist dhe studiues i shqipes*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 11-18.
- Хамити, Аслан: *Научно-образовниоѝ ѓрофил на ѓроф. Ремзи Несими*, Годишен Зборник на Филолошкиот факултет “Блаже Конески”, книга 39-40, Скопје, 2014, f. 21-36.
- Mehmeti, D. Qani: *Kontributi i prof. Remzi Nesimit për gjuhën shqipe*, Shqyrtime albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 115-125.
- Nesimi, Mr. Remzi (Shkup): *Procesi i njësimimit të shqipes letrare në Maqedoni*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe 20-25 nëntor 1972, Prishtinë, 1974, f. 139-142.
- Nesimi, Remzi: *Çështje gjuhësore*, Shkup, 1997.
- Nesimi, Remzi: *E folmja e Dervenit*, Seminari i Albanologjisë, 2008.
- Nesimi, Remzi: *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Studime gjuhësore I (Dialektologji), Prishtinë, 1978, f. 327-352 dhe Dialektologjia shqiptare V, ASHRPS e Shqipërisë, Tiranë, 1987, f. 176-203.
- Nesimi, Remzi, *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve i dhe u në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona 2, Shkup, 1972.
- Poloska, Agim: *Bibliografia e punimeve, studimeve, artikujve dhe monografive shkencore të prof. dr. Remzi Nesimit*, Shqyrtime

albanologjike 5, Shkup, 1998, f. 19-28.

Шаини, Фљорије: *Ремзи Несими и албанскајта лингвистика* (punim magjistrature mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup), Shkup, 2012.

### 3.7. NDIHMESA E PROFESOR TOMOR OSMANIT PËR SHQIPEN STANDARDE

Njeriu nuk mund të mos mahnitet me veprimtarinë e shumanshme e të frytshme gjysmëshekullore të profesorit të çmuar, Tomor Osmani. Me këtë kolos të shkronjave shqipe kam pasur nderin të takohemi, të njihemi, të shoqërohemi e të miqësohemi në shumë konferenca albanologjike të mbajtura në Shqipëri, në Kosovë e në Maqedoni. Ai është njeri me virtyte të larta humane: modest, i sinqertë, i sjellshëm, i kulturuar, i këndshëm, që gjithnjë rrezaton mirësi e energji pozitive.

Kur lexon jetëshkrimin dhe bibliografinë e këtij mjeshtri të madh, del në pah se ai është:

1. pedagog i mrekullueshëm në studimet themelore e të magjistraturës në disa universitete në Shqipëri, Mal të Zi e Maqedoni dhe udhëheqës shkencor për gradën master dhe doktor shkencash;
2. organizues, udhëheqës, koordinator e veprimtar i shquar në funksione e detyra të rëndësishme pedagogjike, arsimore, botuese, shkencore e kulturore;
3. hartues programesh, tekstesh mësimore universitare, bashkautor fjalorësh, redaktor e kryeredaktor, recensent, drejtuesh projektsh;
4. largpamës në politikën gjuhësore dhe në planifikimin e shqipes;
5. punonjës shkencor që zë vend në mesin e gjuhëtarëve më të mirë shqiptarë.

Për punën e tij të frytshme mbi 50-vjeçare i jepet urdhri “Mjeshtër i Madh”, “*mirënjohja e Universitetit “Luigj Gurakuqi”*”, titulli “*Profesor emeritus*” që i dha Universiteti i Shkodrës, “*Certifikatë mirënjohjeje*” që i lëshoi Qendra e Studimeve Albanologjike, përfshihet në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar”,<sup>109</sup> delegat në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, pedagog i ftuar nga Departamenti i linguistikës i Universitetit të Padovës (Itali) për shkëmbim përvojë në

---

<sup>109</sup> *Fjalori enciklopedik shqiptar III*, Tiranë, 2009, f. 1906.

fushën shkencore, anëtar i Këshillit Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe etj.

Kontributi që ka dhënë e po jep profesor Osmani për arsimin, shkencën dhe kulturën shqiptare mund të kundrohet nga shumë këndvështrime, duke trajtuar veprimtarinë e tij të shumëplanëshe në tema të veçanta e më të thelluara. Këtë ia kemi borxh ne dhe gjeneratat e ardhshme jo vetëm që të njihemi me prurjet e tij albanologjike, por personaliteti i tij mund të shërbejë si shembëlltyrë a model për punën arsimore, hulumtuese e shkencore me përkushtim, për dashurinë ndaj shkrimit, ndaj gjuhës dhe ndaj kombit si dhe për punën e palodhshme për një të ardhme të ndritur. Profesor Tomori gjatë punës së tij të frytshme ka zbatuar thënien e Naimit: “Vetëm dritë e diturisë përpara do na shpjerë”!

Duke pasur para sysh se në këtë konferencë shkencore çdonjëri prej nesh do të merret me çështje të veçanta në fusha të caktuara të prurjeve të prof. Tomorit, apo edhe me çështje të përgjithshme të punës së këtij intelektualit shkodran, në këtë kumtim do të ndalemi në ndihmesën e prof. Tomor Osmanit për shqipen standarde.

E sotmja ka edhe të kaluarën. Në këtë pikëpamje, prof. Tomori duke studiuar gjuhën dhe shkrimin e shumë shkrimtarëve shqiptarë do të japë edhe shpjegime të hollësishme për rrugën e zhvillimit të shqipes së sotme e të alfabetit të sotëm, përkatësisht ai ka hedhur dritë mbi traditën shekullore të letrave shqipe, rrjedhimisht edhe mbi variantin e shqipes letrare, shqipes dialektore, përfshirë edhe variantin e shqipes standarde. Nuk ka gjuhësi të sotme pa histori gjuhe e pa dialektologji.

Me kompetencë shkencore ka trajtuar tema nga historia e gjuhës, si: tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor (në katër vëllime), udha e shkronjave shqipe – histori e alfabetit, përpjekjet e Rilindësve për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe, puna shkrimtarëve shqiptarë për alfabetin e gjuhës shqipe, shkrimi i shqipes prej shekullit XIII deri në shekullin XIX (në shekujt XIII-XIV, në shekujt XVI-XVII, në shekujt XVIII-XIX), puna e komiseve letrare, Kongresi i Manastirit etj.

Në përpjekjen tonë për të analizuar, sistemuar e klasifikuar veprimtarinë shkencore e pedagogjike të prof. Tomor Osmanit, arritëm të dallojmë shtatë lëmi prurjesh:

a) **Studime për gjuhën e shkrimtarëve të shquar shqiptarë:** punime me vlerë për 32 mjeshtër të penës, si për Gjon Buzukun, Marin Barletin, Frang Bardhin, Justin Rrotën, Pashko Vasën, Luigj Gurakuqin, Anton Zako Çajupin, Migjenin, Zef Jubanin, Thimi Mitkon, Naum Veqilharxhin, Jeronim de Radën, Faik Konicën, Gjergj Fishtën, Pjetër Bogdanin, Naim Frashërin, Jup Kastratin, Dritëro Agollin, Aleksandër Xhuvanin, Hasan Tahsinin, Ndre Mjedën, Jani Vreton, Dhimitër Kamardën, Sami Frashërin, Konstantin Kristoforidhin, Martin Camajn, Shtjefën Gjeçovin, Selman Rizën, Kolë Ashtën, Hafiz Ali Ulqinakun, Simon Pepën dhe Eqrem Çabejn.

b) **Studime për komisitë letrare:** Komisinë letrare të Shkodrës, Shoqërinë e të Shtypurit Shkronja Shqip, Shoqërinë “Agimi”, Shoqërinë “Bashkimi” (zëra në “Fjalorin Enciklopedik Shqiptar”, Tiranë, 1985).

c) **Studime dialektologjike:** e folmja e Shirokës; dialektizmat, njohja dhe kapërcimi i tyre, prurje dialektore dhe shqipja standarde etj.

ç) **Ndihmesa në hartimin e teksteve mësimore për studentë:** Gjuhë shqipe 1, Tekste normative për drejtshkrim e morfologji, Gramatika të gjuhës shqipe, Çështje të drejtshkrimit dhe të terminologjisë gjatë viteve 1916-1918; anëtar i mjaft grupeve punuese organizuar nga Ministria e Arsimit për përsosjen e programit të Gjuhës Shqipe dhe modernizimin e tij.

d) **Puna e palodhshme për nxënien e shqipes letrare në shkolla:** në punën 50-vjeçare me zell të madh ligjëroi lëndë të gjuhës shqipe dhe bashkë me materien e lëndëve përkatëse, studentëve u mësoi edhe normën letrare në formë të folur e të shkruar. Me shumë sukses trajtoi edhe tema që lidhen me kulturën e gjuhës, si: njohuri morfologjike dhe drejtshkrimore për zhvillimin e aftësive gjuhësore të nxënësve, mësimi i gjuhës shqipe – domosdoshmëri për ruajtjen e identitetit kombëtar në Mal të Zi, aktivizimi i studentëve për punë shkencore, aktori dhe gjuha (në bashkautorësi).

dh) **Prurje për shqipen letrare a standarde** (shtrirë në 26 artikuj): çështje të gjuhës letrare shqipe, për një shqiptim të saktë dhe letrar, disa shënime për rregullat e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, vëzhgime mbi kristalizimin e normës morfologjike të sistemit foljor, klasifikimit të foljeve në zgjedhime; përpjekje për njësimin e drejtshkrimit të shqipes, disa fjalë rreth gjuhës së përbashkët shqipe, puna me drejtshkrimin e

shqipes; fjalori i gjuhës shqipe – arritje e rëndësishme e gjuhësisë sonë, vëzhgime për ligjërimin letrar të qyteteve në kohën tonë, shkrimi i foljeve me t/s, çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe, tabu dhe eufemizma në gjuhën shqipe, çështje të leksikut dhe të fjalëformimit në faqet e një reviste, gjuha e letërsisë dhe procesi i standardizimit të shqipes; çështje të shqipes së sotme standarde, vështruar, kryesisht në rrafshin e lëvizjeve demografike (në bashkautorësi me Artan Haxhin); rreth perspektivës së planifikimit gjuhësor të shqipes (me A. Haxhin), përsosja e standardit gjuhësor në fushën e morfologjisë e të drejtshkrimit, shoqëria shqiptare për problemet gjuhësore në dy dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX, rreth disa tipave të fjalëformimit në publicistikën e sotme, reflekse për gegërishten në rrafshin e planifikimit gjuhësor, rreth marrëdhënieve të standardit gjuhësor të shqipes së sotme me të folmet e veriut në variantin e folur dhe të shkruar, sa është rrezikuar gjuha shqipe në Mal të Zi?, prurjet e dialekteve – domosdoshmëri për pasurimin e gjuhës, format e shumësit në rrafshin e planifikimit gjuhësor të shqipes (në bashkautorësi me Artan Haxhin), shqipja në përgjigje të zhvillimeve të reja të shoqërisë shqiptare.

e) **Pjesëmarrja në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes si dhe në Këshillin Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe.** Në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, të mbajtur në Tiranë prej 20 deri më 25 nëntor 1972, prof. Tomor Osmani referoi në temë: “Procesi i njësimimit të dubleteve drejtshkrimore në ortografinë e viteve 1948, 1951, 1956 dhe 1957”.<sup>110</sup> Duke krahasuar katër drejtshkrimet e sapopërmendura të shqipes, profesori i nderuar ka vërejtur se çdo ortografi pasuese është më e plotë, me më pak përjashtime e më me pak dysi formash normative. Në to ai heton se ç’është zgjidhur drejt, por aty ku gjërat janë lënë pezull jep propozime e zgjidhje të drejta, që tani më i ka dëshmuar e po i dëshmon koha si të qëlluara.

Mjeshtri i madh, kumtesën e përmbyll me këto fjalë: “*Si përfundim mund të themi se numri i dubleteve drejtshkrimore nga ortografia në ortografi ka ardhur gjithnjë duke u pakësuar. Kjo tregon se rregullat tona drejtshkrimore po stabilizohen dhe shumë forma po kristalizohen njëherë e mirë*”.

Asgjë në botë nuk është absolute, e paprekshme, e

<sup>110</sup> Tomor Osmani, *Procesi i njësimimit të dubleteve drejtshkrimore në ortografinë e viteve 1948, 1951, 1956, 1967*; Instituti Albanologjik i Prishtinës, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, 20-25 nëntor, 1972; Prishtinë, 1974, f. 535-544.

papërmirësueshme, e pandryshueshme. Pikërisht edhe zhvillimi i teknikës e i teknologjisë, i shkencës dhe i njerëzimit në përgjithësi mbështetet në përpjekjet e çdo brezi që arrijtjet e gjeneratave të mëparshëm t’i përsosë, t’i përkryejë, t’i mbindërtojë e t’i përditësojë. Çdo herë njeriu ka qenë, është dhe do të jetë në kërkimin e të mirës, të përkryerës, të dobishmes, të asaj që është më e lehtë e më praktike. Nëse gjërat që jepen një herë, nuk ndryshohen kurrë, atëherë jeta dhe çdo punë e njeriut do të ishte e pakuptimtë.

Fatmirësisht shqipja është një gjuhë e gjallë, në lëvizje e në zhvillim, e aftë t’i plotësojë nevojat e kombit, e aftë që t’u përgjigjet kushteve të kohës së re dhe që duhet përpjekur ta bëjmë edhe më të aftë të përballet me gjuhët më të zhvilluara të botës. Rrjedhimisht, edhe normat e standardit të saj nuk duhet të jenë “rreptësisht të ndaluara”. Vetëm për gjuhët e vdekura nuk ka nevojë të harmonizohet norma me stadin e zhvillimit të saj, sepse tek ato më nuk ka lëvizje.

Sipas gjuhëtarëve të njohur Ali Dhrimo dhe Rami Memushaj gjuha shqipe në 34 vjetët e fundit ka shtuar 40 mijë fjalë të reja.<sup>111</sup> Kuptohet se është e nevojshme që këto fjalë të reja të përfshihen në fjalorë, të përcaktohet fusha e përdorimit dhe kuptimet e tyre, të normëzohet shkrimi dhe shqiptimi i tyre etj. E pazgjidhur deri në fund në rregullat e Drejtshkrimit të shqipes na del edhe përdorimi i dysive drejtshkrimore. Në të vërtetë, dublete drejtshkrimore po përdoren edhe sot e kësaj dite në variantin e shqipes standarde, edhe pse sipas normave fonologjike e morfologjike nga dy e më tepër varietetesh, parapëlqehet të përzgjidhet vetëm njëra prej tyre si formë e vetme normative, duke ua lënë shtegun e hapur varianteve të tjera për përdorim stilistik, krahinor e letrar.

Gjuha shqipe, në përgjithësi, dhe shqipja standarde, në veçanti, janë futur në një proces të përshtatjes në kontekste të reja politike, ekonomike e kulturore. Ky rishkallëzim ose ripërshtatje gjuhësore e shqipes ndodh në tri rrafshë:

- a) në rrafshin vendor, si përshtatje e shqipes me rrethanat e reja shoqërore dhe kulturore;
- b) në rrafshin makrorajonal, si përshtatje e shqipes me integrimet evropiane dhe, në përgjithësi;
- c) në rrafshin global, si përshtatje e shqipes me dukuritë dhe me

<sup>111</sup> <http://www.peshkupauje.com/node/35205>



proceset globalizuese.<sup>112</sup>

Punën e përshtatjes së shqipes në kushtet e reja gjeopolitike e globalizuese, veçmas në kristalizimin e rregullave të drejtshkrimit, prof. Osmani po e vazhdon edhe në Këshillin Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe.

Siç thotë studiuesja Shefkije Islamaj, “konteksti ku funksionon shqipja standarde sot është i ri dhe shumë më i gjerë se dje. Ballafaqimi i kulturës shqiptare me kultura të tjera ka vënë para saj sprovën e vetëqëndrueshmërisë, në të vërtetë ndikimi i drejtpërdrejtë i gjuhëve e i kulturave të fuqishme për të paraqet sfidë të madhe, në rend të parë për leksikun e saj. Pasurimi i leksikut sot paraqitet si njëri ndër problemet kryesore të saj dhe parakupton edhe modernizimin e saj. Ky modernizim duhet të jetë më i madh dhe duhet të jetë i “drejtuar”. Shqipja standarde duhet të modernizohet, sepse dhe vetë shqiptarët e shoqëria shqiptare në përgjithësi po modernizohen. Duke qenë ose duke synuar të jetë gjuhë e një kulture të hapur, ajo, duhet të gjejë mënyrat si t’i bëjë ballë kësaj sfide, në të vërtetë, si ta ruajë *identitetin* e saj. Bota moderne, qytetërimi evropian, edhe ndër shqiptarët, hyn përmes gjuhës, përmes elementeve të gjuhës, përmes leksikut të saj”.<sup>113</sup>

Krejtësisht në fund të kumtimit tonë, profesor Tomor Osmanin e falënderojmë dhe e përgëzojmë për punën madhore që ka bërë e po bën në fushën e arsimit, të shkencës e të kulturës shqiptare. Nga prof. Gjovalin Shkurtaj me të drejtë ai është cilësuar si studiuesi më kompetent për problematikën e alfabetëve të gjuhës shqipe, ndërsa nga shumë intelektualë të tjerë është çmuar lart, si: një ndër figurat më të spikatura të inteligjencës shkodrane, krenaria e qytetit të Shkodrës, mjeshtër i madh i gjuhësisë shqiptare etj.

Pedagogut, filologut e mikut tonë të nderuar, Tomor Osmanit i urojmë shëndet e prurje të reja në gjuhësinë shqiptare si dhe në ngritjen e mëtejme të piramidës kombëtare.

<sup>112</sup> Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015, f. 28-29.

<sup>113</sup> Shefkije Islamaj, *Shqipja standarde dhe modernizimi i saj*, Gjuha shqipe 3/2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.

**Literatura:**

Tomor Osmani, *Bibliografi e botimeve shkencore 1963-2015*, Shkodër, 2015.

Tomor Osmani, *Procesi i njësimt të dubleteve drejtshkrimore në ortografinë e viteve 1948, 1951, 1956, 1967*; IAP, Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, 20-25 nëntor, 1972; Prishtinë, 1974, f. 535-544.

*Fjalori enciklopedik shqiptar III*, Tiranë, 2009.

Shefkije Islamaj, *Shqipja standarde dhe modernizimi i saj*, Gjuha shqipe 3/2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.

Shkumbin Munishi, *Shqipja në epokën e globalizimit*, Zeroprint, Prishtinë, 2015.

<http://www.peshkupauje.com/node/35205>

### 3.8. PROFESOR XHEVAT GEGA – GOJËTAR I SHQUAR<sup>114</sup>

#### **Abstrakt**

Kam pasur fatin që të jem student i profesor Xhevatit dhe të ndjek ligjëratat e shkëlqyeshme të tij nga viti i parë e deri në vitin e katërt të studimeve themelore. Studentët e tij e kujtojmë se ishte pedant në veshje, i afërt, i kulturuar, i rregullt në mësimdhënie, pedagog i shkëlqyeshëm. Përveç këtyre cilësive, ai shquhej me kulturën e gjerë dhe gojëtarinë (oratorinë) që kishte.

E folmja e Strugës, baza nyjetimore e tij, është shumë e përafërt me shqiptimin letrar, me leximin e veprave letrare artistike kishte zgjeruar fondin leksikor, me veprimtarinë e shumanshme në hartimin e teksteve shkollore, me përkthim si dhe me shumë aktivitete të tjera redaktuese, botuese, shkencore e shoqërore profesor Xhevati ishte bërë mjeshtër i fjalës. Ai që gojëtar i shkëlqyeshëm: fliste bukur e rrjedhshëm, i lidhte bukur fjalët e shprehjet, ishte i qartë dhe bindës në atë që thoshte.

Ligjërimi i këtij njeriu të gojës dallohej me shqiptim normativ, diksion mjeshtëror, pasuri leksikore si dhe tekst të ndërlidhur për lakmi. Studentët me shumë vëmendje ndiqnim ligjërimit përmbajtjesor, interesant, tërheqës e me plot muzikalitet. Më kujtohet se për të pasuruar fjalorin tim, unë në një fletore të posaçme shënoja çdo fjalë e shprehje të re që dëgjoja nga goja e profesorit, duke shënuar edhe kuptimin e tyre, kështu që arrita ta hartoja një glosar mjaft të pasur, të cilin e shfletoja shpesh.

**Fjalët kyçe:** profesor, gojëtar, diksion, bazë nyjetimore, ligjërimit

#### PROFESSOR XHEVAT GEGA - EXCELLENT SPEAKER

#### **Abstract**

I was fortunate to be a student of Professor Xhevat and to attend his excellent lectures from the first year to the fourth year

---

<sup>114</sup> Kumtesë imja e lexuar në tribunën shkencore “Figura poliedrike e profesor Xhevat Gegës”, ITShKSh, Shkup, 01. 09. 2021.

of our basic studies. We remind his students that he was pedantic in dress, approachable, cultured, regular in teaching, excellent lecturer. In addition to these qualities, he was distinguished by the wide culture and oratory he had.

The dialect of Struga, its nodal base, is very close to standard Albanian pronunciation, with the reading of works of art had expanded the lexical fund, with the multifaceted activity in the drafting of textbooks, with translation and many other editorial activities, publishing, scientific works and social experiments professor Xhevat had become a master of speech. He was an excellent orator: he spoke fluently, he connected words and expressions beautifully, he was clear and convincing in what he said.

The speech of this man was distinguished by normative pronunciation, masterful diction, lexical richness as well as interrelated text for greed. The students listened very attentively to the content, interesting, attractive and full of musicality. I remember that in order to enrich my vocabulary, I wrote down in a special notebook every new word and expression I heard from the professor's mouth, noting their meaning as well, so I managed to compile a very rich glossary, which I browse often.

**Keywords:** professor, orator, diction, articulatory basis, lecture

Në periudha të caktuara të zhvillimit të popullit shqiptar, lindën dhe vepruan njerëz të penës e të pushkës që i dhanë kahjen e duhur kombit e gjuhës. Falë tyre ne kemi ruajtur identitetin kombëtar, gjuhën e kulturën dhe sot gjendemi në një stad të lartë zhvillimi, krahas me popuj të tjerë të qytetëruar. Ndër veprimtarët e njohur, që me tërë qenien e tyre punuan për të mirën tonë kolektive, bën pjesë edhe profesor Xhevat Gega.

Njerëzit e mëdhenj dinë se çfarë duhet bërë në rrethana të caktuara. Në kohën kur te ne pjesa më e madhe e shqiptarëve nuk dinin shkrim-lexim, vitet e pesëdhjeta të shekullit XX, profesor Xhevati punoi mësues në Manastir e Strugë, më pas profesor në normalen e Shkupit, në Akademinë Pedagogjike si dhe në Fakultetin e Filologjisë.

Për të përhapur shkronjat shqipe në Maqedoni e më gjerë, ai që nga viti 1970 botoi një Abetare, që u ribotua disa herë dhe i qëndroi

kohës e vogëlushët tanë edhe sot e tutje mësojnë të shkruajnë e të lexojnë shqip. Profesori ynë e dinte se na mungonin edhe tekstet shkollore, andaj me zell të jashtëzakonshëm, përkushtim e profesionalizëm hartoi libra shkollorë për gjuhë e letërsi shqiptare (ndonjë prej tyre në bashkautorësi).

Publicistika shqipe në Maqedoni duhej filluar nga pika fillestare, andaj jo rastësisht profesor Xhevati vite me radhë e kreu me shumë sukses detyrën e redaktorit të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”.

Nevoja e kohës për përhapjen e letërsisë shqiptare te popujt e tjerë si dhe të letërsisë së huaj në shqip bëri që ai të merret edhe me përkthimin e veprave shqip-gjuhë e huaj e anasjelltas.

Padyshim, ndihmesë të madhe profesor Gega ka dhënë edhe në fushën e studimeve të letërsisë shqiptare, veçmas të asaj që krijohet në Maqedoni, po edhe në letërsinë krahasuese, sidomos ndërmjet letërsisë shqipe e asaj maqedonase. Trajtesa me vlerë na ka lënë edhe për kulturën e gjuhës, të normës standarde, si dhe çështjeve e problemeve të tjera të kohës.

Veprimtaria e tij intelektuale shtrihet edhe në jetën shoqërore e kulturore. Të kujtojmë pjesëmarrjen në shumë konferenca shencore, tryeza të rumbullakëta, seminare, emisione në radio e television, në “Mbrëmjet Strugane të Poezisë“, „Takimet e Racinit“ etj.

Me ndërgjegje, korrektësi e pedantëri ushtroi edhe detyrat redaktuese (të fjalorëve, librave, monografive) si dhe funksionet drejtuese e udhëheqëse të institucioneve arsimore e organizatave kulturore, si shef i Katedrës (duke u ndërruar me prof. Remzi Nesimin derisa u poqën të rinjtë), zëvendësdekan, kryetar i Unionit të Intelegjencisë Shqiptare në Maqedoni etj.

Si student e më pas si koleg, më mahniste se si i shkruante aq mirë e me pedantëri të rrallë shkresat zyrtare, referatet e raportet e punës në makinë shkrimi, duke i sistemuar të gjitha dokumentet e Katedrës në një dosier.

Po të përpiqemi ta përmbledhim këtë që e thamë deri më tani, del se profesor Xhevat Gega është pedagog, studiues, hartues tekstesh shkollore, përkthyes, publicist e veprimtar i shquar i jetës shoqërore e kulturore. Ai është pishtar i arsimit, përhapës i shkronjave shqipe, i dijes dhe i ngritjes arsimore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoni e më gjerë. Iluministët si prof. Xhevati, Remziu, Janura, Sylejmani me shokët

ndoqën rrugën e trasuar nga Rilindësit shqiptarë. Rrugën e shkollimit, të emancipimit e të qytetërimit e ndoqën edhe studentët e tyre të Normales, Akademisë Pedagogjike e të Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Shkup. Për këtë mendjendritur (bashkë me disa intelektualë të tjerë) lidhen pothuajse të gjitha arritjet arsimore e shkencore të shqiptarëve në Maqedoni gjatë 50 viteve, që nga vitet e 50-ta të shekullit të kaluar e deri në fundin e këtij qindvjeçari (deri në pensionimin e tij, më 1996).

Veprimtaria e Xhevat Gegës është shumëplanëshe. Por, mbi të gjitha për mua dhe për shumë nxënës e studentë të tij ai mbetet model i profesorit të përsosur: pedant në veshje, i rregullt në mësim, pedagog i shkëlqyer, objektiv në vlerësim, i dashur me kolegët e studentët, njohës i mirë i letërsisë shqiptare, me njohuri e kulturë të gjerë.

Në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit të Filologjisë në Shkup që nga viti 1978 e deri në pensionim, tetor 1996; përveç ndonjë lëndë tjetër, profesor Xhevati ka ligjëruar Historinë e letërsisë shqiptare 1, 2, 3, 4; përkatësisht Letërsinë e vjetër, Romantizmin, Realizmin dhe Letërsinë bashkëkohore. Kam pasur fatin që të jem student i profesor Xhevatit dhe të ndjek ligjëratat e shkëlqyeshme të tij nga viti i parë e deri në vitin e katërt të studimeve themelore.

Përveç shumë vetive të një njeriu ideal, profesor Xhevati shquhej edhe si gojëtar. E folmja e Strugës, baza nyjëtimore e tij, është shumë e përafërt me shqiptimin letrar. Me leximin e veprave letrare artistike kishte zgjeruar fondin leksikor, me veprimtarinë e shumanshme në hartimin e teksteve shkollore, me përkthim si dhe me shumë aktivitete të tjera redaktuese, botuese, shkencore e shoqërore, profesor Xhevati ishte bërë mjeshtër i fjalës. Ai qe gojëtar i shkëlqyeshëm: fliste bukur e rrjedhshëm, i lidhte bukur fjalët e shprehjet, ishte i qartë dhe bindës në atë që thoshte.

Ligjërimi i këtij njeriu të gojës dallohej me shqiptim normativ, diksion mjeshtëror, intonacion të përshtatshëm, pasuri leksikore si dhe tekst të ndërlikur për lakmi. Ne, studentët me shumë vëmendje ndiqnim ligjërimin përmbajtjesor, interesant, tërheqës e me plot muzikalitet. Më kujtohet se për të pasuruar fjalorin tim, në një fletore të posaçme shënoja çdo fjalë e shprehje të re që dëgjoja nga goja e profesorit, duke shënuar edhe kuptimin e tyre, kështu që arrita ta hartoja një glosar mjaft të pasur, të cilin e shfletoja shpesh.

Ligjërimi i këtij profesori ka shërbyer e do të shërbejë shembull

jo vetëm për studentët e tij, por edhe për shumë folës të tjerë të shqipes. Fjalimi i profesorit ishte gjithnjë i strukturuar mirë në mënyrë logjike, drejtshqiptimore, morfosintaksore e tekstologjike. Ligjrimi i tij ishte i gjallë dhe dinamik, asnjëherë nuk bëhej monoton. Me artin e të folurit, kudo që fliste, arrinte rezultate të shkëlqyera dhe u bë një nga oratorët më të mirë të shqipes.

Ndër shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut e gjithandej ka pasur, ka e do të ketë oratorë të shkëlqyer që mendimin e kanë të formësuar, që fjalinë e kanë të saktë, që ato i vargëzojnë me mjeshtëri në periudha, paragrafë e tekste dhe mbi të gjitha që ligjërimin e kanë të nivelit intelektual.

Shqiptarët zbuluan një rën prej perlave të urtësisë për gojëtarinë, se “mijlisin e prishin ata që flasin e nuk dinë, dhe ata që dinë e nuk flasin”. Profesori ynë i nderuar edhe dinte edhe fliste. Megjithëkëtë, me sa dimë, deri më tani nuk është bërë ndonjë përpjekje për ta pasqyruar, përshkruar a hulumtuar gojëtarinë shqipe. Po të bëhej një vëzhgim i tillë, duke përzgjedhur gojëtarët më të mirë shqiptarë, mendoj se prof. Xhevat Gega do të zinte vendin e merituar si njëri ndër oratorët më të mirë në Maqedoni e më gjerë.

### 3.9. PROF. DR. IMRI BADALLAJ – PEDAGOG DHE ALBANOLOG

#### Shënime biografike dhe bibliografike



Imri Badallaj lindi në Zhur të Prizrenit më vitin 1947. Shkollën fillore e kreu në vendlindje më 1960. Më vitin 1965 kreu Shkollën Normale në Prizren. Gjatë viteve 1965-1967 punoi mësues në Velezhë, në Zhur dhe në Prizren. Studimet i mbaroi në Fakultetin Filozofik - Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe më 1971. Në periudhën 1971-1973 punoi mësimdhënës i Gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Shkollën Normale dhe në Akademinë Pedagogjike të Prizrenit.

Më 1973 filloi punën në Degën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit Filozofik (tani Fakulteti i Filologjisë) si asistent i autorizuar për ligjërata në lëndët: Fonetikë, Dialektologji dhe Kulturë gjuhe. Në vitet 1974-1976 ndoqi Studimet pasuniversitare në Degën e Gjuhësisë në Universitetin e Prishtinës dhe më vitin 1976 magjistroi dhe merr titullin: *Magjistër i shkencave filologjike*. Më 1976 avancohet në titullin ligjërues universitar.

Më vitin 1979 fitoi qëndrim në Universitetin e Humboltit, ku specializohet për fonetikë. Dy vjet (1983-1984) fiton qëndrim për thellim studimi në Berlin dhe njëherësh ligjëron: Fonetikë dhe Gramatikë të shqipes së sotme, në Seksionin e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Humboltit të Berlinit në Gjermani.

Më 1986 merr titullin *Doktor i shkencave filologjike*. Po në këtë vit avancohet në titullin universitar *Docent* për lëndët: Fonetikë e shqipes së sotme dhe Dialektologji në Universitetin e Shkupit “Shën Qirili dhe Metodi” në Degën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe.

Dy vjet (1987-1988) ligjëroi në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Pekinit në Kinë dhe kreu punën e lektorit të shqipes në RTV e Pekinit. Më 1990 avancohet në titullin universitar *Profesor inordinar*. Më 1992 merr pjesë në Simpoziumin: Gjuha, Letërsia dhe



Kultura, me kumtesën: *Dialektet e shqipes në rrjedhën e moteve*, të organizuar nga Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Shkupit, në Shkup. Një vit më vonë (1993) merr pjesë në *Konsultën për Gjuhë Shqipe*, të organizuar nga ASHSH, në Tiranë. Gjatë periudhën 1994-2007 ligjëroi lëndët: Fonetikë me fonologji, Dialektologji, Sociolinguistikë dhe Sintaksë në Universitetin e Tetovës. Në vitin akademik 1997/1998 për një semestër qëndron në Universitetin e Bonit të Gjermanisë me statusin “Gastprofessor”.

Më vitin 1998 avancohet në titullin universitar *Profesor ordinar* në lëndët: Fonetikë e gjuhës shqipe, Dialektologji, Kulturë gjuhe, Gramatikë, Metodologji e punës shkencore, Arbërisht, Shqipja e shek. XVI-XVIII dhe Gjuhësi ballkanike.

Prof. Imriu ligjëroi në studimet pasuniversitare, tani në master: Gjuhë e sotme shqipe, Metodologji e punës shkencore, Sociolinguistikë dhe Gjuhësi ballkanike. Ka udhëhequr dhe udhëheq në cilësinë e mentorit një numër të madh studiuesish për gradën shkencore: magjistrë, master dhe doktor (brenda dhe jashtë vendit tonë). Në Degën e Gjermanistikës është shumë aktiv, duke mbajtur ligjërata, duke udhëhequr diploma, magjistratura dhe doktorata.

Tetë mandate kreu detyrën shef i Degës së Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë. Që nga fillimi i punës së Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi dhe Kulturën Shqiptare është aktiv, duke mbajtur dhe udhëhequr kurse të gjuhës, ligjërata, referime dhe kumtesa. Mban ligjërata të veçanta dhe cikël ligjërata në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ndërsa kursin *Gjuhësi ballkanike* vazhdon ta mbajë të plotë në nivelin e studimeve master.

Më 2004 zgjidhet anëtar i Këshillit për Emërime të Larta të Kosovës dhe e mban këtë post plot tre vjet. Po në këtë vit zgjidhet anëtar i Këshillit Ndërkademi (ASHSH – ASHAK) për disa ndryshime e përmirësime të shqipes standarde, në cilësinë: Udhëheqës i grupit punues mbi shqipen standarde në shkollë dhe në universitet. Më 2006 zgjidhet drejtor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. Më vitin 2009 zgjidhet anëtar i Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe (ASHAK-ASHSH) për hartimin e terminologjisë shqiptare. Po në këtë vit në Kieuti të Italisë i përfundon kërkimet shkencore së bashku me prof. Mario Massaron për hartimin e monografisë *Chieuti e la sua parlata arbëreshe (Qesti dhe e folmja e tij)*, e cila u botua në Itali. Në Bari të Italisë harton *Projektin për*

*ruajtjen e arbërishtes në Regjionin e Puljes* për organizimin e kurseve të *arbërishtes* në Qeft, Kazallveq dhe në Shën Marcan më vitin 2009.

Gjatë veprimtarisë pedagogjike në Degën e Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë ligjëroi lëndët: Fonetikë e gjuhës së sotme shqipe, Fonologji, Dialektologji, Metodologji e punës shkencore, Arbërisht, Gjuhësi ballkanike, Gjeografi gjuhësore, Kulturë gjuhe, Analizë diskursi, Shkrim akademik, Stilistikë gjuhësore, Leksikologji, Shqipja e shek. XVI-XVIII dhe Sociolinguistikë.

Në universitete private ka ligjëruar edhe lëndët: Gjuhësi e përgjithshme, Shqipja e sotme, Sintaksë, Kulturë gjuhe, Gjuhësi teksti në Kolegjin Universitar AAB dhe Kulturë gjuhe dhe dy disiplinat e gramatikës së shqipes: Morfologji dhe Sintaksë në Kolegjin Universitar “Dardania” në Prishtinë.

Prof. dr. Imri Badallaj ligjërata dhe cikël ligjëratash ka mbajtur edhe në disa universitete jashtë vendit: në Maqedoni, në Shqipëri, në Itali, në Gjermani, në Austri, në Bullgari, në Kinë etj.

Ka marrë dhe ende merr pjesë në shumë konferenca, simpoziume e kongrese shkencore. Pothuaj se të gjitha kumtimet e prezantuara në to janë botuar në përmbledhjet e punimeve të konferencave përkatëse.

#### **Disa nga publikimet shkencore:**

- *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit*, Gjurmime albanologjike, nr. 5, Prishtinë, 1976.
- *Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë*, Zëri i Arbëreshëve, nr. 10, Eianina (Itali), 1977.
- *Veçoritë e zanoreve hundore dhe vlera e tyre fonologjike*, Bota e re, nr. 9-10, Prishtinë, 1978.
- *Reflektimi i nazalizimit në toponime dhe mikrotoponime të lokalitetit të Zhurit (Onomastika e Kosovës - Edicion i Institutit Albanologjik)*, Prishtinë, 1979.
- *Edhe diçka rreth nazalizimit në gjuhën shqipe*, Rilindja, nr. 6884, Prishtinë, 1979.
- *Kapërcimi i disa veçorive dialektore në shkollën tonë*, Bota e re, 1980.
- *Disa fenomene fonetike në të folmen e Hasit*, Gjurmime albanologjike, nr. 16, Prishtinë, 1988.
- *Vendi dhe karakteri i theksit në të folmen e Hasit*, Gjurmime albanologjike, nr. 21, Prishtinë, 1992.

- *Rreth kuantitetit të vokaleve në “Mesharin” e Gjon Buzukut*, Seminari XVII.
- Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1995 *Sistemi konsonantik i së folmes së Hasit*, Gjurmime albanologjike, nr. 23, Prishtinë, 1993.
- *Realizime dialektologjike në sferën e shqipes*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996.
- *Format e kohës së ardhme të shqipes krahasuar me ato të serbishtes*, Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Tiranë, 1996.
- *Probleme të objektit dhe të metodës së studimeve në sferën e dialektologjisë*, Filologji nr. 1, Prishtinë, 1996.
- *Maksimilian Lamberci - albanolog i shquar*, Studime (AShAK), nr. 3, Prishtinë, 1997.
- *Sistemi i zanoreve në të folmen e Hasit*, Filologji, nr. 2, Prishtinë, 1996.
- *Vështrim mbi sistemin foljor të së folmes së Hasit*, Filologji, nr. 3, Prishtinë, 1997.
- *Karakterit i nazalizimit në gjuhën shqipe*, Dardania sacra, nr. 1, Prishtinë, 1999.
- *Disa pikëpamje të Eqrem Çabejt rreth kuantitetit të vokaleve të shqipes*, Filologji, nr. 8, Prishtinë, 2000.
- *Rreth paskajores në gjuhën shqipe*, Seminari XIX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2001.
- *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001 (monografi, 302 faqe).
- *Nyjat në të folmet e Vërrinit*, Seminari XXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2001.
- *Maxmilian Lambertz per gli Arbëreshë*, Jeta Arbëreshe, nr. 1, Eianina (Italia), 2002.
- *Norbert Jokli (1877-19942) - albanolog i shquar austriak*, Përmbledhje punimesh, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Shkodër, 2003.
- *Variantet e alfabetëve të Jeronim de Radës*, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare mbi 95-vjetorin e Kongresit të Manastirit, organizuar nga Akademia e Shkencave e Maqedonisë në Shkup.
- Kongresi i Studimeve të Evropës Juglindore, me kumtesën:

- Ndërndikimet e shqipes me gjuhët sllave jugore*, Tiranë, 2003.
- *Rreth konceptit të Eqrem Çabejt mbi kuantitetin dhe vlerën fonologjike të vokaleve të shqipes*, në Përmbledhje kumtesash shkencore, të mbajtura në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Eqrem Çabej dhe Kultura Shqiptare“, Gjirokastër, 2004.
  - *Revista “Jeta Arbëreshe” dhe rëndësia e saj në ruajtjen e italo- arbërishtes*, në Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2004.
  - *Rreth fjalorëve të Gjorgje Pulevskit*, në Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë, Tiranë, 2005.
  - *Rreth programeve të gjuhës shqipe në Kosovë*, në Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004.
  - *E ardhmja e minoritetit arbëresh*, në “Jeta Arbëreshe”, nr. 31-32, Eianina, Itali, 2004.
  - *Shqip, shqiptar, Shqipëri*, në “Jeta Arbëreshe”, nr. 33, Eianina, Itali, 2005.
  - *Meshari i Gjon Buzukut*, në “Jeta Arbëreshe”, nr. 34, Eianina, Itali, 2005.
  - *Risi në programet e shqipes në Kosovë*, “Jeta Arbëreshe”, nr. 36, Eianina, Itali, 2005.
  - *Carlo Tagliavini, gjuhëtar me përmasa të mëdha*, në “Jeta Arbëreshe”, nr. 40, Eianinë, Itali, 2005.
  - *Figura e Skënderbeut në revistën “Ekskluzive”*, në “Jeta Arbëreshe”, nr. 42, 43, 44, Eianinë, Itali, 2005.
  - *Presidenti dr. Ibrahim Rugova*, në “Jeta Arbëreshe”, nr. 44, Eianinë, Itali, 2006.
  - *E ardhmja e minoritetit arbëresh*, “Jeta Arbëreshe”, 31-32, Eianinë (ITALI), 2006.
  - *Kontributi i Emanuil Xhordanit në leksikografinë arbëreshe*, Filologji, nr. 14, Prishtinë, 2006.
  - *Rreth pikëpamjeve të Idriz Ajetit mbi fonetikën historike të shqipes*, Studime (ASHAK), Prishtinë, 2006.
  - *Si është ruajtur italo- arbërishtja*, Filologjia nr. 15, Prishtinë, 2007.
  - *Shqipja standarde dhe dialektet e saj*, SNGJLKSH, Prishtinë, 2007.
  - *Koncepti i Eqrem Çabejt mbi kuantitetin e vokaleve të shqipes*, SNGJLKSH, Prishtinë, 2008.

- *Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së prof. Eqrem Çabejt, “Jeta Arbëreshe”*, nr. 57, Itali, 2008.
- *La figura di Scanderbeg nella rivista “Ekskluzive”*, në Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella litteratura, Napoli (ITALI), 2008.
- *Arbëreshët e Italisë dhe ruajtja e gjuhës së tyre*, në Seminarin e 27-të Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2009.
- *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, në Koha për kulturë, nr. 4191, Prishtinë, 2009.
- *Pse çalon realizimi i shqipes standarde*, në Jeta Arbëreshe, nr. 63, Eianina (Itali), 2009.
- *Edhe një Fjalor i italo-arbërishtes*, në Jeta Arbëreshe, nr. 67, Eianina (Itali), 2010.
- *Vrojtimet e Selman Rizës mbi fonetikën e shqipes*, në Studime filologjike, nr. 1-2, Tiranë, 2010.
- *Vështrim mbi tipat e formave foljore me vlerën e së ardhmes*, në vëllimin e punimeve të Konferencës shkencore: Çështje të studimeve diakronike të shqipes (botim i ASHAK), Prishtinë, 2010.
- *Chieuti e la sua parlata arbëreshe* (Imri Badallaj - Mario Massaro, (Monografi 598 faqe), Apricena (Fg) Itali, 2010.
- *Vrojtimet e Selman Rizës mbi fonetikën e shqipes*, Studime Filologjike, nr. 1-2, Tiranë, 2010.
- *Sa dhe si realizohet shqipja standarde në shkollë dhe në universitet: në Shqipja në etapën e sotme: Politikat dhe e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*, Tiranë, 2011.
- *Dy fjalorët e Gjorgje Pulevskit*, në Filologji, nr. 18, Prishtinë, 2011.
- *Mbi veprimtarinë gjuhësore të profesor Besim Bokshit* (në 80-vjetorin e lindjes) Studime nr. 18 (Organ i ASHAK), Prishtinë, 2012.
- *Mbi Gramatikën historike të shqipes të autorit akademik Koleç Topalli* në Studime (revistë e ASHAK), Prishtinë, 2012.
- *Në dhjetëvjetorin e Jetës Arbëreshe*, në Jeta Arbëreshe, nr. 72, Eianina (Itali), 2012.
- *Infinitivi në shqipen dhe në serbishten*, në Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, Prishtinë, 2012.

- *Si shkruanin autorët italo-arbëreshë para Kongresit të Manastirit, në Studime për nder të Rexhep Ismajlit, Prishtinë, 2012.*
- *Kolë Kamsi mbi italo-arbëreshët dhe gjuhën e tyre, në përmbledhje punimesh të Konferencës ndërkombëtare: Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare, Shkodër, 2013.*
- *Studimet e Bojka Sokolovës mbi të folmet e shqiptarëve të Mandricës, në Seminari XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 2013.*
- *Qëndresa shumëshekullore italo-arbëreshe, në Jeta Arbëreshe, nr. 73, Eianina (Itali), 2013.*
- *Gramatika e de Radës e publikuar me autorësinë e Zef de Radës, Jeta Arbëreshe, nr. 78, Eianina (itali), 2014.*
- *Çfarë alfabetesh përdoren autorët italo-arbëresh para Kongresit të Manastirit, Letërsia dhe kultura arbëreshe – Jeronim de Rada në 200-vjetorin e lindjes, Elbasan, 2015.*
- *Studiues i shquar i dijes abërore, Jeta Arbëreshe, nr. 79, Eianina (Itali), 2015.*
- *Kontributi i Emanuil Xhordanit në leksikografinë arbëreshe, Jeta Arbëreshe, nr. 79, Eianina (Itali), 2015.*
- *Paskajorja geqe e tipit me+pjesore, në SNGJLKSH, Prishtinë, 2015.*
- *Sistemi vokalik i së folmes së Kazallveqit, Jeta Arbëreshe, nr. 80, Eianina (Itali), 2015.*
- *Janet Byron mbi bazën dialektore të shqipes standarde dhe qëndrimi zyrtar ndaj dialekteve, në Studimet albanistike në Amerikë (Konferencë shkencore e mbajtur 25-26 shtator 2015 nga ASHAK), Prishtinë, 2016.*
- *Distribucioni i fonemave në të Folmen arbëreshe të Kazallveqit, Jeta Arbëreshe, nr. 81, Eianinë, 2016.*
- *Sistemi vokalik i të folmes arbëreshe së Kazallveqit, në Jeta Arbëreshe, nr. 80, Eianinë (Itali), 2016*
- *Distribucioni i fonemave konsonantike në të Folmen arbëreshe të Kazallveqit, Jeta Arbëreshe, nr. 81, Eianinë, 2016.*
- *Denduria e përdorimit të emrave asnjans në të folmet italo-arbëreshe, në Jeta Arbëreshe, nr. 82, Eianinë (Itali), 2016.*
- *Vrojtime gjuhësore, Prishtinë, 2017.*
- *Disa dukuri fonetike në arbërishten e Kazallveqit, në Jeta*

- Arbëreshe, nr. 83, Eianina (Itali), 2017.
- *E folmja arbëreshe e Kazallveqit (La parlata albanese di Casalvecchio di Puglia)*, Prishtinë, 2017.
  - *Ndihmesat e Martin Camajt në studimin e të folmeve italo-arbëreshe*, në Jeta Arbëreshe, nr. 84, Eianina (Itali), 2018.
  - *Kontributi i Claus Haebler-it mbi të folmet arbërore të Greqisë*, Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht (ASHAK), Prishtinë, 2018.
  - *Rreth kuantitetit të vokaleve në “Mesharin” e Gjon Buzukut*, në “Studime”, ASHAK, Prishtinë, 2019.
  - *Koha e ardhme (futuri) në italo-arbërishten*, në Jeta Arbëreshe, nr. 88, Eianina (Itali), 2019.
  - *Kontributi shkencor i Martin Camajt në studimin e të folmeve arbëreshe në Itali*, në Gjurmime albanologjike Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, 2019.
  - *Vështrim mbi format foljore të kohës së ardhme (futuri)*, në Studime, nr. 26, (ASHAK), Prishtinë, 2020.
  - *Variante alfabetesh te italo-arbëreshët para Kongresit të Manastirit*, JA, nr. 89, Eianina (Itali), 2020.
  - *Emanuil Xhordani, personalitet poliedrik*, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, në Jeta Arbëreshe, nr. 90, Eianina (Itali), 2020.
  - *Sistemi konsonantik në italo-arbërishten e Qeftit*, Studime, nr. 27 (ASHAK), Prishtinë, 2020.
  - *Qëndresa shumëshekullore e italo-arbëreshëve*, në Continuum, nr. 2 (Revistë e studimeve italo-arbëreshe), Tiranë, 2021.

Me profesorin e studiuesin e mirënjohur Badallaj jam njohur që nga viti 1988, atëherë kur punoja asistent i ri, ndërsa prof. Imriu me ftesën e Departamentit u angazhua për të mbajtur ligjëratat në lëndën e Dialektologjisë së gjuhës shqipe në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit. Me shumë dëshirë e prisja profesorin të vinte një herë në javë për të ligjëruar dhe e shoqëroja gjatë gjithë kohës. Me kureshtje e interesim të jashtëzakonshëm, unë, asistenti i tij, i ndoqa të gjitha ligjëratat e profesorit, duke qenë i pranishëm në sallën e mësimit së bashku me studentët. Edhe gjatë shoqërimit tonë



jashtë amfiteatrit, përpiqesha të përfitoja nga përvoja pedagogjike, hulumtuese e shkencore e prof. Imriut.

Miqësia jonë vazhdoi dhe u forcua edhe kur u regjistrova dhe i mbarova studimet pasuniversitare (dyvjeçare) në Degën e Gjuhës Shqipe në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Edhe në Prishtinë takoheshim shpesh, në fakultet e diku tjetër në qytet. Nën udhëheqjen shkencore të tij si dhe me përkrahjen e pakursyer, magjistrova në temën “Gjuha shqipe në fjalorët e Gjorgji Pulevskit” më vitin 1992.

Edhe pas magjistrimit tim, ne takohemi e komunikojmë shpesh. Shpeshherë takohemi në konferenca shkencore albanologjike që mbahen në Maqedoninë e Veriut, në Kosovë e në Shqipëri.

Veprimtaria pedagogjike e shkencore e prof. Imriut është e pasur. Ai për tani më 60 vjet ka dhënë e po jep ndihmesë të madhe në arsimin universitar, si në studimet e ciklit të parë, ashtu edhe në ciklin e dytë e të tretë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut e përtej këtyre kufijve. Edhe në punën organizative është mjaft bashkëpunues e menaxhues i shkëlqyer. Këtë e ka dëshmuar në tetë mandate në detyrën e shefit të Degës së Gjuhës Shqipe të Fakultetit të Filologjisë të Prishtinës, drejtor i Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare (2006), anëtar i Këshillit për Emërime të Larta të Kosovës (tri vjet 2004-2006), anëtar i Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe (AShAK-AShSh) që nga viti 2009 e ende, anëtar i Këshillit Organizativ të shumë konferencave albanologjike etj.

Puna shkencore e prof. Imriut është shumëplanëshe. Ndhimesë të madhe ka dhënë e po jep në disa fusha të albanologjisë. Disa nga artikujt e këtij gjuhëtari i gjejmë në përmbledhjen e punimeve “Vrojtime gjuhësore”, Prishtinë, 2017. Veprimtaria hulumtuese e tij shtrihet në: Dialektologji, Në studimin e gjuhës, kulturës dhe traditën së shkrimit të Arbëreshëve të Italisë, në kulturën e gjuhës e çështje të shqipes standarde, në historinë e albanologjisë, në studime krahasimtare të shqipes me gjuhët e tjera si dhe në disa fusha të tjera. Vlen të paraqesim disa nga titujt e studimeve të prof. Imriut:

#### a) Në dialektologji

Përgatitjen e shkëlqyer profesionale që ka Badallaj si pedagog shumëvjeçar i lëndës së Dialektologjisë shqiptare në universitetin e Prishtinës, të Tetovës, të Shkupit, të Shkodrës e shfaq edhe në studimet shkencore, sidomos në analizën e të folmeve të gegërishtes verilindore.



Monografi e punime me vlerë në këtë fushë janë: *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit, Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë, Veçoritë e zanoreve hundore dhe vlera e tyre fonologjike, Reflektimi i nazalizimit në toponime dhe mikrotoponime të lokalitetit të Zhurit, Edhe diçka rreth nazalizimit në gjuhën shqipe, Disa fenomene fonetike në të folmen e Hasit, Vendi dhe karakteri i theksit në të folmen e Hasit, Sistemi konsonantik i së folmes së Hasit, Realizime dialektologjike në sferën e shqipes, Probleme të objektit dhe të metodës së studimeve në sferën e dialektologjisë, Sistemi i zanoreve në të folmen e Hasit, Vështrim mbi sistemin foljor të së folmes së Hasit, Karakteri i nazalizimit në gjuhën shqipe, Rreth paskajores në gjuhën shqipe, E folmja e Hasit (monografi, 302 faqe); *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, Paskajorja geqe e tipit me+pjesore, Janet Byron mbi bazën dialektore të shqipes standarde dhe qëndrimi zyrtar ndaj dialekteve e punime të tjera.**

**b) Në studimin e gjuhës, kulturës dhe traditën së shkrimit të Arbëreshëve të Italisë:**

*E ardhmja e minoritetit arbëresh, Carlo Tagliavini, gjuhëtar me përmasa të mëdha, E ardhmja e minoritetit arbëresh, Variante alfabetesh te italo-arbëreshët para Kongresit të Manastirit, Sistemi konsonantik në italo-arbërishten e Qeftit, Kontributi i Emanuil Xhordanit në leksikografinë arbëreshe, Si është ruajtur italo-arbërishtja, La figura di Scanderbeg nella rivista "Ekskluzive", Arbëreshët e Italisë dhe ruajtja e gjuhës së tyre, Chieuti e la sua parlata arbëreshe (në bashkautorësi, monografi 598 faqe), Distribucioni i fonemave në të Folmen arbëreshe të Kazallveqit, Sistemi vokalik i të folmes arbëreshe së Kazallveqit, Distribucioni i fonemave konsonantike në të folmen arbëreshe të Kazallveqit, Denduria e përdorimit të emrave asnjans në të folmet italo-arbëreshe, Disa dukuri fonetike në arbërishten e Kazallveqit, E folmja arbëreshe e Kazallveqit (La parlata albanese di Casavecchio di Puglia), Qëndresa shumëshekullore italo-arbëreshe, Gramatika e de Radës e publikuar me autorësinë e Zef de Radës, Çfarë alfabetesh përdoren autorët italo-arbëresh para Kongresit të Manastirit, Studiues i shquar i dijes abërore, Kontributi i Emanuil Xhordanit në leksikografinë arbëreshe, Edhe një Fjalor i italo-arbërishtes etj.*

**c) Në kulturën e gjuhës e çështje të shqipes standarde:**

*Kapërcimi i disa veçorive dialektore në shkollën tonë, Shqipja standarde dhe dialektet e saj, Risi në programet e shqipes në Kosovë, Rreth programeve të gjuhës shqipe në Kosovë, Pse çalon realizimi i shqipes standarde, Vështrim mbi format foljore të kohës së ardhme (futuri), Vështrim mbi tipat e formave foljore me vlerën e së ardhmes, Sa dhe si realizohet shqipja standarde në shkollë dhe në universitet etj.*

**ç) Në historinë e albanologjisë:**

*Emanuil Xhordani, personalitet poliedrik; Maxmilian Lambertz per gli Arbëreshë, Rreth kuantitetit të vokaleve në “Mesharin” e Gjon Buzukut, Maksimilian Lamberci - albanolog i shquar, Disa pikëpamje të Eqrem Çabejt rreth kuantitetit të vokaleve të shqipes, Norbert Jokli (1877-19942) - albanolog i shquar austriak, Variantet e alfabetëve të Jeronim de Radës, Rreth konceptit të Eqrem Çabejt mbi kuantitetin dhe vlerën fonologjike të vokaleve të shqipes, Revista “Jeta Arbëreshe” dhe rëndësia e saj në ruajtjen e italo-arbërishtes, Rreth fjalorëve të Gjorgje Pulevskit; Shqip, shqiptar, Shqipëri; Meshari i Gjon Buzukut, Rreth pikëpamjeve të Idriz Ajetit mbi fonetikën historike të shqipes, Koncepti i Eqrem Çabejt mbi kuantitetin e vokaleve të shqipes, Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së prof. Eqrem Çabejt, Dy fjalorët e Gjorgje Pulevskit, Mbi veprimtarinë gjuhësore të profesor Besim Bokshit (në 80-vjetorin e lindjes), Mbi Gramatikën historike të shqipes të autorit akademik Koleç Topalli, Vrojtimit e Selman Rizës mbi fonetikën e shqipes e punime të tjera të vyeshme.*

**d) Në studime krahasimtare të shqipes me gjuhët e tjera:**

*Ndërndikimet e shqipes me gjuhët sllave jugore, Format e kohës së ardhme të shqipes krahasuar me ato të serbishtes, Infinitivi në shqipen dhe në serbishte*

## PROF. DR. ASLLAN HAMITI



Asllan Hamiti (1960) është profesor universiteti, studiues i shqipes, hartues tekstesh mësimore. Ligjërues në Katedrën e Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Shkup, disa vjet bashkëpunëtor i jashtëm në Fakultetin Pedagogjik, Universitetin për Menaxhment dhe Teknologji Informatike, Universitetin e Punëtorëve në Shkup, në studimet e masterit në Universitetin e Tetovës, në Universitetin “Ukshin Hoti” të Prizrenit si dhe në Kolegjin Evropian “Juridika” në Prishtinë.

Deri më tani ka marrë pjesë në shumë konferenca albanologjike e në disa projekte kërkimore-shkencore dhe ka botuar mbi 150 artikuj.

Është laureat i çmimit shtetëror “Goce Dellçev” i dhënë si mirënjohje shoqërore për arritje të vazhdueshme në fushën e shkencës, që kanë vlerë të madhe për afirmimin e saj brenda shtetit dhe në përmasa ndërkombëtare për vitin 2014. Më vitin 2016 fitoi çmimin “13 Nëntori”, Dita e çlirimit të Shkupit, për ndihmesë të veçantë shumëvjeçare në fushën e shkencës e të arsimit, që kontribuojnë për afirmimin e qytetit të Shkupit e më gjerë.

**Libra të botuar** (monografi, studime, tekste universitare e parauniversitare):

1. *Gramatika e gjuhës shqipe për klasën III*, Prosvetno Dello, Shkup; 1992, 1994, 1996, 1998; 80 faqe.
2. *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005, 220 faqe (ISBN 9989-665-51-6; COBISS.MK-ID 61923594).
3. *Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin IV të gjimnazit të reformuar* (në bashkautorësi me Zeqirja Nezirin e Agim Lekën), Prosvetno Dello

- ShA, Shkup, 2005, 336 faqe (ISBN 9989-0-0437-4; COBISS.MK-ID 60157194).
4. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe*, Interdiskont, Shkup, 2005, 305 faqe (ISBN 9989 815-42-9); botimi II: Selektor, Shkup, 2011, 339 faqe (ISBN 978-608-4660-01-9; COBISS.MK-ID 89853450); botimi III i ndryshuar: Alma, Shkup, 2020, 288 faqe (ISBN 978-608-66268-2-2; COBISS.MK-ID 52247301).
  5. *Gjuhë shqipe për klasën V* (lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të shkollave fillore të Maqedonisë, në bashkautorësi me Ismail Hamitin), Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2006, botimi II, 2008, 122 faqe.
  6. *Gjuhë shqipe për klasën VI* (lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të shkollave fillore të Maqedonisë, në bashkautorësi me Ismail Hamitin), Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2006, botimi II, 2009, 132 faqe.
  7. *Gjuhë shqipe për klasën VII* (lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të shkollave fillore të Maqedonisë, në bashkautorësi me Ismail Hamitin), Prosvetno Dello ShA, Shkup, 2006, 2012; 182 faqe.
  8. *Фонетика и фонологија на албанскиот јазик*, Менора, Скопје, 2008, 312 faqe (ISBN 978-608-200-002-2); botimi II: Универзитет „Св. Кирил и Методиј“, Филолошки факултет „Блаже Конески“, Скопје, 2011, 314 faqe (ISBN 978-9989-43-348-1; COBISS.MK-ID 90526730).
  9. *Kultura e gjuhës për të gjithë*, Sak-stil, Shkup, 2018, 286 faqe (ISBN 978-608- 66268-0-8; COBISS.MK-ID 108659210).
  10. *Gjuhë shqipe për klasën VI* (të arsimit fillor nëntëvjeçar për nxënësit shqiptarë, në bashkautorësi me Ismail Hamitin), Shkup, 2011, 150 faqe.
  11. *Gjuhë shqipe për klasën VI* (lëndë me zgjedhje për nxënësit joshqiptarë të shkollave fillore të Maqedonisë, në bashkautorësi me Ismail Hamitin), Shkup, 2011, 132 faqe.
  12. *Dialektologjia e gjuhës shqipe* (në bashkautorësi me Ajten Qamilin), Unioni i Intelektualëve Shqiptarë në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2014, 322 faqe (ISBN 978-608-4557-03-6; COBISS.MK-ID 97288714).

13. *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit*, Logos-A, Shkup, 2014, 500 faqe (ISBN 978-9989-58-546-3; COBISS.MK-ID 97233162). Botimi II i shkurtuar: *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit, Dialektologji shqiptare - Të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut 1*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2020.
14. *Gjuhë shqipe për klasën VI të arsimit fillor nëntëvjeçar* (në bashkautorësi me Ismail Hamitin), botim i ndryshuar, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shkup, 2020, 198 faqe (ISBN 978-608-226-839-2; COBISS.MK-ID 51644165).
15. *Shtjellime gjuhësore*, Grafoden, Shkup, 2020, 282 faqe (ISBN 978-608-66268-1-5; COBISS.MK-ID 52189701).
16. *Ndihmesa e disa gjuhëtarëve për shqipen*, Stobi Trejd, Shkup, 2021.

